REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Vëllimi I

janar - qershor 2016

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Published by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Z. Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Kontribuesit:

Dr. Karl Weber , Menaxher i projektit, GIZ
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ
Z. Selim Selimi, Ekspert Ligjor
Novus Consulting

© 2016 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

janar – qershor 2016

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me "Projekti për Reformë Juridike dhe Administrative" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Tabela e Përmbajtjes:

1. Parathënie:..... 10
2. KI63/15, Parashtrues i kërkesës: Bedri Haxhi Halili nga Vushtrria, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit 508/15 të Komisionit Disiplinor të Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë, të 4 majit 2015 .. 11
3. KI135/14, Parashtrues IKK Classic, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014, të 8 prillit 2014 16
4. Rasti KI135/14 Mendim mospajtues 17
5. KI111/15, Parashtrues Musa Shkodra, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit te Gjykatës Supreme, E. Rev. 64/2014, të 18 marsit 2015 34
6. KI101/15, Parashtruesi i kërkesës: Rujdi Kasemlari, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0211-A0001, të 19 marsit 2015 41
7. KI98/15, Parashtrues i kërkesës: Shpendim Bokshi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ac. nr. 4223/2014, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 25 marsit 2015 48
8. KI91/15, Parashtrues Kadri Sherifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP. nr. 320/2011, të 18 janarit 2012 ... 56
9. KI43/15, Parashtruesi i kërkesës: „ECO-HIGJIENA sh.p.k.“ nga Gjilani, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C. nr. 381/2014, të 3 dhjetorit 2014. 62
10. KI100/15, Parashtruesit e kërkesës: Nurten Luboteni, Gazmend Luboteni, Suna Buqinca, Lulieta Hoxha, Mytaher Luboteni, Valbon Luboteni, Veton Luboteni, Diellza Luboteni, Rona Luboteni, Edi Luboteni dhe Bashkim Spahiju, të cilët kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0314, të 23 dhjetorit 2014. 69
11. KI132/15, Parashtrues Manastiri i Deçanit, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit 74
12. KI41/15, Parashtrues i kërkesës: Xheladin Berisha, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 27/2015, të 12 shkurtit 2015 . 79
13. KI125/15, Parashtrues Safet Elshani dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ-UZVP nr. 19/2015, të 28 majit 2015 85
14. KI70/15, Parashtrues Nada Zvezdic, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, C-III-12-1681, të 4 nëntorit 2013 94
15. KI126/15, Parashtrues i kërkesës: Hajzer Aliu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 106/2015, të 6 majit 2015 101

16. KI55/15, Parashtrues Elife Murseli, Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri KI159/14, të 14 prillit 2015, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 108
17. KI135/15, Parashtrues Boban Marinković, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015 114
18. KI129/15 Parashtrues Rrahim Ramadani, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 6/2014, të 24 shkurtit 2015..... 120
19. KI143/15, Parashtruesja e kërkesës: Donika Kadaj-Bujupi, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PNl. nr. 2059/2015, të 23 nëntorit 2015 125
20. KI106/15, Parashtrues Predrag Stojčetovič, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Apelit i AKP-së, GSK-KPA-A-035/14, të 13 majit 2015.....133
21. KI92/15, Parashtrues Naim Sejdiaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4891/2014, i 27 shkurtit 2015..... 140
22. KI82/14, Parashtrues Gani Lahu, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2013, të 18 dhjetorit 2013 146
23. KI60/15, Parashtrues Avni Grajqevci, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 54/2015.....156
24. KI109/15, Parashtrues Milazim Nrecaj, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të Qeverisë së Kosovës, nr. 171, të 9 qershorit 2011. 164
25. KI108/15, Parashtrues i kërkesës: Sylejman Meta, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1328/2015, të 27 prillit 2015. 170
26. KI102/15 dhe KI115/15, Parashtruesit e kërkesës: Ilmi Gashi dhe Naser Raçi, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 76/2015, të 2 prillit 2015, dhe Rev. nr. 89/2015, të 15 prillit 2015 178
27. KI97/15, Parashtrues Veli Kuçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2015, të 5 majit 2015..... 186
28. KI54/15, Parashtruesja e kërkesës: Melihate Nura nga Prishtina, e cila kërkon vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. nr. 31/2014, të 14 janarit 2015. 193
29. KI120/15, Parashtrues Refki Bytyqi, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-14-0220-A001-A0013, të Kolegjit të Apelit të dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 21 majit 2015 200
30. KI89/15, Parashtrues Fatmir Koci, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 473/2014 207
31. KI74/15, Parashtrues Ekrem Jakupi, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 300/2014.....216
32. KO47/16, Parashtruesit e kërkesës: Aida Dërguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i

kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës..... 224
33. KI15/16, Parashtrues i kërkesës: Ramadan Muja, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PA-II-KZ-II-7/15, të 26 nëntorit 2015 240
34. KI116/15, Parashtruesja e kërkesës: Arbenita Ahmeti, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 151/2015, të 19 majit 2015 .248
35. KI45/15, Parashtruesja e kërkesës: Elizabeta Arifi-Deliu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, të 30 shtatorit 2014..... 255
36. KI147/15, Parashtrues SH.P.K. "SYRI", Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015..... 264
37. KI110/15, Parashtruesja e kërkesës: Bedrije Rrahmani nga Prishtina, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, të 31 majit 2007..... 269
38. KI87/15, Parashtruesja e kërkesës: Bahrije Galica, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 277/2014, të 20 nëntorit 2014 276
39. KI72/15, Parashtruesi i kërkesës: Selim Hasani, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 51/2015, të 2 prillit 2014..... 282
40. KI09/16 Parashtrues Behgjet Pacolli, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së moszbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, të 7 prillit 2011..... 290
41. KI148/15, Parashtrues i kërkesës: Xhafer Selmani, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001-C1265, të 11 dhjetorit 2015 298
42. KI59/15, Parashtruesi i kërkesës: Ljutfi Kačka, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Degës në Dragash, P. nr. 78/12, të 25 qershorit 2013..... 304
43. KI 17/16, Parashtrues i kërkesës, Holding Company Inex Interexport a.d. - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit final të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 10/50, të 23 shtatorit 2015, dhe Vendimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 06/195, të 3 shtatorit 2014 311
44. KI40/15, Parashtrues i kërkesës, Fatlume Meta - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, P. nr. 35/10, të 4 prillit 2011.....319
45. KI163/15, Parashtruese Božidarka Banović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3575/13, të 19 tetorit 2015 326
46. KI134/15, Parashtrues Ibrahim Alabaki, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit GSK-KPA-A-229/2013, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 29 shtatorit 2015..... 333
47. KI119/15, Parashtruesja e kërkesës: Borka Stevanović nga Beogradi, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë - Dega në Istog, P. nr. 47/015, të 21 korrikut 2015 340
48. KI30/15, Parashtruesit e kërkesës: Isa Nuza, Naxharije Polloshka, Naxhije Lleshi-Nuza, të cilët kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-II-12-0047,

të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 11 dhjetorit 2014..... 347
49. KI95/15, Parashtruesi i kërkesës: Xhevat Berbati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4312/2014, të 27 shkurtit 2015..... 355
50. KI27/15, Parashtrues Naser Peci, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015 ... 362
51. KI131/15, Parashtrues Selvinaz Top dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr 60/2015, i 25 majit 2015..... 370
52. KI114/15, Parashtrues Feride Aliu – Shala, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 95/2015, të 12 majit 2015 ... 378
53. KI62/15, Parashtrues Xhavit Shala, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4332/2012, të 26 nëntorit 2014 389
54. KI48/14 dhe KI49/14, Parashtrues Komuna e Vushtrrisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri: (1) CP. nr. 46/14, të 6 marsit 2014, (2) CP. nr. 49/14, të 6 marsit 2014, (3) CP. nr. 53/14, të 6 marsit 2014, (4) CP. nr. 52/14, të 11 marsit 2014, (5) CP. nr. 54/14, të 11 marsit 2014 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014..... 395
55. KI93/15, Parashtruesi i kërkesës: Ahmet Tërnava, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 12/2015, të 4 shkurtit 2015. 406
56. KI132/15, Parashtrues Manastiri i Deçanit - Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit 414
57. KI124/15, Parashtrues Arif Kryeziu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërfshirjes në procesin e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" 432
58. KI112/15, Parashtruesit e kërkesës: Feride, Nezaqete, Smajl, Veton, Mirvete, Agim dhe Merita Bulliqi, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 1/2015, të 10 prillit 2015. 438
59. KI76/15, Parashtruesja e kërkesës: Dušanka Mitić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0114-A0001, të 11 dhjetorit 2014..... 446
60. KI43/16, Parashtrues Mehdi Kryeziu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015..... 453
61. KI03/16, Parashtruesja e kërkesës: Remzie Duga, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 226/2015, të 14 shtatorit 2015 463
62. KI118/15, Parashtrues Dragiša Stojković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-129/13, të 3 qershorit 2015 472
63. KI67/15 dhe KI68/15, Parashtrues Mykereme Hoxha dhe Mërgim Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2012, të 7 nëntorit 2014 479

64. KI163/14, Parashtrues Enis Beqiri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 181/2014, të 8 korrikut 2014 488
65. KI01/15, Parashtruesi i kërkesës: Fahredin Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. Pml. Kzz 157/2014, të 2 tetorit 2014. 498
66. KI159/15 Parashtrues Sabri Ferati, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 499/2015, të 29 shtatorit 2015 508
67. KI145/15, Parashtrues Florent Muçaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nr. 321/2015, të 5 nëntorit 2015 516
68. KI23/15, Parashtrues: Miladin Anđelković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN nr. 550/2014, të 31 tetorit 2014 . 524
69. KI10/16, Parashtrues Sanija Bajrami, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2014, të 16 dhjetorit 2014 531
70. KI128/15, Parashtrues Adem Hoti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014 .. 539
71. KI04/16, Parashtrues: "ALDEKO", Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ·UZVP. nr. 10/2015, të 30 korrikut 2015 544
72. KI88/15, Parashtrues Božidar Dimić, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0018 552
73. KI38/16, Parashtrues i kërkesës: Nezir Kryeziu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 148/2015, të 9 nëntorit 2015. 560
74. KI155/15 dhe KI157/15, Parashtruese të kërkesës: Snežana Zdravković dhe Miloratka Nikolić, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015..... 570
75. INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE.....577
76. INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS 589
77. SHKELJE TË NENIT 24, 31, 32, 46, 54 TË KUSHTETUTËS..... 592

Parathënie:

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës, të shkruaj këtë parathënie për Buletinin e 6-të të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Buletini është bërë pikë referimi i dobishëm dhe i cituar shpesh nga ata që punojnë në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut. Edhe këtë herë jemi përkushtuar të tregojmë disa nga rezultatet kryesore të punës sonë të palodhshme.

Ky edicion i Buletinit përmban një numër të rasteve më të veçuara dhe më të rëndësishme, duke përfshirë kërkesën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë, si për përmbajtjen ashtu edhe për procedurën e ndjekur nga Kuvendi i Kosovës me rastin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës. Deputetët parashtrues kërkuan nga Gjykata që të vlerësojë nëse është shkelur neni 86 [Zgjedhja e Presidentit], paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata po ashtu ka nxjerrë dhe dy vendime të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me kërkesat individuale. Nga pikëpamja e gjyqësisë kushtetuese, janë trajtuar çështje të vlefshmërisë juridike të vendimeve të formës së prerë, të mjeteve efektive juridike dhe të së drejtës për vendim të arsyetuar si komponentë e së drejtës së përgjithshme për një proces të rregullt gjyqësor.

Vlen të theksohet e të përsëritet se sa është e rëndësishme që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke përdorur këtë Buletin, si dhe buletinet e mëparshëm, të konsultojnë me vëmendje vendimet e Gjykatës në rastet e ngjashme dhe të marrin parasysh nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi në dritën e rasteve të ngjashme. Duhet kuptuar qartë që, parimisht, e drejta e ankesës nuk mund t'i mohohet asnjë parashtruesi, por do të ishte e dobishme që ata paraprakisht të njoftoheshin me jurisprudencën e Gjykatës dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e kërkesës së tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës në Buletin është t'i tregohet opinionit të gjerë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese.

Këtë vit publikimi i këtij buletini është bërë nga Gjykata, derisa Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) ka vazhduar me asistencë rreth përgatitjeve për botimin e Buletinit, për çka Gjykata i është mirënjohëse.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për gjithë stafin e Gjykatës, me punën dhe me përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi edhe i këtij edicioni të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KI63/15, Parashtrues i kërkesës: Bedri Haxhi Halili nga Vushtrria, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit 508/15 të Komisionit Disiplinor të Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë, të 4 majit 2015

KI63/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2015, i publikuar më 28 janar 2016. *Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Komisionit Disiplinor të Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame, e papranueshme, ratione materiae.* Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në një datë të paspecifikuar pranë Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë është iniciuar procedura disiplinore kundër parashtruesit. Kjo procedurë ka përfunduar me Aktvendimin [508/15] të Komisionit disiplinor, të 4 majit 2015, ku është vendosur që paga e parashtruesit të kërkesës të zvogëlohet për një periudhë të caktuar.

Parashtruesi nga Gjykata kërkon që në vendimet e lartpërmendura të Komisionit Disiplinor të gjejë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Gjykata përcakton se për të qenë një kërkesë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë. Duke pasur parasysh se kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me vendimin e Komisionit Disiplinor të Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë, del se kjo kërkesë nuk është në pajtim me *ratione materiae* të Kushtetutës, pasi që organizimi i brendshëm i bashkësive fetare nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit nuk është "*ratione materiae*" në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI63/15
Parashtrues
Bedri Haxhi Halili
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit 508/15 të Komisionit Disiplinor të Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë, të 4 majit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bedri Haxhi Halili nga Vushtrria (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin 508/15 të Komisionit Disiplinor të Këshillit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë: Komisioni Disiplinor), të4 majit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk i përmend konkretisht nenet e Kushtetutës të cilat janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 maj 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI63/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI63/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 28 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 18 dhjetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të paspecifikuar pranë Komisionit Komunal të Bashkësisë Islame të Komunës së Vushtrrisë është iniciuar procedura disiplinore kundër parashtruesit.

10. Kjo procedurë ka përfunduar me Aktvendimin [508/15] të Komisionit Disiplinor, të 4 majit 2015, ku është vendosur që paga e parashtruesit të kërkesës t'i reduktohet për 20% gjatë 9 (nëntë) muajve të ardhshëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi nga Gjykata kërkon që në vendimet e lartpërmendura të Komisionit Disiplinor të gjejë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Dispozitat përkatëse ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 02/31
Për Lirinë fetare në Kosovë

Neni 5
Neutraliteti fetar

[...]
5.2. Bashkësitë fetare janë të ndara nga autoritetet publike,
[...].

Neni 7
Vetë - përcaktimi dhe vetë - rregullimi

[...]
7.2. Bashkësitë Fetare e rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur organizimin e tyre të brendshëm.
[...].

Pranueshmëria e kërkesës

12. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

14. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 39.2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 39 [Konfesionet Fetare]

"2. Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare".

15. Sa i përket kërkesës konkrete të parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 paragrafi (3) pika (a) dhe (e) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

(a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;

[...]

(e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën".

16. Gjykata ka për detyrë të shqyrtojë nëse ka juridiksion *ratione materiae* në çdo fazë të procedimit. Pajtueshmëria *ratione materiae* e ndonjë kërkese me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse e Kushtetutës në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës buron nga juridiksioni thelbësor i Gjykatës. Për të qenë një kërkesë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë.

17. Duke pasur parasysh se kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me vendimin e Komisionit Disiplinor të Bashkësisë Islame të Komisionit Komunal të Komunës se Vushtrrisë, del se kjo kërkesë nuk është në pajtim me *ratione materiae* të Gjykatës Kushtetuese, pasi që organizimi i brendshëm i bashkësive fetare nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit nuk është "*ratione materiae*" në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenet 39.2 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe me rregullin 36 (3) (a) dhe (e) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI135/14, Parashtrues IKK Classic, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014, të 8 prillit 2014

KI135/14, Aktgjykim i miratuar më 10 nëntor 2015 dhe publikuar më 9 shkurt 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë civile, të drejtat e palëve të treta, subrogimi, vendim i paarsyetuar, cenim i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte rrëzuar vendimet e mëhershme të gjykatave të instancës më të ulët dhe kështu i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën në subrogim të mjeteve që ai i kishte shpenzuar për mjekimin e të siguruarit të tij.

Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese kryesisht për shkelje të së drejtës në pronë dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese në pajtim me mandatin e saj kërkesën e parashtruesit e vlerësoi vetëm për sa i përket respektimit të procedurës kushtetuese. Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse nuk kishte dhënë shpjegim të mjaftueshëm për faktet vendimtare të rastit të shqyrtuar. Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi se me këtë rast ishte shkelur e drejta në pronë e parashtruesit, por vetëm u kufizua në vlerësimin e procesit të rregullt gjyqësor.

Rasti KI135/14 Mendim mospajtues

Parashtrues
IKK Classic
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. Nr. 21/2014, të 8 prillit 2014

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Me respekt shpreh mospajtimin tim me Aktgjykimin dhe me konkluzionet e shumicës në lidhje me këtë kërkesë.

Shumica vendosi se Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e saj, E. Rev. Nr. 21/2014, të 8 prillit 2014, ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe me nenin 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), duke konkluduar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk është arsyetuar lidhur me atë se pse, në pikëpamje të ligjit, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit për kompensim nga Kompania e Sigurimit Sigma të shumës që parashtruesi i kërkesës i ka paguar të siguruarit të tij (në tekstin e mëtejmë: D. H.), sipas kontratës për sigurim që e ka pasur me D. H. Shumica konkludon se Gjykata Supreme nuk dha një përgjigje adekuate në mbështetje të vendimit të saj, duke i mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën për gjykim të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.

> Neni 31, paragrafi 2, i Kushtetutës, parasheh:
>
> *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*
>
> Neni 6, paragrafi 1, i Konventës, parasheh:
>
> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga*

gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë".

Është e pranuarbotërishtse sipas nenit 31të Kushtetutës dhe të nenit 6të Konventës,kërkohet qënjëgjykatëtë japënjë arsyeose disa arsye përvendimin e saj. Nërastin konkret, Gjykata Supreme e Kosovësdha njëvendimtë arsyetuarduke theksuar:

"... gjykatat e shkallës më të ulët gabimisht kanë pranuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, për faktin se i siguruari i paditësit është zhdëmtuar nga e paditura për dëmin kontestues, sipas marrëveshjes së datës 03.02.2009, në shumën prej 2.729 €. Në këtë marrëveshje, në nenin 3 të saj, i dëmtuari, respektivisht i autorizuari i të dëmtuarit, ka deklaruar lirshëm se me pagesën e shumës së lartpërmendur të gjitha kërkesat për këtë dëm, të tanishëm dhe të ardhshëm, lidhur me rastin që është lëndë e trajtimit me këtë marrëveshje, ndaj Kompanisë së Sigurimeve "Sigma" në Kosovë, drejtuesit dhe pronarit të automjetit i cili ka qenë i siguruar në këtë kompani të sigurimeve, dhe ndaj të gjithë personave tjerë, janë përmbushur plotësisht dhe nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj kësaj kompanie të sigurimeve në lidhje me këtë çështje juridike për kompensimin e dëmit. E paditura në kuptim të nenit 940 të LMD ka qenë në detyrim që të siguruarit të paditësit, dëmin e kërkuar t'ia kompensoj dhe është jokontestuese se pas lidhjes së marrëveshjes së lart përmendur, e paditura dëmin e kërkuar ia ka paguar. Po ashtu, i siguruari i paditësit, në kuptim të nenit 941 të LMD në bazë të fajësisë së të siguruarit të padituërs, direkt nga e paditura ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se revizioni i të padituërs është i bazuar, pasi që për aksidentin e lartpërmendur të trafikut në të cilin është lënduar i siguruari i paditëses Driton Hasanmetaj, e paditura ka kryer obligimin e zhdëmtimit me pagesën e shumës prej 2.729.00 € për të cilën i dëmtuari si u tha më lart, drejtpërdrejtë me të padituërën ka lidhur marrëveshje zhdëmtimi. Nga kjo bazë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se paditësi nuk mund të kërkoj regresimin e borxhit kontestues, edhe pse është jokontestuese se paditësi borxhin kontestues për të cilin kërkon që tani e paditura t'ia paguajë, ia ka paguar të dëmtuarit Driton Hasanmetaj, si të siguruar të saj".

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës, IKK, si një kompani e sigurimit, dorëzoi një kërkesë ligjore kundër Kompanisë së Sigurimeve Sigma për kompensim të shumës prej 18.935,36 €, që ajo ia kishte paguar më parë D.H, të siguruarit të saj, për shpenzimet mjekësore të cilat D. H. pretendohet t'i ketë bërë si pasojë e një aksidenti automobilistik me një person të siguruar nga Sigma, me të cilën është pretenduar se personi i siguruar nga Sigma ishte ligjërisht përgjegjës për aksidentin dhe lëndimet që H. Q. i kishte marrë. Sigma, në emër të të siguruarit të saj, palës tjetër të përfshirë në aksidentin automobilistik, kishte negociuar me D. H. dhe arriti një marrëveshje me të, për t'i paguar atij shumën prej 2.729,00 € si marrëveshje të plotë për të gjitha lëndimet që D. H. kishte marrë si pasojë e aksidentit. Si kusht eksplicit i kësaj marrëveshjeje ishte se D. H. të pajtohej se pagesa e shumës prej 2. 729 € nga Sigma, tërësisht dhe plotësisht përmbushte çdo detyrim ligjor që Sigma ose i siguruari i saj kishin ndaj D. H. si pasojë e aksidentit. Sigma nuk kishte asnjë detyrim kontraktual ose ligjor ndaj kompanisë së sigurimit të parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një kërkesë ligjore kundër Sigma për kompensimin e tërësishëm të shumës që IKK ia kishte paguar D. H, të siguruarit e saj. Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi refuzimin e pretendimit të parashtruesit, duke theksuar se Sigma nuk kishte asnjë detyrim ligjor ndaj parashtruesit të kërkesës dhe se Sigma mund të thirrej ligjërisht në marrëveshjen e saj me D. H. si një ndalesë ligjore që mos të paguante asnjë shumë më të madhe as D. H, dhe as parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme arsyetoi në mënyrë efektive se një vendim tjetër do të rezultonte në mosrepektimin e marrëveshjes së vlefshme ligjore që Sigma kishte negociuar me D. H, ku Sigma hoqi dorë nga e drejta për një gjykim për meritat e kërkesës

kundër të siguruarit të saj, në lidhje me kush ishte përgjegjës për aksidentin dhe në lidhje me natyrën dhe shkallën e lëndimeve të D. H. Kjo nënkupton se poqëse do të ishte arritur ndonjë vendim tjetër, Sigma të ishte përgjegjëse për tërë shumën që parashtruesi i kërkesës ia kishte paguar të siguruarit të saj, dhe Sigma nuk do të mund të kontestonte nëse shumat e paguara nga parashtruesi i kërkesës ndaj të siguruarit të tij, do të ishin shuma të duhura në pikëpamje ligjore. Gjykata Supreme me vendimin e saj, nënkuptonte se kërkesa e parashtruesit mund të bëhej kundër D. H, të siguruarit të tij, e jo kundër Sigma, për kompensimin e shumës prej 2. 729 € që D. H. kishte marrë nga Sigma.

Megjithatë, shumica konkludon sevendimi i GjykatësSupremenukishte iarsyetuarpër shkak seme të nuk janë shpjeguar në mënyrë të pakontestueshme çështjet e mëposhtmeligjore:

1. NësemarrëveshjajashtëgjyqësoreE lidhurmidisSIGMAdhe të siguruaritD. H. ia kishte ndaluar parashtruesit të kërkesëstë drejtën përkompensim;
2. Sikompensimii paguar ngaSIGMAtë siguruaritH. Q.e liroi SIGMA t'ia paguajë kompensimin edhe parashtruesit të kërkesës, si dhe;
3. Simarrëveshjajashtëgjyqësore e lidhurnë mesSIGMA dheD. H.mund tëndikojë në të drejtate parashtruesit të kërkesës, kur është e qartë, separashtruesi i kërkesësnukështëpalë nëkëtëmarrëveshje;
4. Në çfarë mënyre shuma prej 2.729,00 € e paguar të siguruarit D. H. i mbulon shpenzimet mjekësore në vlerë prej 18. 985, 36 € të paguara nga parashtruesi i kërkesës; dhe,

(v) nëse jo nga SIGMA, atëherë, kush duhet në fund të fundit, t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën e paguar nga ai për shpenzimet mjekësore të të siguruarit të tij D. H.

Me një lexim të kujdesshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, do të vërtetohej se Gjykata Supreme e Kosovës:

(1) nuk e ka adresuar në mënyrë të qartë çështjen # 1, por ka nënkuptuar se parashtruesit të kërkesës nuk i është ndaluar e drejta për padi ligjore kundër D. H, të siguruarit të tij;

(2) është përgjigjur qartë në pyetjet # 2 dhe 3 duke arsyetuar se Sigma nuk ka pasur detyrim ligjor ndaj parashtruesit të kërkesës; dhe,

(3) asnjëherë nuk është përgjigjur në pyetjen # 4 sepse kjo nuk i është kërkuar, dhe kurrë nuk është dëshmuar se dikush ka qenë i detyruar ta kompensojë parashtruesin e kërkesës për pagesat vullnetare që ia kishte bërë D. H, të siguruarit të tij.

Përgjigjet nëtë gjitha këto pyetjejanë të natyrësligjore qëkërkojnëinterpretimligjor tëligjit tëKosovës, jotë Kushtetutës. Gjykata Supreme eKosovës,joGjykataKushtetuese, është interpretuesipërfundimtar iligjitnë Kosovë. GjykataSupreme e Kosovësnë këtë rast dha një përgjigjetë hollësishmeligjore përpërfundimet dheaktgjykimine saj. Sineni 31i Kushtetutës, po ashtu,edheneni6 i Konventës, nukkërkojnëmëshumë ngaGjykata Supreme. Edhe pse, arsyetimi juridik iGjykatës Supremenë këtë Aktgjykim mund të vihet në pyetje, nuk ka asnjë dyshimseGjykata Supremeka dhënëarsye përkonkluzionet dhe aktgjykimin e saj në këtë rast. Asneni 31 iKushtetutësdhe asneni 6i Konventës nuk kërkojnë më shumë. Prandaj, nuk ka asnjëdëshmi sejanë shkelur të drejtatkushtetuesetë parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë.

Dorëzoi me respekt,

Robert Carolan
Gjyqtar

AKTGJYKIM

në
Rastin KI135/14
Parashtrues
IKK Classic
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014,
të 8 prillit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimit IKK Classic (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga avokatët z. Besnik Nikqi dhe z. Arianit Nikqi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014, të 8 prillit 2014, i cili i është dorëzuar atij më 2 qershor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 22 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 13 dhe 18 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

9. Më 5 maj 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës kompanisë së sigurimeve "SIGMA".

10. Më 25 maj 2015, kompania e sigurimeve "SIGMA" i dorëzoi dokumentet në Gjykatë.

11. Më 29 qershor 2015, gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit përfundoi më 26 qershor 2015.

12. Më 10 nëntor 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 24 nëntor 2008, i siguruari D. H. i parashtruesit të kërkesës, ka pësuar lëndime të rënda në një aksident trafiku të shkaktuar nga B. L, shfrytëzues i sigurimit në kompaninë e sigurimeve "SIGMA" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: SIGMA).

14. D. H. ka marrë trajtim mjekësor në Republikën Federale të Gjermanisë në shumë prej 18.985,36 €, e cila ishte paguar nga parashtruesi i kërkesës.

15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga SIGMA që të kompensohet në shumën e lartpërmendur.

16. Më 3 shkurt 2009, SIGMA dhe D. H. arritën një marrëveshje jashtëgjyqësore, ku ky i fundit u kompensua nga SIGMA në shumën prej 2,729 €. Bazuar në këtë marrëveshje, SIGMA konsideroi se i kishte përmbushur të gjitha detyrimet e saj në lidhje me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut, të 24 nëntorit 2008, duke përfshirë shumën prej 18.985,36€e paguar nga parashtruesi i kërkesës si kompani e sigurimit të D. H.

17. Parashtruesi i kërkesës dhe SIGMA nuk kanë arritur një marrëveshje sa i përket shumës së paguar nga parashtruesi i kërkesës për trajtimin mjekësor, nga D. H. në Gjermani.

18. Më 10 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër SIGMA në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, duke kërkuar kompensimin e shumës prej 18.985,36 €. Parashtruesi pretendoi se SIGMA është dashur t'i kompensojë shpenzimet mjekësore për trajtimin e D.H, në bazë të Rregullës 3 të
Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë së Palës së Tretë të
Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AQBK). Parashtruesi i kërkesës pretendoi më tej, se ai kishte të drejtë të kërkojë kompensim drejtpërdrejt nga SIGMA, pasi D. H. nuk kishte legjitimitet aktiv për të nënshkruar marrëveshjen jashtëgjyqësore, të 3 shkurtit 2009. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, kjo marrëveshje ka të bëjë vetëm me D. H. dhe jo me parashtruesin e kërkesës, ndërsa kompensimi i kërkuar është bazuar në pagesat e bëra në lidhje me lëndimet dhe pasojat që rrjedhin nga to.

19. Më 5 dhjetor 2011, SIGMA u përgjigj se kishte përmbushur detyrimet e saj (pagesën e dëmit material dhe jo material) ndaj D. H. në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore, të 3

shkurtit 2009, dhe se padia e parashtruesit të kërkesës duhej të refuzohej, si e pabazuar.

20. Më 15 dhjetor 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimin I. C. nr. 334/2011) aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe urdhëroi që SIGMA ta paguajë shumën prej 18.985,36 €, me interes vjetor në shkallën prej 3.5% nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

21. Gjykata Ekonomike e Qarkut, *inter alia*, arsyetoi:

> *"E paditura* [KS SIGMA] *nuk e ka regresuar paditësin* [parashtruesi i kërkesës] *nga arsyet e cekura në seanca me pretekst se të tëra obligimet ndaj paditësit janë përmbushur me marrëveshje (3 shkurt 2009) dhe i dëmtuari D. H. është zhdëmtuar. E paditura nuk i ka prezantuar gjykatës provat se i ka përmbushur obligimet ndaj paditësit dhe se e ka bërë regresimin sipas kërkesës së paditësit për dëmin e paguar nga ana e paditëses, obligim i cili rrjedh nga autopërgjegjësia. Nga provat e administruara është vërtetuar fakti se i dëmtuari është zhdëmtuar dhe shpenzimet iu kanë bartur paditësit. Specifikacion për shërbimet e paguara veç e veç dhe shuma e paguar janë precizuar për të gjitha shpenzimet individuale, të bartura nga ai. Rezulton se ekziston përgjegjësia për dëmin e të siguruarit të së padituës dhe mbulesa siguruese nga baza e autopërgjegjësisë e kontraktuar tek e paditura. Ky dëm nuk është regresuar dhe nuk është bërë zhdëmtim nga e paditura KS SIGMA.*
>
> *Në procedurën e rregullt jashtëgjyqësore, i lënduari D. H. është bërë zhdëmtimi të cilin e ka bërë paditësi duke pasur parasysh se ka pasur të njëjtën policë të sigurimit. Kjo e drejtë është paraparë me Rregullën e BQK-së "Mbi sigurimin e autopërgjegjësisë". Sipas fakteve dhe provave kërkesa për zhdëmtimin e drejtpërdrejtë të të lënduarit dhe të paditësit është parashtruar edhe nga ana e të lënduarit dhe paditësi. Nga ana e së padituës është marrë përgjigja se e paditura të lënduarit D.H. ia ka paguar zhdëmtimin duke konsideruar se i njëjti është trajtuar në tërësi, është zhdëmtuar si për dëmin material ashtu edhe për dëmin jo material sipas aktmarrëveshjes. Nga të cekurat më lart rezulton se e paditura nuk e ka kontestuar faktin se i siguruari i paditëses ka pasur lëndime dhe që deri te aksidenti ka ardhur me fajin e të siguruarit të së padituës KS SIGMA. Nga kjo rezulton se me sigurimin e detyruar të autopërgjegjësisë ofrohet mbulesa siguruese për përgjegjësi lidhur me dëmin e shkaktuar palës së tretë në pasuri dhe persona. Në rastin konkret mbulesa siguruese është rregulluar me BQK Rregulli nr. 3. Së fundi, nga provat e prezantuara rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe i njëjti ka të drejtë regresi, duke i referuar përgjegjësisë dhe kompensimit të dëmit sa i përket zhdëmtimit nga baza e sigurimit të autopërgjegjësisë.*

22. Në një datë të pacaktuar, SIGMA parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

23. Më 11 nëntor 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës refuzoi, si të pabazuar ankesën e SIGMA dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

24. Gjykata e Apelit të Kosovës, *inter alia*, arsyetoi:

> *"Dëmi për paditësin përfaqëson tërë atë që ai është dashur t'ia paguaj të siguruarit të tij sipas dispozitave të vendit të tij, sepse i siguruari i realizon të drejtat nga sigurimi shëndetësor dhe pensional sipas dispozitave të vendit ku ai punon. Kur*

paditësi i ka pësuar dhe i ka paguar këto shpenzime atëherë me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka miratuar kërkesëpadinë për shumën e paguar të shpenzimeve të cilat paditësi i ka dokumentuar me prova dhe, në bazë të nenit 939 të LMD, lartësia e dëmit përcaktohet sipas dispozitave të atij vendi sipas të cilave i siguruari i paditësit ka të drejtë ti realizoj, ndërsa siguruesi [parashtruesi i kërkesës] *gëzon të drejtën e regresit për pagesat e kryera.*

Për arsyet e cekura më lart gjykata parashtrimet e të padituërës nga ankesa që i përkasin mungesës së legjitimitetit aktiv të paditësit i konsideron si të paqëndrueshme. Kjo edhe për faktin se padinë nuk e ka ushtruar i dëmtuari në aksidentin e trafikut të datës 24.11.2008, por IKK Classic e cila i ka paguar në tërësi shpenzimet e trajtimit mjekësor të të dëmtuarit ashtu që nuk mund me asnjë rast të konsideroj se e paditura e ka përmbyllur rastin e zhdëmtimit nga aksidenti i datës 24.11.2008 me pagesën e shumës prej 2.729,00 €".

25. Më 4 mars 2014, SIGMA parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar, *inter alia*, shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. SIGMA më tej pretendoi se neni 2, i Rregullës 3 të BQK-së nuk parasheh të drejtat e kompensimit për kompanitë e huaja të sigurimit, se në bazë të nenit 948 të LMD, kompania e sigurimit nuk mund të kërkojë kompensim kundër palëve të treta, sepse kjo e drejtë i takon të siguruarit. SIGMA konkludoi se ka përmbushur detyrimet e saj me pagesën e dëmit material dhe jo material ndaj të siguruarit D. H. dhe se kompania e huaj e sigurimeve do të ketë të drejtë të kompensimit *vis-à-vis* kompanive të sigurimeve të Kosovës vetëm përmes marrëveshjes dypalëshe midis Republikës së Kosovës dhe shtetit të kompanisë së huaj të sigurimit.

26. Më 8 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi E. Rev. nr. 21/2014) aprovoi kërkesën e SIGMA, për revizion si të bazuar, ndryshoi aktgjykimet e mëparshme dhe hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit që ta detyrojë SIGMA të paguajë në emër të borxhit regresiv shumën prej 18. 985, 36 €.

27. Gjykata Supreme arsyetoi:

"*Gjykatat e shkallës më të ulët gabimisht kanë pranuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit* (parashtruesi i kërkesës)*, për faktin se i siguruari i paditësit është zhdëmtuar nga e paditura për dëmin kontestues, sipas marrëveshjes së datës 03.02.2009, në shumën prej 2.729 €. Në këtë marrëveshje, në nenin 3 të saj, i dëmtuari, respektivisht i autorizuari i të dëmtuarit, ka deklaruar lirshëm se me pagesën e shumës së lartpërmendur të gjitha kërkesat për këtë dëm, të tanishëm dhe të ardhshëm, lidhur me rastin që është lëndë e trajtimit me këtë marrëveshje, ndaj Kompanisë së Sigurimeve "Sigma" në Kosovë, drejtuesit dhe pronarit të automjetit i cili ka qenë i siguruar në këtë kompani të sigurimeve, dhe ndaj të gjithë personave tjerë, janë përmbushur plotësisht dhe nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj kësaj kompanie të sigurimeve në lidhje me këtë çështje juridike për kompensimin e dëmit. E paditura në kuptim të nenit 940 të LMD ka qenë në detyrim që të siguruarit të paditësit, dëmin e kërkuar t'ia kompensoj dhe është jokontestuese se pas lidhjes së marrëveshjes së lart përmendur, e paditura dëmin e kërkuar ia ka paguar. Po ashtu, i siguruari i paditësit, në kuptim të nenit 941 të LMD në bazë të fajësisë së të siguruarit të padituërës, direkt nga e paditura ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se revizioni i të padituërës është i bazuar, pasi që për aksidentin e lartpërmendur të trafikut në të cilin është lënduar i siguruari i paditëses Driton Hasanmetaj, e paditura ka kryer obligimin e zhdëmtimit me pagesën e shumës prej 2.729.00 € për të cilën i dëmtuari si u tha më lart,*

drejtpërdrejtë me të padituren ka lidhur marrëveshje zhdëmtimi. Nga kjo bazë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se paditësi nuk mund të kërkoj regresimin e borxhit kontestues, edhe pse është jo kontestuese se paditësi borxhin kontestues për të cilin kërkon që tani e paditura t'ia paguajë, ia ka paguar të dëmtuarit, si të siguruar të saj".

Ligji

Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë

Neni 2
Shumat e sigurimeve - kufizimi i mbulesës siguruese

Detyrimet e një kompanie të sigurimit që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë janë të limituara me shumën minimale të detyruar të sigurimit, e cila është në fuqi në ditën kur ndodh rasti i siguruar, në qoftë se nuk është përcaktuar ndonjë shumë më e lartë e mbulesës siguruese në kontratë të sigurimit.

Shuma maksimale e sigurimit të detyrueshëm për një rast të siguruar, respektivisht shumat e detyrueshme maksimale të sigurimit, të cilat duhet të kontraktohen në sigurimin e autopërgjegjësisë, janë:

a. Për rastin e vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit;
- për person për autobusë dhe automjete të cilat bartin mallra të rrezikshme 100,000 euro, Shuma totale për autobusë dhe automjete të cilat bartin mallra të rrezikshme 1,000,000 euro - Për person për të gjitha automjetet e tjera 100,000 euro, Shuma e përmbledhur për të gjitha automjetet 300,000 euro

b. Për rastet e dëmit në pasuri;
- Për dëm për autobusë dhe automjete të cilat bartin mallra të rrezikshme 100.000 euro
Shuma totale për autobusët dhe automjetet që bartin mallra të rrezikshme 200,000 euro
- Për dëm për të gjitha automjetet e tjera 50.000 euro
- Shuma e përmbledhur për të gjitha automjetet tjera 100,000 euro

Në rast të aksidentit në të cilin marrin pjesë disa automjete, do të aplikohen shumat e gjithëmbarshme të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë në automjetin motorik të përfshirë në të njëjtin aksident.

Nëse ekzistojnë disa kërkesa për zhdëmtim dhe zhdëmtimi i gjithëmbarshëm i tejkalon shumat e siguruara minimale të siguruara të përmendura më lart, të drejtat në zhdëmtim të personave të dëmtuar do të reduktohen në mënyrë proporcionale ndaj kompanisë së sigurimit.

Fondi pensional dhe invalidor, fondi për sigurimin shëndetësor si dhe kompanitë e që merren me sigurime (të detyruara dhe vullnetare) shëndetësore, pensionale apo lloje të ngjashme të sigurimit të jetës, të cilat duhet të paguajnë kontribute në pajtim me pensionin e tyre ose kontratat e sigurimit, ndaj aksidentit, invaliditeit apo sigurimit të pasurisë, kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre për regresi vetëm pas rregullimit të të gjitha zhdëmtimeve që rrjedhin nga rastet përkatëse të siguruara.

Sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë shumat maksimale sipas paragrafit 1, do të jetë, kur është e nevojshme, përcaktohet dhe ndryshohet nga AQBK-ja.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (RSFJ) në pjesët relevante thotë:

KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN (SUBROGIMI)

Neni 939

Me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmin.

Në qoftë se për faj të të siguruarit është bërë e pamundur ky kalim i të drejtave në sigurues, tërësisht ose pjesërisht, siguruesi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të siguruarit.

Kalimi i të drejtave nga i siguruari në sigurues nuk mund të jetë në dëmin e të siguruarit, kështu që në qoftë se kompensimi të cilin e ka marrë i siguruari nga siguruesi për cilindo shkak qoftë është më i vogël nga sa është dëmi që ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që prej pasurisë së personit përgjegjës t'i paguhet mbetja e kompensimit përpara kërkesës së siguruesit në bazë të të drejtave që janë bartë në të.

Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të siguruarit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të siguruarin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi, apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të siguruarit, përveç në qoftë se këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje.
Mirëpo, në qoftë se dikush nga personat e përmendur në paragrafin paraprak ka qenë i siguruar nga përgjegjësia, siguruesi mund të kërkojë nga siguruesi i tij kompensimin e shumës që i ka paguar të siguruarit.

SIGURIMI NGA PËRGJEGJËSIA
Përgjegjësia e të siguruarit

Neni 940

Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, siguruesi përgjigjet për dëmin e lindur nga rasti i siguruar, vetëm në qoftë se personi i tretë i dëmtuar kërkon kompensimin e tij.
Siguruesi përballon, në kuadrin e shumës së sigurimit, shpenzimet e kontestit mbi përgjegjësinë e të siguruarit.

E drejta vetiake e të dëmtuarit dhe padia direkte

Neni 941

Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, personi i dëmtuar mund të kërkojë direkt nga siguruesi kompensimin e dëmit që ka pësuar nga ngjarja për të cilën përgjigjet siguruesi, por jo më tepër se deri në shumën e detyrimit të siguruesit.
Personi i dëmtuar ka që nga momenti kur ka ndodhur rasti i siguruar, të drejtën vetiake në kompensimin nga sigurimi, kështu që çdo ndryshim i më vonshëm për

të drejtat e të siguruarit ndaj siguruesit nuk ka ndikim në të drejtën e personit të dëmtuar në kompensim.

Komentet e SIGMA-s

Më 25 maj 2015, SIGMA ka parashtruar në Gjykatë që, *inter alia*, pala e dëmtuar D. H, ishte kompensuar tërësisht sipas marrëveshjes së tyre, se nuk ka marrëveshje të ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetit të parashtruesit të kërkesës, sipas së cilës ky i fundit do të kishte të drejtë që të kërkojë kompensim për shpenzimet e paguara mjekësore për mjekimin e të siguruarit të tij D. H, se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensim të dëmit është e gabuar, sepse bazohet në interpretimin e gabuar të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe se, nuk ka shkelje të të drejtave të njeriut për shkak se parashtruesi i kërkesës është person juridik dhe jo fizik, dhe nuk mundet të përfshihet në shprehjen "shkelje e të drejtave të njeriut".

Dokumentet shtesë të parashtruesit të kërkesës

Më 13 dhe 18 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë, ku tërhoqi vëmendjen Gjykatës në dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (Aktgjykimi E. Rev. nr 62/2014, i 21 janarit 2015 dhe Aktgjykimi E. Rev. nr. 48/2014, i 27 tetorit 2014), me të cilët Gjykata Supreme urdhëroi shoqëritë e sigurimit vendase që të kompensojnë kompanitë e huaja të sigurimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës Evropiane.

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin është krijuar një situatë ku D. H. i është njohur e drejta për kompensim, ndërsa parashtruesit të kërkesës si palës së tretë, nuk i është njohur kjo e drejtë dhe kjo paraqet shkelje të së drejtës së pronës.

30. Në lidhje me të drejtën e pronës, parashtruesi i kërkesës thekson se:

"Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin e revizionit ka dështuar të arsyetojë bazueshmërinë e refuzimit të pretendimeve të paditësit/parashtruesit (IKK Classic) dhe njëkohësisht duke injoruar institucionin e subrogimit në sigurime, me këtë edhe të drejtën në zhdëmtim të parashtruesit, i cili paraqet instrument të së drejtës për mbrojtje të pronës -një prej ndër të drejtat elementare kushtetuese e paraparë me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme përmban të meta serioze dhe karakterizohet nga arsyetimet joadekuate ligjore, për shkak se Gjykata Supreme nuk arrin të shpjegojë se pse parashtruesi nuk ka të drejtë për kompensim, i cili nga ana e tij, ka rezultuar në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës.

32. Parashtruesi pretendon se *"Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës kërkojnë nga gjykatat vendëse të japin përgjigje të hollësishme për çdo argument apo pyetje. Megjithatë, nëse parashtresa është e rëndësishme për përfundimin e rastit, atëherë gjykata, dhe në këtë rast Gjykata Supreme si instanca e fundit e gjyqësisë së rregullt duhet ta trajtojë atë në mënyrë specifike dhe të qartë në aktgjykimin e vet".*

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

35. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".*

36. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 qershor 2014, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 3 shtator 2014.

37. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor dhe se janë shteruar mjetet juridike. Prandaj, kërkesa është e pranueshme. Gjykata tani do të shqyrtojë dhe vlerësojë meritat e rastit.

Meritat

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka dhënë përgjigje të qartë në lidhje me çështjen kyçe për kompensimin e parashtruesit të kërkesës, dhe si rezultat i kësaj, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur edhe të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

39. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës parasheh:

> *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
>
> *[...]".*

40. Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt), paragrafi 1 i Konventës parasheh:

> *"Në përcaktimin* e *të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja* e *tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda* një *afati të arsyeshëm nga* një *gjykatë* e *pavarur dhe* e *paanshme".*

41. Përveç kësaj, e drejta për një gjykim të drejtë, siç mishërohet në tekstin kushtetues dhe nenin 6 të Konventës, ka karakter themelor për të mbrojtur të drejtat themelore, në këtë rast të drejtën e pronës.

42. Në të vërtetë, neni 46 [Mbrojtja e Pronës] parasheh:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
>
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
>
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve ekspropriohet.*
>
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës, për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

43. Përveç kësaj, neni 1 i Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Konventës thekson se:

> *"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
> *(...)".*

44. Përfundimisht, Gjykata thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

45. Në rastin konkret, ankesa kryesore e parashtruesit të kërkesës sillet rreth faktit se Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë parasysh vetëm marrëveshjen jashtë-gjyqësore për kompensim, të lidhur në mes të siguruarit D. H. dhe SIGMA, duke dështuar të adresojë tërësisht çështjen e shpenzimeve mjekësore të paguara nga parashtruesi i kërkesës për të siguruarin e saj D.H.

46. Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte arsyetuar aktgjykimin e saj si në vijim:

> *"Mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës pranoi si të bazuara pretendimet e revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, meqë gjykatat e shkallës më të ulët gabimisht kanë pranuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit për faktin se i siguruari i paditësit është zhdëmtuar nga e paditura për dëmin kontestues, sipas marrëveshjes së datës 03.02.2009, në shumën prej 2.729 €. Në*

këtë marrëveshje. në nenin 3 të saj, i dëmtuari, respektivisht i autorizuari i të dëmtuarit, ka deklaruar lirshëm se me pagesën e shumës së lartpërmendur të gjitha kërkesat për këtë dëm të tanishëm dhe të ardhshëm, lidhur me rastin që është lëndë e trajtimit me këtë marrëveshje, ndaj Kompanisë së Sigurimeve "Sigma" në Kosovë, drejtuesit dhe pronarit të automjetit i cili ka qenë i siguruar në këtë kompani të sigurimeve, dhe ndaj të gjithë personave tjerë janë përmbushur plotësisht dhe nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj kësaj kompanie të sigurimeve në lidhje me këtë çështje juridike për kompensimin e dëmit. E paditura në kuptim të nenit 940 të LMD ka qenë në detyrim që të siguruarit të paditësit dëmin e kërkuar t'ia kompensoj, dhe është jo kontestuese se pas lidhjes së marrëveshjes së lartpërmendur, e paditura dëmin e kërkuar ia ka paguar. Po ashtu, i siguruari i paditësit, në kuptim të nenit 941 të LMD në bazë të fajësisë së të siguruarit të padituërës direkt nga e paditura ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit. Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se revizioni i të padituërës është i bazuar, pasi që për aksidentin e lartpërmendur të trafikut në të cilin është lënduar i siguruari i paditëses Driton Hasanmetaj, e paditura ka kryer obligimin e zhdëmtimit me pagesën e shumës prej 2.729.00 €, për të cilën i dëmtuari si u tha më lart drejtpërdrejtë me të padituërën ka lidhur marrëveshje zhdëmtimi. Nga kjo bazë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se paditësi nuk mund të kërkoj regresimin e borxhit kontestues. edhe pse është jokontestuese se paditësi borxhin kontestues për të cilin kërkon që tani e paditura t'ia paguajë, ia ka paguar të dëmtuarit D.H, si të siguruar të saj".

47. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të sqarojë se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse Gjykata Supreme e ka interpretuar drejt ligjin e aplikueshëm (ligjshmëria), por do të shqyrtojë nëse gjykata në fjalë me aktgjykimin e saj të lartpërmendur ka shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria), (Shih, për shembull, Rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, para. 65).

48. Për më tepërnë këtë pikë, sirregull i përgjithshëm, krijimi ifakteve të rastit dheinterpretimi iligjitjanëçështjevetëmpër gjykatate rregullta,të gjeturat dhe konkluzionete të cilavenë këtë drejtimjanë të detyrueshme përGjykatën. Megjithatë, kurnjë vendiminjë gjykatetë rregullt është qartaziarbitrar, Gjykatamund dhe duhetta vë atë në dyshim. (Shih *Sisojevadhe të tjerët kundër Letonisë*, [DHM], Aktgjykimi nr. 60654/00, Aktgjykim i15janarit 2007,para. 89).

49. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka gjetur se *"paditësi* [parashtruesi i kërkesës] *nuk mund të pretendojë regres të borxhit të kontestuar, edhe pse është e padiskutueshme se paditësi ia ka paguar borxhin e kontestuar D.H. si të siguruar të saj"*. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk kishte adresuar në mënyrë adekuate dhe nuk kishte shpjeguar çështjen e kompensimit të parashtruesit të kërkesës, e cila ishte pretendimi kryesor në të gjitha procedurat dhe e cila nuk adresoi apo ofroi një shpjegim të qartë pas këtij interpretimi të ligjit. Në të vërtetë, Gjykata Supreme pranoi se parashtruesi i kërkesës i ka paguar shpenzimet mjekësore të palës së dëmtuar D. H, por nuk shpjegoi se pse parashtruesi i kërkesës nuk mund të kërkojë kompensimin e shpenzimeve mjekësore të paguara.

50. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme theksoi: *"se revizioni i të padituërës është i bazuar, pasi që për aksidentin e lartpërmendur të trafikut, në të cilin është lënduar D. H, e paditura ka kryer obligimin e zhdëmtimit me pagesën e shumës prej € 2.729,00, e për të cilën D. H (...) drejtpërdrejt me të padituërën ka lidhur marrëveshje zhdëmtimi"*. Duket se marrëveshja SIGMA e ka përmbushur detyrimin ndaj D. H., por me disa fjalë përmend kompensimin e parashtruesit të kërkesës për shpenzimet e paguara mjekësore. Megjithatë, Gjykata Supreme, disi, konstaton se marrëveshja në

mes SIGMA dhe D. H. anulon edhe çështjen e kompensimit të parashtruesit të kërkesës, por pa arsyetim.

51. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme nuk ka arritur të shpjegojë qartë disa çështje të rëndësishme: (i) nëse marrëveshja jashtë-gjyqësore e lidhur në mes të SIGMA dhe të siguruarit D. H, ia ka mohuar të drejtën parashtruesit për kompensim, (ii) se si kompensimi i paguar nga SIGMA ndaj të siguruarit D. H. e liroi atë t'ia paguajë kompensimin parashtruesit të kërkesës, si dhe, (iii) se si marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të SIGMA-s dhe D. H. mund të prekë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ku është e qartë, se ky i fundit nuk ishte palë në këtë marrëveshje.

52. Gjykata konsideron se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nuk janë adresuar plotësisht dhe në mënyrë të qartë çështjet e kompensimit të shpenzimeve mjekësore të paguara nga parashtruesi i kërkesës; dhe për këtë arsye, nuk ka arritur ta adresojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës dhe të sigurojë arsyetim për këtë. Prandaj, aktgjykimi i kontestuar është nën standardet e kërkuara për një vendim të arsyetuar.

53. Edhe pse gjykatat nuk janë të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës, megjithatë ata duhet të adresojnë pretendimet që janë kryesore për rastet e tyre dhe të cilat ngrihen në të gjitha fazat e procedurës, siç ka ndodhur me kërkesën e tanishme.

54. Gjykata rithekson se e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për vendimet e tyre me baza të arsyeshme, si në nivelin procedural po ashtu edhe material.

55. Konkluzioni i lartpërmendur vërtetohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e cila përcaktoi se dhënia e arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mirë ligjërisht për vendimin e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë edhe kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit (Shih rastin KI72/12, Parashtrues të kërkesës *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2012).

56. GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 (1) të Konventës (në rastin *Hiro Balani kundër Spanjës)*, ku parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar një kërkesë në gjykatë e cila kërkonte një përgjigje konkrete dhe të shpejtë. Gjykata nuk arriti të japë këtë përgjigje duke e bërë të pamundur për të verifikuar nëse ata thjesht e kishin neglizhuar këtë çështje, ose kishin për qëllim ta hidhnin poshtë atë dhe nëse po, cilat ishin arsyet për ta hedhur poshtë atë.

57. Rrjedhimisht, deklarata e arsyeve duhet t'i mundësojë personit të cilit i ishte dedikuar vendimi dhe opinionit në përgjithësi, që të ndjekë arsyetimin që çoi gjykatën që të nxjerrë atë vendim.

58. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet të theksojë marrëdhënien ndërmjet gjetjeve të meritës dhe reflektimeve kur të merret parasysh prova e propozuar, nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të Gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozita ligjore dhe marrëdhënie logjike midis tyre.

59. Për këtë arsye, Gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota në lidhje me pyetjen kryesore përkitazi me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një kompensim, të përcaktuar nga gjykatat e instancës më të ulët, paraqet shkelje të të drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të

drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

60. Prandaj, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës.

61. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

62. Përfundimisht, Gjykatanuk e konsiderontë nevojshmeqë të merretmë tejmepretendiminenenit 46 tëKushtetutës,nëseka pasurshkelje të sëdrejtës sëpronës, në veçanti pasi ajokagjeturshkelje tënenit 31 tëKushtetutësnë lidhjemeparagrafin 1, tënenit 6 tëKonventës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim menenin113.7 të Kushtetutës, nenin 20të Ligjit, dhe rregullave56(1) dhe74(1) tëRregullores së punës, nëseancën e sajtë mbajtur më 10 nëntor2015, me shumicë votash:

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme.

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

III. TA DEKLAROJË, me shumicë votash, të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014, të 8 prillit 2014.

IV. TA KTHEJË, me shumicë votash, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Urdhri;

VI. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u kumtohet Palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI111/15, Parashtrues Musa Shkodra, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit te Gjykatës Supreme, E. Rev. 64/2014, të 18 marsit 2015

KI115/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 22 dhjetor 2015 dhe publikuar më 9 shkurt 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, mbrojtje gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme kishte refuzuar revizionin e parashtruesit kundër vendimeve të gjykatave të rregullta që kishin vërtetuar kërkesën e palës së tretë, që parashtruesit t'i hiqej e drejta e bashkëpronarit të një organizate joqeveritare.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Gjykata theksoi se parashtruesi i kërkesës gjatë ndërtimit të rastit ishte marrë më shumë me çështjet e ligjshmërisë, që bien brenda prerogativës së gjykatave të rregullta dhe, se pretendimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës kanë mbetur të pashpjeguara dhe të paargumentuara në mënyrë të mjaftueshme. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI111/15
Parashtrues
Musa Shkodra
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. 64/2014, të 18 marsit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Musa Shkodra nga Kamenica (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Ymer Huruglica nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 64/2014, të 18 marsit 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 27 prill 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës KI111/15 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 gusht 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI111/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI111/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 2 tetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 22 dhjetor2015,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportuesKolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës dhe z. S. H., në cilësinë e bashkëpronarëve themeluan kompaninë N. SH. "Shkodra" (në tekstin e mëtejmë: NSHSH).

10. Në një datë të pacaktuar, z. S. H. paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje ekonomike (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kundër parashtruesit, me të cilën kërkoi përjashtimin e parashtruesit si bashkëpronar i kompanisë NSHSH.

11. Më 17 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 29 të Ligjit për procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK), dhe nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për gjykatat, konstatoi kompetencën për shqyrtimin e këtij kontesti, dhe si rrjedhojë, nxori Aktgjykimin C. nr. 482/2012, me të cilin e aprovoi si të bazuar padinë e S. H.

12. Në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore theksohet: *"Në procedurën e provave gjykata ka administruar të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke iu dhënë mundësi palëve ndërgjyqëse të deklarohen për secilën provë veç e veç dhe të gjitha provave si tërësi unike duke filluar nga ekspertiza e hartuar nga eksperti R. B. [...]. Në fund, asnjëra palë ndërgjyqëse nuk ka kontestuar provat e lexuara".*

13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në afatin ligjor në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, C. nr. 482/2012, duke theksuar si bazë juridike, shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

14. Më 3 shtator 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ae. nr. 161/2012, me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 17 korrikut 2013.

15. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata e Apelit theksoi: *"Duke vendosur lidhur me ankesat e të padituri, Gjykata e Apelit e Kosovës, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Arsyetimi i aktgjykimit përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë, sipas nenit 194, kujdeset sipas detyrës zyrtare".*

16. Brenda afatit ligjor parashtruesi e parashtroi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët duke pretenduar, si

bazë juridike, shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

17. Më 18 mars 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin E. Rev. 64/2014, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion, duke arsyetuar: *"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale, duke gjetur se ankesat e të paditurit janë të pabazuara dhe duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës sëshkallës së parë. Në aktgjykimin e cekur ajo ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë".*

18. Përveç kësaj, Gjykata Supremenë mënyrë specifikeu përgjigj në pohimet e parashtruesitqë kompensimi i ndarëpërpjesëne tijnë aksionet e kompanisë nukishte i duhur. Gjykata Supreme theksoi:

> "*Lidhur me pretendimet e revizionit rreth kontributit real të ndërgjyqësve me rastin e themelimit të ndërmarrjes, rritjes së kapitalit, çmimit të tanishëm të tregut të ndërmarrjes, në bazë të cilave bëhet ndarja e ndërmarrjes, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se këto fakte kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilën në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet. Por, edhe përkundër kësaj, kjo Gjykatë vlerëson se çështjet e ngritura me këtë pretendim janë vërtetuar në bazë të ekspertizës financiare, e cila gjatë procedurës nuk është kundërshtuar nga palët*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi në kërkesë pretendon: *"Në mbështetje të dispozitës së nenit 113 parag. 7 lidhur me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ushtroj këtë kërkesë për mbrojtje të lidhshmërisë, meqë aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në kundërshtim me dispozitën e nenit të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve /LMD/ / Ligji nr. 04/L-077 i 10 janarit 2012, ... si dhe nuk janë administruar të gjitha provat relevante gjatë vendosjes në këtë çështje juridike".*

20. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

> *„Të deklarohet kërkesa e pranueshme dhe të konstatohet se aktgjykimet e kundërshtuara* janë *marrë me aplikim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht shkeljes së Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeveduke propozuar që çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të sërishme".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë kërkesën eparashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nësekërkesa i kapërmbushurkushtet epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe* lirive *të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Neni 48 i Ligjit, gjithashtu përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se* cilat *të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

24. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) „Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

25. Duke analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për sa i përket shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte ndërtuar ankesën e tij kushtetuese mbi shkeljen e pretenduar të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, si dhe në qëndrimin *"se gjykatat e rregullta kanë marrë aktgjykime në kundërshtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve"* që i takon fushës dhe çështjeve të ligjshmërisë, dhe jo të kushtetutshmërisë.

26. Në rastin konkret, kur është fjala për pretendimet e ankesës kushtetuese me të cilat theksohet vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, Gjykata thekson se me vlerësimin e vet ajo nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e gjykatave të rregullta, sepse është detyrë e gjykatave të rregullta të vlerësojnë provat e paraqitura në bazë të të cilave i vërtetojnë faktet relevante për zbatimin e ligjit material.

27. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, se gjykatat e rregullta në procedurat e tyre nuk i kanë vlerësuar të gjitha faktet relevante dhe provat në këtë çështje juridike, Gjykata thekson se gjykatat vendore kanë liri të caktuar veprimi në këtë drejtim se cilat argumente dhe prova do t'i pranojnë në një rast të caktuar, por në të njëjtën kohë kanë obligim që t'i arsyetojnë vendimet e tyre në atë mënyrë që të paraqesin arsye të qarta dhe të kuptueshme në të cilat i kishin bazuar ato vendime (Shih, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Suominen kundër Finlandës,* Aktgjykimi i 1 korrikut 2003).

28. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se edhe Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj E. Rev. 64/2014 konkludoi se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kishin zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, dhe se të dy aktgjykimet përmbanin fakte të mjaftueshme vendimtare të cilat i ka pranuar edhe Gjykata Supreme kur ka vendosur për meritat e kërkesës së parashtruesit për revizion.

29. Gjykata më tej vëren se parashtruesi në ankesën kushtetuese përmend edhe shkeljen e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; megjithatë, Gjykata është e mendimit se parashtruesi i kërkesës gjatë ndërtimit të rastit ishte marrë më shumë me çështjet e ligjshmërisë që bien brenda prerogativës së gjykatave të rregullta, dhe se pretendimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës kanë mbetur të pashpjeguara dhe të paargumentuara në mënyrë të mjaftueshme.

30. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013 të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

31. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret sipas të cilave ankesa e parashtruesit të kërkesës do të shqyrtohej nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

32. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me rregullat36 (1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 22 dhjetor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI101/15, Parashtruesi i kërkesës: Rujdi Kasemlari, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0211-A0001, të 19 marsit 2015

KI101/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2015, i publikuar më 10 shkurt 2016.
Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, e pambështetur, qartazi e pabazuar.
Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Më 18 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) kundër personave J. N., B. N., si dhe kundër ndërmarrjes shoqërore "KBI Progres-Export" (në tekstin e mëtejmë: KBI) me të cilën kërkoi vërtetimin e të drejtave pronësore mbi dy parcelat e tokës.

Më 19 mars 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin [AC-I-14-0211-A0001], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar me arsyetimin se: *„Pasi që janë shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësve dhe shkresat në dosje të lëndës, Kolegji i Apelit gjeti se ankesa është e pabazuar, dhe rrjedhimisht, vërtetohet Aktvendimi [C-III-12-1711] të Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Specializuar me të drejtë kishte bazuar vendimin e vet në nenin 17.2 dhe nenin 52.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme".*

Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar e ka mbështetur aktvendimin dhe aktgjykimin e vet [C-III-12-1711] në dispozitat ligjore të nenit 17.2 dhe nenit 52.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesi nuk ka dëshmuar në kërkesë se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI101/15
Parashtrues
Rujdi Kasemlari
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-14-0211-A0001, të19 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rujdi Kasemlari nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Refki Taç.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-14-0211-A0001 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të19 marsit 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 31 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës KI101/15 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7të Kushtetutës, nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullin56tëRregullores së punës të GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 9 gusht2015, Kryetarja eGjykatës, me Vendimin nr.GJR. KI101/15, caktoigjyqtaren Snezhana Botusharovagjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, meVendiminnr.KSH. KI101/15,caktoiKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 4 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 22 dhjetor 2015,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportuesKolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 18 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) kundër personave J. N., B. N., si dhe ndërmarrjes shoqërore "KBI Progres-Export" (në tekstin e mëtejmë: KBI) me të cilën ai kërkoi vërtetimin e të drejtave pronësore mbi dy parcelat e tokës.

10. Më 25 tetor 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, ta specifikojë padinë, në të cilën ai duhet t'i deklarojë adresat e sakta të personave të paditur J. N. dhe B. N.

11. Më 15 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës i është përgjigjur kërkesës së Kolegjit të Specializuar në të cilën ai deklaroi se *"të padituri janë shpërngulur në Turqi para 60 vjetësh, që në ndërkohë, ndoshta, u janë ndryshuar mbiemrat prandaj, adresat e tyre ishin të panjohura për të"*.

12. Më 23 maj 2014, Kolegji i Specializuar nxori Aktvendim të pjesshëm [C-III-12-1711] me të cilin hodhi poshtë padinë e parashtruesit kundër personave të paditur J. N., dhe B. N. si të papranueshme, me arsyetimin se: *"paditësit nuk kanë ofruar asnjë adresë (apo as edhe adresën e vjetër që kanë mundur ta dinë) për të padituri n e parë dhe të dytë, apo edhe ndonjë dëshmi tjetër nëse adresa në fjalë është e panjohur për autoritetet, që është detyrim i paditësit në bazë të nenit 17.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme"*.

13. Sa i përket padisë së parashtruesit të kërkesës kundër KBI-së, Kolegji i Specializuar të njëjtën ditë (23 maj 2014) nxori Aktgjykimin [C-III-12-1711] me të cilin refuzoi padinë e parashtruesit për shkak të mungesës së parashtruesit, sipas nenit 52.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme. Në arsyetimin e Aktgjykimit Kolegji i Specializuar theksoi: *"Paditësit nuk ishin paraqitur në seancën dëgjimore të datës 28.01.2014. Paditësit nuk kanë caktuar përfaqësues që t'i përfaqësojë ata në mungesë të tyre. Z. R. T. u paraqit pranë gjykatës në seancën dëgjimore duke deklaruar se ai ishte Përfaqësues i Paditësve, por nuk prezantoi ndonjë autorizim të vlefshëm, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohej si përfaqësues ligjor i paditësve."*

14. Më 7 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktvendimit të pjesshëm për papranueshmërinë e padisë, si edhe kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, të 23 majit 2014.

15. Më 19 mars 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin [AC-I-14-0211-A0001] , me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar me arsyetimin se*: „Pasi që janë shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësve dhe shkresat në dosje të lëndës, Kolegji i Apelit gjeti se ankesa është e pabazuar, dhe rrjedhimisht, vërtetohet Aktvendimi [C-III-12-1711] i Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Specializuar me të drejtë kishte bazuar vendimin e vet në nenin 17.2 dhe nenin 52.2 të Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: "*Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, me anashkalimin e obligimeve nga neni 19.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, me urdhrin që paditësit që në afat prej 15 ditësh, ta përcjellin adresat e të padituve, të cilët përndryshe ishin janë shpërngulur në Turqi para 50 vitesh, ka cenuar të drejtën për gjykim, e cila ka të bëjë me të drejtën e pronësisë, të cilat të drejta që janë garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe dokumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë".*

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës *„me anë të kësaj kërkese i apelohet Gjykatës Kushtetuese që të merr VENDIM duke shpallur Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I-14-0211-A0001, të dt. 19 mars 2015, kundërkushtetuese, me supozim që në procedurën e rigjykimit të eliminohen cenimet e të drejtës ...".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Nëmënyrë që të jetënë gjendje tëshqyrtojë ankesën eparashtruesit, Gjykata së pari duhet tëvlerësojë nëseaii kapërmbushurkriteret epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuara më tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[…]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[…]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar ankesën e tij kushtetuese mbi pretendimin për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

23. Përkitazi me ankesën se parashtruesi nuk ka përfituar nga gjykimi i drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se e drejta për gjykim të drejtë është një e drejtë komplekse që përmban një sërë të drejtash që duhet të sigurohen, në mënyrë të barabartë, nga të gjitha autoritetet kompetente dhe të gjitha palët në procedurë.

24. Gjithashtu, Gjykata rikujton se parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm kërkon që gjykatat t'i referohen një norme specifike ligjore, ndërsa baza juridike e aktgjykimit nuk duhet të jetë arbitrare, d.m.th. jashtë rastit konkret.

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar e ka mbështetur aktvendimin dhe aktgjykimin e vet [C-III-12-1711] në dispozitat ligjore të nenit 17.2 dhe nenit 52.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme që parashohin:

17.2 "Parashtruesi duhet të shkruajë, në kërkesën apo ankesën e tij, edhe emrin e secilit person që identifikohet shprehimisht si Palë Kundërshtare. Parashtruesi bën përpjekje të arsyeshme dhe të vëmendshme për të vërtetuar dhe për të ofruar adresën më të fundit të njohur të secilit person të tillë, si dhe për ta ofruar atë informatë në kërkesën apo ankesën e tij".

52.2 „Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale".

26. Në këtë mënyrë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë gjetur se parashtruesi ka dështuar të përmbushë kërkesat procedurale të përcaktuara me legjislacion. Gjykata vëren më tej se Kolegji i Apelit në Aktvendimin [AC-I-14-0211-A0001] gjithashtu, vërtetoi saktësinë e dispozitave ligjore në të cilat Kolegji i Specializuar kishte bazuar vendimin e tij.

27. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së janë të pabazuara.

28. Duke vlerësuar arsyet e ankesës kushtetuese nga aspekti i nenit 46 të Kushtetutës dhe të drejtës së pronës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata është e

mendimit se vet fakti i thjeshtë që parashtruesi në çështjen juridike të vërtetimit të të drejtave të tij pronësore nuk ka arritur të bindë gjykatat e rregullta, nuk paraqet bazë të vlefshme për të konstatuar shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, nëse ai nuk dëshmon se me vendimin e gjykatës ai është privuar nga prona e tij arbitrarisht apo padrejtësisht (Shih rastin, *mutatis mutandis, Mezõtúr-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

29. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013 të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

30. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesi nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me rregullat36 (1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 22 dhjetor2015,me shumicë votash

VENDOS

V. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI98/15, Parashtrues i kërkesës: Shpendim Bokshi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ac. nr. 4223/2014, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 25 marsit 2015

KI98/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2015, i publikuar më 10 shkurt 2016.
Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta në mjete juridike, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mosshterim i mjeteve juridike.*
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejmë: KPMM) i ka shqiptuar dy gjoba administrative parashtruesit të kërkesës, në shumën prej 10.000 eurosh, për arsye të zhvillimit të veprimtarisë së separacionit të resurseve minerale pa licencë për kryerjen e aktiviteteve të tilla.

Parashtruesi u ankua tek gjykatat e rregullta. Gjykata e Apelit refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se me Vendimin Ac. nr. 4223/2014 e Gjykatës së Apelit, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe me nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Gjykata vlerësoi se parashtruesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet efektive juridike me të cilat ka mundur të kontestojë ligjshmërinë e Aktvendimit të KPMM (KA. nr. 189/12, të 14 majit 2012) si dhe të Aktvendimit të KPMM (KA. nr. 219/2012, të 3 korrikut 2012) në procedurën administrative në Gjykatën Supreme, sipas këshillës juridike.
Kërkesa është shpallur e papranueshme, ngase parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI98/15
Parashtrues
Shpendim Bokshi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 4223/2014, të 25 marsit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Shpendim Bokshi, pronar i personit juridik Sh.p.k. "Bokshi" nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin (Ac. nr. 4223/14), të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 25 marsit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe me nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 korrik 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI98/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI98/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 7 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesi plotësimin e formularit të kërkesës. Njëkohësisht, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të dorëzojë në Gjykatë vendimet të cilat i konteston dhe të bashkëngjitë dokumentet përkatëse që vërteton se është pronar i personit juridik Sh.p.k. "Bokshi".

8. Më 14 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë vetëm vendimet të cilat ai i konteston.

9. Më 17 shtator 2015, Gjykata kërkoi përsëri nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e formularit të kërkesës dhe dorëzimin e dokumentit përkatës që dëshmon se ai është pronar i personit juridik Sh.p.k. "Bokshi".

10. Më 6 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar dhe certifikatën e regjistrimit të personit juridik Sh.p.k. "Bokshi".

11. Më 26 tetor 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të deklarohet nëse në të njëjtën kohë ka paraqitur edhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit të Kosovës.

12. Më 16 nëntor 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të cilën e kishte paraqitur te Prokurori i Shtetit më 6 maj 2015.

13. Më 22 dhjetor2015, pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportuesKolegji shqyrtuesi rekomandoinjëzëriGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në procedurën administrative

14. Më 14 maj 2012, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejmë: KPMM) me Aktvendimin (KA. nr. 189/12) kishte shqiptuar gjobë administrative ndaj parashtruesit të kërkesës në shumë prej 5.000 euro, për zhvillimin e veprimtarisë të separacionit të burimeve minerale pa licencën e duhur për kryerje të veprimtarisë së tillë.

15. Më 3 korrik 2012, KPMM me Aktvendimin (KA. nr. 219/2012) kishte shqiptuar gjobën tjetër (të re) administrative ndaj parashtruesit të kërkesës në shumë prej 5.000 euro, pasi që pretendohet se parashtruesi kishte vazhduar veprimtarinë e separacionit të burimeve minerale pa licencë.

16. Në të dy aktvendimet e lartpërmendura të nxjerra nga KPMM gjendet këshilla juridike:

> *"Kundër këtij aktvendimi është lejuar inicimi i procedurës administrative, në pajtim me Ligjin për procedurën administrative. Padia për inicimin e procedurës administrative duhet të paraqitet në Gjykatën Supreme brenda 30 ditëve nga dita e dërgimit të këtij Aktvendimi nga KPMM".*

Përmbledhja e fakteve në procedurën përmbarimore

17. Më 2 maj 2013, KPMM parashtroi propozim në Gjykatën Themelore në Gjakovë për përmbarimin e Aktvendimit (KA. nr. 189/12, të 14 majit 2012) dhe të Aktvendimit (KA. nr. 219/2012, të 3 korrikut 2012), me të cilat aktvendime kishte shqiptuar gjobat administrative ndaj parashtruesit të kërkesës në shumën e përgjithshme prej 10.000 euro.

18. Më 14 maj 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendimin (E. nr. 378/13), lejoi përmbarimin e Aktvendimit (KA. nr. 189/12, të 14 majit 2012) dhe të Aktvendimit (KA. nr. 219/2012, të 3 korrikut 2012).

19. Më 27 maj 2013, parashtruesi i kërkesës ushtroi prapësim kundër Aktvendimit (E. nr. 378/13) të Gjykatës Themelore në Gjakovë për lejimin e përmbarimit, duke argumentuar se në këtë çështje përmbarimore mungonte titulli përmbarimor, dhe propozoi që përmbarimi të shpallej i palejuar.

20. Më 24 maj 2014, Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendimin (E. nr. 378/13) e refuzoi prapësimin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit (E. Nr. 378/13, të 24 majit 2014) për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe propozoi që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar.

22. Më 25 mars 2015, Gjykata e Apelit me Aktvendimin (AC. nr. 4223/2014), refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin (E. Nr. 378/13, të 24 majit 2014) e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

23. Në Aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se "[...] *Aktvendimi i goditur është i drejtë dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur e ka refuzuar kundërshtimin e parashtruesit si të pabazuar. Kjo nga fakti se parashtruesi është zënë duke zhvilluar aktivitet të veçantë-Separacion, në mënyrë ilegale, prandaj KPMM i ka shqiptuar gjobat sipas Aktvendimit (KA. nr. 189/12 të 14 majit 2012) dhe të Aktvendimit (KA. nr. 219/2012 të 3 korrikut 2012) [...]*".

24. Për më tepër, Gjykata e Apelit arsyetoi se, edhe pse *"[...] Aktvendimet e KPMM mund të goditen në procedurë administrative përmes fillimit të Konfliktit Administrativ, kjo nuk paraqet pengesë ligjore për përmbarim, për shkak se sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, ushtrimi i padisë kundër vendimeve administrative nuk e ndalon ekzekutimin e tyre [...]*".

25. Më 6 maj 2015, parashtruesi ia dorëzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin (E. nr. 378/2013) e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe me Aktvendimin (Ac. nr. 4223/14) e Gjykatës së Apelit i

janë shkelur të drejtat e garantuara siç janë përmendur në paragrafin 3, të këtij dokumenti.

27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se aktvendimet e kontestuara janë tërësisht të pabazuara dhe të paligjshme edhe për shkaqe procedurale dhe materiale.

28. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] Gjykata themelore në Gjakovë përkatësisht gjyqësori, nuk është as kompetente lëndore e as vendore për përmbarimin e gjobës administrative të shqiptuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Prishtinë. Gjykata nuk përmbaron gjoba, taksa dhe tatime, përkatësisht detyrime fiskale publike në procedurën e përmbarimeve civile. Detyrimet tatimore, taksat dhe detyrimet publike përmbarohen njësoj si dhe tatimet, nga organi i cili ka vendosur, nëse ato janë ligjore"*.

29. Parashtruesi i kërkesës kërkon: "*Lus Prokurorinë e Shtetit të Kosovës që pranë Gjykatës Supreme të Kosovës të ngritë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në mënyrë që kjo padrejtësi ordinere që më është bërë të eliminohet, [...] dhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës t'i shpallë antikushtetuese vendimet gjyqësore"*.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

32. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

33. Për më tepër, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës, parasheh:

> *"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar"*.

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, kërkesën e tij e bazon në zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, në veçanti duke theksuar se "*gjyqësori, nuk është kompetent lëndor e as vendor për përmbarimin e gjobës administrative të shqiptuar nga Komisioni i Pavarur...*".

35. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur mjetet juridike efektive me të cilat kishte mundësi të konteston ligjshmërinë e Aktvendimit të KPMM (KA. nr. 189/12, të 14 majit 2012) dhe Aktvendimit të KPMM (KA. nr. 219/2012, të 3 korrikut 2012), në procedurë administrative në Gjykatën Supreme në pajtim me këshillën juridike.

36. Gjykata, po ashtu, i referohet Ligjit nr. 03/L-202 për konfliktet administrative, i cili sipas nenit 23, paragrafi 1 dhe 2 përcakton si në vijim:

"1. Për paditë kundër akteve administrative të të gjitha organeve vendos gjykata kompetente për çështjet administrative në shkallë të parë, nëse me dispozita të tjera ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Kundër vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, ankesa mund të paraqitet te gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë".

37. Gjykata vëren se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kanë mundur të parashtrohen në Gjykatën Supreme, në pajtim me Ligjin nr. 03/L-202 për konfliktet administrative.

38. Pastaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës njëkohësisht me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë e dorëzoi edhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit, më 6 maj 2015, dhe se procedura lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është ende e përfunduar.

39. Në këto rrethana, dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi në Gjykatë, rezulton se ai nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike efektive të cilat i ka pasur në dispozicion.

40. Prandaj, kërkesa është e parakohshme, për shkak se rasti i parashtruesit, i cili ka të bëjë me propozimin për refuzimin e përmbarimit të Aktvendimit të KPMM, për shkak të mungesës së juridiksionit të gjykatave të rregullta, është ende në pritje të njoftimit nga Prokurori i Shtetit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

41. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e kompetencave ligjore, dhe se detyra e tyre kushtetuese dhe prerogative është t'i interpretojnë çështjet e fakteve dhe të ligjit, të cilat janë relevante për rastet e paraqitura para tyre.

42. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, t'u ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih rastin KI41/09, parashtrues i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* Aktvendimin për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).

43. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore (Shih rastin KI07/09, parashtrues të kërkesës *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendimi për papranueshmëri i 19 majit 2010).

44. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk duhet të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese para se t'ua japë mundësinë gjykatave të rregullta për t'i përfunduar procedurat të cilat parashtrohen para tyre, për të korrigjuar dhe eliminuar shkeljet e Kushtetutës.

45. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj që të jetë në gjendje të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin113paragrafi7të Kushtetutës, nenet20dhe48të Ligjitdhe me rregullin36(1) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 22 dhjetor2015,me shumicë votash

VENDOS

IX. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

X. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

XI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI91/15, Parashtrues Kadri Sherifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP. nr. 320/2011, të 18 janarit 2012

KI91/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2015, publikuar me 10 shkurt 2016
Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, shkelje kushtetuese, shkelje të ligjit, kërkesë e paafatshme, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesi, pretendonte ndër të tjera, se me vendimet e kontestuara, përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. nr. 491/2009, i ishin shkelur të drejtat e garantuara me Ligj dhe me Kushtetutë, për shkak të mbajtjes së tij padrejtësisht në vuajte të dënimit prej 6 (gjashtë) vjetësh.

Si përfundim, Gjykata gjeti se kërkesa e parashtruesit, përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011 nuk i përmbushte kriteret procedurale të pranueshmërisë, të kërkuara me nenin 49 të Ligjit, sepse ishte parashtruar jashtë afatit ligjor.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI91/15
Parashtrues
Kadri Sherifi
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP. nr. 320/2011, të 18 janarit 2012
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Kadri Sherifi, me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP. nr. 320/2011, të 18 janarit 2012 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. nr. 491/2009, të 28 marsit 2011 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut).

3. Aktgjykimi AP. nr. 320/2011 i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 27 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011, të 18 janarit 2012, dhe i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, P. nr. 491/2009, të 28 marsit 2011, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të garantuara me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Në fakt, parashtruesi nuk ka saktësuar në kërkesë ndonjë dispozitë kushtetuese përkitazi me pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, megjithatë Gjykata kupton se fjala është për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 2 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI91/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI491/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

9. Më 7 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kësaj kërkese iu dërgua Gjykatës Supreme.

10. Më 1 tetor 2015, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, përkitazi me faktin nëse parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 216/2014, të 12 majit 2015.

11. Më 7 tetor 2015, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Themelore në Prishtinë, përkitazi me datën e pranimit të vendimit përfundimtar (Aktgjykimi Ap. nr. 320/2011) nga parashtruesi.

12. Më 22 tetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë informoi Gjykatën se parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Ap. nr. 320/2011, më 27 shkurt 2012.

13. Më 19 nëntor 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore informata shtesë përkitazi me faktin nëse parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 216/2014, të 12 majit 2015.

14. Më 2 dhjetor 2015, Gjykata Themelore informoi Gjykatën se parashtruesi nuk kishte ushtruar të drejtën e ankesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 216/2014.

15. Më 18 dhjetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

16. Më 25 nëntor 2010, Prokuroria Publike e Qarkut të Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: PPQ), me kërkesë të personave të dëmtuar (paditësve), ngriti aktakuzën PPQ 804-3/2009 kundër parashtruesit, vëllait të tij dhe disa të akuzuarve të tjerë, duke kërkuar shpalljen e tyre fajtorë për veprën penale "trafikim me emigrantë", sipas nenit 138, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

17. Më 28 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 491/2009), shpalli fajtor parashtruesin për kryerjen e veprës penale, sipas nenit 138 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së. Shpalljen fajtor të parashtruesit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e bazoi në provat e PPQ-së dhe në deklaratat e palëve të dëmtuara. Gjykata në fjalë, duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të rastit, erdhi në përfundim se parashtruesi është fajtor për kryerjen e veprës penale dhe e dënoi atë me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjetësh, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

18. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme. Sipas shkresave të lëndës, ankesë kishte ushtruar edhe PPQ-ja në Prishtinë, për shkak të masës së ulët të dënimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, duke kërkuar ngritjen e masës së dënimit.

19. Më 18 janar 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi AP. nr. 17/2015) i refuzoi si të pabazuara ankesat, si të parashtruesit të kërkesës ashtu edhe të PPQ-së, duke e vërtetuar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. nr. 491/2009, të 28 marsit 2011.

20. Më 14 mars 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, P. nr. 491/2009, të 28 marsit 2011, i cili u bë i formës së prerë, pasi që Gjykata Supreme e vërtetoi atë më 18 janar 2012 (Aktgjykimi AP. nr. 17/2015).

21. Më 12 maj 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi KP. nr. 216/2014) refuzoi kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale. Arsyen e refuzimit gjykata në fjalë e mbështet në faktin se *"provat dhe faktet në të cilat është thirrur parashtruesi nuk ofrojnë arsye për lejimin e rishikimit të procedurës penale"*. Parashtruesit me këtë aktvendim i ishte dhënë e drejta e ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit, në afat prej 3 (tri) ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi pretendon se me vendimet e kontestuara, përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. nr. 491/2009, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Ligj dhe me Kushtetutë, për shkak të mbajtjes së tij padrejtësisht në vuajte të dënimit prej 6 (gjashtë) vjetësh.

23. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta gabimisht dhe padrejtësisht e ngarkuan atë me vepër penale, për faktin se i njëjti nuk ka marrë pjesë në veprimet e kundërligjshme për të cilat pretendon se i ka kryer një person tjetër, i cili ndodhej në arrati dhe jo ai.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata Kushtetuese, para se të shqyrtojë një kërkesë, së pari vlerëson nëse ajo i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht(...)".*

26. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) i Rregullores së punës të Gjykatës, parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[…]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit, të mjetit të fundit juridik, te parashtruesi".

[…]

27. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011, është marrë më 18 janar 2012 dhe i është dorëzuar parashtruesit më 27 shkurt 2012. Megjithatë, parashtruesi kërkesën e dorëzoi në Gjykatë më 2 korrik 2015, që tregon se kërkesa është parashtruar pas 3 (tre) vjet e katër muajsh prej datës kur aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit.

28. Siç dhe mund të vërehet, kërkesa e parashtruesit, përkitazi me kontestimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AP. nr. 320/2011, të 18 janarit 2012, është dorëzuar në Gjykatë pas afatit të përcaktuar me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit dhe të Rregullores së punës.

29. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi kërkesës së tij ia bashkëngjiti edhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, KP. nr. 216/2014, me të cilin kishte kërkuar rishikimin e procedurës penale (si mjet i jashtëzakonshëm juridik). Gjykata, sipas detyrës zyrtare, kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për të kuptuar nëse parashtruesi kishte ushtruar të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të gjykatës së instancës së parë. Nga informatat e siguruara, Gjykata kuptoi se parashtruesi nuk e kishte shfrytëzuar të drejtën e ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit. Kjo do të thotë se parashtruesi nuk i kishte shterur mjetet juridike, sipas ligjit në fuqi, pavarësisht këshillës juridike të dhënë me Aktvendimin në fjalë, lidhur me të drejtën për ushtrimin e ankesës në Gjykatën e Apelit, në afat prej 3 (tre) ditësh nga pranimi i Aktvendimit të Gjykatës Themelore.

30. Sidoqoftë, Gjykata konsideron se Aktvendimi i Gjykatës Themelore, KP. nr. 216/2014, nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit të kësaj kërkese, përderisa parashtruesi nuk e konteston kushtetutshmërinë e tij, por të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 491/2009, të cilat janë përmendur në paragrafin 2 të këtij Aktvendimi.

31. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AP. nr. 320/2011 (mjetit përfundimtar), nuk i ka përmbushur kriteret procedurale të pranueshmërisë, të kërkuara me nenin 49 të Ligjit, sepse është ushtruar jashtë afatit ligjor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) c), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI43/15, Parashtruesi i kërkesës: „ECO-HIGJIENA sh.p.k.“ nga Gjilani, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C. nr. 381/2014, të 3 dhjetorit 2014.

KI43/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2015, i publikuar më 10 shkurt 2016.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, masat e përkohshme, e parakohshme.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me mosdorëzimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Kosovës. Njëkohësisht, parashtruesi kërkon që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme dhe të urdhërojë Gjykatën Themelore në Gjilan që të anulojë të gjitha veprimet me të cilat vendimi i Gjykatës Themelore është bërë i formës së prerë.

Gjykata konstatoi se më 20 maj 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën e Apelit ku procedura është në vazhdim e sipër. Gjykata më tej rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t’i shterë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Rrjedhimisht, Gjykata është e mendimit se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës. Gjykata, gjithashtu, për të njëjtën arsye refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI43/15
Parashtrues
ECO-HIGJIENA sh.p.k
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C. nr. 381/2014, të 3 dhjetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kompania ECO-HIGJIENA sh.p.k. nga Gjilani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqëson Besim Osmani, avokat nga Kamenica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan C. nr. 381/2014, të 3 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C. nr. 381/2014, të 3 dhjetorit 2014.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se mosdorëzimi i Aktgjykimit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], si dhe me dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të cilat, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

5. Në të njëjtën kohë, parashtruesi kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme dhe të urdhërojë Gjykatën Themelore në Gjilan, që të anulojë procedurën në rastin, C. nr. 381/2014, deri sa të nxirret vendimi i fundit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54

dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 14 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI43/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI43/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 1 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin, me të cilin dëshmon që është përfaqësues ligjor i Kompanisë ECO-HIGJIENA sh.p.k. nga Gjilani. Më 12 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.

10. Më 15 qershor 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Gjilan. Më 26 qershor 2015, Gjykata ka pranuar përgjigje nga Gjykata Themelore në Gjilan. Në përgjigjen e Gjykatës Themelore theksohet se Aktgjykimi, C. nr. 381/2014, sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës (ankesa është dorëzuar më 12 qershor 2015) gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

11. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI43/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese më 26 qershor 2015.

12. Më 16 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës e informoi Gjykatën se kundër Aktgjykimit C. nr. 381/2014 të Gjykatës Themelore kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe se ky proces ende vazhdon.

13. Më 18 dhjetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

14. Në të njëjtënkohë, Kolegji shqyrtues i ka propozuarGjykatës në përbërje të plotë të refuzojë kërkesën e parashtruesit për Masë të përkohshme, me arsyetiminse ainuk kaparaqitur asnjëdëshmibindësepër të justifikuarvendosjene Masës së përkohshme, si të nevojshme, për të shmangurnjë dëmtë pariparueshëm, apo dëshmisenjë masë e tillë është nëinteres publik.

Përmbledhja e fakteve

Procedura administrative brenda kompanisë

15. Nga shkresat e lëndës rrjedh se Bordi i Drejtorëve i Kompanisë ECO-HIGJIENA sh.p.k. nga Gjilani në vitin 2012 ka suspenduar nga puna dy punëtorë të saj.

16. Në procedurë të mëtejme u arrit një marrëveshje mes këtyre dy punëtorëve dhe ECO-HIGJIENA, ashtu që EKO-HIGJIENA anuloi vendimin për suspendimin e këtyre punëtorëve, dhe të njëjtit punëtorë paraqitën dorëheqje nga pozitat e tyre.

Procedura në gjykatat e rregullta në kontestin civil

17. Punëtorët e lartpërmendur dorëzuan padi në Gjykatën Themelore në Gjilan në lidhje me dorëheqjen e kontestuar, e cila sipas pretendimeve të tyre ishte bërë nën presion, të ushtruar nga Bordi i Drejtorëve i ECO-HIGJIENA.

18. Më 2 maj 2013, Gjykata Themelore në Gjilan, me Aktgjykimin, C. nr. 809/12 e aprovoi kërkesëpadinë e punëtorëve të lartpërmendur dhe e obligoi Kompaninë ECO-HIGJIENA që punëtorët e përmendur t'i kthejë në pozitat e tyre dhe t'ua kompensojë të ardhurat personale që nga data e dorëheqjes së kontestuar.

19. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër vendimit të Gjykatës Komunale.

20. Më 8 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin, AC. nr. 1857/13 e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C. nr. 809/12, dhe të njëjtin e ndryshoi pjesërisht.

21. Punëtorët e lartpërmendur dorëzuan kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

22. Më 12 maj 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Rev nr. 87/2014, e aprovoi pjesën e revizionit në lidhje me kthimin e punëtorëve të përmendur në vendet e tyre të punës, ndërsa vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë e anuloi dhe e ktheu në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

23. Më 3 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan, në procedurën e përsëritur, nxori Aktgjykimin C. nr. 381/14.

24. Më 19janar 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë përrevizionnë GjykatënSupreme të Kosovës kundër vendimit tëGjykatës Komunale.

25. Më 30 prill2015, Gjykata ThemelorenëGjilan erefuzoi kërkesën e parashtruesit përrevizion si tëpalejueshme.

26. Më20maj2015, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesënë Gjykatën eApelit kundër vendimit të Gjykatës Themelore për refuzimin e kërkesës për revizionin. Kjoprocedurëështë endenë zhvillim e sipër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me mosdorëzimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 381/14, të 3 dhjetorit 2014, atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

28. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata:

„I. Të shpallë si të pranueshme kërkesën tonë;
II. Të konsatoj se Gjykata në rastin me numër C. nr. 381114, ku vendimin saj meritor e ka bërë të formës së prerë, ka bërë shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 32 dhe 22.1.2;
III. Të urdhëroj Gjykatën Themelore në Gjilan që të anuloj të gjitha veprimet me të cilat është bërë i formës së prerë vendimi me numër C. nr. 381/14;
IV. Të urdhëroj Gjykatën Themelore në Gjilan që vendimin me numër C. nr. 381/14 të ma dërgoj mua si i autorizuar, ashtu që ndaj këtij vendimi të ushtroj të drejtën time në ankimim".

29. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata:

„që ta sjellë një masë të caktuar apo ta urdhëroj Gjykatën Themelore në Gjilan që të ndërpres të gjitha veprimet lidhur me ekzekutimin e vendimit me numër C. nr. 381/2014, deri në vendosjen meritore të kësaj kërkese".

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47. 2 të Ligjit, i cili parasheh se:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

33. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nësejanë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

34. Në lidhje më këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka theksuar se Gjykata Themelore në Gjilan me mosdorëzimin e Aktgjykimit, C. nr. 381/14, atij i ka shkelur të drejtën për mjet juridik, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës.

35. Gjykata vëren se më 20 maj 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën e Apelit ku procedura është në vazhdim e sipër.

36. Gjykata më tej rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

37. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar

shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i vendit siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Aktvendimi për papranueshmëri, *AAB-RIINVEST Universiteti SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës* së Kosovës, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendim i 28 korrikut 1999).

38. Rrjedhimisht, Gjykata është e mendimit se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores.

39. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

40. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme ose të urdhërojë Gjykatën Komunale në Gjilan të pezullojë të gjitha procedurat në lidhje me përmbarimin e vendimit me numër C. nr. 381/2014, derisa të vendoset në mënyrë meritore në lidhje me këtë kërkesë.

41. Për të lejuar Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të përcaktojë:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme.

(c) masa e përkohshme është me interes publik".

42. Siç është konkluduar më parë, kërkesa është e papranueshme, prandaj kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin36(1) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 18 dhjetor 2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI100/15, Parashtruesit e kërkesës: Nurten Luboteni, Gazmend Luboteni, Suna Buqinca, Lulieta Hoxha, Mytaher Luboteni, Valbon Luboteni, Veton Luboteni, Diellza Luboteni, Rona Luboteni, Edi Luboteni dhe Bashkim Spahiju, të cilët kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0314, të 23 dhjetorit 2014.

KI100/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2015, i publikuar më 11 shkurt 2016.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, e paafatshme.

Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Paraardhësit ligjor të parashtruesve të kërkesës kanë iniciuar në Gjykatën Komunale në Prizren procedurën gjyqësore për anulimin e kontratës së shitblerjes së pronës. Procedurat gjyqësore u zhvilluan në instanca të ndryshme deri te Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme. Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-I-14-0314) e refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë, ndër të tjera, se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme i shkeli të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të drejtat e garantuara me nenin 1 të Protokollit numër 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 janar 2015. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë më 23 korrik 2015, pra, kanë kaluar më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur Aktgjykimi u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës. Kërkesa është e papranueshme sepse është parashtruar jashtë afatit.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin Nr. KI100/15
Parashtrues
Nurten Luboteni, Gazmend Luboteni, Suna Buçinca, Lulieta Hoxha, Mytaher Luboteni, Valbon Luboteni, Veton Luboteni,Diellza Luboteni, Rona Luboteni, EdiLuboteni dhe Bashkim Spahiu

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0314, të 23 dhjetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nurten Luboteni, Gazmend Luboteni, Suna Buçinca, Lulieta Hoxha, Mytaher Luboteni, Valbon Luboteni, Veton Luboteni, Diellza Luboteni, Rona Luboteni, Edi Luboteni dhe Bashkim Spahiu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga avokati z. Mas-har Pirana.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-14-0314 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme), të 23 dhjetorit 2014.

3. Vendimi i kontestuar u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 janar 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë shkelur e drejta e parashtruesve për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 korrik 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 9 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 11 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 22 dhjetor2015,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 21 prill 2009, paraardhësit ligjor të parashtruesve të kërkesës kanë iniciuar në Gjykatën Komunale në Prizren procedurën gjyqësore për anulimin e kontratës së shitblerjes së pronës.

11. Procedurat gjyqësore u zhvilluan në instanca të ndryshme deri te Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme.

12. Në të vërtetë, më 23 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-I-14-0314), refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

13. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *"u janë shkelur të drejtat elementare kushtetuese të tyre në mbrojtjen e të drejtave në pronë e në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të drejtave të garantuara me nenin 1 të Protokollit numër 1. të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut"*.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]"*.

16. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> ...
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose [...]"*.

17. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 janar 2015. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë më 23 korrik 2015. Pra, më shumë se 4 (katër) muaj kanë kaluar nga dita kur Aktgjykimi u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës.

18. Gjykata konsideron se kërkesa është e paafatshme.

19. Prandaj, Gjykata konkludon se në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin49të Ligjitdhe me rregullin36(1) (c) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 22 dhjetor2015,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI132/15, Parashtrues Manastiri i Deçanit, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

KI132/15, Vendim për vazhdim të masës së përkohshme i miratuar më 10 shkurt 2016 dhe publikuar më 12 shkurt 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, masa të përkohshme, kërkesë e pranueshme, res judicata, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, Kolegji i Apelit*

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme kishte vendosur në një kontest pronësor ndërmjet parashtruesit dhe palëve të treta në favor të parashtruesit dhe ai vendim kishte marrë formë të prerë *res judicata*. Palët e treta, ndërkohë, paraqitën ankesë tek Kolegji i Apelit që e pranoi ankesën e palëve të treta dhe konstatoi se ankesa ishte bazuar, anuloi vendimet e mëparshme për atë çështje dhe konstatoi se Dhoma e Posaçme nuk ishte kompetente për ta gjykuar atë çështje. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese kryesisht për shkelje të parimit *res judicata* nga Kolegji i Apelit, asnjë nga palët e treta nuk kishte të drejtë ankimi pasi që ata në instancën e fundit ishin deklaruar si persona të cilët nuk ishin të autorizuar në procedurë, dhe se Kolegji i Apelit nuk kishte të drejtë të shqyrtonte parashtresat e tyre. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e masave të përkohshme dhe pezullimin e procedurave gjyqësore deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese duke vlerësuar rrethanat e rastit mori vendim për vazhdim të masës së përkohshme deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për çështjen që ishte objekt shqyrtimi kushtetues.

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KI132/15
Parashtrues
Manastiri i Deçanit
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Manastiri i Deçanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Dragutin (Sava) Janjić, kryemurg i Manastirit të Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston dy vendime, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, që të dyja të 12 qershorit 2015, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), vendime këto që parashtruesit i janë dorëzuar më 9 korrik 2015.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të lartpërmendura, me të cilat pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata të vendos Masë të përkohshme, respektivisht të pezullohet çdo procedurë gjyqësore, veprim apo vendim i autoriteteve publike në lidhje me këtë ankesë kushtetuese deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) përkitazi me këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 4 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI132/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, me Vendimin KSH. KI132/15, Kryetarja e Gjykatës e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 4 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Po të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Dhoma e Posaçme t'i sigurojë Gjykatës një listë të caktuar të dokumenteve shtesë.

9. Më 5 nëntor 2015, Dhoma e Posaçme dorëzoi dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

10. Më 9 nëntor 2015, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

11. Më 12 nëntor 2015, gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e Masës së përkohshme. Në të njëjtën datë, Gjykata vendosi njëzëri ta miratojë Masën e përkohshme deri më 29 shkurt 2016.

12. Më 3 dhjetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme lidhur me Vendimin për Masë të përkohshme. Në të njëjtën datë, Gjykata po ashtu e njoftoi Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Deçan, Ndërmarrjen shoqërore (NSH) Bletaria "Apiko", Ndërmarrja hoteliere turistike "Iliria" (NSH) dhe komunën e Deçanit lidhur me Vendimin për Masë të përkohshme.

13. Më 25 janar 2016, Gjykata pranoi dy shkresa nga NSH Bletaria "Apiko" dhe nga (NSH) Ndërmarrja hoteliere turistike "Iliria", ku autorizohet z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, t'i përfaqësojë ato pranë Gjykatës. Gjithashtu, dy NSH-të kërkuan nga Gjykata që t'u ofrojë një kopje të kërkesës dhe t'u lejohet mundësia për të paraqitur komentet e tyre lidhur me kërkesën.

14. Më 2 shkurt 2016, Gjykata u përgjigj në kërkesën e dy NSH-ve të 25 janarit 2016, dhe i ftoi ato të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën, deri më 16 shkurt 2016.

15. Më 10 shkurt 2016, gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës që të miratohet vazhdimi i kohëzgjatjes së Masës së përkohshme. Në të njëjtën datë, Gjykata vendosi njëzëri të miratojë vazhdimin e Masës së përkohshme deri më 31 maj 2016.

Përkitazi me vazhdimin e Masës së përkohshme

16. Gjykata i referohet Vendimit të saj për Masën e përkohshme të 12 nëntorit 2015, në Rastin KI132/15.

17. Gjykata u ka lejuar palëve të interesuara të dorëzojnë komente të mëtejme përkitazi me pranueshmërinë dhe meritat e rastit, dhe do t'i lejojë parashtruesit të kërkesës mundësinë të komentojë lidhur me parashtresat e tilla që mund t'i dorëzohen Gjykatës.

18. Rrjedhimisht, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejmë që do të nxirret nga Gjykata në të ardhmen, përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kërkesës, Gjykata vendos që Masa e përkohshme e miratuar të vazhdohet deri më 31 maj 2016.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullave 55 dhe 56 të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA VAZHDOJË Masën e përkohshme të miratuar më 12 nëntor 2015, respektivisht, të pezullojë çdo procedurë gjyqësore, veprim ose vendim të autoriteteve publike lidhur me këtë ankesë kushtetuese;

II. Kjo Masë e përkohshme të vazhdohet deri më 31 maj 2016;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI41/15, Parashtrues i kërkesës: Xheladin Berisha, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 27/2015, të 12 shkurtit 2015

KI41/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 korrikut 2015, i publikuar më 18 shkurt 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, pensioni invalidor, qartazi e pabazuar*.

Parashtruesi parashtroi kërkesë në Fondin Pensional të Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) për t'ia njohur të drejtën e tij për pension invalidor. Punëdhënësi miratoi kërkesën e parashtruesit për pension invalidor, duke filluar nga 1 dhjetori 2005 e deri më 1 janar 2011 (Vendimi nr. 188/1).

Më 5 janar 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë te punëdhënësi për vazhdimin e pensionit invalidor ose për kthimin e tij në punë. Meqenëse parashtruesi nuk ka marrë përgjigje nga punëdhënësi, ai parashtroi padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 21 janar 2011. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se *„Në bazë të vendimeve gjyqësore që nga vendimi i Gjykatës Komunale e gjerë të Gjykatës Supreme, vendimet janë në favor timin, por gjerë më tani nuk kam mundur ti realizoj të drejtat e mia elementare nga marrëdhënia e punës. Në bazë të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI41/15
Parashtrues
Xheladin Berisha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2015, të 12 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Xheladin Berisha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Shtitaricë, komuna e Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2015, të 12 shkurtit 2015, i cili i është dorëzuar më 24 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjesështëvlerësimi i kushtetutshmërisë sëAktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2015, me të cilin pretendohet të jetë shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 mars 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI41/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI41/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 1 qershor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesi që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim për z. Zanfir Kryeziu dhe ta sqarojë kërkesën e tij duke saktësuar vendimin e fundit, të cilin ai e konteston. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 4 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se ai e kishte revokuar autorizimin për z. Zanfir Kryeziu dhe dorëzoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2015, të 12 shkurtit 2015.

9. Më 1 korrik2015,Kryetarja e Gjykatës caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalovićanëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të ish-kryetarit Enver Hasanit, mandati i të cilitsigjyqtariGjykatësKushtetueseka përfunduarmë 26 qershor2015.

10. Më 8 korrik2015,Kolegji shqyrtues miratoi raportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 nëntor 2005, parashtruesi parashtroi kërkesë në Fondin Pensional të Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) për t'ia njohur të drejtën e tij për pension invalidor.

12. Më 24 nëntor 2005, punëdhënësi miratoi kërkesën e parashtruesit për pension invalidor, duke filluar nga 1 dhjetori 2005 e deri më 1 janar 2011 (Vendimi nr. 188/1).

13. Më 5 janar 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë te punëdhënësi për vazhdimin e pensionit invalidor ose për kthimin e tij në punë. Meqenëse parashtruesi nuk ka marrë përgjigje nga punëdhënësi, ai parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 21 janar 2011.

14. Më 27 shkurt 2012, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 113/11), refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Gjykata Komunale konstatoi se punëdhënësi i kishte plotësuar tërësisht obligimet ndaj parashtruesit të kërkesës, të parapara me Vendimin nr. 188/1, të 24 nëntorit 2005. Prandaj, kërkesa e parashtruesit që të vazhdohet me pagesën e pensionit suplementar deri në moshën e pensionimit, ishte e pabazuar.

15. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

16. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 4585/2012) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 113/11, të 27 shkurtit 2012. Gjykata e Apelit e Kosovës vlerësoi se marrëdhënia e punës, në pajtim me vullnetin e palëve, ishte transformuar në një marrëdhënie kontraktuese, ku punëdhënësi ishte obliguar t'ia paguante parashtruesit të kërkesës pensionin invalidor brenda një periudhe prej 5 (pesë) vjetësh. Ky obligim ishte plotësuar nga punëdhënësi.

17. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 27/2015) refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion si të pabazuar. Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi i kërkesës ishte pensionuar në bazë të kërkesës së tij dhe ai nuk parashtroi asnjë ankesë te Komisioni për Rishqyrtimin e Kontesteve kundër vendimit për pension invalidor. Gjykata Supreme konstatoi se punëdhënësi kishte përmbushur obligimin e tij ndaj parashtruesit të kërkesës në pajtim me vendimin për pension invalidor, të 24 nëntorit 2005.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi, në kërkesën e tij, thekson si në vijim: *"Në bazë të vendimeve gjyqësore që nga vendimi i Gjykatës Komunale e gjerë të Gjykatës Supreme, vendimet janë në favor timin, por gjerë më tani nuk kam mundur ti realizoj të drejtat e mia elementare nga marrëdhënia e punës. Në bazë të dispozitave të Kushtetutës së Rep. Kosovës".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Për të qenë në gjendje të gjykojëkërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutëdhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

22. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat parashohin:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
>
> *c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
>
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

23. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Rev. nr. 27/2015, të 12 shkurtit 2015) ishte shkelur e drejta e tij e punës.

24. Gjykata rikujton se, nërastet e tjera (p. sh. KI40/09), kishtevendosur për kompensimin e përkohshëmpër ndërprerjen e punësimitnga ana eKEK-ut. Megjithatë, Gjykata vëren sekërkesae tanishme,KI41/15,ndryshon ngarastet elartpërmendura(p. sh. KI40/09). Në të vërtetë, në këto raste, KEK-udheish-punonjësit e nënshkruan një marrëveshje përkompensimine përkohshëmderi në themelimin eFonditPensionalInvalidortëKosovës, pramenjë referencë përnjë datëtë pacaktuar,ndërsa, në rastine tanishëm,KI41/15, KEK-udheish-punonjësit nënshkruan një marrëveshje përkompensimtë përkohshëmpërnjë afatpesëvjeçar, praduke iu referuar njëdate të caktuar(Shih rastin KI50/14, Parashtrues i kërkesës:*ShemsiBekteshi*,Aktvendimpërpapranueshmëri, i10 nëntorit 2014).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsye të qarta për vendimet e tyre dhe se vetë parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për pension invalidor, me të cilën është pajtuar punëdhënësi në afat prej 5 (pesë) vjetësh.

26. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk kishte ofruar dëshmi për të treguar se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij.

27. Gjykata thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren ngaGjykata Supreme. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra eGjykatës Kushtetuese është tëkonstatojë nëseprocedurate gjykatave të rregullta ishin të drejta nëtërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën në tëcilën janë marrëato dëshmi(Shih Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

28. Sa i përket rastit konkret, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse në gjykatat e rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*,*Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim për pranueshmëri të kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

29. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d), 36 (2) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 8 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI125/15, Parashtrues Safet Elshani dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ-UZVP nr. 19/2015, të 28 majit 2015

KI125/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 shkurtit 2016, publikuar më 25 shkurt 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojta e pronës, ekspropriimi, refuzim i kërkesës për masë të përkohshme, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesit pretendonin se gjykatat e rregullta ua shkelën të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]. Parashtruesit, gjithashtu pretendonin shkeljen e nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe shkeljen e nenit 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Kjo për faktin se gjykatat e rregullta hodhën poshtë kërkesat e tyre si të paafatshme. Më tej, parashtresat argumentuan se në bazë të nenit 34 të Ligjit nr. 12/57 për Eksproprijimet e Republikës Federative të Jugosllavisë, nuk ishte sanksionuar afati për paraqitjen e kërkesës, për anulimin e vendimit mbi shpronësimin, duke pretenduar se ata dorëzuan kërkesën e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit të lartpërmendur në gjykatën e rregullt.

Gjykata, pasi analizoj pretendimet e parashtruesve erdhi në përfundim se faktet e paraqitura, në asnjë mënyrë nuk i arsyetonin shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese në të cilat thirreshin parashtruesit e kërkesës dhe se ata nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre dhe nuk argumentuan me tej se si dhe pse u shkelen të drejtat e tyre. Si përfundim, kërkesa u deklarua qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin Nr. KI125/15
Parashtrues
Safet Elshani dhe të tjerët
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ-UZVP nr. 19/2015, të 28 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga 6 (gjashtë) parashtrues, respektivisht nga z. Safet Elshani, nga z. Ismet Elshani, nga z. Bektash Elshani, nga z. Zymer Elshani, nga z. Mehmet Elshani dhe nga z. Imer Elshani, me vendbanim në Suharekë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Ata përfaqësohen nga z. Zef Delhysa, avokat në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ-UZVP nr. 19/2015 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 28 majit 2015, i cili u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 16 qershor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesve të kërkesës kundër Aktgjykimit (AA. nr. 111/2014, të 24 shkurtit 2015) të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), në lidhje me anulimin e vendimit për ekspropriim.

4. Parashtruesit pretendojnë se gjykatat e rregullta ua kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]. Parashtruesit gjithashtu pretendojnë shkeljen e nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së; dhe shkeljen e nenit 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

5. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendos Masë të përkohshme, përkatësisht ta urdhërojë

Komunën e Suharekës të ndalojë qasjen, përdorimin ose ndonjë aktivitet tjetër të ndërtimit në pronën e paluajtshme e cila është objekt i kontestit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 15 tetor 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë përmes postës.

8. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI125/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja me Vendimin, KSH. KI125/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

9. Më 4 dhjetor 2015, Gjykata i informoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi qëata të dorëzojnë autorizimin për z. Zef Delhysa, në rast se ata vendosin që të përfaqësohen nga ai. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 14 dhjetor 2015, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan autorizimin në Gjykatë.

11. Më 18 dhjetor 2015, parashtruesit e kërkesës dorëzuan një dokument shtesë me të cilin kërkuan nga Gjykata që të vendos Masë të përkohshme.

12. Më 25 janar 2016, Gjykata i dërgoi një letër Gjykatës Themelore në Prishtinë duke kërkuar një kopje të fletëkthesës, me të cilën konfirmohet dita kur parashtruesit e kërkesës e pranuan vendimin e kontestuar.

13. Më 26 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë.

14. Më 8 shkurt 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

15. Babai i ndjerë i parashtruesve të kërkesës kishte të drejtat e pronësisë mbi një tokë që ndodhet në Komunën e sotme të Suharekës.

16. Më 17 dhjetor 1962, Sekretariati Krahinor për Punë dhe Financa (Vendimi Nr. 03-6091/62) shpronësoi tokën e babait të ndjerë të parashtruesve me qëllim të krijimit të një tregu të perimeve në Suharekë.

17. Më 9 shkurt 2010, parashtruesit si trashëgimtarë të tokës së atit të tyre të ndjerë, parashtruan kërkesë në Komunën e Suharekës, me të cilën kërkuan anulimin e vendimit të lartpërmendur për shpronësim.

18. Më 2 mars 2010, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Suharekës (në tekstin e mëtejmë: Drejtoria e UKPMM), me Vendimin Nr. 07-465-71, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesve si të pabazuar. Ajo e bazoi vendimin e saj në faktin se parashtruesit e kërkesës kanë humbur afatin e parashikuar me ligj për të kërkuar një anulim të tillë.

19. Parashtruesit e kërkesës u ankuan kundër vendimit të lartpërmendur në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AKK).

20. Më 20 maj 2010, AKK-ja (Aktvendimi nr. 03/432/10) refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar. AKK-ja vërtetoi Vendimin e Drejtorisë së UKPMM duke deklaruar se ajo kishte respektuar ligjin në fuqi, sipas të cilit pala e interesuar nuk mund të kërkojë anulimin e një vendimi për shpronësim pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) vite nga dita që është bërë i plotfuqishëm.

21. Të pakënaqur me përfundimin e procedurës në Drejtorinë e UKPMM-së dhe AKK-së, parashtruesit e kërkesës iniciuan konflikt administrativ duke kontestuar Aktvendimin (Nr. 03/432/10, të 20 majit 2010) të AKK-së.

22. Më 16 janar 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi, A. Nr. 569/10) refuzoi padinë e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar. Ajo arsyetoi se kërkesa e parashtruesve për anulimin e vendimit për shpronësim është dorëzuar *"përtej çdo afati ligjor të mundshëm"*.

23. Parashtruesit parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale. Sipas parashtruesve të kërkesës, ligji i zbatueshëm nuk parashihte një afat kohor për parashtrimin e një kërkese për anulimin e vendimit për shpronësim.

24. Më 24 shkurt 2015, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e paditësve si të pabazuar. Ajo arsyetoi se Gjykata Themelore në Prishtinë kishte zbatuar drejt të drejtën materiale duke aplikuar nenin 21.5 të Ligjit për shpronësimet (Gazeta Zyrtare Nr. 21/78). Sipas kësaj dispozite ligjore, Gjykata e Apelit më tej arsyetoi se të gjitha palët e interesuara mund ta kontestojnë vendimin për shpronësim në afat prej 10 (dhjetë) vitesh nga momenti kur një vendim i tillë ishte bërë i ekzekutueshëm. Gjykata e Apelit më tej vazhdoi se me ndryshimin e këtij ligji, ishte paraparë që afati i fundit për të dorëzuar kërkesë të tillë është reduktuar në 5 (pesë) vjet.

25. Kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe përmban shkelje procedurale. Ata kërkuan nga Gjykata Supreme ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe ta kthejë çështjen për rigjykim.

26. Më 28 maj 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi ARJ-UZVP nr. 19/2015) e refuzoi kërkesën e parashtruesve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm si të pabazuar dhe konstatoi se:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës [...] qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë në tërësi e aprovon si të rregullt dhe të drejtë. [...] Në bazë të nenit 21.4 të Ligjit për Ekspropriiim nr. 21/78 pasi të kalojnë 10 vjet nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi ekspropriiimin, nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi. [...] Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme nuk gjeti që të vendos ndryshe nga ajo që vendosi gjykata e shkallës së dytë, e që e refuzoj si të pabazuar ankesën e paditësve. [...]".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesit pretendojnë se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së dhe nenit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së; dhe të drejtën e tyre në bazë të nenit 17 të DUDNJ-së.

28. Në mbështetje të shkeljeve të pretenduara lidhur me respektimin e të drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së, parashtruesit deklaruan se: *"[...] kërkesa e parashtruesve bazohet në ligj, të cilat dispozitat ligjore organet e të gjitha distancave në këtë qështje juridike e kanë cenuar [...]".*

29. Në këtë drejtim, ata më tej pretendojnë se në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 12/57 për Ekspropriiimet e Republikës Federative të Jugosllavisë *"nuk është sanksionuar afati për paraqitjen e kërkesës për anulimin e vendimit mbi shpronësimin"*. Prandaj, duke pasur parasysh se nuk kishte kufizim të afatit kohor, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata kanë dorëzuar kërkesën e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit të lartpërmendur.

30. Në fund, parashtruesit e kërkesës përfundojnë duke kërkuar nga Gjykata si në vijim:

> "*Me anë të kësaj kërkese apelohet Gjykata Kushtetuese që të marr VENDIM duke shpallur aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP. nr. 19/20 15 dt.28.05.2015, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. nr. 111/2014 të dt.24.02.20 15, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për çështje administrative A. nr. 569110, dt.16.01.2014, Aktvendimin e Agjencisë kadastrale të Kosovës nr. 03/432/10 dt.20.0S. 2010, si dhe Aktvendimin e Drejtorisë për Urbanizëm kadastër pronë dhe mbrotje të mjedisit 07 nr. 465-71 dt.02.03.2010, kundërkushtetuese, me propozim që në procedurën e rivendosjes apo rigjykimit të eliminohen cenimet e cekura dhe të vërtetuara nga Gjykata kushtetuese".*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[…]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
> *[…]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

33. Siç u cek më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi (ARJ-UZVP Nr. 19/2015, i 28 majit 2015) i Gjykatës Supreme është marrë me shkelje të së *"drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; parimet e përgjithshme dhe mbrojtjen e pronës",* siç janë të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollin nr. 1, dhe DUDNJ. Për më tepër, parashtruesit gjithashtu pretendojnë se Aktgjykimi (AA. nr. 111/2014, i 24. shkurtit 2015) i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi (A. nr. 569/10, i 16 janarit 2014) i Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjithashtu ishin nxjerrë me shkeljen e të drejtave të tilla.

34. Në lidhje me*"të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm"* dhe *"parimet e përgjithshme"*, parashtruesit e kërkesës thjesht iu referohen neneve përkatëse të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Ata nuk japin ndonjë arsyetim të mëtejshëm se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tilla nga gjykatat e rregullta.

35. Sa i përket të drejtës për *"mbrojtjen e pronës",* parashtruesit pretendojnë se gjykatat e rregullta gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale pasi që *"ligji i zbatueshëm nuk ka paraparë një afat ligjor për parashtrimin e kërkesës për anulimin e një vendimi për shpronësim".*

36. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi, kur kanë refuzuar kërkesën e parashtruesve për anulimin e vendimit për shpronësim. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se çështjet që parashtruesit ngrenë janë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë.

37. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkelje të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata e Apelit kur ajo refuzoi ankesën e tyre të parashtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata Supreme theksoi se "*gjykatat e shkallës së dytë drejt kanë aplikuar dispozitat e procedurës administrative, Ligjit për konfliktin administrativ dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ekspropriim, me që paluajtshmëria e paditësve është ekspropriuar në vitin 1659* **[1962]***, ndërsa paditësit kanë kërkuar anulimin e vendimit mbi ekspropriimin pas kalimit të afatit […]".*

38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

39. Gjykata Kushtetuese thekson më tej se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e

rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë, se parashtruesit nuk janë të kënaqur me rezultatin e rastit, nuk do të thotë që ata nuk mund të ngrenë kërkesë të pranueshme duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ.

40. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kishin pasur mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tyre para gjykatave të rregullta. Çështja e ligjit të zbatueshëm është adresuar gjerësisht nga të gjitha gjykatat e rregullta. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesve nëse ligji i zbatueshëm kishte parashikuar një afat për të paraqitur kërkesë për anulimin e vendimit për eksproprijim apo jo.

41. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia, Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

42. Gjykata vëren se arsyetimi që i referohet kërkesës për anulimin e vendimit për eksproprijim në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

43. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese në të cilat thirren parashtruesit e kërkesës dhe se ata nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tyre.

44. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar mbi baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

45. Parashtruesit e kërkesësgjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata të vendos Masë të përkohshme, përkatësisht ta urdhërojë Komunën e Suharekës të ndalojë qasjen, përdorimin ose ndonjë aktivitet tjetër të ndërtimit në pronën e paluajtshme e cila ishte eksproprijuar në vitin 1962.

46. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës deklarojnë që:

> *"Komuna e Suharekës si institucion Kushtetues i pushtetit lokal, është njoftuar nga parashtruesit e kërkesës se të njëjtit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me kërkesë të veçantë [...].*

Komuna e Suharekës […] në paluajtshmerinë lëndore nuk ka investuar asnjë cent [EURO cent], mirëpo para 3-4 ditëve, […] të njëjtën paluajtshmëri pasi që e nivelizon e shtron me zhavorr me qëllim që e njëjta paluajtshmëri të shfrytëzohet si auto-parking. […] Komuna e Suharekës jo vetëm që nuk pret verdiktin e Gjykatës Kushtetuese në rastin konkret, por tani e nderon destinimin e theksuar si më lart[…]".

47. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se Komuna e Suharekës po ndërmerr "*vendime të paligjshme"*, të cilat mund të krijojnë *"komplikime ligjore"* të mëtejshme lidhur me këtë rast. Në mënyrë që të shmangen komplikimet e tilla që mund të shkaktojnë dëm të pariparueshëm dhe në mënyrë që mos të prodhojnë më shumë tension në lidhje me situatën aktuale, parashtruesit pretendojnë se Masa e përkohshme duhet të jepet nga Gjykata.

48. Në mënyrë që Gjykata të vendos Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, nevojitet që:

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; ose

(…) Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

49. Siç u theksua më lart, parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47.2 të Ligjit, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d), 55 (4) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 shkurt 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Arta Rama-Hajrizi

KI70/15, Parashtrues Nada Zvezdic, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, C-III-12-1681, të 4 nëntorit 2013

KI70/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2016, publikuar me 25 shkurt 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, e drejta për mjete juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojta e pronës, kërkesë e parakohshme, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesja, në këtë rast kryesisht ankohej për zvarritjen e zgjidhjes së kontesteve pronësore, të cilat ishin në pritje prej 12 vitesh për tu vendosur në gjykatat e rregullta, duke aluduar në shkeljet te nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për një Gjykim te Drejte dhe te Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për te Drejtat e Njeriut], nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e te Drejtave], të Kushtetutës, si dhe me nenin 6.1, ne lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në ketë rast, Gjykata, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, konsideroi se gjykatës së rregullt duhet t'i ofrohet mundësia e vendosjes përfundimtare për çështjen e cila pritej te shqyrtohej para saj. Prandaj, kërkesa u konsiderua e parakohshme dhe rrjedhimisht e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI70/15
Parashtrues
Nada Zvezdić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, C-III-12-1681, të 4 nëntorit 2013
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Nada Zvezdić, me banim në Kragujevc, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (C-III-12-1681, të 4 nëntorit 2013) (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar).

3. Parashtruesja e kërkesës nuk ka përmendur ditën kur i është dorëzuar vendimi i kontestuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkese, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të garantuara me nenet: 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6.1, në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji*)* dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë:Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 qershor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 13 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës. Një kopje e kërkesës iu dërgua Kolegjit të Specializuar.

9. Më 7 tetor 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesja të dorëzojë informata dhe sqarime shtesë brenda afatit kohor prej 7 (shtatë) ditëve.

10. Parashtruesja nuk e dorëzoi informatën dhe sqarimin e kërkuar.

11. Më 25 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 8 janar 1998, parashtruesja së bashku me 10 (dhjetë) individë të tjerë parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (P. nr. 1402/92, P. nr. 60/97, P. nr. 2/98 dhe P. nr. 5/98), kundër të paditurve: SHA "Ereniku", NSH "Prodhimtaria Primare" në Gjakovë dhe Komunës së Gjakovës. Ata kërkuan anulimin e kontratës mbi dhuratën e pronës së paluajtshme dhe vërtetimin e pronësisë së tyre, e cila tani është e regjistruar në emër të të paditurës së parë SHA "Ereniku".

13. Më 23 gusht 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktvendimi C. nr. 85/2007) e shpall veten jokompetente për zgjidhjen e kërkesës dhe vendos që lëndën t'ia dërgojë Kolegjit të Specializuar. Në të vërtetë, lënda iu referua Kolegjit të Specializuar më 22 tetor 2012.

14. Më 4 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar (Aktvendimi C-III-12-1681) vendosi që *"procedura në padinë e Aleksander Zvezdić dhe të tjerët kundër të paditurës 'Ereniku' pezullohet derisa Dhoma e Posaçme të përcaktojë statusin e të paditurës 'Ereniku' në lëndën nr. SCC-08-0124 me anë të aktvendimit përfundimtar dhe të zbatueshëm".*

15. Për më tepër, Kolegji i Specializuar shpjegoi se "*Dhoma e Posaçme e ka një lëndë në pritje e cila ka të bëjë me statusin juridik të NSH-së së paditur 'Ereniku'. Padia është regjistruar nën numrin SCC-08-0124. [...]... Prandaj, së pari duhet të përcaktohet statusi juridik i të paditurës 'Ereniku' në mënyrë që të dihet përfundimisht nëse 'Ereniku' është NSH; pra, nëse është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në mënyrë që Dhoma e Posaçme të mund të vendos nëse e paditura mund të ketë statusin ligjor të së paditurës në një padi pranë Dhomës së*

Posaçme, që është një nga elementet e rëndësishme të kritereve të pranueshmërisë së padisë".

16. Përveç kësaj, Kolegji i Specializuar theksoi që "*Në pajtim me nenin 10.6 të Ligjit të Dhomës së Posaçme 04/L-033, pala ka të drejtë të apelojë ndaj aktgjykimit apo aktvendimit (...) tek Kolegji i Apelit (...) brenda 21 (njëzetenjë) ditësh.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja kryesisht ankohet për zvarritjen e zgjidhjes së kontesteve pronësore, të cilat janë në pritje qe 12 (dymbëdhjetë) vjet.

18. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës, *inter alia*, pretendon se "*në qoftë se patundshmëritë, të cilat janë lëndë të kontesteve, shiten sipas procedurave të tenderëve të privatizimit, nëpërmjet Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, kontestet bëhen të diskutueshme, dhe ne do të privohemi nga prona e patundshme, si pasojë e mosaktivitetit të gjykatave, të cilat i punojnë lëndët tona".*

19. Parashtruesja e kërkesës konkludon se parashtrimi i kërkesës është bërë *"për shkak të shkeljes të drejtës për gjykim të drejtë (neni 6.1 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), e drejta për zgjidhje efektive juridike (nenet 6.1 dhe 13 të KEDNJ-së) dhe e drejta për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm (neni 6.1 i KEDNJ-së)".*

20. Për më tepër, parashtruesja përmend se "*Ne nuk i kemi shteruar mjetet juridike siç kërkohet",* sepse *"Është e qartë se në rastin konkret shterimi i mjeteve të mundshme juridike do të ishte joefektiv".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Gjykata vëren paraprakisht se nuk është përmendur data e vendimit të kontestuar. Megjithatë, për shkak të natyrës së ankesës (mosshterimit), Gjykata konsideron se ky lëshim është i parëndësishëm për vendimin që do të merret.

23. Gjykata më tej vëren se parashtruesja ankohet përkitazi me tejzgjatjen e procedurave, respektivisht vonesën e vendosjes lidhur me kontestet pronësore nga gjykatat, duke iu referuar dispozitave të ndryshme kushtetuese përkitazi me të drejtat themelore të njeriut, të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

24. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se duhet të përmbushen disa kritere të caktuara përkitazi me pretendimin për shkelje të të drejtës për një vendim gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm, siç janë: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e parashtruesit, sjellja e autoriteteve gjyqësore apo administrative në raport me kërkesat e parashtruesit, si dhe ekzistenca e lidhjes në mes të procedurave të ndryshme.

25. Gjykata konsideron se i mbetet parashtrueses së kërkesës ta dëshmojë pretendimin dhe të paraqesë prova relevante dhe përkatëse, në mënyrë që ankesa të jetë e bazuar.

26. Megjithatë, parashtruesja nuk i mbështeti dhe dëshmoi pretendimet e saj. Në të vërtetë, parashtruesja nuk tregon se ajo ishte ankuar në gjykatën e rregullt për zgjatjen e procedurës. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës nuk kishte parashtruar ankesë te Kolegji i Apelit kundër vendimit për pezullimin e rastit dhe rrjedhimisht zvarritjes së zgjidhjes së rastit të saj.

27. Prandaj, Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse pretendimet e parashtrueses së kërkesës janë të bazuara dhe paraqesin bazë kushtetuese për shkeljen e të drejtës së saj për zgjidhje efektive juridike dhe të drejtën për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

28. Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

29. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"Gjykata mund ti shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".*

31. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar (Aktvendimi C-III-12-1681, i 4 nëntorit 2013), ka pezulluar gjykimin e çështjes deri në vendosjen për statusin e të paditurës SHA "Ereniku" (lënda në pritje SCC-08-0124) me aktvendim të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm.

32. Gjykata verën se parashtruesja është e vetëdijshme përkitazi me kriteret e shterimit të mjeteve juridike të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Megjithatë, parashtruesja menjëherë e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, me pretendimin se *"mjetet juridike në dispozicion do të ishin joefektive".*

33. Sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar shpjegoi se rasti "*është pezulluar deri sa Dhoma e Posaçme të përcaktojë statusin e të paditurës "Ereniku*". Prandaj, Kolegji i Specializuar konsideron se nuk mund të merret një vendim për rastin e parashtrueses pa u përcaktuar fillimisht statusi i të paditurës "Ereniku". Prandaj, referimi në rastet e GJEDNJ-së nga parashtruesja e kërkesës nuk mund të jenë të aplikueshme në rrethanat e rastit të saj.

34. Gjykata konsideron që rasti i parashtrueses nuk është vendosur përfundimisht nga Kolegji i Specializuar, për shkak të arsyeve të lidhura me kompleksitetin e rastit.

35. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në pajtim me parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta duhet t'u ofrohet mundësia e vendosjes përfundimtare për çështjen deri në shqyrtimin e tyre. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtave të njeriut, në

përgjithësi, nuk duhet të lejohet që të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet më parë nga gjykatat e rregullta.

36. Parimi i shterimit të mjeteve juridike (që ka të bëjë me parimin e subsidiaritetit) kërkon që parashtruesi t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurat në gjykatat e rregullta, para se ato të vijnë në Gjykatë. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës ofron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të kërkesës kushtetuese (Shih Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI07/09, *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18, Aktvendim për papranueshmëri në Rastin KI41/09, *AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinëkundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, Nr. 25803/94, , Vendim i 28 korrikut 1999).

37. Prandaj, Gjykata konstaton se në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, kërkesa është e parakohshme, dhe për këtë arsye e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 25 janar 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI126/15, Parashtrues i kërkesës: Hajzer Aliu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 106/2015, të 6 majit 2015

KI126/15, aktvendim për papranueshmëri i 26 janarit 2016, të publikuar më 29 shkurt 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, parashkrimi fitues (usucapio), mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar*

Më 6 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Rev. nr. 106/2015), refuzoi kërkesën për revizion dhe e vërtetoi Aktgjykimin (Ac. nr. 1824/2012) e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është zgjidhur kontesti pronësor juridik i vërtetimit të të drejtave të pronësisë mbi tokën ndërtimore, e cila ishte regjistruar si pronësi shoqërore e Komunës së Skenderajt.
Parashtruesit i kërkesës në thelb pretendoi se ai e ka fituar të drejtën pronësore përmes parashkrimit fitues (usucapio) në pronën shoqërore. Të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës në thelb konsistojnë në zbatimin e gabuar të nenit 29 të LTHMJP-së, dhe se, për shkak të interpretimit të tillë të gabueshëm të ligjit janë shkelur nenet 31, 46, 53 dhe 54 të Kushtetutës dhe neni 6 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.
Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin qe ai e kundërshton janë administruar hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedura pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishte e drejtë. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI126/15
Parashtrues
Hajzer Aliu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 106/2015, të 6 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Hajzer Aliu nga Skënderaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati, z. Adem Vokshinga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 106/2015, të 6 majit 2015), të cilin e ka pranuar më 25 qershor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës. Parashtruesi i kërkesës konsideron se në procedurat pranë gjykatave të rregullta është bërë shkelja e neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI126/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI126/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 24 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të pacaktuar në vitin 1983, toka ndërtimore e cila ishte e evidentuar si pronë shoqërore e Komunës së Skënderajt është dhënë për shfrytëzim të ndërmarrjes OP "Prvi Maj" në mënyrë që të zhvillojë veprimtari për prodhimin e blloqeve ndërtimore.

10. Përfaqësuesi ligjor i ndërmarrjes OP "Prvi Maj" (në tekstin e mëtejmë: OP "Prvi Maj") ishte në atë kohë parashtruesi i kërkesës.

11. OP "Prvi Maj", në pajtim me lejen e ndërtimit të lëshuar më parë e ndërtoi një fabrikë për prodhimin e blloqeve të ndërtimit në tokën ndërtimore që ishte e evidentuar si pronë shoqërore e Komunës së Skënderajt.

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ndërtoi një ndërtesë banesore pa leje të ndërtimit, shtëpi në sipërfaqe prej 133.80 m² në tokën ndërtimore që i ishte dhënë në shfrytëzim OP "Prvi Maj" dhe e evidentuar si pronë shoqërore e Komunës së Skënderajt.

13. Në një datë të pacaktuar në vitin 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Skënderaj duke kërkuar që të vërtetohet se parashtruesi përmes parashkrimit, si posedues në mirëbesim, u bë pronar i ngastrave kadastrale në të cilat ndërtoi objektin e banimit, shtëpi me sipërfaqe prej 133,80 m².

14. Më 24 qershor 2010, Gjykata Komunale në Skënderaj me Aktgjykim (C. nr. 195/2009) e refuzoi në tërësi, si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar se:

> *"neni 29 i Ligjit mbi marrëdhëniet juridiko-pronësore të RSFJ-së në mënyrë të qartë përcakton se e drejta e pronësisë me parashkrim fitues nuk fitohet në pronën shoqërore".*

15. Në afatin ligjor, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit (C. nr. 195/2009) të Gjykatës Komunale në Skënderaj.

16. Më 2 shtator 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin (Ac. nr. 1824/2012) refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 195/2009) e Gjykatës Komunale në Skënderaj, të 24 qershorit 2010.

17. Në afatin ligjor, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit (Ac. nr. 1824/2012) të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

18. Më 6 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Rev. nr. 106/2015), refuzoi kërkesën për revizion dhe e vërtetoi Aktgjykimin (Ac. nr. 1824/2012) e Gjykatës së Apelit të Kosovës me arsyetim të detajuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e lartpërmendura pranë gjykatave të rregullta është bërë shkelja e neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të nenit 6 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)

20. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se gjykatat e rregullta e kanë zbatuar gabimisht nenin 29 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (në teksti e mëtejmë: LTHMJP), sepse "*me nenin16 të Ligjit mbi Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore-Juridike të RSFJ-së është shfuqizuar dispozita e nenit 29 e këtij ligji dhe atë në vitin 1996*".

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me nenin 16 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore të RSFJ-së, ishte shfuqizuar dispozita e cila ndalon fitimin e së drejtës së pronësisë në pasurinë shoqërore me parashkrim fitues (*usucapio*).

22. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se në bazë të nenit 21 të LTHMJP-së ekzistonte mundësia që e drejta e pronësisë të fitohet "*me ndërtimnë tokën e huaj*" dhe, duke pasur parasysh se neni 29 i LTHMJP-së ishte shfuqizuar, atëherë ekziston mundësia e fitimit të drejtës së pronësisë edhe në tokën shoqërore.

23. Parashtruesi i kërkesës, si bazë ligjore për njohjen e të drejtës së pronësisë cek nenin 22 të LTHMJP-së, i cili parasheh *"...Personi që me material të vet, me punë personale punon një send të ri, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send. E drejta e pronësisë mbi sendin e ri i takon pronarit nga materiali i të cilit këtë send, në bazë të veprimit juridik, e ka punuar personi tjetër...".*

24. Parashtruesi kërkon nga Gjykata ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme dhe të konstaton si në vijim:

> *"Të konstaton se ka pasur shkelje të nenit 46 (Mbrojtja e pronës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (E drejta e pronës) të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*
> *Ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për një proces të rregullt).*

Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, Rev-nr. 106/2015 të dt. 06.05.2015 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac. nr. 1824/2012 të dt. 02 shtator 2014 si dhe aktgjykimin atë të Gjykatës Komunale në Skenderaj C. nr. 195/2009 të dt. 24.06.2010".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Gjykata, gjithashtu, duhet të shqyrtojë edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

27. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
...

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

28. Gjykata vëren se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës në thelb konsistojnë në zbatimin e gabuar të nenit 29 të LTHMJP-së, dhe se, për shkak të interpretimit të tillë të gabueshëm të ligjit janë shkelur nenet 31, 46, 53 dhe 54 të Kushtetutës dhe neni 6 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

29. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi të njëjtat pretendime i paraqiti edhe në procedurën e kërkesës për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin (Rev. nr. 106/2015) të 6 majit 2015, arsyetoi në mënyrë të detajuar mënyrën në të cilën gjykata e zbatoi të drejtën procedurale dhe materiale:

"... Paditësi ka deklaruar se patundshmërinë kontestuese e shfrytëzon nga viti 1983, mirëpo deri në ndryshimin e ligjit MTHMJP në vitin 1996 të drejtën e pronësisë nuk ka mund ta fitojë me parashkrimin fitues, ndërsa nga viti 1996 e deri në kohën e ushtrimit të padisë nuk ka kaluar koha e paraparë dhe nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për fitimin e pronësisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të patundshmërinë kontestuese, andaj edhe pretendimin se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, Gjykata Supreme e vlerësoi si të pabazuar".

30. Parashtruesi i kërkesës në esencë të lëndës e kundërshton mënyrën në të cilën është aplikuar e drejta procedurale dhe materiale, dhe të cilën e kanë arsyetuar gjykatat e rregullta në tri shkallë. Ky përfundim u arrit nga gjykatat e rregullta pas shqyrtimit të detajuar të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesi dhe kështu të tri shkallët theksojnë se:

"Në situatën konkrete, paditësi që në fillim ka qenë në dijeni se po ndërton në tokën e huaj, e cila është pronë shoqërore, ashtu që nuk mund të konsiderohet se i njëjti tani këtë e ka bërë me mirëbesim" (bona fides*).*

31. Parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesë argumentet dhe dëshmitë, që ai i konsideronte relevante për rastin e tij. Njëkohësisht, ai kishte mundësi të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, si gabimisht të interpretuar, në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës në procedurë të rregullt gjyqësore.

32. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë administruar hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedura pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishte e drejtë.

33. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse ligjore (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin: nr. KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

34. Edhe pse parashtruesi pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetim të gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si vendimet e lartpërmendura kishin shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

35. Gjykata, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk mund të konkludon se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

36. Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk arriti të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, sipas rregullit 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) b) të Rregullores së punës, më 26 janar 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI55/15, Parashtrues Elife Murseli, Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri KI159/14, të 14 prillit 2015, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

KI55/15, Vendim për refuzim të kërkesës, i 18 dhjetorit 2015, publikuar më 29 shkurt 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë për rishqyrtim, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës, refuzim i kërkesës*

Parashtruesja, ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Kushtetuese me Aktvendimin për papranueshmëri, rasti KI159/14, vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta i bënë të ligjshme, ku sipas saj edhe procedurat e kundërligjshme i bënë kundërkushtetues. Parashtruesja pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe shkelje të së drejtës në punë dhe ushtrimit të profesionit, e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.

Gjykata, në këtë rast, gjeti se parashtruesja në kërkesën e tanishme për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, nuk kishte paraqitur asnjë fakt të ri apo provë të re, në bazë të së cilës do të trajtohej një çështje e cila nuk ishte trajtuar, ose ishte anashkaluar të trajtohej në procedurat e mëhershme në Gjykatë. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë kërkesë, Gjykata kishte vendosur në kërkesat e mëparshme të parashtruara nga parashtruesja. Si përfundim, Gjykata konsideroi se kërkesa e parashtrueses, është përsëritje e një kërkese të mëhershme, për çështje që tashmë kishte vendosur Gjykata.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS
në
Rastin nr. KI55/15
Parashtrues
Elife Murseli
Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri KI159/14, të 14 prillit 2015, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Elife Murseli (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja), nga fshati Doganaj, komuna e Kaçanikut, e cila përfaqësohet nga z. Rifat Abdullahi, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), në Rastin KI159/14, të 14 prillit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është rishqyrtimi i Aktvendimit për papranueshmëri i Gjykatës, në Rastin KI159/14, përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

4. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 30 prill 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 5 maj 2015, parashtruesja dorëzoi dokument shtesë në Gjykatë.

8. Më 1 qershor 2015, parashtruesja dorëzoi dokument shtesë në Gjykatë.

9. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI55/15 caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI55/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

10. Më 22 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi dorëzimin e autorizimit për përfaqësim për z. Rifat Abdullahin.

11. Më 5 gusht 2015, parashtruesja dorëzoi autorizimin për përfaqësim të kërkuar nga Gjykata.

12. Më 18 dhjetor 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi njëzëri Gjykatës të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Gjykata vëren se faktet në kërkesën e tanishme janë të njëjta me përmbledhjen e fakteve të përcaktuara në Rastin KI159/14.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KI159/14, të 14 prillit 2015

14. Më 24 tetor 2014, parashtruesja znj. Elife Murseli, dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014.

15. Parashtruesja, në Rastin KI159/14, pretendonte se me Aktvendimin (Ac. nr. 1235/2014) e Gjykatës së Apelit të Kosovës i ishin shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

16. Gjykata, në Rastin KI159/14, vlerësoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, i 5 majit 2014 dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/13, i 4 marsit 2014, në arsyetimet e tyre të hollësishme japin përgjigje në pretendimet e parashtruesespërkitazi me kërkesën për kthim në vendin e punës dhe kërkesën pronësore në shumë prej 9.351,30 €, si dhe arsyet për aplikimin e dispozitave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

17. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të të drejtave të parashtrueses të garantuara me Kushtetutë, në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, i 5 majit 2014.

18. Në bazë të fakteve dhe rrethanave që janë paraqitur në kërkesën nr. KI159/14, Gjykata, më 14 prill 2015, vendosi të shpallë kërkesën e parashtrueses të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Pretendimet e parashtrueses

19. Parashtruesja në kërkesën e tanishme pretendon se Gjykata Kushtetuese me Aktvendimin për papranueshmëri (Rasti KI159/14), *"[...] vendimet gjyqësore të*

ankimuara i bënë të ligjshme, me këtë e bënë të ligjshme procedurën e kundërligjshme dhe kundërkushtetuese e cila ka zgjatur mbi 5 vite dhe po vazhdon [...]".

20. Rrjedhimisht, parashtruesja pretendon se Aktvendimi në fjalë ka shkelur të drejtat e saj kushtetuese, sikurse janë përmendur në paragrafin 3, të këtij dokumenti.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata, para se ta shqyrtojë një kërkesë, së pari vlerëson nëse ajo i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Gjykata i referohet fillimisht nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili parasheh:

> *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".*

23. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores, i cili parasheh:

> *"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është [...] përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze".*

24. Gjykata poashtu i referohet rregullit 36.3 (d) të Rregullores, i cili parasheh:

> *(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
> *[...] d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;*
> *[...].*

25. Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesën e tanishme nuk ka paraqitur asnjë fakt të ri apo provë të re, në bazë të së cilës do të trajtohej një çështje e cila nuk është trajtuar, ose është anashkaluar të trajtohet, në procedurat e mëhershme në Gjykatë. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë kërkesë, Gjykata tashmë ka vendosur.

26. Prandaj, kërkesa e tanishme, në thelb, është përsëritje e një kërkese të shqyrtuar më parë nga Gjykata. Gjykata nuk ka juridiksion të vendosë për çështjet e njëjta juridike për të cilat ka vendosur një herë. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, përkitazi me kërkesat individuale, është përcaktuar qartë me nenin 113.7 të Kushtetutës. Me akte individuale të autoriteteve publike në kuptim të nenit 113.7, duhet nënkuptuar të gjitha aktet individuale të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, që paraqesin objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë sipas kuptimit të këtij neni, përveç atyre të vetë Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, duhet kuptuar qartë dhe drejtë se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion t'i rihapë dhe t'i rigjykojë vendimet e saj për të cilat ka vendosur *(Shih, Naser Dragusha dhe 4 punëtorë të tjerë, KI28/15, Vendim për refuzim të Kërkesës, i 11 nëntorit 2015; Bajrush Gashi, KI26/14, Vendim për hedhje poshtë të Kërkesës, i 26 marsit 2015; Mentor Paqak, KI166/14, Vendim për hedhje poshtë të Kërkesës, i 22 majit 2015, dhe Bejtullah Sogojeva, KI179/14, Vendim për hedhje poshtë të Kërkesës, i 13 gushtit 2015).*

27. Gjykata Kushtetuese rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

28. Sa i përket kërkesëssë parashtrueses për të mbajtur seancë dëgjimore, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*
>
> *2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, Gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".*

29. Gjykata konsideron që shkresat e lëndës të kësaj Kërkese janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast, sipas formulimit të paragrafit 2 të nenit 20 të Ligjit.

30. Prandaj, kërkesa e parashtrueses për mbajtje të seancës dëgjimore hedhet poshtë si e papranueshme.

31. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses, është përsëritje e një kërkesë të mëhershme, për çështje tashmë të vendosura nga Gjykata.

32. Prandaj, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI135/15, Parashtrues Boban Marinković, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311- A0001-A0023, të 15 korrikut 2015

KI135/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 26 janar 2016 dhe i publikuar më 8 mars 2016.

Fjalët Kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut, barazia para ligjit, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Parashtruesi kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin pretendohet se parashtruesi është diskriminuar në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me rastin e mospërfshirjes së parashtruesit në listën e punonjësve që kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i "DTP Voçar".

Gjykata konstatoi se pretendimet për diskriminim të paraqitura nga parashtruesi janë të pabazuara dhe në anën tjetër thekson se diskriminimi ekziston nëse rezulton me një trajtim të ndryshëm të individit dhe në qoftë se trajtimi nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm çka parashtruesi nuk e ka dëshmuar.
Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI135/15
Parashtrues
Boban Marinković
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Boban Marinković nga Graçanica (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme), AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme me të cilin pretendohet se parashtruesi është diskriminuar sipas nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI135/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI135/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtaret: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 16 dhjetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 28 janar2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte punonjës i "DTP Voćar" (në tekstin e mëtejmë: "DTP Voćar") deri në vitin 1999.

10. Më 2 maj 2007, "DTP Voćar" ishte privatizuar.

11. Më 21 korrik 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit publikoi listën e përkohshme të punonjëseve që kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i "DTP Voćar", në të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ishte i përfshirë.

12. Më 10 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).

13. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve se është viktimë e diskriminimit, në Dhomën e Posaçme dorëzoi edhe vendimin e themelimit të marrëdhënies së punës me "DTP Voćar" nr. 48, të vitit 1998.

14. Në një datë të pacaktuar në vitin 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme), nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0045], me të cilin e aprovoi ankesën e parashtruesit si të bazuar dhe e detyroi Agjencinë Kosovare të Privatizimit që parashtruesin ta përfshinë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i "DTP Voćar".

15. Në një datë të pacaktuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit ushtroi ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme [SCEL-11-0045], në të cilën theksoi: "*Ankuesi (parashtruesi i kërkesës) nuk e ka dorëzuar librezën e tij të punës, nuk ka dëshmuar se në ndonjë mënyrë është diskriminuar dhe nuk ishte i regjistruar si punonjës në kohën kur është bërë privatizimi",* që është në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 *(shih, paragrafin 16 të Raportit).*

16. Më 15 korrik 2015, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin [AC-I-14-0311-A0001-A0023], me të cilin e aprovoi ankesën e Agjencisë Kosovare të

Privatizimit dhe e refuzoi Aktgjykimin [SCEL-11-0045] e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme.

Ligji përkatës

17. Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/ 13, parasheh: *"Punëtori konsiderohet si legjitim (për 20%) nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se 3 (tri) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar (që do ti takonin 20%), nëse nuk do të kishin qenë të diskriminuar".*

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi në kërkesë theksoi "*senë bazë të dokumentacionit të kompletuar, të cilin e ka dorëzuar në Agjencinë e Privatizimit dhe në Dhomën e Posaçme, dhe në bazë të të cilitankesa e tij paraprake u karakterizua si e bazuar, ai ka të drejtë në të të ardhura nga privatizimi i DTP-së Voćar".*

19. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën *"që si punëtor i rregullt i 'DTP-së Voćar', ai të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve të 'DTP-së Voćar', të cilëve u takojnë të të ardhurat nga privatizimi"* .

Pranueshmëria e kërkesës

20. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

23. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

24. Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për sa i përket shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), vëren se parashtruesi e ndërtoi kërkesën e tij mbi pretendimet e diskriminimit, gjë që është në kuadër të nenit 24 të Kushtetutës [Barazia para Ligjit] dhe nenit 14 të KEDNJ-së.

25. Duke vlerësuar arsyet e ankesës kushtetuese nga pikëpamja e dispozitës së nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata thekson se diskriminimi ekziston nëse rezulton me një trajtim të ndryshëm të individit dhe në qoftë se trajtimi nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

26. Për më tepër, për të konstatuar diskriminimin, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi në përgjithësi të thirret se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, por ai duhet të tregoj bazën e kësaj pabarazie.

27. Gjykata, më tej, i referohet qëndrimit juridik të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se "*diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme*" (Shih, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, paragrafi 48, GJEDNJ 2002-IV, Aktgjykimi: *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi: *D. H. dhe të tjerë kundër Republikës Çeke*, paragrafi 44)".

28. Gjykata Kushtetuese është e mendimit se në procedurën e mbajtur nuk ka fakte apo rrethana të cilat në ndonjë mënyrë do të tregonin se në procedurat para Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme, parashtruesit i janë shkelur të drejtat ose liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ. Prandaj, referimin në shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me ndalimin e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese e konsideron si të pabazuar.

29. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (Shih, Rasti nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

30. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret sipas të cilave kërkesa e parashtruesit do të shqyrtohej nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

31. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me rregullin36(1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 26 janar2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI129/15 Parashtrues Rrahim Ramadani, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 6/2014, të 24 shkurtit 2015

KI129/15, Aktvendim për papranueshmëri i 26 janarit 2016, publikuar më 8 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta e ushtrimit të profesionit, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin CML. nr. 6/2014, refuzoi, si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion në Gjykatën e Apelit, për ankesën e paraqitur kundër vendimit të KPMK-së.

Parashtruesi pretendoi se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij nga neni 49 i Kushtetutës, për shkak se aprovoi vendimin e gjykatave më të ulëta për mospagesën e diferencës në lartësinë e pagës, gjë që parashihet në paragrafin II të vendimit të KPMK-së.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se vendimi i fundit i dorëzuar nga gjykatat e rregullta e deri në ditën e dorëzimit në Gjykatën Kushtetuese kanë kaluar më shumë se 4 (katër) muaj, rrjedhimisht, kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
Në bazë të kësaj, Gjykata përfundoi se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme sepse është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI129/15
Parashtrues
Rrahim Ramadani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 6/2014, të 24 shkurtit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rrahim Ramadani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 6/2014,të 24 shkurtit 2015, i cili i është dorëzuar atij më 23 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 tetor 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI129/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. KSH. KI129/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 24 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës, dhe njëkohësisht kërkoi nga parashtruesi dhe nga Gjykata provën për dorëzimin e aktgjykimit të kundërshtuar.

8. Më 26 janar2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues,Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka pasur marrëdhënie të themeluar të punës si mësimdhënës deri më 30 shtator 2007.

10. Më 14 dhjetor 2007, për shkak të riorganizimit dhe sistematizimit të ri në arsimim, organi ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Prishtinës mori vendimin [01. nr. 24385] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejmë: MASHT), si dhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPM) ndaj vendimit [01. nr. 24385] të Komunës së Prishtinës.

12. Sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, së pari MASHT-i, e pastaj edhe KPM-ja, morën vendime me të cilat e anuluan vendimin [01. nr. 24385] të Komunës së Prishtinës dhe urdhëruan që parashtruesin e kërkesës ta përfshijnë në planin e ri të sistematizimit dhe t'ia gjejnë një vend tjetër të punës.

13. Më 14 tetor 2008, Komuna e Prishtinës dhe parashtruesi i kërkesës lidhën kontratë të punës me të cilën parashtruesi ishte sistemuar në vend të ri të punës.

14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër Komunës së Prishtinës, në të cilën kërkoi që në emër të pagave të papaguara, ndryshimit në pagë, kontributeve dhe tatimeve t'i paguhet një shumë unike e llogaritur, të cilën e ka propozuar ai vetë.

15. Në fakt, më 24 shkurt 2015, Gjykata Supreme [Aktgjykimi CML. nr. 6/2014] refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 26 gushtit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij nga neni 49 i Kushtetutës, për shkak se nuk lejoi pagesën e diferencës në lartësinë e pagës, gjë që parashihet në paragrafin II të vendimit të KPMK-së.

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën: "*Dëshiroj që të më bëhet pagesa e diferencës prej 1 tetorit 2008 e deri tani 85 muaj dhe të kthehem në vendin e mëparshëm ose të qëndroj në këtë vend pasi edhe 4 vite kam deri te pensioni*".

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari duhet tëshqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohetbrenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".*

21. Gjykata, gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[…]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

22. Gjykata vëren se Aktgjykimi [CML. nr. 6/2014] i Gjykatës Supreme i 24 shkurtit 2014 i është dorëzuar parashtruesit më 23 mars 2015, çka dhe mund të vërtetohet bazuar në dëshmitë që Gjykata Supreme i ka dorëzuar në Gjykatë.

23. Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 28 tetor 2015; pra, pas kalimit të afatit 4 (katër) mujor nga dita që ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

24. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se afati prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është i natyrës prekluzive dhe është themeluar për të siguruar parimin e sigurisë juridike duke siguruar, që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim kushtetues (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

25. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me rregullin36(1) (b) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 26 janar 2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI143/15, Parashtruesja e kërkesës: Donika Kadaj-Bujupi, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PNl. nr. 2059/2015, të 23 nëntorit 2015

KI143/15, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës dhe për refuzim të kërkesës për masë të përkohshme i 8 shkurtit 2016, i publikuar më 10 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, imuniteti, kërkesë pa objekt, kërkesë për masë të përkohshme.*

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit i është shkelur e drejta e saj për imunitet, e cila garantohet me nenin 75, paragrafin 1 dhe 2 të Kushtetutës. Ajo ka pretenduar se një deputet i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as të ndalohet përderisa është duke kryer detyrat dhe përgjegjësit e tij/saj në Kuvend. Njëkohësisht, ka pretenduar se *"Gjykata e Apelit ka vepruar në mënyrë diskriminuese kundër parashtrueses së kërkesës"*.

Në ndërkohë, më 9 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML 277/2015) aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtrueses për mbrojtje të ligjshmërisë, duke zëvendësuar masën e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak deri më 18 dhjetor 2015.

Gjykata, më tej, konstatoi se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk është më vendim përfundimtar i autoritetit publik për qëllime të kërkesës së parashtruar në Gjykatë. Gjykata konstatoi se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme u shqyrtua Aktvendimi i Gjykatës së Apelit. Prandaj, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme tani është vendim përfundimtar për çështjen kontestuese. Gjykata konkludoi se kërkesa nuk paraqet më kontest juridik, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme e ka zgjidhur kontestin juridik.

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS

DHE PËR REFUZIM TË KËRKESËS PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KI143/15
Parashtrues
Donika Kadaj-Bujupi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2059/2015, të 23 nëntorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Donika Kadaj-Bujupi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), të cilën e përfaqëson z. Arianit Koci, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2059/2015, të 23 nëntorit 2015, me të cilin u vërtetua Aktvendimi PPRKR. nr. 415/2015 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i 18 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 75 [Imuniteti] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Përveç kësaj, parashtruesja kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, *"me anë të së cilës znj. Donika Kadaj-Bujupi menjëherë do t'i ndërpritet masa e paraburgimit, deri në marrjen e një vendimi meritor për këtë çështje"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 dhjetor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

7. Më 3 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 4 dhjetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të qartësojë nëse për çështjen e njëjtë është duke u zhvilluar ndonjë procedurë gjyqësore në gjykatat e rregullta ose nëse është ushtruar ndonjë mjet juridik. Një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.

9. Më 8 dhjetor 2015, parashtruesja e kërkesës e njoftoi Gjykatën se ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

10. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës informata shtesë për ta përditësuar Gjykatën për rrjedhën e procedurës përkitazi me mjetin e jashtëzakonshëm juridik, duke përfshirë vendimin eventual përfundimtar.

11. Më 22 dhjetor 2015, parashtruesja e informoi Gjykatën se Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykimin (PML 277/2015, të 9 dhjetorit 2015) lidhur me kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë.

12. Më 24 dhjetor 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme të dorëzojë kopjen e Aktgjykimit të saj PML 277/15, të 9 dhjetorit 2015. Në të njëjtën datë, Gjykata Supreme e dorëzoi kopjen e kërkuar të Aktgjykimit të saj.

13. Më 8 shkurt 2016, Gjykata mbajti këshillime për rastin dhe vendosi ta hedhë poshtë kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 18 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi PPRKR. nr. 415/2015) ia caktoi parashtrueses së kërkesës masën paraburgimit prej 18 nëntorit 2015 deri më 18 dhjetor 2015.

15. Parashtruesja ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se veprimet e saj nuk duheshin kualifikuar si vepër penale, por si veprime politike për të cilat ajo gëzon imunitet funksional parlamentar.

16. Më 23 nëntor 2015, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN1. nr. 2059/2015) refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtrueses, me shpjegimin se Gjykata Themelore në vendimin e saj ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm përkitazi me ekzistimin e dyshimit të kryerjes së veprës penale, dhe se çështja e imunitetit të deputetëve tashmë ishte trajtuar nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e saj në Rastin KO98/11, të 20 shtatorit 2011.

17. Më 3 dhjetor 2015, Gjykata mësoi se parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar edhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

18. Më 8 dhjetor 2015, pas kërkesës së Gjykatës për informata shtesë, parashtruesja e informoi Gjykatën se ajo kishte parashtruar edhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, pasi që e kishte dorëzuar kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese më 2 dhjetor 2015.

19. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, PML 277/2015) aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtrueses për mbrojtje të ligjshmërisë, duke zëvendësuar masën e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak deri më 18 dhjetor 2015. Gjykata Supreme gjithashtu e adresoi pretendimin e parashtrueses lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 75 të Kushtetutës.

20. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata sërish kërkoi informata shtesë lidhur me "*rrjedhën e procedurës përkitazi me mjetin e jashtëzakonshëm"*.

21. Më 22 dhjetor 2015, parashtruesja e kërkesës e informoi Gjykatën se Gjykata Supreme ka nxjerrë aktgjykim, me të cilin masa e paraburgimit ishte zëvendësuar me masën e arrestit shtëpiak.

22. Gjykata nuk ka marrë asnjë informatë të mëtejshme për ecurinë e procedurave të tjera lidhur me rastin e parashtrueses së kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesja pretendon se me vendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit i është shkelur e drejta e saj për imunitet e cila garantohet me nenin 75, paragrafin 1 dhe 2 të Kushtetutës. Ajo pretendon se një deputet i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as të ndalohet përderisa është duke kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj në Kuvend.

24. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pohon se ka shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Lidhur më këtë, ajo pretendon se "*Gjykata e Apelit ka vepruar në mënyrë diskriminuese kundër parashtrueses së kërkesës,* sepse "*në një rast tjetër në të cilin ishte i përfshirë një deputet tjetër i Kuvendit të Republikës së Kosovës e kishte ndërprerë masën e paraburgimit duke u thirrur në nenin 75, par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".*

25. Përveç kësaj, parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, duke ia ndërprerë paraburgimin, për shkak të pësimit të dëmeve të pariparueshme për shkak të qëndrimit të saj të mëtutjeshëm në paraburgim dhe për shkak se asaj i mohohet e drejta për të përfaqësuar qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës e ka kontestuar Aktvendimin PN1. Nr. 2059/2015, të Gjykatës së Apelit të 23 nëntorit 2015 dhe kundër të njëjtit vendim kishte parashtruar edhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për të cilën Gjykata Supreme vendosi më 9 dhjetor 2015.

27. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk e ka kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Për më tepër, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme iu dorëzua Gjykatës me iniciativë të vetë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e rithekson se i ka takuar parashtrueses të ndërmarrë iniciativë procedurale, të asistojë në mënyrë aktive dhe të paraqesë të gjitha informacionet dhe provat relevante lidhur me kërkesën dhe përfundimisht të mbështesë pretendimet e saj. Gjykata nuk mund të zëvendësojë parashtruesen në ndërtimin e rastit të saj.

28. Gjykata më tej vëren se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme u shqyrtua dhe vlerësua Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit. Tani Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është vendimi përfundimtar për çështjen kontestuese. Prandaj, aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk është më vendim përfundimtar i autoritetit publik për qëllime të kërkesës së parashtruar në Gjykatë.

29. Gjykata rikujton se më 4 dhjetor 2015, parashtrueses i ishte kërkuar "*që ta informojë Gjykatën dhe të vazhdojë ta mbajë të informuar, nëse për çështjen e njëjtë juridike është duke u zhvilluar ndonjë procedurë gjyqësore në gjykatat e rregullta ose nëse keni ushtruar ndonjë mjet tjetër juridik për çështjen juridike të njëjtë".*

30. Përveç kësaj, më 14 dhjetor 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që ta informojë për "*rrjedhën e procedurës përkitazi me mjetin e jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe vendimin e mundshëm të formës së prerë"* dhe e njoftoi atë se *"në mungesë të informacioneve, Gjykata do të procedojë me shqyrtimin e kërkesës sipas shkresave ekzistuese të lëndës".*

31. Gjykata vëren se shkresat ekzistuese të lëndës më nuk përmbajnë një vendim përfundimtar të autoritetit publik që pretendohet se shkel të drejtat dhe liritë individuale të parashtrueses të garantuara me Kushtetutë, dhe objekt që mund të kontestohet nga parashtruesja e kërkesës. Për më tepër, Gjykata rikujton se i ka takuar parashtrueses së kërkesës të qartësojë dhe të precizojë nëse donte të procedonte dhe si donte të procedonte me kërkesën që ishte në procedurë e sipër pranë Gjykatës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që parashohin:

> *Neni 22*
>
> *"4. (...) Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës".*
>
> *Neni48*
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se (...) cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

34. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 32 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet (...) nuk përfaqësojnë një rast (...)."*

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nuk mund të konsiderohet më vendim përfundimtar siç është kontestuar fillimisht nga parashtruesja e kërkesës.

36. Gjykata konsideron se kërkesa nuk paraqet më kontest juridik, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme e ka zgjidhur çështjen.

37. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se objekti i çështjes i kërkesës nuk përfaqëson më rast.

38. Si përfundim, Gjykata gjen se pretendimi i parashtrueses së kërkesës është pa objekt dhe kërkesa hedhet poshtë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22.4 dhe 48 të Ligjit, si dhe me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

39. Gjykata rikujton se parashtruesja ka kërkuar nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të ndërpresë masën e paraburgimit deri në nxjerrjen e një vendimi meritor.

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon se aprovimi i Masës së përkohshme është i një rëndësie të veçantë, për shkak të pësimit të dëmit të pariparueshëm dhe të mohimit të së drejtës së saj për të përfaqësuar qytetarët e Republikës së Kosovës.

41. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> "*Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për Masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:*
>
> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës (...)".*

42. Gjykata po ashtu rikujton se Gjykata Supreme, duke vepruar lidhur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, e zëvendësoi masën e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak.

43. Përveç kësaj, më 3 dhjetor 2015, Gjykata mësoi se parashtruesja e kërkesës ka parashtruar kërkesë për mjet të jashtëzakonshëm juridik. Ky fakt u konfirmua nga parashtruesja e kërkesës më 8 dhjetor. Kërkesa për mjet të jashtëzakonshëm juridik kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit u vendos nga Gjykata Supreme më 12 dhjetor 2015.

44. Për më tepër, Gjykata vëren se, siç arsyetohet më sipër, kërkesa është hedhur poshtë pasi pretendimi i parashtrueses mbeti pa objekt.

45. Kësisoj, Gjykata konsideron se që nga paraqitja e kërkesës për mjet të jashtëzakonshëm juridik, kërkesa për Masë të përkohshme nuk ka më bazë për t'u vendosur nga Gjykata.

46. Prandaj, në mbështetje të rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtrueses për vendosjen e Masës së përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 22.4 dhe të nenit 48 të Ligjit, si dhe në mbështetje të rregullave 32 (4), 55 (4) dhe 56 (3) dhe (5) të Rregullores së punës, më 8 shkurt 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI106/15, Parashtrues Predrag Stojčetovič, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Apelit i AKP-së, GSK-KPA-A-035/14, të 13 majit 2015

KI106/15, Aktvendim për papranueshmëri i 26 janarit 2016, publikuar më 10 mars 2016.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, barazia para ligjit, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës, Kolegji i Apelit i AKP-së ka nxjerrë Aktgjykimin, GSK-KPA-A-035/14, të13 majit 2015, me të cilin ishte refuzuar, si e pabazuar ankesa parashtruesit e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215//2013, të 21 gushtit 2013.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Supreme e Kosovës, Kolegji i Apelit i AKP-së ka shkelur të drejtën e parashtruesit të garantuar me Kushtetutë, barazinë para ligjit dhe mbrojtja e pronës. Parashtruesi, më tej, pretendoi senë një situatë identike faktike dhe ligjore, e drejta në pronë në banesë i është njohur të tjerëve.
Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij. Prandaj, kërkesa u deklarua si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI106/15
Parashtrues
Predrag Stojčetović
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Apelit i AKP-së, GSK-KPA-A-035/14, të13 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Predrag Stojčetović, me vendbanim në fshatin Biti e Poshtme, komuna e Shtërpcës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet me autorizim nga avokati z. Ljubomir Pantović.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-035/14, të13 majit 2015, me të cilin ishte refuzuar, si e pabazuar ankesa parashtruesit e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë:KKPK) KPCC/D/R/215//2013, të 21 gushtit 2013.

3. Aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuarparashtruesit të kërkesës më 3 korrik 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëAktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 gusht 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 29 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 26 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi kërkoi nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejmë: KKPB) konfirmimin e të drejtave pronësore mbi banesën e cila gjendet në Ferizaj.

11. Më 30 prill 2005, KKPB (Vendimi HPCC/D/189/2005/C), ka hedhur poshtë kërkesën pronësore të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetim thuhet: "*... Stojčetović nuk ka paraqitur çfarëdo dëshmie dokumentare me të cilën do të dëshmonte se ka pasur posedim mbi pronën e as nuk ka dëshmuar të drejtën pronësore...*".

12. Parashtruesi kërkoi nga KKPB-ja rishqyrtimin e atij vendimi.

13. Më 15 korrik 2006, KKPB-ja (Vendimi HPCC/REC/66/2006) përsëri ka hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës me të njëjtat argumente.

14. Më 22 gusht 2007, parashtruesi ka paraqitur kërkesë pronësore në KKPK (e cila e zëvendësoi KKPB-në), me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës në pronë dhe posedim të sërishëm të banesës.

15. Më 21 gusht 2013, KKPK-ja (Vendimi KPCC/D/2015/2013,) ka refuzuar kërkesën pronësore, me arsyetim se "*dokumentet e paraqitura nga ana e parashtruesit nuk janë verifikuar pozitivisht nga ana e Sekretarisë Ekzekutive*". Përveç kësaj, KKPK-ja theksoi se deklaratat e dorëzuara të tre dëshmitarëve *"në mungesë të dëshmisë dokumentare, nuk janë të mjaftueshme për të vendosur të drejtën mbi pronën në kërkesë"*.

16. Më 9 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Vendimit të KKPK-së, për shkak të *"vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të fakteve"*.

17. Më 13 maj 2015, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi GSK-KPA-A-035/14), e refuzoi ankesën si të pabazuar. Kolegji i Apelit konstatoi se: "*KKPK-ja ka marrë vendim të saktë, në bazë*

të procedurës detale e të saktë" dhe se *"nuk është bërë cenimapo konstatim jo i plotë i gjendjes faktike"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*në një situatë identike faktike dhe ligjore, e drejta në pronë në banesë i është njohur"* tjerëve. "*Kjo është bërë në procedurën në KKBP, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës krejtësisht e ka injoruar këtë fakt"*.

20. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që *"t'i njihet e drejta në pronë në banesën e cila ndodhet në Ferizaj"*.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> "7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

23. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

24. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

25. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pohon se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, duke pretenduar se të drejtat e tij janë shkelur për shkak të "*vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike"*.

26. Gjykata vlerëson seKolegji i Apelitanalizoigjerësishtprovat e paraqituradhepretendimet e bëranga parashtruesi i kërkesës, duke arsyetuar në mënyrë të detajuarse pseështë refuzuarankesa e tij.

27. Në të vërtetë, Kolegji i Apelit vëren se *"Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk ka qenë në gjendje që ex officio të sigurojë çfarëdo qoftë dëshmie për të mbështetur kërkesën pronësore të Stojçetoviqit"*. Prandaj, Kolegji i Apelit konkludoi se "*KKPK-ja ka marrë vendim të saktë, në bazë të procedurës detale e të saktë"*.

28. Për më tepër, Kolegji i Apelit vëren më tej se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"KKBP ka vendosur ndryshe, ndonëse ekzistojnë lëndë identike (DS003510 dhe DS603418), me datë të njëjtë të ndarjes së pronës, ku KKBP ka vendosur në dobi të parashtruesit të kërkesës"*. Parashtruesi gjithashtu pretendon se "*pa marrë parasysh natyrën e njëjtë të dokumenteve të cilat janë paraqitur në këto lëndë nga parashtruesi i kërkesës, KKBP-ja i ka marrë parasysh këto dokumente, gjë që nuk e ka bërë në lëndën e tij"*.

29. Kolegji i Apelit theksoi se ai *"nuk është kompetent për lëndët e KKBP-së apo të shikojë arsyetimin e vendimeve të KKBP-së ose të vlerësojnë saktësinë e tyre"*. Përveç kësaj, Kolegji i Apelit vërejti se *"Me vendimin HPCC/REC/66/2006, kërkesa për rishqyrtim të vendimit HPCC/REC/189/2005/C, e parashtruar nga ana e ankuesit është refuzuar. Kjo do të thotë se vendimi HPCC/REC/189/2005/C është i plotfuqishëm dhe se nuk mund të atakohet me ankesë"*.

30. Gjykata vëren se konkluzioni i Kolegjit të Apelit është në harmoni me praktikën e saj gjyqësore (Shih Gjykata Kushtetuese, Rasti nr. KI104/10, paragrafët 64 dhe 74 të Aktgjykimit, të 10 majit 2012).

31. Bazuar në sa u tha më lart, Gjykata konsideron separashtruesi i kërkesës nukka shpjeguarsi dhe pse konkluzioni se ai *"nuk ka dëshmuar"*të drejtën e tijpronësore mbi banesën, i cili është dhënë nëaktgjykimin ekontestuar, i ka shkelur të drejtate tij përbaraziparaligjitdhepër mbrojtjen e pronës.

32. Gjykata më tej konsideron se procedurat në KKPK dhe në Kolegjin e Apelit ishin të drejta dhe se vendimet ishin plotësisht të arsyetuara, duke shpjeguar se parashtruesi i kërkesës *"nuk ka dëshmuar çfarëdo qoftë të drejte pronësore mbi pronën në kërkesë"* (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

33. Për më tepër, parashtruesi nuk ka parashtruar asnjë provë *prima facie*, që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, GJEDNJ, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

34. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesinuke ka ndërtuarpretendimin e tijnë bazakushtetuese. Përkundrazi, ai e ka bazuarankesëne tij në*"vërtetim të gabuar dhejo të plotëtë fakteve"*. Kjo bienë juridiksionin egjykatave të rregullta. Në fund, parashtruesi i kërkesës përfundoipretendimine tij duke kërkuar nga Gjykataqë t'ia njeh *"të drejtën në pronë në banesën e cila ndodhet në Ferizaj"*.

35. Gjykata konsideron se ky pretendim dhe kërkesë paraqet ankesë për shkallë të katërt. Gjykata thekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta, gjatë vërtetimit të fakteve apo zbatimit të së drejtës materiale. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,*

Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011) .

36. Gjykata më tutje thekson se nuk është detyrë e saj që të vlerësojë nëse Kolegji i Apelit i ka vërtetuar drejt faktet apo ka interpretuar ligjin e aplikueshëm (ligjshmëria), por të shqyrtojë nëse Kolegji i Apelit i ka shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria) (Shih p.sh Rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës *Besa Qirezi,* Aktgjykimi i 4 shkurtit 2015, para. 65).

37. Për më tepërnë këtë pikë, sirregull i përgjithshëm, vërtetimi ifakteve të rastit dheinterpretimi iligjitjanëçështjevetëmpër gjykatate rregullta,të gjeturat dhe konkluzionete të cilavenë këtë drejtimjanë të detyrueshme përGjykatën Kushtetuese. Megjithatë, kurnjë vendiminjë gjykatetë rregullt është qartaziarbitrar, Gjykatamund dhe duhetta vë atë në dyshim. (Shih *Sisojevadhe të tjerët kundër Letonisë*, [DHM], Aktgjykimi nr. 60654/00, Aktgjykim i15janarit 2007,para. 89).

38. Prandaj, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të së drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

39. Si përmbledhje, kërkesaështë qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 26 janar 2016, njëzëri .

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI92/15, Parashtrues Naim Sejdiaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4891/2014, i 27 shkurtit 2015

KI92/15, Aktvendim për papranueshmëri i 9 shkurtit 2016, publikuar më 10 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar*.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac. nr. 4891/2014, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, ndërsa e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore me të cilin, për shkak të borxheve të papaguara nga parashtruesi ndaj BKT-së, lejohet përmbarimi i procedurës nga përmbaruesi privat.

Parashtruesi pretendoi se me vendimin e kontestuar i janë shkelur e drejta për proces të rregullt dhe e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave siç garantohen me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk ka arritur të ofrojë fakte apo dëshmi *prima facie* për të arsyetuar pretendimet e tij dhe se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI92/15
Parashtrues
Naim Sejdiaj
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 4891/2014, të 27 shkurtit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Naim Sejdiaj nga Podujeva, të cilin e përfaqëson z. Gani Asllani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 4891/2014, i 27 shkurtit 2015, i cili është dorëzuar parashtruesit më 13 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sipas nenit 31 (Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm) dhe nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregulloja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës me vendim caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 7 tetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një

kopje të kërkesës Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), si palë e tretë dhe e interesuar, duke i kërkuar asaj që komentet eventuale t'ia dërgojë në Gjykatë në afatin e përcaktuar nga Gjykata.

8. Më 20 tetor 2015, Gjykata pranoi komentet e BKT-së lidhur me kërkesën.

9. Më 9 shkurt 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 29 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur një kontratë me BKT për marrjen e kredisë në emër të Kompanisë private pronar i vetëm i të cilës ishte ai, në shumën dhe afatin e kthimit të kredisë sikur që ishte përcaktuar në kontratë. Kontrata dhe anekset e sajë kanë përfshirë edhe kushtet e specifikuara për pasojat në rast të moskthimit të kredisë.

11. Më 6 nëntor 2013, BKT ka paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë një Propozim për Ekzekutimin në Paluajtshmëri - Hipotekë kundër pasurisë së parashtruesit, të paraqitur si garanci hipotekare me rastin e marrjes së kredisë, për shkak të mospagesës së rregullt të kësteve të kredisë.

12. Më 8 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin E. nr. 1578/2013, lejoi përmbarimin e propozuar.

13. Kundër këtij Aktvendimi parashtruesi ka ushtruar prapsim në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Parashtruesi ka theksuar se vonesat në pagesën e kredisë kanë ardhur si pasojë e lëndimeve serioze të parashtruesit në aksident komunikacioni si dhe ka kundërshtuar mënyrën e llogaritjes së kamatave mbi borxhin kryesor.

14. Më 19 nëntor 2014,Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktvendimin E. nr. 1578/2013, me të cilin refuzoi, si të pabazuar, prapësimin e ushtruar nga parashtruesi "*për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetjeje pretendimeve të tyre dhe, nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e parapara ligjore për anulimin e aktvendimit apo pezullimit të tij*".

15. Kundër këtij Aktvendimi parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

16. Më 27 shkurt 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktvendimin AC. nr. 4891/2014, me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, ndërsa e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

17. Gjykata e Apelit në Aktvendimin e vet theksoi, se "*kjo gjykatë duke vlerësuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht aktvendimin e atakuar me të cilin është refuzuar prapësimi i debitorit, gjen se një përfundim i tillë i gjykatës është i bazuar dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore, andaj edhe aktvendimi i atakuar ka arsye të plota dhe bindëse*".

18. Më 30 mars 2015, Gjykata Themelore me Aktvendimin E. nr. 1578/13, lejoi transferimin e procedurës përmbaruese te një përmbarues privat.

19. Më 8 prill 2015, përmbaruesi privat D. B. nxori konkluzionin për vazhdimin e procedurës përmbarimore, në Rastin E. nr. 1578/13.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se BKT i ka kalkuluar në mënyrë jo ligjore kamatat mbi borxhin kryesor dhe gjykatat e rregullta, duke lejuar procedurën përmbaruese mbi patundshmërinë e tij, gjithashtu kanë bërë shkelje ligjore sepse kanë dështuar ta konstatojnë gabimin e BKT-së.

21. Parashtruesi, më tej, ka pretenduar se me transferimin e lëndës tek përmbaruesi privat, gjykata ka shkelur nenin 67 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sepse përmbaruesi privat që do të vazhdojë procedurën përmbarimore, ka qenë zyrtarë i lartë në BKT.

22. Parashtruesi nga Gjykata ka kërkuar që të caktohet një ekspert, i cili do të përcaktojë shumën e saktë të borxhit, që parashtruesi ka për ta kthyer në BKT.

Përgjigjja e BKT-së lidhur me kërkesën e parashtruesit

23. BKT në përgjigjen e dërguar në Gjykatë, ka theksuar se "*Pra nga siç u përshkrua më lart, shihet qartë që debitori ka ushtruar mjetet e rregullta juridike si instrumente ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe kësisoj është siguruar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ngase edhe vendimi në shkallë të parë edhe vendimi në shkallë të dytë është marrë nga organet kompetente për zbatimin e ligjit duke sjellë vendime të bazuara në ligjin e zbatueshëm, së këndejmi, BKT konsideron që në rastin konkret pretendimet e debitorit, se atij i është shkelur dhe mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga organet e drejtësisë së Republikës së Kosovës nuk qëndron!*".

Pranueshmëria e kërkesës

24. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> "*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi tëpabazuar, nëse bindet se:*
>
> *(b) faktet* e *paraqitura në asnjë mënyrë nuk* e *arsyetojnë pretendimin për shkeljen enjë të drejte kushtetuese".*

27. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata vëren që ai e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4891/14, me të cilin gjykata vendosi lidhur me ankesën e tij kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me lejimin e ekzekutimit në patundshmërinë e tij.

Dispozitat relevante kushtetuese lidhur me rastin

Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

28. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e Aktvendimit të kontestuar në prizmën e pretendimeve për shkelje kushtetuese dhe fakteve të prezantuara nga parashtruesi, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më lart, Gjykata konstaton se nuk gjen argumente të kenë ndodhur shkelje të dispozitave kushtetuese. Këto pretendime të parashtruesit janë mbështetur vetëm në "*... konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjegjësisht kalkulimin jo të duhur ligjor të kamatave*, ..." janë pretendime për shkelje ligjore, jo shkelje kushtetuese.

29. Gjykata, më tej, konstaton se pretendimet e parashtruesit për çështjet e ngritura u trajtuan në mënyrë adekuate nga gjykatat e rregullta, e sidomos nga Gjykata e Apelit, e cila e ka arsyetuar Aktvendimin e vet duke mosgjetur asnjë shkelje në raport me pohimet e parashtruesit dhe duke elaboruar gjerësisht obligimet kontrakuale të parashtruesit në raport me BKT-ën.

30. Sa i përket pretendimit tjetër të parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, gjegjësisht, anshmërisë së pretenduar në gjykim, për arsye se sipas pohimit të parashtruesit, përmbaruesi privat tek i cili ishte transferuar procedura e ekzekutimit ka qenë zyrtar i lartë i BKT-së. Në kohën kur kontesti ishte zhvilluar, parashtruesi nuk paraqiti asnjë provë për të mbështetur pohimin . Për më tepër, parashtruesi theksoi se ky veprim bie ndesh me nenin 67 të LPK-së, po nuk shpjegoi pretendimin se si u cenua neni 31 i Kushtetutës.

31. Gjykata rithekson se njëri nga parimet themeltare të gjykimit kushtetues, është ai i subsidiaritetit. Në kontekstin e veçantë të Gjykatës Kushtetuese do të thotë që detyra për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta u takon në radhë të parë gjykatave të rregullta dhe jo drejtpërsëdrejti, dhe menjëherë Gjykatës Kushtetuese. (Shih*Scordino kundër Italisë,* nr. 1, [DHM], § 140).

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi kishte mundësi të shumta për të shfaqur pretendimet e tij dhe për të kundërshtuar pohimet e BKT-së si palë kundërshtare. Andaj, në asnjë mënyrë nuk vërtetohet pretendimi që parashtruesi mund të jetë trajtuar pafavorshëm në cilën do mënyrë gjatë procesit gjyqësor. (Shih, mes të tjerash, Rastin KI71/15, parashtruesi *Miftar Bajrami*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës - Vlerësim i kushtetushmërisë së Vendimit CML. Nr. 5/2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 dhjetorit 2014).

33. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj, nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut me vendimin e kontestuar dhe në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2 pika b) dhe (d), Gjykata gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) (d) të Rregullores së punës, më 9 shkurt 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI82/14, Parashtrues Gani Lahu, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2013, të 18 dhjetorit 2013

KI82/14, Aktvendim për papranueshmëri i 28 janarit 2016, publikuar më 10 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për mjete juridike, e drejta për proces të rregullt, e drejta për zgjidhje efektive, qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin, Rev. nr. 297/2013, refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion si të pabazuar, po ashtu miratoi qëndrimin ligjor dhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit, se padia e parashtruesit të kërkesës është e paafatshme.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me këtë vendim të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 32 [E drejta për mjete juridike] të Kushtetutës së Kosovës dhe neni 6 [E drejta për proces të rregullt], si dhe neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta ose arbitrare në vendimet e tyre. Gjykata, po ashtu, theksoi se parashtruesi nuk ka dëshmuar mjaftueshëm pretendimet e tij në lidhje me shkeljet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, kërkesa deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI82/14
Parashtrues
Gani Lahu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 297/2013, të 18 dhjetorit 2013
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu - Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesaështë dorëzuar nga z. Gani Lahu, i përfaqësuar nga z. Adem Vokshi, avokat nga Mitrovica (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 297/2013, të 18 dhjetorit 2013, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 190/2013, të 12 korrikut 2013. Vendimi i Gjykatës Supreme iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 19 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 297/2013, të 18 dhjetorit 2013, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 190/2013, të 12 korrikut 2013.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljetënenit 32[E DrejtapërMjete Juridike] të Kushtetutëssë Republikës sëKosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje menenin 6(E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13(E drejta përzgjidhje efektive) të Konventës Evropianepërtë Drejta të Njeriut(në tekstin e mëtejmë: Konventa) në lidhje melargimin e tijnga puna.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës, nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullin56tëRregullores së punës të GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 maj 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 10 qershor2014,KryetariiGjykatës, me Vendimin nr.GJR. KI82/14, caktoigjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendiminnr.KSH. KI82/14,caktoiKolegjin shqyrtuestë përbërënga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 16 qershor 2014, parashtruesi ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

9. Më 14 shtator 2015, parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë iu kërkua të paraqesin prova të dorëzimit të aktgjykimit të fundit të kontestuar.

10. Më 21 shtator 2015, parashtruesi parashtroi komentet e tij në lidhje me dorëzimin e Aktgjykimit të fundit të kontestuar.

11. Më 28 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 12 mars 2002, Administrata Civile e UNMIK-ut njoftoi parashtruesin për suspendimin e tij nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Hekurudhave të UNMIK-ut sa i përket aktiviteteve të prokurimit, që pretendohen të jenë bërë në kundërshtim me rregulloret e UNMIK-ut. Në njoftim u theksua se kohëzgjatja e suspendimit të parashtruesit të kërkesës është në pritje të hetimeve të mëtejshme.

13. Në gusht të vitit 2002, ishte shpallur konkursi për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Hekurudhave të UNMIK-ut. Parashtruesi i kërkesës aplikoi për këtë pozitë përkundër suspendimit, por një person tjetër u caktua në vend të tij.

14. Më 22 tetor 2002, parashtruesi ishte njoftuar për ndërprerjen e punësimit të tij në Hekurudhat e UNMIK-ut. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në këtë njoftim nuk kishte asnjë këshillë ligjore sa i përket mjeteve juridike në dispozicion të tij.

15. Më 5 nëntor 2002, parashtruesi i kërkesës parashtroi kundërshtim ndaj njoftimit të lartcekur, duke kërkuar anulimin e tij derisa hetimi të përfundojë ose t'i sigurojë atij

një tjetër vend pune që korrespondon me aftësitë e tij profesionale. Parashtruesi pretendohet se, nuk ka marrë asnjë informatë në këtë drejtim edhe pse Hekurudhat e UNMIK-ut ishin të obliguara ta bëjnë këtë sipas rregullit 44 të Rregullores së punës.

16. Më 18 shkurt 2003, parashtruesi parashtroi padi kundër Hekurudhave të UNMIK-ut – Fushë-Kosovë në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës deklaroi, *inter alia,* se ai kishte punuar për 12 (dymbëdhjetë) vite në Hekurudhat e UNMIK-ut dhe se Hekurudhat e UNMIK-ut e kanë ndërprerë punësimin e tij në mënyrë të paligjshme.

17. Më 7 prill 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C1. nr. 39/2003, aprovoi padinë e parashtruesit, e anuloi si të paligjshëm njoftimin e 22 tetorit 2002 për ndërprerjen e punësimit të parashtruesit të kërkesës me Hekurudhat e UNMIK-ut, i obligoi Hekurudhat e UNMIK-ut që ta kthejnë parashtruesin në vendin e punës që korrespondon me aftësitë dhe kualifikimet e tij profesionale, duke përfshirë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita kur aktgjykimi kishte marrë formën e prerë.

18. Në një datë të pacaktuar, Hekurudhat e UNMIK-ut parashtruan padi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke pretenduar, se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte marrë me shkelje të rregullave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe se duhet të kthehej në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

19. Më 24 prill 2004, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e Hekurudhave të UNMIK-ut dhe vërtetoi aktgjykimin e kontestuar të gjykatës së shkallës së parë.

20. Në një datë të pacaktuar, Hekurudhat e UNMIK-ut parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit, duke pretenduar shkelje substanciale të ligjit procedural, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 11 nëntor 2004, Gjykata Supreme me Aktvendimin, Rev. nr. 84/2004 aprovoi kërkesën për revizion, anuloi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit, dhe e ktheu rastin në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

22. Më 25 tetor 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C1. nr. 473/04, e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me anulimin e njoftimit për suspendim nga puna dhe kthim në punë - në Hekurudhat e UNMIK-ut me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër vendimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike, duke propozuar që padia e tij të aprovohet si e bazuar dhe vendimi i kontestuar të prishet apo ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

24. Më 14 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin AC. nr. 57/2006, anuloi vendimin e lartcekur të gjykatës së shkallës së parë dhe e ktheu rastin në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

25. Në ndërkohë, Hekurudhat e UNMIK-ut u trashëguan nga Hekurudhat e Infrastrukturës së Kosovës SH. A. (certifikata për regjistrimin e biznesit Nr. 70325327 të 23 gushtit 2011).

26. Më 6 shtator 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C1. nr. 398/08, aprovoi padinë e parashtruesit si të bazuar, anuloi si të paligjshëm njoftimin për ndërprerjen e punësimit të parashtruesit, obligoi Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës SH. A. që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në punë në përputhje me aftësitë dhe kualifikimet e tij profesionale me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

27. Në Aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Komunale në Prishtinë arsyetoi se është e padiskutueshme se Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A. është pasardhëse e Hekurudhave të UNMIK-ut, se parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar deri atëherë në Hekurudhat e UNMIK-ut për 12 (dymbëdhjetë) vjet, që me suspendim nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm parashtruesi i kërkesës duhej të ishte caktuar në një tjetër pozitë që korrespondon me aftësitë dhe kualifikimet e tij profesionale, se procedura hetimore në lidhje me akuzat për korrupsion ndaj parashtruesit të kërkesës duhej të ishte përfunduar, se Hekurudhat e UNMIK-ut nuk e vërtetojnë përgjegjësinë e parashtruesit të kërkesës se ai kishte shkelur detyrat e tij të punës.

28. Në një datë të pacaktuar, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH. A. ushtroi ankesë kundër vendimit të lartcekur të gjykatës së shkallës së parë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit procedural, vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale me propozim, që të refuzohet padia e parashtruesit dhe të prishet vendimi i kontestuar apo ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

29. Më 12 korrik 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Vendimin AC. nr. 190/2013, aprovoi ankesën e Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës SH. A., anuloi vendimin e lartcekur të gjykatës së shkallës së parë (Shih paragrafin 32 më lart) dhe refuzoi padinë e parashtruesit si të paafatshme.

30. Në Aktvendimin e lartcekur, Gjykata e Apelit të Kosovës arsyetoi se nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për shkak se nuk është i bazuar në ligj dhe është marrë me shkelje thelbësore procedurale, se neni 83 i Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës parasheh se i punësuari i cili është i pakënaqur me vendimin përfundimtar të punëdhënësit të tij ose nëse punëdhënësi nuk ka marrë një vendim brenda afatit kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita kur punonjësi, ka paraqitur kundërshtimin e tij - atëherë punonjësi ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij në gjykatën kompetente, që në rastin konkret, kemi të bëjmë me një afat prekluziv që nuk mund të ndryshohet nga palët ndërgjyqëse dhe as nga gjykata. Pra, padia e parashtruesit duhet detyrimisht të hidhet poshtë si e parakohshme për shkak se ajo është parashtruar jashtë afatit prekluziv ligjor.

31. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion kundër vendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit procedural, aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet vendimi i Gjykatës së Apelit dhe të vërtetohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë (Shih paragrafin 32 më lart).

32. Më 18 dhjetor 2013, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 297/2013, refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion si të pabazuar. Gjykata Supreme miratoi qëndrimin ligjor dhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit se padia e parashtruesit të kërkesës është e paaaftshme.

33. Pjesa përkatëse e Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme thekson:

> *"Në rastin konkret, paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur pas afatit të parashikuar me ligjin e lartpërmendur, për arsye se padia në gjykatë është paraqitur me datë 18.2.2003, ndërsa njoftimin nga e paditura e ka marrë me datë 22.10.2002.*
>
> *Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e nenit 83 të LPTHMP, për arsye se ky afat është prekluziv dhe pas skadimit të tij punëtori e humb të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, prandaj, padia e paraqitur pas këtij afati doemos duhet të hidhet poshtë si e pasafatshme. Në rastin konkret, paditësi ka kundërshtuar informimin mbi përfundimin e punësimit më datë 5.11.2002, ndërsa padinë në gjykatë e ka dorëzuar më 18.2.2003, do me thënë më tepër se tre muaj".*

Dispozitat përkatëse të kontesteve civile (kontestet e punës) para hyrjes në fuqi të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-22, i miratuar më 1 tetor 2010

Ligji Themelor i Punës në Kosovë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 60/89, 42/90, 42, 92 dhe 24/94)

> *"Neni 83, një punonjës i cili nuk është i kënaqur me vendimin e organit kompetent të organizatës, ose në qoftë se organi nuk arrin të marrë një vendim brenda 30 ditëve nga dita e parashtrimit të ankesës, respektivisht kundërshtimit, ka të drejtë në afatin tjetër prej 15 ditësh që të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij para gjykatës kompetente".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës, *inter alia,* pretendon se *"me rastin e vendosjes mbi revizionin e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës nuk pati parasysh dhe nuk vlerësoj e as nuk u përgjigj në shumëllojshmërinë e pretendimeve të parashtruara në këtë lëndë siç ishin: "ndërrimi i statusit të punës, mos dhënia e këshillës juridike, moszhvillimi i asnjë procedure disiplinore në kuptimin e dispozitave të ligjeve të përmendura më lart. Me këtë rast parashtruesit i janë cenuar të drejtat themelore për të qenë i barabartë*

para ligjit dhe për të mbrojtur të drejtat e tij në mënyrë efektive. Gjithashtu, nga ana e Gjykatës Supreme nuk u morën parasysh të gjitha provat në tërësinë e çështjes sipas praktikave të GJEDNJ-së për të dhënë arsye të mjaftueshme për refuzimin e argumenteve të parashtruara ose nëse aktgjykimi i saj tregon "arbitraritet të dukshëm".

35. Në lidhje me procedurat e zhvilluara para punëdhënësit të tij, parashtruesi ka shtuar*: "Duke u nisur nga fakti se parashtruesit nuk i është dhënë mundësia për përdorimin e mjetit efektiv brenda organizatës se tij punuese me mosdhënien e këshillës juridike në vendimet e të paditurës (informimin mbi përfundimin e punësimit në Hekurudhat e UNMIK-ut të dt. 17. 10.2002) dhe mos përgjigjen ndaj kundërshtimeve me shkrim të parashtruesit, nuk i është dhënë mundësia për përdorimin e mjetit efektiv brenda organizatës, parashtruesit i është cenuar e drejta elementare për ankim efektiv, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutën e republikës së Kosovës neni 32 dhe neni 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Meqenëse parashtruesit i është marrë e drejta për ankim brenda punëdhënësit, të njëjtit nuk mund ti mohohet mbrojtja gjyqësore dhe se gjykatat lidhur me padinë e parashtruesit duhet të vendosin meritorisht".*

36. Sa i përket mospërputhjeve të pretenduara në marrjen e vendimeve nga gjykatat e rregullta, parashtruesi deklaroi*: "Me ndërrimin e kolegjeve gjykuese të gjykatave ndërrohen edhe mendimet dhe qëndrimet e marra lidhur me të njëjtën çështje. Si ndryshe të kuptohet kur për të njëjtën çështje Gjykata e Qarkut (tani Apelit) dhe ajo Supreme shprehen për të njëjtën çështje. Me siguri se sikur të ishte padia e ushtruar jashtë afatit atëherë me siguri se nga ana e Gjykatës së Qarkut fillimisht e pastaj nga ana e Gjykatës Supreme kur vendosi për revizionin herën e parë me dt. 11.11.2004 do të hudhej padia e parashtruesit qysh atëherë si e pasafatshme e jo të pritet plot 8 vite dhe tani të merret një qëndrim i tillë diametralisht i kundërt me atë të marrë tetë vite më parë".*

37. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që ta deklarojë kërkesën të pranueshme, (ii) ta deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin Rev. nr. 297/13, të Gjykatës Supreme të Kosovës të 18 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimin AC. nr. 190/2013, të Gjykatës së Apelit të Kosovës të 12 korrikut 2013, dhe (ii) të vërtetojë Aktgjykimin C. nr 1398/08, të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 6 shtatorit 2012.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

40. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

41. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

42. Sa i përket pretendimeve në lidhje me mospërputhje në marrjen e vendimeve të gjykatave të rregullta të bëra nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata së pari vëren se vendimet në fjalë kanë të bëjnë me periudhën 1999-2005, që do të thotë, se ato ishin nxjerrë në rrethana të ndryshme dhe në një kohë kur Gjykata nuk kishte juridiksion kohor dhe si të tilla nuk janë *ratione temporis* të pajtueshme me Kushtetutën, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008. (Shih, për shembull, Rasti Nr. KI47/14, parashtrues *Mustafë Zejnullahu*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 gushtit 2014 , paragrafi 25).

43. Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit për mospërputhje në marrjen e vendimeve të gjykatave të rregullta nuk është bindës dhe mjaftueshëm i dëshmuar; por ngre çështje të interpretimit dhe kualifikimit të dispozitave ligjore të cilat në të vërtetë bien në fushëveprimin e gjykatave të rregullta, të dhëna atyre me Kushtetutë dhe me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

44. Gjykata, gjithashtu, vëren se gjykatat e rregullta kanë konstatuar se ankesa e parashtruesit është parashtruar 3 (tre) muaj pas afatit ligjor, që sipas interpretimit të tyre i ka përjashtuar ato që të marrin një vendim për meritat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

45. Gjykata theksonse nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave, ose aplikimin eligjit(ligjshmërisë), përveç dhepër aq saato mund tëkenë shkelur të drejtatdhe liritë e mbrojturanga Kushtetuta(kushtetutshmëria).

46. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e vendit, përveç dhe për aq sa ato gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta. Ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet që kanë çuar gjykatat e rregullta të nxjerrin një vendim në vend të një tjetri. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të kishte vepruar si gjykatë e shkallës së tretë apo të katërt, që do të ishte shpërfillje e kufijve të imponuara në veprimin e saj (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, dhe shih gjithashtu *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, dhe shih Rastin KI86/11,

parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

47. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

48. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dëshmuar mjaftueshëm pretendimin e tij në lidhje me shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

49. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 28 janar 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI60/15, Parashtrues Avni Grajqevci, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 54/2015

KI60/15, Aktvendim për papranueshmëri i 9 shkurtit 2016, publikuar më 10 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Pml. nr. 54/2015, aprovoi vendimin e Gjykatës Themelore dhe të Apelit që parashtruesi të dënohet me 6 (gjashtë) muaj burg.

Parashtruesi pretendoi se me këtë vendim është shkelur parimi *ne bis in idem*. Po ashtu, pretendoi se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Njerëzor ose Poshtërues], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe tërësisht shpjegon pse ka vërtetuar se gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë vlerësuar rastin. Kësisoj, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata konstatoi se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta dhe se në to nuk gjinden shkeljet e pretenduara. Kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar siç është e paraparë me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI60/15
Parashtrues
Avni Grajqevci
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 54/2015, të 16 marsit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Avni Grajqevci (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Obiliqi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 54/2015, të 16 marsit 2015, i cili i ishte dorëzuar atij më 27 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenet 3, 5, 6, 10, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI60/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI60/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama Hajrizi.

7. Më 27 tetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 9 shkurt 2016,passhqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportuesKolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 maj 2010, patrulla e trafikut të Policisë së Kosovës ndaloi veturën e drejtuar nga parashtruesi i kërkesës për një kontroll të rregullt.

10. Gjatë kontrollit të dokumenteve të udhëtimit të parashtruesit, rrjedh, se ka pasur konflikt verbal ndërmjet parashtruesit dhe patrullës policore të trafikut, dhe më vonë edhe konflikt fizik, që rezultoi edhe me lëndime nga të dy palët.

11. Më 12 maj 2010, Inspektorati Policor i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: IPK) për shkak të pretendimeve për përdorim të tepruar të forcës nga ana e një polici të trafikut, inicioi hetim të brendshëm.

12. Pas përfundimit të hetimit, IPK-ja i rekomandoi Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që kundër njërit prej policëve të shqiptojë masën e caktuar, në bazë të Udhëzimit Administrativ, Nr. 15/2008 për Llojet e Shkeljeve të Rënda dhe të Lehta Disiplinore në Policinë e Kosovës.

13. Më 11 maj 2011, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nxori Vendimin [P. nr. 222/VDP/2011], me të cilin e aprovoi propozimin e IPK-së. Në vendim theksohet se "*për shkak të përdorimit të tepruar të forcës, zyrtarit policor i shqiptohet masa disiplinore ndalesë në pagë për një periudhë të caktuar kohore*".

14. Më 14 tetor 2011, Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: PPK) ka ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të paraparë me nenin 317, paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

15. Më 12 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktvendimin [KA. nr. 352/11], me të cilin e refuzoi aktakuzën e PPK, me arsyetimin se „*aktakuzanuk*

përmban prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet".

16. Në afatin ligjor, PPK paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale, të 14 tetorit 2011.

17. Më 7 maj 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktvendimin [Pn. nr. 184/2013], me të cilin e aprovoi aktakuzën e PPK dhe ktheu lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim, me arsyetimin: *„Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, provat në bazë të të cilave është ngritur aktakuza përkitazi me këtë vepër penale e mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale".*

18. Më 24 shkurt 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin [P. nr. 2252/2013], me të cilin e shpalli parashtruesin fajtor për veprën penale për të cilën ishte akuzuar, dhe e dënoi me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Në dispozitivin e Aktgjykimit theksohet: *"[...] pasi që i pandehuri refuzoi të pranoj fajësinë, gjykata i prezantoi provat, dëshmitarët, raportet e ekspertëve të mjekësisë ligjore, dhe përveç kësaj gjykata me rastin e caktimit të dënimit e vlerësoi edhe deklaratën e të pandehurit".*

19. Më 13 mars 2014, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të 24 shkurtit 2014, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

20. Më 11 shtator 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin [PA1. nr. 427/2014], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, sepse "*megjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë drejtë e aplikoi dhe të drejtën penale kur të akuzuarin e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, gjithashtu dhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe në këtë proces asnjë fakt i vetëm nuk mbeti i dyshimtë ose i paqartë...".*

21. Më 20 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes së dispozitave të kodit penal.

22. Më 16 mars 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Pml. nr. 54/2015] me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar, me konstatimin se *„Mbi bazën e këtyre provave, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të padyshimtë ka vërtetuar se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë elementet e figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe këtë qëndrim e mbështet edhe gjykata e shkallës së dytë me arsyetimin e duhur, e që e aprovon edhe Gjykata Supreme".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*është shkelur parimi Ne bis in idem, sepse nëse dikush është shpallur fajtor për një vepër penale, atëherë nuk mundeni të shpallni fajtor dhe dikë tjetër, ku kemi të bëjmë me të njëjtën ngjarje* (në këtë rast parashtruesi i kërkesës), *gjithashtu gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe rrjedhimisht të gjitha gjykatat, dhe në fund edhe nga Gjykata Supreme mi kanë shkelur të drejtat e mija të garantuara me Kushtetutë (Neni 34) dhe KEDNJ*".

24. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë: "*kërkoj që rasti të shqyrtohet, të aplikohen mjete të jashtëzakonshme për mbrojtjen e ligjshmërisë, të fillon*

procedura e re apo ndërmerret ajo që është në juridiksionin tuaj, në mënyrë për të korrigjuar parregullsitë dhe padrejtësitë në rastin tim".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

28. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(3) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(4) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

29. Pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, Gjykata gjeti se parashtruesi i kërkesës ankesën e tij kushtetuese e ndërtoi mbi parimin e doktrinës *Ne bis in idem*, si dhe në argumentin se gjykatat e rregullta kishin gabuar në vërtetimin e gjendjes faktike. Parashtruesi pohoi se pikërisht për shkak të mosrespektimit të këtij parimi dhe lëshimit të gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese, si dhe të drejtat dhe liritë të garantuara me KEDNJ.

30. Megjithatë, argumentin e parashtruesit se ky është një rast *Ne bis in idem*, i cili është përcaktuar sipas nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale (Kodi Nr. 04/L-123), si dhe sipas nenit 34 të Kushtetutës, Gjykata e konsideron si të pabazuar, sepse vepra për të cilën është shpallur fajtor zyrtari policor me Vendimin [P. nr. 222/VDP/2011], nuk është e njëjtë si vepra penale për të cilën parashtruesi ishte akuzuar dhe me vonë dënuar me aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Supreme, gjë që mund të shihet dhe konkludohet si nga shkresat e lëndës ashtu edhe nga argumentet të paraqitura nga parashtruesi në kërkesë.

31. Më tej, kur bëhet fjalë për pretendimet e ankesës kushtetuese me të cilën theksohet vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, Gjykata thekson se ajo nuk mund të zëvendësojë

vlerësimin e gjykatave të rregullta me vlerësimin e saj, për shkak se gjykatat e rregullta duhet të vlerësojnë provat të cilat i administrojnë dhe në bazë të cilave vërtetojnë faktet relevante për zbatimin e të drejtës materiale.

32. Gjykata e vlerëson si të pabazuar edhe referimin e parashtruesit të ankesës kushtetuese për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 23 dhe 27 të Kushtetutës. Kjo, jo vetëm për shkak se ankesa kushtetuese në këtë drejtim në vetvete nuk përmban arsye të detajuara, por për shkak se parashtruesi në asnjë fazë të procedurës në gjykatat e rregullta nuk është referuar në shkeljet e pretenduara dhe, si të tilla, gjykatat nuk i kanë marrë në shqyrtim.

33. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu i konsideron si të pabazuara, sepse në mënyrë që të konstatohet diskriminimi, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi në përgjithësi të pretendojë se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, ndërsa ndërkohë nuk tregon bazën për këtë pabarazi.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës juridike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila thekson se "*diskriminimi është trajtimi i ndryshëm, pa një qëllim objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme*" (Aktgjykimi: W*illis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, paragrafi 48, GJEDNJ 2002-IV, Aktgjykimi *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, aktgjykimi *D. H. dhe të tjerë kundër Republikës Çeke*, paragrafi 44.

35. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij sipas nenit 49 të Kushtetutës.

36. Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës Supreme të cilin e konteston parashtruesi në asnjë mënyrë nuk ia ndalon atij punën apo ushtrimin e profesionit, apo në ndonjë mënyrë tjetër, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ia kufizon të drejtat e tij nga neni 49 i Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, Gjykata është e mendimit se pretendimet e parashtruesit për shkeljen e pretenduar janë gjithashtu të pabazuara (Shih, *mutatis mutandis*, Aktvendim për papranueshmëri nr. RK734/14 në Rastin KI09/14 i 24 nëntorit 2014, paragrafi 29).

37. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata rithekson se e drejta për gjykim të drejtë vlerësohet në bazë të procedurës në tërësi (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, Nr. 146, paragrafi 68).

38. Gjithashtu, e drejta për një gjykim të drejtë i obligon gjykatat që të paraqesin arsyet për vendimin, të cilat u mundësojnë palëve përdorimin e mjeteve efektive juridike në dispozicion, gjë që parashtruesi e bëri në të gjitha fazat e procedurës penale. Që do të thotë se nëse ka një mangësi në një fazë të procedurës, ajo mund të kontestohet dhe korrigjohet në një fazë tjetër të procedurës.

39. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 54 të Kushtetutës sipas mendimit të Gjykatës nuk qëndrojnë, sepse ai kurrë nuk ka paraqitur një kërkesë për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese para gjykatave të rregullta.

40. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (Shih rastin *Mezõtúr-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

41. Gjykata, më tej, rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

42. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, pasi që në kërkesë nuk është provuar se vendimi i kontestuar i shkelë të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ.

43. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me rregullat36 (1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 9 shkurt 2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI109/15, Parashtrues Milazim Nrecaj, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të Qeverisë së Kosovës, nr. 171, të 9 qershorit 2011.

KI109/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 9 shkurt 2016 dhe publikuar më 17 mars 2016

Fjalët Kyç*: Kërkesë individuale, mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut, mosshterim i mjeteve juridike, parimi i subsidiaritetit*

Objekt i çështjes i kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, më të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai është privuar nga e drejta që i takon sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Parashtruesi konteston Vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Qeverisë se Kosovës që parandalon realizimin e të drejtave të tij.

Gjykata vërejti se parashtruesi nuk ka ushtruar ndonjë mjet juridik ndaj vendimit të kontestuar të Ministrisë. Prandaj, Gjykata ritheksoi se është përgjegjësi e vetë parashtruesit të kërkesës që të shfrytëzojë të gjitha mjetet efektive juridike para se të parashtrojë kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një akti të një autoriteti publik në Gjykatën Kushtetuese.
Gjykata konsideroj se në këtë rast nuk ka vendim përfundimtar të autoritetit kompetent që në këtë fazë do të mund të ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI109/15
Parashtrues
Milazim Nrecaj
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të Qeverisë së Kosovës, Nr. 171, të 9 qershorit 2011
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Milazim Nrecaj nga Sallagrazhda, komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Qeverisë së Kosovës, Nr. 171 (në tekstin e mëtejmë: MPMS), të 9 qershorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës KI109/15 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai është privuar nga e drejta që i takon sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, Nr. 04/L-054 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për statusin dhe të drejtat).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 42 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës(në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI109/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI109/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 25 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe MPMS për regjistrimin e kërkesës.

8. Gjykata, gjithashtu,kërkoi nga parashtruesi që ta plotësojë kërkesën me informata të nevojshme dhe ta dorëzojë vendimin të cilin ai e konteston.

9. Më 9 tetor 2015, parashtruesi ishte përgjigjur vetëm pjesërisht në kërkesën e Gjykatës, të 25 shtatorit 2015; gjegjësisht, ai dorëzoi në Gjykatë vetëm Vendimin Nr. 171 të kontestuar nga ai.

10. Më 9 shkurt 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës dhe e ëma e tij bashkërisht dorëzuan një kërkesë në administratën komunale në Suharekë, me të cilën ata kërkuan që t'u lëshohet një vërtetim që tani i ndjeri Rr. N. (babai i parashtruesit të kërkesës) ishte viktimë e luftës së vitit 1999.

12. Të njëjtën ditë, Drejtoria për Administratë dhe Inspeksion i Komunës së Suharekës nxori Aktvendimin me të cilin vërtetohet se Rr. N. ishte viktimë e luftës. Vendimi gjithashtu lejonte regjistrimin e mëvonshëm të të ndjerit Rr. N. në librin përkatës të të vdekurve.

13. Në një datë të pacaktuar në vitin 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në MPMS duke kërkuar njohjen e të drejtave nga Ligji për statusin dhe të drejtat. Ai e bazoi kërkesën e tij në faktin se babai i tij ishte viktimë e luftës.

14. MPMS refuzoi të pranojë kërkesën e tij. MPMS e njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk mund të pranonte kërkesën e tij për shkak të vendimit të Ministrit të MPMS Nr. 171, të 9 qershorit 2011. Në këtë Vendim, *inter alia*, thuhej:

    a) *Se numri i parashtruesve të kërkesës për pensione dhe përfitime sipas Ligjit për vlerat e luftës të mbyllet me gjendjen e 31 majit 2011.*

    b) *Se deri në miratimin e vendimit të ri politik nga Ministri i MPMS-së të mos pranohet asnjë kërkesë e re për realizimin e pensioneve të parapara me Ligjin për vlerat e luftës, si dhe të mos pranohet asnjë kërkesë për njohjen e ndonjë të drejte.*

    c) *Përderisa për aplikacionet që janë pranuar deri më 3.05.2011 në koordinim me menaxhmentin e lartë, MPMS të gjejë zgjidhje ligjore.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Në kërkesën e tij, parashtruesi thekson si në vijim: "*Kam vërtetimin nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga Kuvendi Komunal i Suharekës nga neni 3, paragrafi 1.10 i Ligjit mbi statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, viktimave civile dhe familjet e tyre Nr. 04/L-054 {...} dhe në pajtim me këtë kërkoj të drejtat që më takojnë*".

16. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

> *"Unë dëshiroj ta konfirmoj se nëna ime dhe unë bashkë me të ta përfitojmë të drejtën të cilëni takon me ligj, dhe të mos të na bëhet e padrejtë qe 16 vite. Departamenti i Mirëqenies Sociale me vendim po ashtu nga N. R., na ka neglizhuar dhe kërkoj nga autoriteti më i madh shtetëror të na kthej të drejtën nënës, mua dhe gjithë familjes, në këtë gjendje të rëndë financiare".*

Pranueshmëria e kërkesës

17. Në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

19. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka përfituar nga e drejta për pension në pajtim me Ligjin për statusin dhe të drejtat. Parashtruesi i kërkesës thekson se "*kjo është pasojë direkte e Vendimit Nr. 171 të Ministrit të MPMS për bllokimin e të gjitha kërkesave për pensione të tilla të dorëzuara pas 31 majit 2011*".

20. Edhe pse ky vendim ndërlidhet në përgjithësi me të gjitha kërkesat për pensione në bazë të Ligjit për statusin dhe të drejtat, Gjykata vëren se të drejtat e parashtruesit preken drejtpërdrejt nga ky vendim, prandaj ai është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës.

21. Më tej, Gjykata i referohet nenit 47.2 të Ligjit, që parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Për më tepër, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës, parasheh:

> *"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij konteston vetëm Vendimin nr. 171 të MPMS. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ky vendim e parandalon atë nga realizimi i të drejtave të tij.

24. Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka ushtruar ndonjë mjet juridik, as ndaj Vendimit të Ministrit të MPMS Nr. 171, të 9 qershorit 2011, për të cilin pretendon se ia ka shkelur të drejtat e tij për pension, e as ndaj refuzimit të MPMS për t'ia pranuar kërkesën për pension.

25. Gjykata konsideron se parashtruesi ka pasur mjete juridike në dispozicion, siç janë të rregulluara me nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-202 për konfliktet administrative.

Neni 10.

"Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor".

26. Prandaj, Gjykata rithekson se është përgjegjësi e vetë parashtruesit të kërkesës që të shfrytëzojë të gjitha mjetet efektive juridike para se të parashtrojë kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një akti të një autoriteti publik në Gjykatën Kushtetuese.

27. Gjykata rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore (Shih Vendimin në rastin KI07/09, parashtrues të kërkesës *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).

28. Arsyetimi për rregullin e shterimit, si në këtë rast, është që t'u ofrohet mundësia gjykatave të rregullta, të parandalojnë ose adresojnë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih: Aktvendim për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* KI41/09 i 21 janarit 2010, dhe shih: *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).

29. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se në këtë rast nuk ka vendim përfundimtar të autoritetit kompetent, i cili në këtë fazë do të mund të ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin36 (1) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 9 shkurt2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI108/15, Parashtrues i kërkesës: Sylejman Meta, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1328/2015, të 27 prillit 2015.

KI108/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 shkurtit 2016, i publikuar më 17 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, qartazi e pabazuar.*

Në një datë të paspecifikuar, N.N.T. "Eko" nga Gjakova, për punimet e kryera në objektin “Agrollapi” në Fushë Kosovë, dërgoi tek parashtruesi i kërkesës faturën (nr. 09/10) përkitazi me borxhin, duke i dhënë afat prej 7 (shtatë) ditësh për pagesën e tij.

Më 30 tetor 2014, Përmbaruesi Privat, me Urdhrin (P. nr. 503/14) miratoi Propozimin për Përmbarim të paraqitur nga N.N.T. "Eko", dhe arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbushur borxhin që rrjedh nga fatura e cekur më lart. Parashtruesi i kërkesës parashtroi prapësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë, kundër Urdhrit (P. nr. 503/14) për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, duke theksuar se fatura nuk është nënshkruar dhe vulosur nga parashtruesi i kërkesës.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar. Gjithashtu, Gjykata hodhi poshtë kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI108/15
Parashtrues
Sylejman Meta
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1328/2015, të 27 prillit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Sylejman Meta, pronar i personit juridik N.P.M. „Metaj“ me seli në Drenas (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin (Ac. nr. 1328/2015), e Gjykatës së Apelit të Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) të 27 prillit 2015, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit më 19 maj 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) si dhe me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të vendosë Masë të përkohshme për të ndaluar ekzekutimin e Aktvendimit (Ac. nr. 1328/2015) të Gjykatës së Apelit.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 54,

55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI108/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI108/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 1 tetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

9. Më 27 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën për Masë të përkohshme.

10. Më 23 nëntor 2015, Gjykata njoftoi Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë, në cilësinë e palës në procedurë, për regjistrimin e kërkesës dhe për kërkesën për Masë të përkohshme të parashtruar nga parashtruesi.

11. Më 25 nëntor 2015, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dorëzoi disa dokumente në Gjykatë.

12. Më 9 shkurt 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës dhe refuzimin e kërkesës për caktimin e Masës së përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një datë të paspecifikuar, N.N.T. “Eko” nga Gjakova, për punimet e kryera në objektin “Agrollapi” në Fushë-Kosovë, dërgoi tek parashtruesi i kërkesës faturën (nr. 09/10) përkitazi me borxhin, duke i dhënë afat prej 7 (shtatë) ditësh për pagesën e tij.

14. Në një datë të paspecifikuar, N.N.T. “Eko” parashtroi Propozim për lejimin e përmbarimit tek Përmbaruesi Privat, kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të kalimit të afatit për pagesën e borxhit i cili rrjedh nga fatura e cekur më lart.

15. Më 30 tetor 2014, Përmbaruesi Privat, me Urdhër (P. nr. 503/14) miratoi Propozimin për Përmbarim të N.N.T. “Eko”, dhe arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbushur borxhin që rrjedh nga fatura e cekur më lart.

16. Më 15 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi prapësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë, kundër Urdhrit (P. nr. 503/14) për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, duke theksuar se fatura-dokumenti i besueshëm (nr. 09/10), nuk është nënshkruar dhe vulosur nga parashtruesi i kërkesës dhe se kjo faturë nuk është bazuar në ndonjë punë juridike.

17. Më 24 mars 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendim (PPP. Nr. 24/15) e refuzoi, si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës.

18. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Themelore në Gjakovë arsyetoi:

> *"[...] Përkitazi me pretendimet se fatura është e falsifikuar, nuk ka bashkëngjitur asnjë provë të besueshme e cila do ta bënte të besueshme këtë pretendim të prapësimit.*
>
> *Duke u përgjigjur në prapësim kreditori (N.N.T. "Eko") ka theksuar se pretendimi i debitorit (parashtruesit të kërkesës) se fatura është falsifikuar nuk qëndron për faktin se fatura nr. 09/10 e dt. 9.10.2014 është regjistruar në librin e shitjes për vitin 2014 si e tillë në faqen tre të N.N.T. "Eko" ku shihen furnizimet dhe TVSH-ja si dhe dokumentin e paraqitjes së deklarimit në ATK për periudhën tatimore 10/2014 [...]".*

19. Më 2 maj 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelitkundër Aktvendimit (PPP. Nr. 24/15) të Gjykatës Themelorepër shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore.

20. Më 27 prill 2015, Gjykata e Apelit me Aktvendim (Ac. nr. 1328/2015) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin (PPP. Nr. 24/15) e Gjykatës Themelore.

21. Në Aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit arsyetoi se *"[...] një përfundim i tillë i gjykatës është i bazuar se ka mbështetje në dispozitat ligjore dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë [...]".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin (Ac. nr. 1328/2015) e Gjykatës së Apelit, i janë shkelur të drejtat e garantuara sikurse janë përmendur në paragrafin 3, të këtij dokumenti.

23. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të *"[...] konstatohen shkeljet e të drejtave nga Kap. II i Kushtetutës së Kosovës në procedimin e çështjes pranë Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, me Aktvendimin Ac. nr. 1328/2015 të datës 27.04.2015[...]".*

24. Parashtruesi i kërkesës, lidhur me kërkesën e tij për Masë të përkohshme pretendon se:

> *"[...]*
>
> *Dëmi i Paripareshëm dhe Cenimi i Interesit Publik*
>
> *Tani që jam duke e shkruar këtë Propozim për Masë të përkohshme, vetëm ka filluar faza e dytë e procedurës përmbarimore, gjegjësisht, faza e ekzekutimit, me ç'rast ka filluar vlerësimi dhe shënjimi i sendeve që do të shiten me qëllim që të realizohet kredia e kreditorit, në këtë rast Përmbaruesi privat Gj. R. ka për synim që në emër të "borxhit" të kreditorit të shes pronën publike ku debitori gjendet si qiramarrës, gjegjësisht, në kërkesën tij Përmbaruesi privat Gj. R. e Njofton*

Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë se ngastra nr. 27113, në vendin e quajtur "Krivova" ZK Korretica e Epërme, me sipërfaqe prej 0.61. 17 ha, është në pronësi të Komunës së Drenasit, me qira-mbajtje prej 99 vite nga N.P.M. "Metaj", do të shërbej si mjete për realizimin e kërkesës së kreditorit[...]".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

26. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

27. Gjykata e thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

28. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'ishqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e *pabazuar.*

(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;
[...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

29. Siç është theksuar më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin (Ac. nr. 1328/2015) e Gjykatës së Apelit janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës si dhe me nenin 6.1 të KEDNJ.

30. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat pretendime të cilat i ka paraqitur edhe në procedurën me rastin e ankesës para Gjykatës së Apelit, e cila me Aktvendimin (Ac. nr. 1328/2015) e 27 prillit 2015, ka dhënë përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me arsyet e zbatimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

31. Në këtë drejtim, Gjykata, gjithashtu, vëren se Gjykata e Apelit ka arsyetuar Aktvendimin e saj në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës *"[...] se nuk hyjnë në shkaqet të parapara nga neni 71 të LPP-së, e të cilat poqëse ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, e sidomos duke pas parasysh se lidhur me pretendimet nga kundërshtimi, parashtruesit i kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë të formës së shkruar që do të mbështetë pretendimet e tij, siç është paraparë në dispozitën e nenit 69 par. 4 të LPP-së, e që sipas dispozitës së cekur është paraparë që*

provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe do të refuzohet prapësimi […]".

32. Gjykata, gjithashtu, vëren se Gjykata e Apelit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe në tërësi e mbështeti arsyetimin e Gjykatës Themelore të Gjakovës.

33. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit shqyrtoi secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës duke shpjeguar në mënyrë të detajuar, pse është dashur që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës së instancës më të ulët.

34. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, konsideron se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nuk ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, ashtu siç pretendon parashtruesi i kësaj kërkese.

35. Përkitazi me pretendimet tjera që i takojnë gjendjes faktike dhe interpretimit të dispozitave të ligjit, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj tëmerret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat apo autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

36. Gjykata, gjithashtu, thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28).

37. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-se, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

38. Gjykata më tej, konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe ato në Gjykatën e Apelit, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatismutandis, Shub kundër Lituanisë,* Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

39. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës* së *Sllovakisë,* nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk kishte saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

40. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij janë të padëshmuara dhe të pabazuara, prandaj kërkesa e tij duhet deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

41. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar.

Kërkesa për Masë të përkohshme

42. Siç është theksuar edhe më lart, parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata të ndaloj ekzekutimin e Aktvendimit (Ac. nr. 1328/2015) të Gjykatës së Apelit për arsyet nga paragrafi 22 i këtij dokumenti.

43. Në mënyrë që Gjykata të vendos Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4 dhe 5) të Rregullores së punës, nevojitet që:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; ose*
> *(...)*
>
> *Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

44. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme. Për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) (d) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 9 shkurt 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJE kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI102/15 dhe KI115/15, Parashtruesit e kërkesës: Ilmi Gashi dhe Naser Raçi, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 76/2015, të 2 prillit 2015, dhe Rev. nr. 89/2015, të 15 prillit 2015

KI102/15 dhe KI115/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit, i publikuar më 17 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, pension invalidor, qartazi e pabazuar*.

Të dy parashtruesit paraqitën kërkesën në Fondin Pensional të Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) që t'ju njohë të drejtën për pension invalidor. Punëdhënësi i aprovoi kërkesat e parashtruesve për pension invalidor. Me vendimet e lartcekura u përcaktua se pagesa e pensionit për parashtruesit e kërkesës do të jetë për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

Pas përfundimit të periudhës prej 5 vitesh, parashtruesit paraqitën padi kundër punëdhënësit me kërkesë që punëdhënësi të vazhdojë me pagesën e pensioneve invalidore. Parashtruesit e kërkesës pretenduan se me aktgjykimet e kontestuara të Gjykatës Supreme të Kosovës *"janë shkelur të drejtat e tyre të punës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës"*. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"nëse shëndeti i punëtorit është përmirësuar, punëtori kthehet në punë"*.

Gjykata konkludoi se parashtruesit e kërkesës nuk kishin shpjeguar pse dhe si ishin shkelur të drejtat e tyre të punës, të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesve, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ata e kundërshtojnë janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
rastet e bashkuara nr.
KI102/15 dhe KI115/15
Parashtrues
Ilmi Gashi dhe Naser Raçi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 76/2015, të 2 prillit 2015,
dhe
Rev. nr. 89/2015, të 15 prillit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI102/15, është dorëzuar nga z. Ilmi Gashi, ndërsa kërkesa KI115/15, është dorëzuar nga z. Naser Raçi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

A. Sa i përket kërkesës KI102/15

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 76/2015, të 2 prillit 2015.

B. Sa i përket kërkesës KI115/15

3. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 89/2015, të 15 prillit 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 qershor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se është *"shkelur e drejta e Kushtetutës, neni 49"*.

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 korrik 2015, parashtruesi Ilmi Gashi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 9 shtator 2015, parashtruesi Naser Raçi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 1 tetor 2015, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës KI102/15, në Gjykatën Supreme.

10. Më 20 tetor 2015, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës KI115/15 në Gjykatën Supreme.

11. Më 25 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, urdhëroi bashkimin e kërkesës KI115/15 me kërkesën KI102/15. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë me atë që ishte vendosur me Vendimin nr. KSH. KI102/15.

12. Më 26 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit dhe Gjykatën Supreme për bashkimin e kërkesave.

13. Më 22 dhjetor 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

A. *Sa i përket kërkesës KI102/15*

14. Nënjë datë të pacaktuarnë vitin 2005,KorporataEnergjetike e Kosovës(në tekstin e mëtejmë: KEK), e aprovoi kërkesëne parashtruesit përpensionnënkategorinë“A”(Vendimi nr.45), në pajtim me Rregulloren eUNMIK-ut 2001/35dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.

15. Me vendimet elartcekurau përcaktua se pagesa epensionitpërparashtruesin e kërkesësdo të jetë përnjë periudhë të caktuarprej 5 (pesë)vitesh (prej 1 prillit 2005deri më 1maj 2010), ndërsa shumae pensionit mujordo të jetë105euro. Për më tepër, në vendim thuhet sepala e pakënaqurmund të paraqesë ankesënëKomisioninpërshqyrtimin ekontesteve.

16. Sipasdokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruarasnjëankesë ndajkëtij vendimi.

17. Siç specifikohet nëmarrëveshje, KEK kishte ndërprerëpagesën epensionittë parashtruesit të kërkesës, pas datës së fundit.

18. Në një datë tëpaspecifikuar,parashtruesi parashtroi padinë GjykatënThemelore në Prishtinë.

19. Më 13 maj 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1021/2010) refuzoi, si të pabazuara paditë e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore konstatoi se *"KEK-u ka përmbushur obligimin në bazë të marrëveshjes dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar kur është nënshkruar marrëveshja"*.

20. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

21. Më 26 shkurt 2004, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 3925/2013) e refuzoi, si të pabazuar ankesën dhe i vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore.

> *"Meqë në marrëveshjen e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës në nenin e kësaj marrëveshje është paraparë që kjo marrëveshje të filloj nga dt. 01.04.2005 dhe do të përfundon pas pagesës prej 60 muajve, e cila përfundon me dt. 01.05.2010, kjo pagesë është paraparë në nenin 2.1 pika al. të marrëveshjes gjegjësisht statutit të Fondit Pensional Invalidor dhe të vdekurve të Korporatës Energjetike të Kosovës, me dt. 01.11.2002. Nga kjo rezulton se e paditura ka përmbushur obligimin në bazë të marrëveshjes së cituar më lart, përkatësisht vendimit nr. 45 të dt. 24.03.2005, në të cilin vendim është përcaktuar saktë data kur fillon pagesa e pensionit me dt. 01.04.2005 dhe përfundon me dt.01.05.2010, gjithashtu është përcaktuar saktë se kur përfituesi i këtij pensioni do t'i ndërprehet dhe atë si me datën e cituar më lart. Shuma e pensionit është përcaktuar në shumë prej 105 euro. Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka mundur të ushtrojë ankesë dhe se një të drejtë të tillë paditësi nuk e ka shfrytëzuar. Andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar".*

22. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

23. Më 2 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 76/2015) e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion.

24. Gjykata Supreme konstatoi:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, arsyetimin e aktgjykimit të gjykatave të instancës më të ulët e ka pranuar si të drejtë, meqë paditësi vetë ka aplikuar për pensionim, e cila kërkesë i është miratuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut, dhe në bazë të këtyre fakteve e paditura me Vendimin nr. 45 datë 24.3.2005 , ka informuar paditësin për kushtet konkrete të pensionimit. Me vendimin e cekur më lart të paditurës, është përcaktuar se pagesa e pensionit fillon më 1.4.2005 dhe përfundon më 1.5.2010, në lartësinë mujore prej 105 €. Kundër këtij vendimi paditësi ka mundur të paraqesë ankesë Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes administratës së Fondit Pensional, por ankesë nuk ka ushtruar dhe pensionin e ka pranuar gjer më 1.5.2010. Kjo Gjykatë vlerëson se paditësi është pajtuar që marrëdhënien e tij të punës ta shndërrojë në marrëdhënie tjetër juridike, ndërsa thëniet e revizionit se paditësi ndërkohë është aftësuar për punë, por nuk është pranuar kthimi i tij në punë e as që është vazhduar pagesa. Gjykata Supreme e shqyrtoi por e njëjta nuk pat ndikim për të vendosur ndryshe, ngase në vendimin e të paditurës është cekur se (me këtë vendim zëvendësohen të gjitha aktet e gjertanishme të nënshkruara në mes KEK-ut dhe shfrytëzuesit). Kjo Gjykatë vlerëson se e paditura ka përmbushur obligimin e saj ndaj paditësit, ngase ka vepruar konform vendimit të cekur i cili nuk është kundërshtuar nga paditësi. Me nenin 11.1, pika (b) të Ligjit Themelor të Punës në*

Kosovë, është paraparë se kontrata e punës mund të shkëputet me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit".

B. *Sa i përket kërkesës KI115/15*

25. Nënjë datë të pacaktuarnë vitin 2004,KorporataEnergjetike e Kosovës(në tekstin e mëtejmë: KEK), e aprovoi kërkesëne parashtruesit përpensionnënkategorinë"A"(Vendimi nr.140), në pajtim me Rregulloren eUNMIK-ut 2001/35dhe Statutin e FonditPensional të KEK-ut.

26. Me vendimet elartcekurau përcaktua se pagesa epensionitpërparashtruesin e kërkesësdo të jetë përnjë periudhë të caktuarprej 5 (pesë)vitesh (prej 1 korrikut 2004deri më 1gusht 2010), ndërsa shumae pensionit mujordo të jetë105euro. Për më tepër, në vendim thuhet sepala e pakënaqurmund të paraqesë ankesënëKomisioninpërshqyrtimin ekontesteve.

27. Sipasdokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruarasnjëankesë ndajkëtij vendimi.

28. Siç specifikohet nëmarrëveshje, KEK kishte ndërprerëpagesën epensionittë parashtruesit të kërkesës, pas datës së fundit.

29. Në një datë tëpaspecifikuar,parashtruesi parashtroi padinë GjykatënThemelore në Prishtinë.

30. Më 27 shkurt 2012, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1333/2011) i refuzoi paditë e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore konstatoi se *"KEK-u ka përmbushur obligimin në bazë të marrëveshjes dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar kur është nënshkruar marrëveshja".*

31. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

32. Më 11 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 5267/2012) e refuzoi, si të pabazuar ankesën dhe i vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore, duke theksuar që.

"Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë se paditësi ka shkuar në pension të parakohshëm si invalid i kategorisë së 3-të, sipas kërkesës-aplikimit të tij, i cili i është lejuar me Vendimin e të paditurës nr. 140/53, i datës 13.7.2004, i cili gjen mbështetje në Rregulloren e UNMIK-ut nr. i 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të të paditurës, e që pagesa e paraparë e pensionit i është bërë në lartësinë mujore prej 105,00 €, për pesë vite, duke filluar nga data 1.7.2004 dhe i ka përfunduar me datë 1.8.2009. Ky vendim e ka pasur edhe kështillën juridike, se pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë kundër tij, gjë që paditësi asnjëherë nuk e ka bërë, çka nënkupton se ai është pajtuar me të njëjtin në të gjitha pjesët e tij, edhe sa i përket kohës së pensionimit e edhe lartësisë së pagesës, prandaj, ky vendim ka marrë formën e prerë dhe është zbatuar në përpikëri nga e paditura e cila e ka përmbushur detyrimin e vet të pagesës ndaj paditësit për gjatësinë kohore prej 5 vitesh, prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se paditësit i mungon baza ligjore për miratimin e kërkesëpadisë së tij, meçka pajtohet edhe kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë".

33. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

34. Më 15 prill 2015, Gjykata Supreme (Rev. nr. 89/2015) e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion.

35. Gjykata Supreme konstatoi:

> *"Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit se nga ana e gjykatave të shkallës më të ulët, çështja e paditësit nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me çështjet tjera të palëve tjera, edhe pse lidhur me të njëjtën gjendjen faktike e juridike ekziston aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese edhe për 26-ish punëtor të paduturës, kërkesa e të cilëve është pranuar. Gjykata Supreme gjen se këto pretendime të revizionit nuk qëndrojnë për faktin se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në të cilin paditësi është thirrur në revizion nuk i referohet çështjes kontestuese të cilën paditësi e ka ngritur në gjykatë, por i njëjti ka të bëjë me situatën në të cilën raportet mes të paduturës dhe punëtorëve të caktuar janë rregulluar me një marrëveshje të veçantë, sipas të cilës e paditura është detyruar që këtë pagesë mujore prej 105 €, në muaj t'ua bëjë gjer në formimin e Fondit Pensional e Invalidor të Kosovës, ndërsa në rastin konkret raporti në mes paditësit dhe të paduturës është rregulluar me një vendim i cili nga e paditura është marrë sipas aplikimit të paditësit për pension të parakohshëm, dhe me të njëjtin është pranuar aplikimi dhe kërkesa e paditësit për pension të parakohshëm me kohëzgjatje të caktuar prej 5 viteve, dhe e paditura sipas këtij vendimi ka kryer obligimin e pagesës së këtij pensioni, ndërsa në të njëjtin vendim nuk është paraparë vazhdimi i kësaj pagese edhe pas periudhës 5 vjeçare të precizuar në këtë vendim. Paditësi ka qenë në dijeni për kohëzgjatjen e këtij pensioni të precizuar në këtë vendim, mirëpo ka pranuar këto kushte të pagesës së këtij pensioni, dhe kundër këtij vendimi nuk është ankuar. Për këto arsye Gjykata Supreme , pranon në tërësi si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të shkallës së parë sipas të cilit e paditura pa një vendim, marrëveshje apo ndonjë rregullore apo akt të brendshëm juridik, respektivisht pa ndonjë bazë ligjore, nuk është e detyruar që paditësit t'ia vazhdojë pagesën e këtij pensioni të parakohshëm, gjer në arritjen e moshës për pension prej 65 vjet, të paraparë me ligj".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktgjykimet e kontestuara të Gjykatës Supreme të Kosovës *"janë shkelur të drejtat e tyre të punës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës"*.

37. Parashtruesit pretendojnë se *"ishin të informuar se nëse shëndeti i punëtorit është përmirësuar, punëtori kthehet në punë"*.

38. Përveç kësaj, parashtruesit kërkuan nga Gjykata Kushtetuese të "*anulojë aktgjykimet e gjykatave të ulëta dhe ti kthejë parashtruesit në punë"*.

Pranueshmëria e kërkesës

39. Së pari, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

41. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin mbi baza kushtetuese dhe nuk kanë dhënë prova që dëshmojnë se të drejtat dhe liritë e tyre themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

43. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë sa që procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

44. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme aktgjykimet e saj dhe Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

45. Gjykata rikujton se rastet e tjera të KEK-ut në të cilat janë referuar parashtruesit e kërkesës (p.sh. KI40/09) janë gjykuar lidhur me kompensimin e përkohshëm për shkëputjen e marrëdhënies së punës nga KEK-u. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkesat e tanishme KI102/15 dhe KI115/15 dallojnë nga rastet e lartcekura (p. sh., KI40/09). Në të vërtetë, në këto raste, KEK-u dhe ish-punonjësit tjerë nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm deri në krijimin e Fondit Pensional dhe Invalidor të Kosovës me referencë për një datë të pacaktuar, përderisa në rastin konkret KI102/15 dhe KI115/15, KEK-u dhe ish-punonjësit tjerë nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, pra duke iu referuar një date të caktuar.

46. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kishin shpjeguar pse dhe si ishin shkelur të drejtat e tyre të punës, të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. Deklarata e thjeshtë, se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga ana e gjykatës së rregullt, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

47. Pra, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

48. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesat janë qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht, të papranueshme

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

I. T'I DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI97/15, Parashtrues Veli Kuçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2015, të 5 majit 2015

KI97/15, Aktvendim për papranueshmëri i 26 janarit 2016, publikuar më 17 mars 2016.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e lirisë dhe e sigurisë, barazia para ligjit, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. nr. 137/2015, të5 majit 2015, me të cilin u refuzua, si i pabazuar revizioni i parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 632/2013, të 28 tetorit 2014.

Thelbi i vendimeve të kontestuara kishte të bënte me kërkesën e parashtruesit për kompensimin e dëmit në emër të pensioneve të papaguara.
Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazinë para ligjit dhe të drejtën e lirisë dhe sigurisë.
Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur dhe dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI97/15
Parashtrues
Veli Kuçi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2015, të 5 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Veli Kuçi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në fshatin Shirokë, komuna e Suharekës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2015, të5 majit 2015, me të cilin u refuzua, si i pabazuar revizioni i parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 632/2013, i 28 tetorit 2014, përkitazi me kërkesën për kompensimin e dëmit në emër të pensioneve të papaguara.

3. Aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 korrik 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëAktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), respektivisht neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] si dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 korrik 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 28 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 26 janar2016,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Që nga viti 1973, parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në Sekretariatin Krahinor të Punëve të Brendshme të ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: SKPB).

11. Parashtruesi i kërkesës ka punuar në disa vende të punës në SKPB si zyrtar i autorizuar. Me rastin e kryerjes së detyrës zyrtare në SKPB, më 1 prill 1981, parashtruesi i kërkesës ishte plagosur gjatë kohës së demonstratave në rrugë.

12. Më 25 shtator 1989, me anë të Aktvendimit 05-nr. 580-366/86, bazuar në ligjin e atëhershëm në fuqi, parashtruesit të kërkesës i është pranuar e drejta për pension të parakohshëm të pleqërisë.

13. Më 5 korrik 2010, parashtruesi i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kërkesën për "*riaktivizim të pensionit të punës dhe invalidor"* të cilin e ka gëzuar deri në vitin 1998.

14. Më 19 korrik 2010, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS), të njëjtën e ka refuzuar me arsyetimin se ky është problem i të gjithë pensionistëve në Kosovë të cilët kanë qenë pensionistë nga fondi i ish Federatës Jugosllave. MPMS-ja, më tutje, ka theksuar se e drejta në pensionin e pleqërisë realizohet me mbushjen e moshës 65 vjeçare.

15. Më 10 gusht 2010, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë në procedurë kontestimore kundër MPMS-së, ku kërkon që të obligohet MPMS-ja t'i paguajë kompensimin në emër të dëmit material, gjegjësisht pensioneve të papaguara që nga viti 1998, si dhe riaktivizimin e pensionit të punës dhe invalidor.

16. Më 15 tetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1774/1000), refuzoi, si të pabazuar kërkesëpadinë.

17. Në arsyetim të vendimit më tutje theksohet: "*... Të padituërës i mungon legjitimiteti pasiv dhe se çështja e legjitimitetit pasiv për të padituërën i referohet raportit material juridik, në mungesë të së cilit vendosi që kërkesëpadinë e paditësit kundër të padituërës ta refuzoj si të pabazuar".*

18. Më 19 janar 2013, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës së Apelit me ankesë ndaj Aktgjykimit të cekur në paragrafin 14, duke pretenduar "*shkelje të rëndë të Ligjit dhe nuk është prezantuar gjendja objektive*".

19. Më 28 tetor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 632/13), refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetim të vendimit Gjykata e Apelit thekson se Aktvendimi i atakuar është në tërësi i rregullt dhe i ligjshëm, dhe se MPMS-ja nuk është trashëgimtare e fondit pensional të atëhershëm dhe për këtë arsye i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike.

20. Më 28 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar se Aktgjykimi i cekur në paragrafin 17, është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 5 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 137/2015) refuzoi, si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës.

22. Gjykata Supreme theksoi: *"Gjykata e shkallës së dytë në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare ... Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon kjo gjykatë ..."*.

23. Për qëllim të një prezantimi të plotë të procedurave dhe fakteve, Gjykata vëren se më 11 maj 2011, parashtruesi kishte paraqitur kërkesën me numër KI63/11 në Gjykatë. Parashtruesi kishte kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 1239/2010, të 23 marsit 2010, në konflikt administrativ, përmes së cilës i ishte refuzuar e drejta për riaktivizim të pensionit invalidor. Më 11 korrik 2011, Gjykata, përmes Aktvendimit për papranueshmëri KI63/11, kishte hedhur poshtë kërkesën e tij në pajtim me rregullin 36 (2b) si qartazi, të pabazuar. Në rastin konkret, kërkesa e mëparshme e parashtruesit pranë Gjykatës nuk bie brenda fushës së objektit të çështjes së kësaj kërkese, për arsye se parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike tani konteston vendime tjera të gjykatave të rregullta të zhvilluara në procedurë kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës.

25. Parashtruesi i kërkesës kërkon si në vijim:.

"E lusim Gjykatën Kushtetuese të anulojë vendimin me të cilin jam dëmtuar...".

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> "7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

29. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

30. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës.

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij ishin shkelur për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve. Megjithatë, ai nuk dëshmon në mënyrë të argumentuar pretendimin e tij për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, që ka rezultuar në shkelje të drejtave të tij kushtetuese.

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me vlerësimin e fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale dhe ligjore nga gjykatat e rregullta. Vlerësimi i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

33. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë që parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurave tëpërfunduara në gjykatat e rregullta, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezőtúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21). Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih Rastin KI198/13,parashtrues i kërkesës*Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

34. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se si dhe pse konkludimi i Gjykatës Supreme ia cenon të drejtat për barazi para ligjit, të drejtën e lirisë dhe të sigurisë dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

35. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në mënyrë të hollësishme arsyetoi se pse u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit. Në mënyrë të veçantë, Gjykata Supreme konstatoi se MPMS-ja nuk mund të jetë palë në procedurë në këtë çështje juridike për shkak se i mungon legjitimiteti pasiv. Në Aktgjykimin e kontestuar gjykata Supreme thekson: "*E paditura nuk është suksesore juridike përkatësisht trashëgimtare e këtij organi dhe për këtë arsye i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike*".

36. Gjykata më tej konsideron se procedurat në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme nuk kanë qenë të padrejta ose arbitrare (Shih, rasti *Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

37. Gjykata thekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

38. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur dhe dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, më 25 janar 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI54/15, Parashtruesja e kërkesës: Melihate Nura nga Prishtina, e cila kërkon vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. nr. 31/2014, të 14 janarit 2015.

KI54/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 janarit 2016, i publikuar më 17 mars 2016.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Gjykata Supreme [Aktvendimi ARJ. nr. 31/2014] e refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AA. nr. 59/2014] dhe Aktgjykimit [A. nr. 607/2008] të Gjykatës Supreme, si të pavlefshme, pasi është paraqitur jashtë afatit të paraparë me ligj.

Parashtruesja e kërkesës ankohet në faktin se për ankesën kundër Aktgjykimit te Gjykatës Supreme ka vendosur Gjykata e Apelit, dhe si rrjedhojë i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit shpjegoi në detaje çështjen e kompetencës në këtë rast, duke cituar Ligjin për gjykatat, Nr. 03/L-199, në bazë të cilit Gjykata e Apelit kishte juridiksion për të vendosur për rastin konkret juridik, prandaj, Gjykata e Apelit i arsyetoi vendimet e saj dhe argumentoi çdo pretendim të parashtrueses në lidhje me refuzimin e ankesës së saj.

Gjykata gjithashtu konstatoi se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim te jashtëzakonshëm të Aktgjykimit si të palejuar, sepse është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesja nuk e ka mbështetur pretendimin e saj në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë provë për të treguar se si dhe pse të drejtat dhe liritë e saj të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 te Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI54/15
Parashtrues
Melihate Nura
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ. nr. 31/2014, të 14 janarit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Melihate Nura nga Prishtina, të cilën në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson e bija e saj znj. Afërdita Nura-Lama (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [ARJ. nr. 31/2014], i 14 janarit 2015. Ky Aktgjykim i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 13 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur neni 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 prill 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI54/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH.

KI54/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 1 korrik 2015, me Vendimin GJR. KI54/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit më 26 qershor 2015, i skadoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 20 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 28 janar2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportuesKolegji shqyrtuesi rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 7 nëntor 2007, Komuna e Prishtinës nxori Aktvendimin [05 nr. 350-23648] me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtrueses për dhënien e lejes tekniko-urbanistike për renovimin e objektit të banimit të dëmtuar.

11. Kundër Aktvendimit të lartcekur, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në organin e shkallës së dytë të Komunës së Prishtinës.

12. Më 22 shkurt 2008, organi i shkallës së dytë të Komunës së Prishtinës nxori Vendimin [01 nr. 350-23648], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar.

13. Kundër vendimeve të lartcekura të Komunës së Prishtinës, parashtruesja parashtroi ankesë në Kolegjin për çështje administrative të Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla sipas Ligjit për gjykatat i zbatueshëm në atë kohë.

14. Më 31 tetor 2012, Kolegji për çështje administrative i Gjykatës Supreme të Kosovës [Aktgjykimi A. nr. 607/2008] e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar.

15. Kundër Aktgjykimit të shkallës së parë [A. nr.607/2008] të Gjykatës Supreme, parashtruesja parashtroi ankesë në Kolegjin e shkallës së dytë për çështje administrative të Gjykatës Supreme, si gjykatë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla sipas Ligjit për gjykatat të zbatueshëm në atë kohë.

16. Duke pasur parasysh hyrjen në fuqitë Ligjit të ripër gjykatat, sipas ankesës së parashtruesesvendosi Departamenti për çështje administrativetë Gjykatës së Apelit. Në lidhje me juridiksionin e gjykatësnë këtë rastGjykata e Apelitkonstatoi në vijim:

> *“Gjykata e Apelit ka juridiksion në këtë çështje juridike në bazë të nenit 39 të Ligjit për gjykatat nr. 03/L-199, me të cilin është përcaktuar se: "të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës së lartë për kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë me 1 janar të vitit 2013, trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit”.*

17. Më24korrik 2014, Departamenti për çështje administrative i Gjykatës së Apelit e hodhi poshtë[Aktgjykimi AA. nr.59/2014] ankesën e parashtruesessi të pabazuardhee vërtetoi Aktgjykimin[A. nr.607/2008] të Gjykatës Supreme.

18. Më 14 tetor 2014, parashtruesja dorëzoi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

19. Më 14 janar 2015, Gjykata Supreme [Aktvendimi ARJ. nr. 31/2014] e refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AA. nr. 59/2014] dhe Aktgjykimit [A. nr. 607/2008] të Gjykatës Supreme, si të pavlefshme, pasiështë paraqiturjashtëafatit të paraparë me ligj.

Dispozita relevante ligjore lidhur me Ligjin për gjykatat

LIGJI PËR GJYKATAT NR. 03 L-199

Neni 39
Zgjidhja e lëndëve të pakryera

1. Të gjitha lëndët, të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit.

2. Të gjitha lëndët, të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykatës Komunale apo Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore e cila ka juridiksionin territorial përkatës.

Ligji hyri në fuqi më 1 janar 2011.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon:

"Gjykata më e ulët, në këtë rast Gjykata e Apelit, kurrsesi nuk mundet të vendosë sipas ankesës së ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, pra të Gjykatës më të Lartë".

21. Parashtruesja e kërkesës, më tej, pretendon:

"*Në rastin konkret kompetente për të vendosur përkitazi me ankesën e ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 607/2008, dt. 31.10.2012, është vetëm Gjykata Supreme e Kosovës*".

22. Parashtruesja kërkon nga Gjykata:

"Për këtë çështje në shkallë të dytë të vendosë Gjykata Supreme e Kosovës, si Gjykatë kompetente në këtë rast, ose në rastin më të mirë nëse anulohen të dy aktgjykimet e përmendura, pra i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës, atëherë Gjykata kompetente të vendosë sipas ligjit".

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara më Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

26. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

27. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ankohet në faktin se për ankesën kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ka vendosur Gjykata e Apelit, dhe si rrjedhojë i është shkelur e drejtae garantuarme nenin102.3[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor].

28. Në këtë drejtim, Gjykata verën se Gjykata e Apelit shpjegoi në detaje çështjen e kompetencës në këtë rast, duke cituar Ligjin për gjykatat, Nr. 03/L-199, në bazë të cilit Gjykata e Apelit kishte juridiksionpër të vendosur përrastin konkret juridik, prandaj,Gjykata e Apelit i arsyetoi vendimet e sajdhe argumentoiçdopretendim të parashtrueses në lidhje me refuzimin e ankesës së saj.

29. Gjykatagjithashtu vëren seGjykata Supreme refuzoikërkesën eparashtruesespërrishqyrtimtë jashtëzakonshëm tëAktgjykimitsitë palejuar,sepseështë paraqiturjashtëafatit të paraparë ligjor.

30. Gjykata rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e marra nga Gjykata Supreme. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të përcakton nëse procedurat e gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë dëshmitë (Shih, Rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, më 10 korrik 1991).

31. Në këtë rast, Gjykata nuk konstaton se procedurat përkatëse para Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

32. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesja nuk e ka mbështetur pretendimin e saj në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë provë për të treguar se si dhe pse të drejtat dhe liritë e saj të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar.

33. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin36 (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 28 janar2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI120/15, Parashtrues Refki Bytyqi, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-14-0220-A001-A0013, të Kolegjit të Apelit të dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 21 majit 2015

KI120/15, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2016, publikuar më 22 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin AC-I-14-0220-A001-A0013, e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme refuzoi kërkesën e parashtruesit për përfshirje në listën e punëtorëve që përfitojnë nga 20% i privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Industria Ushqimore" nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Parashtruesi pretendoi se vendimi i ka shkelur të drejtat për barazi të gjykimit të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës. Në bazë të kësaj ai kërkon të anulohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Specializuar, si kundër kushtetuese dhe kundërligjore.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktvendimi i Kolegjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i arsyetuar. Në vazhdimësi, Gjykata duke u bazuar në pretendimet e parashtruesit të kërkesës vërejti se ai nuk ka dëshmi që tregojnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI120/15
Parashtrues
Refki Bytyqi
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-14-0220-A001-A0013 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 21 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Refki Bytyqi, nga fshati Randobravë, komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin AC-I-14-0220-A001-A0013 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme), të 21 majit 2015, i cili i është dorëzuar atij më 8 qershor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. GJR. KI120/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI120/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 23 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 10 shkurt 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore "Industria Ushqimore" (në tekstin e mëtejmë: NSH) deri në vitin 1998, kur për shkak të lëndimit në vendin e punës doli në pension invalidor.

10. Më 2 gusht 2011, NSH u privatizua.

11. Më 3 maj 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Agjencia e Privatizimit) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët e kishin fituar të drejtën për një pjesë të të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH-së, në të cilën nuk gjendej parashtruesi i kërkesës.

12. Më 25 maj 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) ndaj listës përfundimtare të Agjencisë së Privatizimit.

13. Më 22 qershor 2012, Agjencia e Privatizimit u përgjigj në ankesën e parashtruesit të kërkesës duke theksuar se *"ai nuk i përmbush kushtet për realizimin e të drejtave në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/ 13, prandaj, i propozon Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme) ta refuzojë ankesën e parashtruesit si të papranueshme"*.

14. Më 16 maj 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin [C-U-120018], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin se: "*Në bazë të dokumenteve të bashkëngjitura të dorëzuara nga parashtruesi dhe Agjencia e Privatizimit, mund të konkludohet se parashtruesi prej vitit 1998 është në pension invalidor, dhe në bazë të kësaj ai nuk ka mundur të përmbush kriterin e paraparë në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13"*.

15. Më 25 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme [C-U-120018].

16. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës theksoi se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e kishte vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale, dhe se Aktgjykimi ishte kontradiktor dhe konfuz.

17. Më 21 maj 2015, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin [AC-I-14-0220-A001-A0013] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të palejuar, me arsyetimin se "*Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme ka vendosur drejtë kur ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar, sepse ai nuk kishte arritur t'i përmbush kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi në kërkesë theksoi se "*Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme i ka shkelur të drejtat për barazi të gjykimit, të garantuara me nenin 31. të Kushtetutës*".

19. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që *"të anulohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme si kundërkushtetuese dhe kundërligjore, si dhe të obligohet Agjencia e Privatizimit ta përfshijë në listën përfundimtare të punëtorëve të cilët e realizojnë të drejtën për 20% nga privatizimi*".

Pranueshmëria e kërkesës

20. Në mënyrë që të jetë në gjendje të zgjidhë ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

22. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit parasheh si në vijim:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj*".

23. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, që parasheh:

(5) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[…]
d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(6) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[…]
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

24. Duke i analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar ankesën e tij kushtetuese mbi pretendimet për shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës, i cili për nga përmbajtja korrespondon me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

25. Në rastin konkret, Gjykata gjen se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme, e më vonë edhe Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, i kanë bazuar aktgjykimet e veta në dispozitat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ku thuhet:

"Punëtori ka të drejtë në një pjesë të 20% të të hyrave nga shitja nëse ai ka qenë i evidentuar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit/likuidimit dhe nëse ka qenë në listën e pagave të NSH-së për jo më pak se tri vite. Punëtori i cili nuk i plotëson këto kushte megjithatë mund të ketë të drejtë për 20% nëse vërtetohet se diskualifikimi i tij është bërë në bazë diskriminuese".

26. Prandaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta gjetën se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i përmbushë kërkesat procedurale të përcaktuara me ligj, dhe rrjedhimisht ai nuk mund të gjendet në listën e punëtorëve të kualifikuar të cilët e kanë fituar të drejtën për 20 (njëzet) për qind nga privatizimi.

27. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm kërkon që gjykatat t'i referohen normës së caktuar juridike, ndërsa baza juridike e aktgjykimit nuk duhet të jetë arbitrare, pra jashtë lëndës konkrete, dhe, sipas mendimit të Gjykatës, gjykatat e rregullta i janë përmbajtur kësaj gjatë procedurës së rregullt.

28. Për më tepër, Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme kishte dhënë konkludime të qarta dhe të sakta në Aktgjykimin [C-I-14-0220-A001-A0013], të bazuara në interpretimin i cili është i pranueshëm sipas Kushtetutës dhe në zbatimin e të drejtës relevante, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në procedurën gjyqësore.

29. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih Rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesi *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

30. Si përmbledhje, Gjykata është e mendimit se në procedurën e zbatuar nuk ka fakte apo rrethana të cilat në ndonjë mënyrë do të tregonin se parashtruesit të kërkesës, në procedurat që i paraprinë procedurës në Gjykatë, i janë shkelur të drejtat e njeriut apo liritë e garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ. Prandaj, Gjykata gjen se referenca për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës është e pabazuar.

31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI89/15, Parashtrues Fatmir Koci, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 473/2014

KI89/15, Aktvendim për papranueshmëri i 28 janarit 2016, publikuar më 22 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, legaliteti dhe proporcionaliteti në raste penale, qartazi e pabazuar*.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin, PAKR. nr. 473/2014, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, me të cilin parashtruesi shpallet fajtor për veprën penale, marrje e ryshfetit.

Parashtruesi pretendoi se me këtë vendim të Gjykatës së Apelit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 33 [Parimi i legjitimitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale], 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] të Kushtetutës së Kosovës, nenin 6 (1) dhe 3 (d) të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk ka arritur të tregoj dhe të mbështes me fakte konkrete, se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ apo DUDNJ, sepse faktet e paraqitura asesi nuk tregojnë për shkeljet e pretenduara. Kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar ashtu siç është e paraparë me rregullin 36 (1) d) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin KI89/15
Parashtrues
Fatmir Koci
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 473/2014,
të 21 nëntorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Fatmir Koci nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga znj. Flutra Hoxha, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. Nr. 473/2014, të 21 nëntorit 2014, në lidhje me Aktgjykimin P. nr. 353/13 të Gjykatës Themelore në Prizren, të 11 korrikut 2014.

3. Aktgjykimi i fundit i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar PAKR. Nr. 473/2014, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 21 nëntorit 2014.

5. Parashtruesi pretendonshkeljen enenit24[Barazia para Ligjit], 31 [E DrejtapërGjykim të Drejtë dhetë Paanshëm], 33[Parimi i Legalitetit dheProporcionalitetit në Rastet Penale], 54[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) nëlidhje menenin 6(1) dhe 3(d) të Konventës Evropiane për tëDrejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa) dhe nenit 7 tëDeklaratës Universale për tëDrejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 23 qershor 2015, parashtruesi dorëzoi me postë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 17 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin në lidhje me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë dëshmi të dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar, si dhe parashtresat e paraqitura gjatë rrjedhës së procedurës të rregullt. Të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës.

10. Më 28 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës përveç paraqitjes së dokumenteve të reja gjithashtu, e informoi Gjykatën, se ai e ka revokuar autorizimin e znj. Myrvete Çollaku dhe ka autorizuar znj. Flutra Hoxha për ta përfaqësuar atë në Gjykatë.

11. Më 28 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës si person zyrtar - elektricist i Kompanisë së Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEDS), ka kërkuar nga një individ privat X shumën prej 500€, që mos ta dërgojë orën e energjisë elektrike për testim (*kalibrim*) në zyrën e KEDS-it, në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës dhe X ishin pajtuar të takohen në një restorant të caktuar në Prizren për ta përmbyllur "marrëveshjen" e lartcekur.

13. Në ndërkohë, X kontaktoi Policinë e Kosovës dhe u tregoi atyre bisedën e tij me parashtruesin e kërkesës. Policia e Kosovës i dha 500 € personit X, në mënyrë që t'ia ofrojë ato parashtruesit të kërkesës.

14. Më 2 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës dhe X u takuan në një restorant të caktuar në Prizren ku parashtruesi pranoi 500 € nga personi X. Parashtruesi i kërkesës ishte ndaluar më pas nga Policia e Kosovës, e cila gjeti sasinë e theksuar të parave në çantën e tij.

15. Më 3 gusht 2013, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka kërkuar paraburgimin dhe vendimin për fillimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës, në bazë të veprave penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit dhe marrjes së ryshfetit, të parapara me nenet 422 dhe 428 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

16. Më 3 gusht 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë me Vendimin PPr. KR. 73/13 aprovoi kërkesën e Prokurorit Publik dhe urdhëroi një muaj paraburgim për parashtruesin e kërkesës.

17. Më 22 tetor 2013, Prokurori parashtroi Aktakuzën PPr. Nr. 155/13 kundër parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore në Prizren - për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit - sipas nenit 428, paragrafi 2, i KPRK-së. Prokurori kishte theksuar, *inter alia*, është përtej dyshimit se parashtruesi ishte një zyrtar i KEDS, dhe se ai pranoi 500 € nga X.

18. Parashtruesi deklaroi në Gjykatën Themelore, *inter alia*, se veprimet e tij nuk ishin të paligjshme për shkak se X ka deklaruar se ai nuk është i dëmtuar, se ai i mori paratë nga X për të paguar borxhin e energjisë elektrike dhe jo si ryshfet, dhe se nuk është dëshmuar se ai ka kryer veprën penale në fjalë.

19. Më 11 korrik 2014, Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykimin, P. nr. 353/13, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor duke theksuar:

> *"ËSHTË FAJTOR Se më datën 02.08.2013 rreth orës 13,10 minuta në Prizren, në cilësinë e personit zyrtar - elektricist për matjen e njehsorëve pranë KEDS në Prizren, drejtpërdrejtë kërkon përfitim për vete në mënyrë që si zyrtar për matjen e njehsorëve të veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare (të cilat rrjedhin nga kontrata e punës me nr. 12105/0 të datës 01.01.2013), për të mos dërguar njehsorin e rrymës në kalibrim në Prishtinë, e cila paraprakishht ishte marrur nga shtëpia e të dëmtuarit disa ditë më parë, në atë mënyrë që nga i dëmtuari Arsim Sadiku gjatë takimit të tyre në restoranin e marketit "Super Viva" pranon shumën prej 500 euro në apoena 10 x 50 Euro, duke i futur në çantë ashtu që në momentin e daljes nga restorani ndalohet nga Njësiti i krimeve ekonomike dhe me kontrollim paraprak tek ai janë gjetur paratë të cilat i njëjti i kishte marrur e të cilat me pas janë konfiskuar.*
>
> *- Kësodore ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga nenin 428 par. 2 të KPK-së.*
>
> *GJYKON me dënim me gjobë në shumën prej 1000/njëmijë/euro, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 3 (tre) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 03.08.2013 e gjerë më 21.10.2013".*

20. Gjykata Themelore, *inter alia*, arsyetoi se gjetjet e veta i kishte bazuar në deklaratat e të dëmtuarit X, se parashtruesi në cilësinë e personit zyrtar - elektricist i KEDS drejtpërdrejt – ka kërkuar fitim - nga X, që parashtruesi i kërkesës pranoi 500 € nga X dhe u ndalua më pas nga Policia e Kosovës.

21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës duke pretenduar, *inter alia*, se Gjykata Themelore ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale dhe vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi kryesisht u ankua se Policia e Kosovës ka kurdisur që ai të pranojë para nga X, që X ka pranuar se ai ka bërë një gabim të fakteve dhe të ligjit (*lajthim faktik dhe juridik*), dhe se, dënimi me burgim dhe gjobë është i rëndë duke marrë parasysh gjendjen familjare të parashtruesit.

22. Më 21 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin PAKR. Nr. 473/2014, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

23. Në pjesën relevante të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit theksohet:

"Duke i vlerësuar këto prova dhe fakte kjo Gjykatë gjen se pretendimet në ankesë sa i përket gjendjes faktike nuk mund të pranohen si të tilla. Në radhë të parë i dëmtuari vet e ka paraqitur rastin në polici, pastaj dëshmia e tij e dhënë në polici dhe në Prokurori korrespondon me dëshmitë e zyrtarëve policor dhe provat tjera materiale CD e incizuar, listingun e thirrjeve/Sms hyrëse-dalëse, prandaj pretendimi se dëshmia e të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor është reale, se i dëmtuari ishte në lajthim faktik dhe se rasti është sajuar përjashtohet tërësisht. Se cilën deklaratë do ta aprovojë gjykata ajo nuk është e lidhur as e kufizuar me rregulla të posaçme formale provuese. Në parim mbeshtetet ajo deklaratë që ka mbështetje në provat tjera. Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë elementet e veprës penale, nga neni 428 par.2 të KPK për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor është i drejtë. Sipas përkufizimit ligjor të dispozitës së lartcekur kjo vepër penale ekziston atëherë kur personi zyrtar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare. Këto forma të veprimit të kryerjes së kësaj vepre penale personi zyrtar i ndërmerr për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, pra bëhet fjalë për veprim të palejueshëm, të paligjshëm të personit zyrtar. Ndërsa, meqë është vërtetuar se i pandehuri të dëmtuarit i kërkoj dhe i mori para për të mos e dërguar njehsorin elektrik në Qendrën e Kalibrimit, kjo gjykatë vlerëson se tek veprimet e tij janë përmbushur elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetitnga neni 428 par.2 të KPRK, ngase ai ka marrë para që të veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, pra, të ndërmarrë veprimin e kundërligjshëm. Ndërsa, qëndron fakti se gjykata nuk e ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim në dënimin e shqiptuar, mirëpo, në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim thjesht teknik ngase siç del nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar koha e kaluar në arrest shtëpiak të pandehurit i është llogaritur nga dita e caktimit të paraburgimit. I pandehuri ka qëndruar në paraburgim prej 3.08.2013 deri më 2.09.2013, ndërsa në dënimin e shqiptuar gjykata ia ka llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 3.08.2013 deri me 21.10.2013. Për, këto arsye kjo Gjykatë i vlerësoj si të pabazuara edhe pretendimet ankimore sa i përket shkeljes se ligjit penal".

Ligji

Pjesa përkatëse e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, parashihen si më poshtë:

Neni 428
Marrja e ryshfetit

1. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

2. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) dhe 3 (d) të Konventës dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*ai ishte futur në grackë dhe se rasti i tij ishte një kurdisje nga Policia e Kosovës për shkak se ai kishte pranuar paratë për të paguar borxhin dhe jo si ryshfet, dhe se, rastisi që X të jetë mik i policit hetues*".

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit - në seancën kryesore - nuk ka marrë parasysh se X ka deklaruar se ai ia kishte dhënë të hollat për të paguar borxhin dhe jo si ryshfet, se X ka kërkuar publikisht falje nga parashtruesi i kërkesës, dhe se, X nuk ka parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit (*kërkesë pasurore-juridike*) nga parashtruesi i kërkesës.

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, sepse as ai dhe as avokati i tij nuk janë njoftuar kur prokurori e ka marrë në pyetje X, se gjykatat e rregullta nuk i kanë vlerësuar deklaratat e tij, por vetëm ato të Prokurorisë dhe Policisë së Kosovës, dhe për më tepër, gjykatat e rregullta nuk e kanë vërtetuar si duhet faktin se ai nuk ishte një person zyrtar, por më tepër një elektricist që ofron shërbime për punëdhënësin e tij.

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e tij e burgimit është shumë e lartë dhe jo në proporcion me aktakuzën, sepse në raste të ngjashme gjykatat e rregullta kanë dhënë dënime më pak të ashpra.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme, (ii) të konstatojë shkelje të neneve 21, 24, 31, 33, 54 të Kushtetutës, nenit 7 të DUDNJ dhe nenit 6 të Konventës dhe (iii) të përcaktojë ndonjë të drejtë apo përgjegjësi për palët në këtë kërkesë të cilat kjo Gjykatë e nderuar i konsideron ligjërisht të bazuara dhe të arsyetuara.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

33. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 2 (b) të Rregullores së punës, i cili saktëson:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *...*
>
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *...*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

34. Sa i përket pretendimit të futjes në grackë nga Policia e Kosovës, Gjykata konsideron se çështje me rëndësi është nëse Policia e Kosovës mund të konsiderohet se iu ka "bashkëngjitur" apo "infiltruar" në veprimtarinë kriminale e jo se ta ketë iniciuar atë. Në rastin konkret, edhe pse Policia e Kosovës kishte ndikuar në rrjedhën e ngjarjeve, sidomos duke i dhënë kartëmonedhat personit privat X, veprimet e saj duhet të trajtohen si të "bashkëngjitura" veprimtarisë kriminale e jo se ta ketë iniciuar atë, pasi iniciativa në këtë rast ishte marrë nga personi privat X. Ky i fundit ishte ankuar në Policinë e Kosovës se parashtruesi i kërkesës do të kërkonte ryshfet për të arritur një rezultat të favorshëm në rastin e tij, dhe vetëm pas kësaj ankese Policia e Kosovës kishte hyrë në veprim. (Shih rasti *Miliniene kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 74355/01, GJEDNJ, Aktgjykim i 24 qershorit 2008).

35. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se nuk ishte njoftuar kur X është marrë në pyetje nga Prokurori, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se kjo çështje është ngritur nga parashtruesi i kërkesës gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt. Kjo çështje është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese - në pajtim me parimin e subsidiaritetit - nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë paraprakisht e ngritur dhe vlerësuar në procedurë të rregullt.

36. Sa i përket pretendimeve në lidhje me vlerësimin e provave gjegjësisht cilave dëshmi duhet t'u jepet më shumë peshë dhe përparësi, sjellja e dëshmitarit X *post factum* dhe ashpërsia e dënimit janë të gjitha çështje të faktit dhe ligjit që bien nën kompetencat e gjykatave të rregullta. Në të vërtetë, në bazë të Kushtetutës sonë, është detyrë dhe prerogativë e gjykatave të rregullta që të vërtetojnë çështjet e faktit dhe të ligjit. Përveç kësaj, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në këtë kërkesë që do të tregonte se prova është marrë në mënyrë të paligjshme ose në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

37. Në fund, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vetëm numëron dhe në përgjithësi përshkruan përmbajtjen e dispozitave kushtetuese pa dëshmuar saktësisht, se si janë shkelur ato dispozita në rastin e tij siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

38. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

39. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

40. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

41. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

42. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Konventë apo DUDNJ, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që Gjykata e Apelit të Kosovës ia kishte mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

43. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 28 janar 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI74/15, Parashtrues Ekrem Jakupi, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 300/2014

KI74/15, Aktvendim për papranueshmëri i 28 janarit 2016, publikuar më 22 mars 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, dinjiteti i njeriut, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për kompensimin e dëmit,*

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin, Rev. nr. 300/2014, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me vendimin e së cilës refuzohet kërkesa për kompensimin e dëmit ndaj parashtruesit.

Parashtruesi pretendoi se me vendimin e gjykatave të rregullta të konfirmuara si të drejta nga Gjykata Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata konsideroi se parashtruesi vetëm i ka përmendur dispozitat kushtetuese pa dëshmuar saktësisht, se si janë shkelur, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Pra, nuk ka fakte ose dëshmi *prima facie* në të cilat i mbështet pretendimet e tij. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI74/15
Parashtrues
Ekrem Jakupi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 300/2014, të 8 dhjetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesaështë dorëzuar nga z. Ekrem Jakupi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë:parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 300/2014, i 8 dhjetorit 2014, në lidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 3945/2012, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 14 shkurtit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 302/07, të 1 marsit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 300/2014, të 8 dhjetorit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 shkurt 2015.

4. Parashtruesi i kërkesëspretendon shkeljene nenit23[Dinjiteti i Njeriut] dhe nenit 31[E DrejtapërGjykim të Drejtë dhetë Paanshëm]të Kushtetutëssë Republikës sëKosovës (në tekstin e mëtejmë:Kushtetuta),në lidhje mekompensiminjomaterialpër shkak tëshkarkimittë paligjshëmnga puna.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës dhe në nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 qershor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht2015,KryetarjaeGjykatës caktoigjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dheKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 17 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të paraqesë prova lidhur me ditën e dorëzimit të vendimit të kontestuar. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës u dërgua në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

9. Më 28 shtator 2015, parashtruesi dorëzoi dëshmi të datës së dorëzimit të aktgjykimit të fundit të kontestuar.

10. Më 28 janar 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 20 tetor 2004, parashtruesi i kërkesës është pushuar nga puna nga punëdhënësi i tij ProCredit Bank në Prishtinë.
12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prishtinë kundër ProCredit Bank në lidhje me largimin e tij nga puna.

13. Më 22 mars 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 2142/09, anuloi si të paligjshëm vendimin e ProCredit Bank, me të cilin i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës parashtruesit të kërkesës. Më 4 maj 2011, parashtruesi u kthye në vendin e tij të punës.

14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër ProCredit Bank, duke pretenduar kompensim për dëmet e pretenduara që ai pësoi si pasojë e shkarkimit të tij të paligjshëm nga puna, për fitimet e humbura dhe dëmin jomaterial të shkaktuar nga vuajtjet psikike dhe ankthit mendor në lidhje me largimin e tij nga puna.

15. Më 1 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C1. nr. 302/07, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke detyruar ProCredit Bank t'i paguajë parashtruesit kompensim për dëmin material të fitimit të humbur, për pagat e tij të papaguara, por refuzoi, si të pabazuar pretendimin e parashtruesit për kompensim për dëmin jomaterial për shkak të vuajtjes psikike dhe ankthit mendor në lidhje me largimin e tij nga puna. Gjykata arsyetoi, ndër të tjera, se: (i) neni 200 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejmë: LMD) nuk parasheh që kompensimi monetar do të jepet për dhembje të përjetuara psikike - ankthin mendor të përjetuar për shkak të pushimit nga puna dhe (ii) kërkesëpadia e parashtruesit në këtë pikë është e paafatshme për shkak se padia për të bërë një kërkesë të tillë është parashkruar.

16. Më 26 mars 2012, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut të atëhershme në Prishtinë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit procedural, vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh mendimet e ekspertëve mjekësorë lidhur me vuajtjet e tij psikike dhe ankthin mendor në lidhje me largimin e tij nga puna.

17. Më 1 janar 2013, hyri në fuqi Ligji për gjykatat, Nr. 03/L-199. Në bazë të nenit 17. 1. 2 të këtij ligji: *"Gjykata e Apelit themelohet si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës. Selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë"*.

18. Më 14 shkurt 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 3945/2012, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit pranoi vlerësimin faktik dhe juridik të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe aprovoi arsyetimin e saj duke konstatuar se neni 200 i LMD-së, nuk parasheh se kompensimi monetar do të jepet për dhimbje të përjetuar psikike - ankth mendor të përjetuar për shkak të pushimit nga puna.

19. Më 11 nëntor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar zbatim të gabuar të ligjit material nga ana e gjykatave të instancës më të ulët. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se gjykatat më të ulëta kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale kur konstatuan se neni 200 i LMD-së nuk parasheh se kompensimi monetar do të jepet për dhimbje të përjetuar psikike - ankth mendor të përjetuar për shkak të pushimit nga puna.

20. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 300/2014, refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizionin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

21. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme thekson:

> *"Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, kjo për faktin se kjo formë e dëmit të kontestit të punës në bazë të dispozitës së nenit 200 të LMD-së, që ka qenë në fuqi në kohën kontestuese, është i panjohur. Me paragrafin e parë të këtij neni shprehimisht përcaktohen dhe janë numëruar një për një personat që kanë të drejtën e shpërblimit të dëmit në të holla ... Me këtë dispozitë parashikohet mundësia e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të cenimit të ndjenjave në rastet kur palë e dëmtuar paraqiten të afërmit e personit i cili, për shkak të këtij dëmtimi, ka ngelur invalid i rëndë. Kjo len të kuptohet se të dëmtuarit kompensimi në emër të dëmit jomaterial mund të gjykohet vetëm atëherë kur lëndimi është manifestuar në një nga mënyrat e përmendura të dëmit... çka në rastin konkret sipas vlerësimit të drejtë të gjykatës së shkallës së dytë nuk qëndron. Duke pasur parasysh faktin se qoftë në bazë të ligjit apo në praktikën gjyqësore e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme në kushtet e përcaktuara ligjore nuk është pranuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre, në rastin e tij, kanë shkelur nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*gjykatat e cekura kanë bërë interpretim të gabuar të dispozitës së nenit 200 al. 1 të LMD-së i cilika qenë ligj i zbatueshëm deri me dt. 20.12. 2012, kur ka hyrë në fuqi LMD-ja e R. Kosovës dhe në këtë mënyrë paditësit i janë shkelur rëndë të drejtat nga neni 31 (2) të Kushtetutës*".

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Gjykata Supreme në Prishtinë, si autoritet publik, me mospërfilljen për nocionin e dëmshpërblimit moral ka cenuar të drejtat individuale të paraqitësit të kërkesës të garantuara me nenin 23 të Kushtetutës"*.

25. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"deklarimi i kësaj Gjykate rreth kësaj çështjeje ndërlidhet drejtpërdrejtë edhe me obligimin dhe inkurajimin e institucioneve shtetërore për të marrë parasysh më tepër çështjen e dëmshpërblimit moral"*.

26. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme, (ii) të mbajë një seancë dëgjimore në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, (iii) të konstatojë se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 23 të Kushtetutës dhe (iv) të përcaktojë ndonjë të drejtë apo përgjegjësi për palët në këtë kërkesë të cilat kjo Gjykatë e nderuar i konsideron ligjërisht të bazuara dhe të arsyetuara.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

29. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

30. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *...*
> *d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta e kthyen parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të punës dhe urdhëruan punëdhënësin e tij që në emër të dëmit material - t'ia kompensojë pagat e papaguara parashtruesit të kërkesës; megjithatë, në përputhje me ligjin e aplikueshëm në atë kohë gjykatat e rregullta refuzuan kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në lidhje me dëmin jomaterial.

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi pretendon se "*gjykatat e cekura kanë bërë interpretim të gabuar të dispozitës së nenit 200 al. I të LMD-së i cilika qenë ligj i zbatueshëm deri me dt.20.12.2012 kur ka hyrë në fuqi LMD-ja e R. Kosovës dhe në këtë mënyrë paditësit i janë shkelur rëndë të drejtat nga neni 31 (2) të Kushtetutës".*

33. Gjykata gjithashtu vëren se (i) gjykatat e rregullta arsyetuan se ligji i aplikueshëm në atë kohë nuk ka përmendur ankthin mendor të përjetuar për shkak të pushimit nga puna si një nga shkaqet që garanton kompensim në të holla, (ii) kërkesa e parashtruesit për dëmin jomaterial ishte e paafatshme për shkak të parashkrimit, dhe (iii) parashtruesi në thelb ankohet se gjykatat e rregullta duhet të kenë aplikuar një dispozitë ligjore në vend të një tjetre.

34. Në dritën e pretendimeve të bëra nga parashtruesi dhe arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta, Gjykata vlerëson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla të mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. Ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet që kanë çuar një gjykatë të rregullt të nxjerrë një vendim në vend të një tjetri. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të kishte vepruar si gjykatë e shkallës së tretë apo të katërt, që do të ishte shpërfillje e kufijve të imponuar në veprimin e saj. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* kërkesa nr. 30544/96, [DHM], Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28).

35. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

36. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se, vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës*Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

37. Gjykata thekson se detyra e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë provat (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

38. Përfundimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi vetëm numëron dhe në përgjithësi, përshkruan përmbajtjen e dispozitave kushtetuese pa dëshmuar saktësisht se si janë shkelur ato dispozita në rastin e tij siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

39. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të tij themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se Gjykata Supreme e Kosovës i ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

40. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

41. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për të mbajtur seancën e shqyrtimit verbal, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*
>
> *2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, Gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".*

42. Gjykata konsideron se dokumentet që gjenden në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast sipas formulimit të paragrafit 2 të nenit 20, të Ligjit.

43. Prandaj, kërkesa e parashtruesit që të mbahet një seancë e shqyrtimit verbal refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) (b) të Rregullores së punës, me shumicë, më 28 janar 2016

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Arta Rama-Hajrizi

KO47/16, Parashtruesit e kërkesës: Aida Dërguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

KO47/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 2016, i publikuar më 4 prill 2016

Fjalët kyç: *deputet, kuvendi, kërkesa për masë të përkohshme, seanca dëgjimore, zgjedhja e presidentit, qartazi e pabazuar*.

Në këtë kërkesë, njëzet e tetë (28) deputetë të Kuvendit të Kosovës kontestuan Vendimin nr. 05-V-233 të Kuvendit "për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës", të 26 shkurtit 2016, të cilët njëkohësisht kërkuan vendosjen e masës së përkohshme dhe seancën dëgjimore në këtë lëndë.
Parashtruesit e kërkesës kontestuan çështjen e numrit të nevojshëm të deputetëve për kuorum për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5 të Kushtetutës.
Gjykata konkludoi se nuk është as parakusht dhe as kërkesë kushtetuese për vlefshmërinë e vendimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës sipas nenit 86, paragrafët 4 dhe 5, që të gjithë njëqind e njëzet (120) deputetë të jenë të pranishëm dhe të votojnë, siç është pretenduar në kërkesën e parashtruesve.
Gjykata, në bazë të nenit 42, paragrafit 1.3 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, konkludoi se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, pasi që parashtruesit e kërkesës nuk i kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre se vendimi i Kuvendit *"për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës"* është në kundërshtim me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5 të Kushtetutës.
Pasi që kërkesa e parashtruesve është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, e papranueshme, Gjykata konkludoi se kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit dhe, rrjedhimisht, duhet të refuzohet.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KO47/16
Parashtrues
Aida Dërguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti
dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Aida Dërguti, z. Bali Muharremaj dhe z. Enver Hoti, që gjithashtu përfaqësojnë edhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Shih Shtojcën).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-233 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) "*për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*" (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i Kuvendit), i nxjerrë në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit më 26 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i vendimit të lartpërmendur të Kuvendit, me të cilin z. Hashim Thaçi u zgjodh President i Republikës së Kosovës.

4. Parashtruesit pretendojnë se është shkelur neni 86 [Zgjedhja e Presidentit], paragrafët 4 dhe 5, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sepse, sipas parashtruesve, *"[...] kjo zgjedhje është përcjellë me shkelje përmbajtjesore dhe të procedurave të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës [...]"*.

5. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme. Gjithashtu, parashtruesit kërkojnë që Gjykata të mbajë një seancë dëgjimore dhe t'i ftojë ata për ta paraqitur rastin e tyre.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 113.5 dhe 116 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 42 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 4 mars 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

8. Më 7 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KO47/16, caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, me Vendimin KSH. KO47/16, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 7 mars 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 7 mars 2016, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Presidentit të zgjedhur, z. Hashim Thaçi, dhe e ftoi që të dorëzonte komente, nëse kishte ndonjë, përkitazi me kërkesën, deri më 14 mars 2016. Gjykata nuk mori asnjë koment.

11. Më 7 mars 2016, Gjykata ia dorëzoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, me kërkesën e qartë që t'ua shpërndajë atë të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe t'i ftojë ata të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën, deri më 14 mars 2016.

12. Më 7 mars 2016, Gjykata i dorëzoi nga një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës të Kosovës, Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit dhe i ftoi ata që të dorëzojnë komentet e tyre përkitazi me kërkesën, nëse kanë ndonjë, deri më 14 mars 2016. Gjykata nuk mori asnjë koment.

13. Më 14 mars 2016, Kryetari i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës komentet e tij përkitazi me kërkesën.

14. Më 21 mars 2016, pasi e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

15. Më 24 shkurt 2016, pas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit të Republikës e Kosovës ftoi deputetët për një seancë të jashtëzakonshme, që do të mbahej më 26 shkurt 2016. Rendi i ditës për këtë seancë të jashtëzakonshme përmbante një pikë: *Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës.*

16. Sipas procesverbalit të dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës, seanca e jashtëzakonshme u zhvillua si në vijim:

17. Më 26 shkurt 2016, Kryetari i Kuvendit e hapi seancën e jashtëzakonshme dhe njoftoi se 2 (dy) kandidatët e propozuar për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës ishin: z. Hashim Thaçi dhe z. Rafet Rama.

18. Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit konfirmoi se e kishte shqyrtuar dokumentacionin lidhur me 2 (dy) kandidatët dhe konstatoi se kandidatët e

propozuar për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës i plotësonin të gjitha kushtet e përcaktuara me dispozita të Kushtetutës dhe të Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës.

19. Pastaj, sipas procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme, seanca e jashtëzakonshme u ndërpre disa herë për shkak se disa deputetë të Kuvendit hidhnin gaz lotsjellës në sallën e Kuvendit.

20. Për pasojë, Kryetari i Kuvendit njoftoi se Kryesia e Kuvendit kishte marrë vendim (Vendimi 05-V-252) për të përjashtuar 6 (gjashtë) deputetë nga pjesëmarrja në seancën e jashtëzakonshme për shkak të sjelljes dhe të veprimeve të tyre, që pengonin vazhdimin e punimeve të seancës së jashtëzakonshme.

21. Më pastaj, Kryesia e Kuvendit mori sërish vendim (Vendimi 05-V-253) për të përjashtuar edhe 5 (pesë) deputetë të tjerë mbi të njëjtën bazë, sepse me sjelljen dhe me veprimet e tyre pengonin vazhdimin e punimeve të seancës jashtëzakonshme.

22. Në vazhdim, para se të fillonte votimi, Kryetari i Kuvendit i ftoi të gjitha grupet parlamentare të nominonin përfaqësuesit e tyre përkatës në Komisionin votues *ad hoc* për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni). Shefat e grupeve parlamentare të PDK, LDK, SLS dhe 6+ nominuan përfaqësuesit e tyre në Komision. Gjithashtu, një deputet që përfaqësonte njërin nga grupet parlamentare të opozitës, Vetëvendosjen, u nominua për të shërbyer si anëtar në Komision, me pretendimin e përfaqësimit edhe të dy grupeve tjera parlamentare të opozitës, AAK dhe NISMA.

23. Pastaj, Kryetari i Kuvendit njoftoi se deputetët që përfaqësonin grupet parlamentare të opozitës u vetëlarguan nga seanca e jashtëzakonshme. Sipas procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme, përfaqësuesi i grupit parlamentar të Vetëvendosjes mori pjesë në punimet e Komisionit gjatë raundit të parë dhe gjatë raundit të tretë të votimit.

24. Kryetari i Kuvendit e hapi raundin e parë të votimit dhe thirri me radhë emër për emër deputetët që të hidhnin votën e tyre në kutinë e votimit. Procedura u menaxhua dhe u mbikëqyr nga Komisioni.

25. Në raundin e parë të votimit, 81 (tetëdhjetë e një) deputetë morën pjesë në votim. 50 (pesëdhjetë) deputetë votuan për z. Hashim Thaçi, ndërsa 4 (katër) deputetë votuan për z. Rafet Rama. 27 (njëzet e shtatë) vota ishin të pavlefshme. Pas kësaj, Komisioni shpalli se do të mbahej raundi i dytë i votimit.

26. Kuvendi pastaj zhvilloi raundin e dytë të votimit, ku 81 (tetëdhjetë e një) deputetë morën pjesë në votim. 64 (gjashtëdhjetë e katër) deputetë votuan për z. Hashim Thaçi, ndërsa 2 (dy) deputetë votuan për z. Rafet Rama. 15 (pesëmbëdhjetë) vota ishin të pavlefshme. Pastaj, Komisioni shpalli se do të mbahej raundi i tretë i votimit.

27. Pas mbajtjes së raundit të tretë të votimit, Komisioni shpalli se 81 (tetëdhjetë e një) deputetë morën pjesë në votim. 71 (shtatëdhjetë e një) votuan për z. Hashim Thaçi. Asnjë nga deputetët nuk votoi për z. Rafet Rama. 10 (dhjetë) vota ishin të pavlefshme.

28. Sipas Raportit përfundimtar të Komisionit, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e tij, 81 (tetëdhjetë e një) deputetë votuan në raundin e tretë të votimit. Komisioni, në raportin e tij, deklaroi se z. Hashim Thaçi u zgjodh President i Republikës së Kosovës.

29. Në bazë të këtij raporti, Kryetari i Kuvendit shpalli se z. Hashim Thaçi u zgjodh President i Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

30. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"[...] kjo zgjedhje është përcjellë me shkelje përmbajtjesore dhe të procedurave të parapara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [...]"*.Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 86, paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës.

31. Parashtruesit e kërkesës ankohen se gjatë tri raundeve të votimit nuk u përmbushën kërkesat e nenit 86, paragrafi 4, për këto arsye:

> *"Bazuar në rezultatet e votimit të raundit të tretë, i cili përshkohej, si dy raundet e para të votimit, me shkelje të Kushtetutës, respektivisht nenit 86 (4) dhe (5), nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit shpall zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, në lidhje me kuorumin e përcaktuar sipas Nenit 86 (4) për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, në Aktgjykimin KO29/11, të datës 30 mars 2011 (Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011), në paragrafin 85 '[...] Gjykata vëren se lidhur me numrin e votave që kërkohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86 (4) i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat (2/3-at) e* ***'votave të të gjithë deputetëve'*** *(në versionin origjinal) të Kuvendit, që do të thotë se të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, dhe kandidati i cili merr 80 ose më shume vota nga votat e të gjithë deputetëve (në raundin e parë dhe të dytë) do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës, mbahet raundi i tretë. Neni 27 i Ligjit për deputetë dhe neni 27.4 i Rregullores së punës së Kuvendit, përmban formulim identik të fjalëve: 'dy të tretat (2/3) e* ***votave të të gjithë deputetëve*** *të Kuvendit'. Kërkesa eksplicite dhe konstatimi i Gjykatës Kushtetuese se 'kushti i nenit 86, që të gjithë deputetët duhet të votojnë, megjithatë nuk u plotësua' vlen edhe në rastin e seancës së datës 26 mars 2016* [Korrigjim nga Gjykata: 26 shkurt 2016]. *Me fjalë të tjera, pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në seancë nuk është vetëm detyrë e tyre, por është edhe 'kusht' i domosdoshëm për vlefshmërinë e zgjedhjes".*

32. Në bazë të kërkesës, parashtruesit i referohen Aktgjykimit të Gjykatës në Rastin KO29/11, Parashtrues *Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë*, Aktgjykim i 30 marsit 2011 (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi në Rastin KO29/11). Ata konsiderojnë se procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës është kundërkushtetuese dhe e pavlefshme, sepse, sipas parashtruesve, në votim nuk morën pjesë të gjithë 120 (njëqind e njëzet)deputetët.

33. Përveç kësaj, parashtruesit i shtrojnë Gjykatës një numër pyetjesh, në formë të kërkesës, për t'ia dorëzuar Kuvendit për sqarim. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që t'i drejtohet Kuvendit me pyetjet në vijim:

> *(a) A ishin të pranishëm në seancën e datës 26 shkurt 2016* ***të gjithë deputetët*** *e Kuvendit?; Nëse jo, dhe kjo është evidente sepse mungonin 39 deputetë, ose rreth 1/3 e deputetëve të Kuvendit, deputetët që mungonin në seancën e datës 26 shkurt 2016* ***akishin marrë leje nga Kryetari i Kuvendit*** *për mungesën e tyre?*

(b) Nëse deputetët nuk kishin marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, cilat ishin shkaqet e mungesës së tyre?

(c) Me rastin e mbajtjes së seancës të datës 26 shkurt 2016 a kishte përbërje të plotë Kuvendi i Kosovës, ashtu si parasheh neni Neni 64 (1) [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës "Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur […]"?

(d) Nëse Kuvendi nuk ishte në përbërje të plotë, cilët deputetë mungonin pa lejen e Kryetarit të Kuvendit?

(e) Si mund të arsyetohet fakti i mungesës së deputetit dhe njëherit Kryetarit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, z. Glauk Konjufca, i cili gjendet në burg pa heqje të imunitetit të deputetit nga Kuvendi i Kosovës, ashtu si parasheh Kushtetuta në nenin 75 (1) dhe (2), Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111 në nenin 9 (2) dhe (9), për vepra tanimë të amnistuara me Ligjin për Amnistinë Nr. 04/L209?

(f) Si arsyetohet mospërbërja e plotë e Kuvendit, respektivisht mosplotësimi i menjëhershëm i vendit të deputetit sipas kërkesës së nenit 70 (4) [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës, pas dorëheqjes së deputetit z. Ramush Haradinaj?

(g) Si shpjegohet përjashtimi i deputetëve të partive opozitare nga seanca në mënyrë kolektive, siç ka bërë Kryetari i Kuvendit në seancën e datës 26 shkurt 2016, pa ndonjë arsyetim të bazuar ligjor dhe kushtetues?

(h) Si e shpjegon Kuvendi mungesën e paarsyetuar, respektivisht pa lejen e Kryetarit të Kuvendit, të deputetëve të partive të koalicionit qeverisës: Adem Salihaj, Anton Quni, Gëzim Kelmendi, Hatim Baxhaku, Shpejtim Bulliqi, Vjosa Osmani?

(i) Meqenëse "Zgjedhja e Presidentit të Kosovës, i cili sipas nenit 83 [Statusi i Presidentit] është Kreu i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e njerëzve të Republikës së Kosovës, është e një rëndësie kaq të madhe […]", sipas Aktgjykimit KO29/11, të datës 30 mars 2011, paragrafi 84, cilat ishin shkaqet e mungesës së deputetëve të partive të koalicionit qeveritar?

34. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se "*të gjitha pyetjet e ngritura meritojnë një vëmendje të posaçme të Gjykatës, sepse në rastin e zgjedhjes së Presidentit kemi të bëjmë jo vetëm me Kreun e Shtetit, por, ajo që është edhe më me rëndësi, kemi të bëjmë me funksionin që përfaqëson unitetin e njerëzve të Republikës së Kosovës*".

Kërkesat e parashtruesve

35. Në kërkesën e tyre, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që ta shpallë si kundërkushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

36. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, duke pezulluar vendimin e Kuvendit deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata. Parashtruesit e arsyetojnë kërkesën e tyre duke theksuar se *"këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme për të ardhmen e vendit*".

37. Gjithashtu, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore dhe t'i ftojë ata për të paraqitur rastin e tyre.

Komentet e dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit

38. Në parashtresën e tij drejtuar Gjykatës, Kryetari i Kuvendit e informoi Gjykatën lidhur me procedurën e ndjekur për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 26 shkurt 2016.

39. Gjithashtu, Kryetari i Kuvendit thekson se procedura për zgjedhjen e Presidentit dëshmohet nga raportet e Komisionit votues për zgjedhjen e Presidentit, si dhe nga procesverbalet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit. Sipas parashtresës së Kryetarit të Kuvendit:

[...]

"8. Sipas procedurës së zbatuar për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të pasqyruar sipas të dhënave të lartshënuara, parashtruesi i kësaj përgjigje vlerëson se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka zbatuar procedurën e zgjedhjes së Presidentit në përputhje me nenin 86 të Kushtetutës, për arsye si në vijim: Në procedurën për zgjedhjen e Presidentit janë nominuar dhe kanë marrë pjesë të paktën dy kandidatë; Nominimet e kandidatëve janë verifikuar dhe është konstatuar se ato janë në përputhje me nenin 86 të Kushtetutës; Të tri raundet e votimit në zbatimin e procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës janë zhvilluar në kushte të barabarta, sepse në të tri raundet e votimit, në votim kanë marrë pjesë 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit; Gjatë zhvillimit të tri raundeve të votimit nuk është paralajmëruar dhe nuk është zhvilluar pauzë e deputetëve; Të tri votimet, gjatë zhvillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës janë zhvilluar si një procedurë e vetme unike; Gjatë zhvillimit të tri raundeve të votimit, të pranishëm në sallë kanë qenë 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Gjatë zhvillimit të tri raundeve të votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës kanë votuar 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Parashtruesi i kësaj përgjigje rithekson se të gjitha veprimet e tjera juridike dhe politike të ndërmarra nga Kuvendi dhe deputetet si individë, gjatë zhvillimit të seancës së jashtëzakonshme, të datës 26 shkurt 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës se Kosovës, nuk përbëjnë çështje kushtetuese që lidhen me procedurën kushtetuese të zgjedhjes se Presidentit, sipas nenit 85 dhe 86 të Kushtetutës, si dhe për më tepër këto veprime nuk e ndikojnë aspektin kushtetues të zhvillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës".

[...]

40. Rrjedhimisht, në komentet e tij dorëzuar Gjykatës, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës thekson se dispozitat e nenit 86 të Kushtetutës u respektuan gjatë seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Fushëveprimi i kërkesës

41. Gjykata rikujton se parashtruesit kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 05-V-233 të miratuar nga Kuvendi "*për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*" si

për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur, në bazë të nenit 113, paragrafi 5, të Kushtetutës.

42. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ky vendim shkel nenin 86, paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës. Në veçanti, ata pohojnë se mungonte kuorumi i nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit, siç kërkohet me nenin 86, paragrafi 4 dhe 5, të Kushtetutës.

43. Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument në lidhje me përmbajtjen e vendimit të kontestuar.

44. Gjithashtu, sa i përket asaj se parashtruesit po ashtu kanë kërkuar që Gjykata t'i drejtojë një sërë pyetjesh Kuvendit, Gjykata gjen se kjo kërkesë nuk hyn në fushëveprimin e kërkesave të dorëzuara sipas nenit 113.5 të Kushtetutës. Neni 113.5 parashikon: *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë(n) të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".* [Gjykata vëren se në versionin serbisht të këtij neni thuhet: *"[...]kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji të miratuar nga Kuvendi [...]*Gjykata po ashtu bën me dije se, në bazë të Kushtetutës, nuk ka juridiksion që të shërbejë si ndërmjetës për t'i adresuar Kuvendit pyetjet e parashtruesve të kërkesës.

45. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se, në bazë të juridiksionit të Gjykatës të përcaktuar në nenin 113.5 të Kushtetutës, fushëveprimi i kësaj kërkese është i kufizuar në çështjen e pajtueshmërisë me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës, për sa i përket procedurave të ndjekura në Kuvend me rastin e votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës më 26 shkurt 2016.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Në mënyrë që Gjykata të mund të gjykojë për kërkesën e parashtruesve, është e nevojshme që së pari të ekzaminojë nëse janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

47. Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesit mund të konsiderohen palë e autorizuar. Lidhur më këtë, neni 113.5 i Kushtetutës parashikon:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".*

48. Në kërkesën e tanishme, 28 (njëzet e tetë) deputetë kontestojnë Vendimin nr. 05-V-233 të Kuvendit për "zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës", të 26 shkurtit 2016. Prandaj, parashtruesit janë palë e autorizuar dhe kanë të drejtë ta referojnë këtë çështje në Gjykatë, në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës.

49. Sa i përket kushtit të mëtejmë të nenit 113.5 të Kushtetutës se parashtruesit duhet ta kishin paraqitur kërkesën *"brenda 8 (tetë) ditësh nga data e miratimit*" të ndonjë vendimi nga Kuvendi, Gjykata vëren se Kuvendi e miratoi vendimin e tij më 26 shkurt 2016, kurse parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë më 4 mars 2016. Prandaj, parashtruesit kanë respektuar afatin kohor për të paraqitur parashtresë në Gjykatë, siç përcaktohet në nenin 113.5 të Kushtetutës.

50. Gjykata duhet po ashtu të vlerësojë nëse parashtruesit kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 42 të Ligjit dhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës.

51. Neni 42 i Ligjit specifikon kriteret për saktësinë e kërkesës, në rastet kur kërkesat ngrihen në bazë të nenit 113.5, të Kushtetutës. Neni 42 i Ligjit parashikon:

> *"Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme, inter alia:*
> *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
> *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> *1.3. paraqitja e provave mbi të cilat mbështetet kontesti".*

52. Përveç kësaj, Gjykata duhet të vlerësojë gjithashtu nëse parashtruesit kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre, siç kërkohet me rregullin 36 të Rregullores së punës.

53. Lidhur më këtë, rregulli 36 i Rregullores së punës përmban këtë kërkesë:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
>
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

54. Në vazhdim, në pajtim me fushëveprimin e kërkesës, siç është përcaktuar nga Gjykata në këtë Aktvendim, Gjykata do të vlerësojë vetëm nëse kërkesa e parashtruesve sa i përket pyetjes nëse gjatë procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës është shkelur neni 86, paragrafët 4 dhe 5, është në përputhje me nenin 42 të Ligjit dhe me rregullin 36 të Rregullores së punës.

55. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit], paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës që parashikojnë:

> *"[...]*
>
> *4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
>
> *5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.*
>
> *[...]"*

56. Sa i përket të procedurës së ndjekur për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, u zhvilluan 3 (tri) raunde të votimit. Që të 3 (tri) raundet e votimit u zhvilluan me votim të fshehtë. Nga këto 3 (tri) raunde të votimit, mund të nxirren konkludimet vijuese:

57. Në raundin e parë të votimit, votuan 81 (tetëdhjetë e një) deputetë. 50 (pesëdhjetë) deputetë votuan për z. Hashim Thaçi, ndërsa 4 (katër) deputetë votuan për z. Rafet Rama. 27 (njëzet e shtatë) vota ishin të pavlefshme.

58. Në raundin e dytë të votimit, votuan 81 (tetëdhjetë e një) deputetë. 64 (gjashtëdhjetë e katër) deputetë votuan për z. Hashim Thaçi, ndërsa 2 (dy) deputetë votuan për z. Rafet Rama. 15 (pesëmbëdhjetë) vota ishin të pavlefshme.

59. Në raundin e tretë të votimit, votuan 81 (tetëdhjetë e një) deputetë. 71 (shtatëdhjetë e një) deputetë votuan për z. Hashim Thaçi. Asnjë nga deputetët e pranishëm nuk votoi për z. Rafet Rama. 10 (dhjetë) vota ishin të pavlefshme.

60. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se është e qartë që, në të tri raundet e votimit, në votim morën pjesë 81 (tetëdhjetë e një) deputetë.

61. Gjykata vëren se ankesa e parashtruesve në mënyrë specifike ka të bëjë me çështjen e kuorumit të nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, siç parashikohet me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës.

62. Gjykata vëren se kuorumi i referohet numrit minimal të deputetëve që duhet të jenë të pranishëm për marrjen e një vendimi në mënyrë të vlefshme. Neni 69, paragrafi 3, i Kushtetutës parashikon që Kuvendi i Kosovës ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma (1/2) e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kjo dispozitë vlen përveç nëse Kushtetuta në mënyrë specifike kërkon një shumicë më të madhe për marrjen e një vendimi. Aty ku Kushtetuta në mënyrë specifike përcakton që nevojitet një numër më i madh i deputetëve për marrjen e një vendimi, atëherë shumica e kërkuar e përcakton kuorumin e nevojshëm.

63. Gjykata thekson që për të qenë e vlefshme procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, në raundin e parë dhe të dytë të votimit, të paktën 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë, ndërsa në raundin e tretë, të paktën shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë, në pajtim me paragrafët 4 dhe 5, të nenit 86, të Kushtetutës.

64. Në mënyrë që raundi i parë i votimit të jetë i vlefshëm, të paktën 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Nëse ky kusht nuk plotësohet, raundi i parë do të jetë i pavlefshëm. Rrjedhimisht, nuk mund të mbahet raundi i dytë. Në mënyrë që raundi i dytë i votimit të jetë i vlefshëm, numri i njëjtë, pra të paktën 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Nëse ky kusht nuk plotësohet, raundi i dytë i votimit do të jetë i pavlefshëm. Vetëm atëherë kur raundi i parë dhe raundi i dytë i votimit janë të vlefshëm, mbahet raundi i tretë. Për të qenë i vlefshëm, raundi i tretë kërkon të paktën praninë dhe votimin e shumicës të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

65. Ashtu siç e përcakton Kushtetuta në paragrafët 4 dhe 5 të nenit 86, kandidati që merr të paktën votat e 2/3 (dy të tretave) të të gjithë deputetëve të Kuvendit në raundin e parë ose në raundin e dytë, ose të paktën votat e shumicës të të gjithë deputetëve të Kuvendit në raundin e tretë, do të zgjedhet President i Republikës së Kosovës.

66. Kësisoj, në rastin e tanishëm, është e qartë që të paktën 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve ishin të pranishëm dhe votuan në raundin e parë dhe në raundin e dytë të votimit, ndërkaq që, gjithashtu, shumica e nevojshme e të gjithë deputetëve të Kuvendit ishte e pranishme dhe votoi në raundin e tretë të votimit.

67. Në kërkesën e tanishme, parashtruesit ngrenë shqetësime specifike për faktin se, të gjithë 120 (njëqind e njëzet) deputetët nuk ishin të pranishëm ose nuk kishin leje për mungesën e tyre gjatë seancës së jashtëzakonshme. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës, në mënyrë specifike citojnë paragrafin 85 të Aktgjykimit në Rastin KO29/11. Në paragrafin 85 të Aktgjykimit të lartcekur në Rastin KO29/11 thuhet:

> *"Lidhur me këtë, Gjykata vëren se lidhur me numrin e votave që kërkohen për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86.4 i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat (2/3-at) e '**votave të të gjithë deputetëve**" (në versionin origjinal) të Kuvendit, që do të thotë se të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, dhe kandidati i cili merr 80 ose më shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve (në raundin e parë dhe të dytë) do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës, mbahet raundi i tretë. Neni 27 i Ligjit për deputetë dhe neni 27.4 i Rregullores së punës së Kuvendit, përmban formulim identik të fjalëve: 'dy të tretat (2/3) e **votave të të gjithë deputetëve** të Kuvendit'".*

68. Në mendimin e tyre, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se paragrafi 85 i Aktgjykimit në Rastin KO29/11 lë të kuptohet që, nëse që të gjithë 120 (njëqind e njëzet) deputetët nuk janë të pranishëm ose nuk janë formalisht të lejuar nga Kryetari i Kuvendit të mungojnë në seancë, atëherë Presidenti i Republikës së Kosovës nuk mund të konsiderohet i zgjedhur nga 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, siç kërkohet me nenin 86, paragrafi 4.

69. Gjykata rikujton se në Aktgjykimin në Rastin KO29/11, ndër të tjera, kishte gjetur se në raundin e parë dhe në raundin e dytë të votimit nuk kishte numër të mjaftueshëm të deputetëve të pranishëm për të formuar të paktën shumicën prej 2/3 (dy të tretave) të nevojshme, siç kërkohet me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5, të Kushtetutës. Rrjedhimisht, raundi i parë dhe raundi i dytë i votimit ishin të pavlefshëm dhe raundi i dytë, respektivisht raundi i tretë, nuk kanë mundur të mbahen. Ndërsa, në rastin e tanishëm, numri i deputetëve të pranishëm dhe që votuan në tri raundet e votimit ishte i mjaftueshëm për të arritur shumicën e nevojshme për zgjedhjen e Presidentit, siç parashikohet në nenin 86, paragrafët 4 dhe 5.

70. Për më tepër, Gjykata vëren se interpretimi i paragrafit 85 të Aktgjykimit në Rastin KO29/11, siç mëtohet në kërkesën e parashtruesve, nuk korrespondon me vlerësimin e Gjykatës në atë aktgjykim. Paragrafi 85 i Aktgjykimit në Rastin KO29/11 duhet kuptuar në kontekstin e fushëveprimit të përgjithshëm të atij aktgjykimi dhe në veçanti, në pjesën përkitazi me "Votimin në Kuvend", konkretisht, paragrafët 80 deri në 84 të aktgjykimit të njëjtë. Në këta paragrafë thuhet:

> *80. Për më tepër, Ligji Nr. 03/L-111 mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për deputetët) dhe neni 3 dhe 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, miratuar më 29 prill 2010, theksojnë edhe më shumë se deputetët e Kuvendit janë përfaqësuesit e Popullit dhe do të kenë të drejta të barabarta dhe obligim që të marrin pjesë plotësisht në proceduarat e Kuvendit dhe do t'i ndjekin detyrat si përfaqësues të njerëzve të Kosovës në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Kjo do të thotë, duke*

marrë votën e qytetarëve, deputetët kanë obligime ndaj atyre, inter alia, siç përcaktohet në nenin 40 [Obligimet] të Ligjit për deputetë, duke qenë të obliguar të marrin pjesë në seancat plenare ose në takimet e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilat, ata janë anëtarë. Nëse deputeti nuk mundet të marrë pjesë në seancat e Kuvendit ose në takimet e organeve ndihmëse të Kuvendit, atëherë, ai/ajo duhet të informojë Kryetarin e Kuvendit, respektivisht, Kryetarin ose Zëvendëskryetarin e atij organi, duke paraqitur arsyet për mungesën e tij/saj, siç kërkohet nga neni 40.3 i Ligjit për deputetë.

81. Obligimi i deputetëve reflektohet edhe më shumë në betimin që anëtarët e Kuvendit duhet të bëjnë pas verifikimit të mandateve të tyre, sipas nenit 10 të Rregullores së punës së Kuvendit, që përmban:

"Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!"

82. Për më tepër, Gjykata thekson se sipas nenit 27 të Rregullores së punës së Kuvendit, anëtarët e Kuvendit do të pajtohen me Kodin e sjelljes, i cili është i bashkangjitur me Rregulloren. Kodi i sjelljes siguron qartësisht se anëtarët e Kuvendit kanë detyrë që të respektojnë ligjin dhe të veprojnë në çdo rast në pajtim me besimin që publiku iu ka dhënë atyre.

83. Në këto rrethana, të gjithë 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndjehen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për deputetët, Rregullores së punës së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes të marrin pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe të përkrahin procedurat që parashihen aty, por mbi të gjitha, një obligim vis-a-vis për njerëzit e Kosovës që i zgjodhën ata.

84. Zgjedhja e Presidentit të Kosovës, i cili sipas nenit 83 [Statusi i Presidentit] është Kreu i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e njerëzve të Republikës së Kosovës, është e një rëndësie kaq të madhe, saqë të gjithë deputetët, si përfaqësues të popullit të Kosovës, duhet ta konsiderojnë si detyrë kushtetuese të tyren, përveç nëse ju lejohet nga Presidenti i Kuvendit, të marrin pjesë në procedurën për zgjedhjen e Presidentit siç përcaktohet në nenin 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.

71. Duke adresuar pretendimet e parashtruesve, Gjykata së pari rikujton dhe thekson paragrafin 1 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës që "*Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues*" si dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës që "*Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit*".

72. Në vazhdim, Gjykata vëren se formulimi që "*të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë*", i përmendur në paragrafin 85 të Aktgjykimit në Rastin KO29/11, duhet kuptuar në lidhje me domethënien e paragrafëve 83 dhe 84 të atij aktgjykimi. Detyrimet e deputetëve për të marrë pjesë në seancat plenare të Kuvendit janë të rregulluara dhe burojnë nga Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Deputetët), Rregullorja e punës së Kuvendit dhe nga Kodi i sjelljes për deputetë. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara me Ligjin për Deputetët, nuk e

zhvlerëson një vendim të Kuvendit për aq sa shumica e nevojshme për marrjen e një vendimi, siç është specifikuar në Kushtetutë, mbahet në Kuvend.

73. Më tej, Gjykata vëren se formulimi "*minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit*", i përmendur në paragrafin 85 të Aktgjykimit në Rastin KO29/11, duhet kuptuar në lidhje me domethënien e paragrafëve 80 deri në 82 të atij aktgjykimi. Siç përmendet në paragrafin 80 të Aktgjykimit në Rastin KO29/11, detyrimi ligjor i deputetëve për ta informuar Kryetarin e Kuvendit, respektivisht kryetarin, zëvendëskryetarin e një organi ndihmës, duke paraqitur arsyet e mungesës së tij/saj, përcaktohet dhe buron nga Ligji për Deputetët, konkretisht neni 40.3 i tij. Sërish, mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara me Ligjin për Deputetët, nuk e zhvlerëson një vendim të Kuvendit për aq sa shumica e nevojshme për marrjen e një vendimi, siç është specifikuar në Kushtetutë, mbahet në Kuvend.

74. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se nuk është as parakusht dhe as kërkesë kushtetuese për vlefshmërinë e vendimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës sipas nenit 86, paragrafët 4 dhe 5, që të gjithë 120 (njëqind e njëzet) deputetët të jenë të pranishëm dhe të votojnë, siç është pretenduar në kërkesën e parashtruesve.

75. Nga sa u tha më lart, pretendimi i parashtruesve përkitazi me shkeljen e nenit 86, paragrafëve 4 dhe 5, nuk qëndron.

76. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 42, paragrafit 1.3, të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, pasi që parashtruesit e kërkesës nuk i kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre se vendimi i Kuvendit "për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës" është në kundërshtim me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5 të Kushtetutës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

77. Sa i përket kërkesës për Masë të përkohshme, Gjykata vëren se parashtruesit kërkojnë që Gjykata të pezullojë vendimin e Kuvendit deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata.

78. Parashtruesit e arsyetojnë kërkesën e tyre duke theksuar:

> *"Këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme për të ardhmen e vendit".*

79. Neni 27 i Ligjit dhe, më konkretisht, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës përcaktojnë që "*në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e Masës së përkohshme*".

80. Gjykata më tej i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës që parasheh:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmerinë e kërkesës;*
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*

(c) Masa e përkohshme është me interes publik.
Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

81. Megjithatë, pasi që kërkesa e parashtruesve është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, e papranueshme, Gjykata konkludon se kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit dhe, rrjedhimisht, duhet të refuzohet.

Kërkesa për seancë dëgjimore

82. Gjykata rikujton se parashtruesit kërkojnë që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore dhe t'i ftojë ata për të paraqitur rastin e tyre.

83. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se në bazë të rregullit 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës: *"Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe"*. Gjykata mori parasysh dokumentet që ishin ofruar dhe nuk pati nevojë për informacione shtesë për të marrë vendimin e saj lidhur me këtë rast. Për këtë arsye, Gjykata konsideron se seanca dëgjimore nuk është e nevojshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, të nenit 27 dhe nenit 42, paragrafi 1.3, të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 36 (1) (d), (2) (d) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 21 mars 2016, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. TA REFUZOJË kërkesën për dëgjim publik;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

Shtojca

Vetëvendosje

1. Visar Ymeri
2. Albin Kurti
3. Aida Dërguti
4. Sali Salihu
5. Ilir Deda
6. Shqipe Pantina
7. Albulena Haxhiu
8. Mytaher Haskuka
9. Besnik Bislimi
10. Besa Baftiu
11. Ismajl Kurteshi
12. Rexhep Selimi
13. Puhie Demaku
14. Fisnik Ismaili

AAK

15. Bali Muharremaj
16. Rrustem Berisha
17. Daut Haradinaj
18. Donika Kadaj-Bujupi
19. Teuta Haxhiu
20. Lah Brahimaj
21. Pal Lekaj
22. Time Kadrijaj

NISMA

23. Fatmir Limaj
24. Valdete Bajrami
25. Haxhi Shala
26. Zafir Berisha
27. Shukrije BytyqiEnver Hoti

KI15/16, Parashtrues i kërkesës: Ramadan Muja, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PA-II-KZ-II-7/15, të 26 nëntorit 2015

KI15/16, aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2016, i publikuar më 5 prill 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, e parakohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për barazi para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mosshterim i mjeteve juridike*

Parashtruesi i kërkesës, në esencë, pretendon se Gjykata Supreme me pranimin e ankesës të cilën e ka ushtruar Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës ndaj aktvendimit (PAKR 349/14 të 22 qershorit 2015) të Gjykatës së Apelit, gabimisht ka aplikuar dispozitat nga Kapitulli XXI i KPPK-së dhe me këtë ka shkelur nenet 24, 31 dhe 54 te Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon vënien e masës së përkohshme *"me të cilën i urdhërohet Gjykatës së Apelit të Kosovës mos të ndërmerr kurrfarë veprimi procedural për vendosje, siç ishte caktuar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës".*
Më 10 mars 2016, Gjykata Supreme e Kosovës e njoftoi Gjykatën se në Gjykatën Supreme është në pritje një procedurë në lidhje me çështjen e njëjtë ligjore sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë (Pkl. nr. 14/2016).
Gjykata përfundoi se të gjitha këto çështje duhet së pari të shqyrtohen në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Kosovës në procedurën për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata gjithashtu refuzoi si të pabazuar kërkesën për masë të përkohshme, , sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Kërkesa u shpall e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI15/16
Parashtrues
Ramadan Muja
Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PA-II-KZ-II-7/15, të 26 nëntorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ramadan Muja nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson z. Ruzhdi Berisha, avokat në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PA-II-KZ-II-7/15, të 26 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës. Parashtruesi i kërkesës konsideron se me këtë aktvendim janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi njëkohësishtkërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të vendosë Masë të përkohshme "*me të cilën i urdhërohet Gjykatës së Apelit të Kosovës mos të ndërmerr kurrfarë veprimi procedural për vendosje, siç i është caktuar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës…*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 13 janar 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën përmes shërbimit të rregullt postar, të cilën Gjykata e pranoi më 22 janar 2016.

7. Më 12 shkurt 2016, më Vendimin GJR. KI15/16, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI15/16, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 25 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 3 mars 2016, Gjykatakërkoi nga parashtruesi që të dorëzojë informata shtesë në lidhje me ndonjë procedurë gjyqësore në pritje në gjykatat e rregullta për të njëjtën çështje ligjore ose nëse ka parashtruar ndonjë mjet juridik për të njëjtën çështje ligjore e cila është e njëjtë me objektin e çështjes së kësaj kërkese.

10. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që ta informojë në lidhje me ndonjë procedurë gjyqësore në pritje në Gjykatën Supreme përkitazi me çështjen e njëjtë ligjore.

11. Më 10 mars 2016, Gjykata Supreme e dorëzoi përgjigjen sipas kërkesës së Gjykatës, duke konfirmuar një procedurë ligjore, është në pritje para Gjykatës Supreme në lidhje me çështjen e njëjtë ligjore, përkatësisht kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

12. Në të njëjtën datë, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit dorëzoi përgjigje në kërkesën e Gjykatës, duke theksuar se ai përfaqëson parashtruesin e kërkesës në çështje penale dhe se ka të akuzuar të tjerë në këtë rast.

13. Përfaqësuesi ligjor në përgjigjen e tij thekson se, në bazë të nenit 408, paragrafi 4, të KPP-së nuk ekziston mundësi ankese kundër vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme (PA-II-KZ-7/15). Për më tepër, ai e informon Gjykatën se ai, si avokat mbrojtës i parashtruesit, nuk ka ushtruar "kurrfarë mjeti tjetër juridik në këtë çështje juridike penale". Njëkohësisht, ai, si avokat mbrojtës i parashtruesit të kërkesës, *nuk është në dijeni nëse ndonjë nga avokatët e të akuzuarve e ka bërë këtë.*

14. Më 16 mars 2016, Kolegji shqyrtues mbajti këshillime për rastin dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës të deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhje e fakteve

15. Më 27 shkurt 2013, prokurori publik ngriti aktakuzë kundër Ramadan Mujës dhe të tjerëve për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo të autoritetit zyrtar sipas nenit 422 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

16. Më 25 mars 2013, u mbajt shqyrtimi fillestar në praninë e të pandehurve, avokatëve mbrojtës dhe prokurorit.

17. Më 13 gusht 2013, filluan shqyrtimet gjyqësore dhe në kuadër të gjykimit kryesor janë mbajtur 28 (njëzet e tetë) seanca.

18. Më 13 mars 2014, Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykim (P. nr. 171/13; PP. nr. 147/2011) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e "*veprës penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në vazhdimësi (pikat 1 deri 4) dhe pjesërisht në bashkëkryerje (pikat 2 deri 4), në përputhje me nenin 422, paragrafin 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tuje "KPRK").*"

19. Më 27 maj 2014, avokatët e parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarve të tjerë parashtruan ankesë kundër aktgjykimit (P. nr. 171/13; PP. nr. 147/2011) të Gjykatës Themelore në Prizren.

20. Më 22 korrik 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori aktvendim (PAKR 349/14), me shumicën e votave, me të cilin aprovoi ankesën e parashtruar nga avokatët mbrojtës, e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren (P. nr. 171/13, PP. nr. 147/2011 të 13 marsit 2014) dhe urdhëroi që:

> *"Lënda kthehet në Gjykatën Themelore të Prizrenit për rigjykim".*

21. Më 4 shtator 2015, Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit (PAKR 349/14, të 22 qershorit 2015) të Gjykatës së Apelit.

22. Në një datë të pacaktuar, avokatët e parashtruesit të kërkesës dhe të të akuzuarve të tjerë parashtruan përgjigje ndaj ankesës së Prokurorit të Shtetit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke cekur se "*ankesa është e paligjshme dhe njëkohësisht e papranueshme*", që neni 407 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) saktë i përshkruan rastet se kur mund të paraqitet ankesa kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, duke i propozuar gjykatës që të refuzojë ankesën e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës si të palejueshme.

23. Më 26 nëntor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendim (PA-II-KZ-II. 7/15) pranoi ankesën e parashtruar nga Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës kundër aktvendimit (PAKR 349/14, të 22 qershorit 2015) të Gjykatës së Apelit dhe urdhëroi si në vijim:

> *"Aktvendimi* (PAKR 349/14, i 22 qershorit 2015*) i Gjykatës së Apelit ... anulohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së Apelit përrishqyrtim nga një trup i ri gjykues".*

24. Më 10 mars 2016, Gjykata Supreme e Kosovës e informoi Gjykatën se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë (Pkl. nr. 14/2016) ishte në procedurë pranë Gjykatës Supreme në të njëjtën çështje ligjore.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi i kërkesës, në esencë, pretendon se Gjykata Supreme me pranimin e ankesës të cilën e ka ushtruar Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës ndaj aktvendimit (PAKR 349/14 të 22 qershorit 2015) të Gjykatës së Apelit, gabimisht ka

aplikuar dispozitat nga Kapitulli XXI i KPPK-së dhe me këtë ka shkelur nenet 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin (PA-II-KZ-II 7/15, e 26 nëntorit 2015) e Gjykatës Supreme të Kosovës i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Parashtruesi i kërkesës arsyeton gjerësisht pretendimet e tij në tri faqe të kërkesës të parashtruar para Gjykatës, duke u munduar që këto pretendime t'i mbështesë me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ).

27. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: *"Me asnjë dispozitë të KPP-s nuk parashihet procedura e vendosjes nga ana e Gjykatës Supreme përkitazi me ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së apelit me të cilin anulohet aktgjykimi i shkalles së parë. Kodi nuk e parasheh këtë veprim procedural, andaj edhe një ankese e këtillë nuk është e lejuar."*

28. Nga të lart cekurat, parashtruesi i kërkesës thekson se *"rrjedh konstatimi i vetëm se ankesa e Prokurorit të Shtetit/ Prokurorit të EULEX-t [...] është dashur të hidhet menjëherë nga Gjykata e Apelit në bazë të nenit 411 par. 2 të KPPK-së e pasi që kjo nuk është bë nga Gjykata e Apelit, këtë është dashur ta bënë Gjykata Supreme e R. të Kosovës në bazë të par. 9 të të njëjtit nen të KPPK-së."*

29. Parashtruesi i drejtohetGjykatës me kërkesën si në vijim:

> *"TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme,*
>
> *TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje nga neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,*
>
> *TË ANULOJË aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës PA-II-KZ-II-7/2015 dt. 26 nëntor 2015 dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së Apelit për vendosje lidhur me lejueshmërinë e ankesës së Prokurorit të Shtetit të paraqitur kundër aktvendimit të asaj gjykate PAKR 349/14 dt. 22 korrik 2015."*

30. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës kërkon vënien e Masës së përkohshme *"me të cilën i urdhërohet Gjykatës së Apelit të Kosovës mos të ndërmerr kurrfarë veprimi procedural për vendosje, siç i është caktuar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

33. Gjykata thekson edhe nenin 47.2 të Ligjit, i cili përcakton:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.".

34. Për më tepër, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës, parasheh:

"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

35. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin (PA-II-KZ-II. 7/15, e 26 nëntorit 2015) e Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin u urdhërua që "*lënda t'i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim nga një trup të ri gjykues*".

36. Në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me pranimin e ankesës të cilën Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës e paraqiti kundër aktvendimit (PAKR 349/14, të 22 qershorit 2015) të Gjykatës së Apelit, gabimisht zbatoi dispozitat e KPP-së dhe kështu i shkeli nenet 31, 24 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

37. Të njëjtën kohë, me parashtrimin e kësaj kërkese në Gjykatë, çështja e lejueshmërisë së ankesës, e parashtruar nga Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës kundër aktvendimit (PAKR 349/14, të 22 qershorit 2015), ishte dorëzuar në Gjykatën Supreme përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Kjo kërkesë në Gjykatën Supreme ishte regjistruar me numrin Pkl. nr. 14/2016.

38. Nga sa u tha më lart, rezulton se procedurat në gjykatat e rregullta për çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk kanë përfunduar.

39. Gjykata konkludon se të gjitha këto çështje së pari duhet të shqyrtohen nga gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme në procedurën në pritje sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

40. Në këtë rast, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe detyra e tyre kushtetuese është t'i interpretojnë çështjet faktike dhe të ligjit të cilat janë të rëndësishme për rastet e ngritura para tyre.

41. Arsyetimi për rregullin që së pari duhet përfunduar procedurat në gjykatat e rregullta është që gjykatave të rregullta t'u ofrohet mundësia për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih Aktvendimin për papranueshmëri, *UniversitetiAAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, GJEDNJ, Aktvendimi i 28 korrikut 1999).

42. Parim është se mekanizmi i mbrojtjes i themeluar me Gjykatë Kushtetuese është subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, *inter alia*, aktgjykimin e GJEDNJ-së *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 7

dhjetorit 1976, Seria A, nr. 24, fq. 22, paragrafi 48, dhe aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Aksoy kundër Turqisë,* të 18 dhjetorit 1996, nr. 21987/93, paragrafi 51).

43. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese para se t'ua japë mundësinë gjykatave të rregullta për t'i përfunduar procedurat të cilat parashtrohen para tyre, në mënyrë që t'u lejohet mundësia për t'i korrigjuar dhe për t'i eliminuar shkeljet e Kushtetutës.

44. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk janë përfunduar procedurat para gjykatave të rregullta për çështjet që janë ngritur para Gjykatës Kushtetuese dhe, rrjedhimisht kërkesa është e parakohshme, dhe si e tillë e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

45. Siç u përmend më lart, parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme *".. me të cilën i urdhërohet Gjykatës së Apelit të Kosovës mos të ndërmerr kurrfarë veprimi procedural për vendosje, siç i është caktuar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës…".*

46. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4 dhe 5) të Rregullores së punës, duhet të përcaktojë si në vijim:

"Rregulli 55
(4) (a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin […] prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

[…]
Rregulli 55
(5) Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

47. Siç u përmend më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, për shkak se objekti i çështjes së kërkesës është ende në pritje para gjykatave të rregullta. Për këtë arsye, parashtruesi nuk ka dëshmuar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës, më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI116/15, Parashtruesja e kërkesës: Arbenita Ahmeti, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 151/2015, të 19 majit 2015

KI116/15, aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2016, të publikuar më 6 prill 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, alimentacioni, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Më 19 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 151/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin (Ac. nr. 1980/2014) e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është zgjidhur kontesti pronësor juridik në lidhje me ndarjen e pasurisë bashkëshortore dhe alimentacionin e fëmijëve që kanë lindur si rezultat i çështjes gjyqësore të ndarjes së mes të parashtruesit të kërkesës në njërën anë dhe bashkëshortit të saj në anën tjetër

Parashtruesja e kërkesës në thelb pretendon se gjendja faktike lidhur me vlerën e pasurisë është përcaktuar në bazë të gjetjeve të një eksperti të angazhuar nga gjykata, dhe se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh ekspertizën në bazë të së cilës parashtruesja e ka parashtruar padinë, me ç'rast janë shkelur nenet 46 dhe 54 të Kushtetutës në procedurë në gjykatat e rregullta, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtrueses së kërkesës, që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar siç duhet dhe se ato janë shqyrtuar si duhet nga gjykatat, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ajo e konteston janë parashtruar hollësisht, dhe se, në pajtim me këtë, procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësi, ishin të drejta. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI116/15
Parashtrues
Arbenita Ahmeti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 151/2015, të 19 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Arbenita Ahmeti nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga avokati Xhevat Bici nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 151/2015), të 19 majit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës. Parashtruesja e kërkesës konsideron se në procedurat në gjykatat e rregullta janë shkelur të drejtat e saj, të garantuara me nenet 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 shtator 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 tetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 21 tetor 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës të dorëzojë autorizimin me të cilin e autorizon avokatin Xhevat Bici që ta përfaqësojë atë dhe e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 29 tetor 2015, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi autorizimin e nënshkruar.

9. Më 10 shkurt 2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportuesKolegji shqyrtuesi rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kërkesëpadi për ndarjen e pasurisë së arritur në martesë.

11. Më 28 shkurt 2014, Gjykata Themelore me Aktgjykimin (C. nr. 339/2012) e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe në dispozitiv vendosi si në vijim:

> *"I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Arbenita Ahmeti nga Prishtina, si e BAZUAR dhe* [fëmija i mitur] *i besohet për ruajtje, përkujdesje dhe edukim nënës-paditëses Arbenita Ahmeti, nga Prishtina, deri në ndryshimin e rrethanave në bazë të të cilave është vendosur me këtë aktgjykim.*
>
> *II. CAKTOHET kontakti i fëmiut të mitur me babain-të paditurin Xh. P., nga fshati Sllovi, dy herë në muaj dhe atë çdo të enjte të dytë dhe të katërt duke filluar nga ora 13,00-15,00, dhe ditën e dytë gjatë festave fetare dhe zyrtare si dhe gjatë ditëlindjes së fëmiut po në të njëjtën kohë. Në rast të pamundësisë të mbajtjeve të kontakteve sipas orarit të lartcekur, i njëjti kontakt mund të realizohet ndryshe nga ajo siç është caktuar më lart në atë mënyrë që ky kontakt të realizohet gjatë kohës sa i padituri gjendet në Kosovë. Kontakti realizohet në Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë, Njësia Kodra e Trimave dhe nën mbikëqyrjen e kësaj qendre.*
>
> *III. APROVOHET kërkesëpadia e precizuar e paditëses Arbenita Ahmeti dhe DETYROHET i padituri Xh. P., nga fshati Sllovi, tani me vendqëndrim në Gjermani, që në emër të alimentacionit* [për fëmijën e mitur] *të paguajë shumën prej 200 €, në muaj duke filluar nga data e gjykimit 28.02.2014 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për një gjë të tillë, dhe atë më së voni deri më datën, 05 të muajit në vijim.*
>
> *IV. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditëses Arbenita Ahmeti, me të cilën ka kërkuar që në emër të ushqimit, i padituri të detyrohet t'ia paguajë shumën prej 100.€, në muaj, si e pabazuar, për shkak të heqjes dorë të paditëses nga kjo pjesë e kërkesëpadisë.*
>
> *V/a APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e precizuar e paditëses dhe DETYROHET i padituri Xh. P. që paditëses Arbenita Ahmeti, në emër të gjësendeve personale të cilat i ka pasur në pronësi të veten me rastin e krijimit të bashkësisë faktike martesore dhe të cilat i kanë shërbyer për përdorim personal e të cilat kanë mbetur tek i padituri me rastin e shkëputjes së kësaj bashkësie faktike martesore, në emër të tyre t'ia kompensojë kundërvlerën në të holla në shumë prej 7858.90.€, me kamatë ligjore duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 09.06.2011 e deri te pagesa definitive si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e*

procedurës kontestimore në shumë prej 1660. € të gjitha këto në afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

V/b REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së precizuar e paditëses me të cilën ka kërkuar që i padituri, Xh. P., në emër të gjësendeve personale për të cilat e njëjta me rastin e krijimit të bashkësisë faktike i ka pasur në pronësi dhe të cilat i kanë shërbyer për përdorim personal ku këto sende kanë mbetur tek familja e të padituri me rastin e shkëputjes së kësaj bashkësie, t'ia kompensojë kundërvlerën e tyre dhe atë mbi shumën e gjykuar në shumë prej 29.093.10.€, si e pabazuar".

12. Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë kundër pikave IV dhe V/b të dispozitivit të Aktgjykimit (C. nr. 339/2012) të Gjykatës Themelore, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet në pjesët e kontestuara dhe kërkesëpadia të aprovohet në tërësi, ose e njëjta të anulohet dhe lënda të kthehet për rigjykim.

13. I padituri Xh. P. parashtroi ankesë kundër pikave I, II, III dhe V/a të dispozitivit të Aktgjykimit (C. nr. 339/2012) të Gjykatës Themelore, me propozim që të anulohet aktgjykimi në ato pjesë dhe lënda të kthehet për rigjykim, apo të ndryshohet në mënyrë që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në dispozitiv nën pikat I, II, III dhe V/a në tërësi dhe dispozitivi i aktgjykimit të vërtetohet në pikat IV dhe V/b.

14. Më 3 shkurt 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin (Ac. nr. 1980/ 2014) i refuzoi ankesat e parashtruara nga parashtruesja e kërkesës (paditësja) dhe nga i padituri Xh. P. si të pabazuara, dhe vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 339/2012) e Gjykatës Themelore me një arsyetim të detajuar të secilit pretendim ankimor.

15. Parashtruesja parashtroi kërkesë për revizion kundër pikës V/b të dispozitivit të Aktgjykimit me të cilin i është refuzuar kërkesëpadia në lidhje me gjësendet personale, me propozim që të ndryshohet pjesa e kontestuar e aktgjykimit në mënyrë që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet për shumën 29,093.10 €.

16. Më 19 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë (Aktgjykimi Rev. nr. 151/2015), e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion dhe vërtetoi Aktgjykimin (Ac. nr. 1980/2014) e Gjykatës së Apelit të Kosovës me arsyetim të detajuar:

"... Gjykata Supreme e Kosovës, arsyetimin e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm, meqë gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar gjendjen faktike ka angazhuar ekspertin R. R, i cili mendimin e tij e ka bazuar në bazë të provave materiale, dëshmitë e dëshmitarëve, vizitat familjare te paditësja dhe i padituri, ka bërë identifikimin e gjësendeve, ka hulumtuar tregun lidhur me çmimet, pastaj në bazë të gjitha të dhënave ka konstatuar se vlera e gjësendeve të llogaritura arrin shumën prej 11.227 €. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e paditëses lidhur me ekspertizën e Sh. B, por e njëjta nuk pat ndikim për të vendosur ndryshe, ngase paditësja nuk e ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit R. R. e as që ka kërkuar ekspertizë tjetër, andaj edhe pretendimi i revizionit se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, kjo Gjykatë e vlerësoi si të pabazuar...".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në procedurat në gjykatat e rregullta janë shkelur nenet 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"... Është shkelur neni 46 dhe 54 i Kushtetutës, pra, iu është mohuar e drejta në pasuri personale Arbenita Ahmeti, ndërsa* [për

fëmijën e mitur] *mohohet e drejta në ushqim, prej datës së ndarjes së prindërve nuk iu është pranuar e drejta në ushqim prej kur i takon por vetëm prej ditës së vendosjes".*

19. Parashtruesja, po ashtu, kërkon: *"... të vlerësohet ligjshmëria e aktgjykimeve pasi iu ka shkelur e drejta e pasurisë personale e cila ka qenë pasuri vetëm e paditëses, sepse një pjesë është çejzi i saj, stolitë e arit si dhe gardëroba, e këto trajtohen pasuri e veçantë e paditëses. Gjykatat nuk kanë vlerësuar kurrë aktgjykimet e paditëses për lartësinë e vlerës, eksperti është caktuar nga gjykata, ndërsa nuk është marrë për bazë ekspertiza e mëhershme, ekspertiza nuk është kërkuar nga paditësja, por gjykata e ka caktuar vetë. Për ushqimin nuk është caktuar prej ditës kur ka qenë i detyruar të paguajë ushqimin baba, por është vendosur prej ditës kur ka vendosur Gjykata, pra është dëmtuar për vite ...".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

22. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (2) (b) dhe d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*
>
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

23. Parashtruesja e kërkesës në thelb pretendon se gjendja faktike lidhur me vlerën e pasurisë është përcaktuar në bazë të gjetjeve të një eksperti të angazhuar nga gjykata, dhe se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh ekspertizën në bazë të së cilës parashtruesja e ka parashtruar padinë, me ç'rast janë shkelur nenet 46 dhe 54 të Kushtetutës në procedurë në gjykatat e rregullta, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.

24. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka parashtruar këto pretendime edhe në procedurën sipas kërkesës për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovëska dhënë shpjegim të detajuar lidhur me mënyrën se si gjykata kishte vërtetuar gjendjen faktike.

25. Parashtruesja e kërkesës tani për herë të parë në procedurën në Gjykatën Kushtetuese pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta "... [fëmijës së mitur] *i mohohet e drejta në ushqim, prej datës së ndarjes së prindërve nuk iu është pranuar e drejta në ushqim prej kur i takon por vetëm prej ditës së vendosjes".* Këto pretendime nuk kanë qenë më parë objekt i kontestit në procedurë në gjykatat e rregullta.

26. Siç u përmend më lart, Gjykata vëren se pretendimet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës janë në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga ajo në Gjykatë.

27. Gjykata vëren se gjatë procedurës, me propozim të parashtrueses së kërkesës, Gjykata e Apelit i aprovoi parashtrueses Masën e përkohshme, me të cilën *"i padituri është i detyruar që në emër të alimentacionit* [për fëmijën e mitur] *të paguajë shumën nga 100 € në muaj, si dhe për paditësen Arbenita Ahmeti të paguajë shumën nga 60 € për muaj, pas përfundimit të procedurës me një vendim përfundimtar...".*

28. Parashtruesja e kërkesës në thelb konteston mënyrën se si është vërtetuar gjendja faktike, të cilën e kanë arsyetuar gjykatat e rregullta në tri shkallë. Megjithatë, ky përfundim u arrit nga gjykatat e rregullta, pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës.

29. Parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia që në faza të ndryshme të asaj procedure të paraqesë argumente dhe dëshmi, që i konsideronte relevante për rastin e saj. Të njëjtën kohë, ajo ka pasur mundësi të kontestonte në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, si të interpretuar gabimisht, në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës në procedurë të rregullt gjyqësore.

30. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtrueses së kërkesës, që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar siç duhet dhe se ato janë shqyrtuar si duhet nga gjykatat, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ajo e konteston janë parashtruar hollësisht, dhe se, në pajtim me këtë, procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësi, ishin të drejta (Shih Rastin*Bogusława KNIAT kundër Polonisë*Vendim i GJEDNJ-së për papranueshmërinë e kërkesës nr. 71731/01 të 11 dhjetorit 2001).

31. Gjykata më tej thekson që nuk është detyrë e saj, sipasKushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih Rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

32. Edhe pse parashtruesja e kërkesës pretendon se të drejtat e saj janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ajo nuk ka treguar se si vendimet e lartpërmendura kanë shkelur të drejtat e saj kushtetuese.

33. Parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

34. Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kushtet e pranueshmërisë. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

35. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) b) dhe d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI45/15, Parashtruesja e kërkesës: Elizabeta Arifi-Deliu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, të 30 shtatorit 2014.

KI-45/15, Aktvendim për papranueshmëri i 8 marsit 2016, i publikuar më 8 prill 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Më 15 dhjetor 2011, Policia e Kosovës i shpalli 30 (tridhjetë) vende të lira të punës për pozitën e Asistentit administrativ, për të cilën pozitë kishte aplikuar parashtruesja e kërkesës. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të testimit, parashtruesja ishte njoftuar se ajo nuk ishte në listën e 30 (tridhjetë) kandidatëve të përzgjedhur për pozitën e Asistentit administrativ.
Më 30 shtator 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (ARJ-UZVP. nr. 13/2014), refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm si të pabazuar.
Parashtruesja e kërkesës pretendoi se Policia e Kosovës dhe gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].
Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtrueses, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ajo kundërshton janë të paraqitura në mënyrë të detajuar dhe se, në bazë të asaj që u tha, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësi, ishin të drejta. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI45/15
Parashtrues
Elizabeta Arifi-Deliu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, të 30 shtatorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Elizabeta Arifi-Deliu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, i 30 shtatorit 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (AA. nr. 1/2014, të 25 marsit 2014).

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 22 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit (A. nr. 02/175/2012, të 27 korrikut 2012) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPM) dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së *"Renditjes përfundimtare të kandidatëve (30 kandidatët e parë) të 20 prillit 2012, në Policinë e Kosovës, duke pasur parasysh përbërjen e Komisionit Përzgjedhës"*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 prill 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI45/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI45/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

9. Më 10 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe KPM-së.

10. Më 10 qershor 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë fletëkthesën, e cila tregon se kur parashtrueses së kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, të 30 shtatorit 2014.

11. Më 29 qershor 2015, Gjykata e pranoi fletëkthesën e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që tregon se parashtrueses së kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme më 22 dhjetor 2014.

12. Më 1 korrik 2015, me Vendimin nr. KSH. KI45/15 për zëvendësimin e gjyqtarit raportues, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese.

13. Më 8 mars 2016, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 15 dhjetor 2011, Policia e Kosovës i shpalli 30 (tridhjetë) vende të lira të punës për pozitën e Asistentit administrativ, për të cilën pozitë kishte aplikuar parashtruesja e kërkesës.

15. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të testimit, parashtruesja ishte njoftuar se ajo nuk ishte në listën e 30 (tridhjetë) kandidatëve të përzgjedhur për pozitën e Asistentit administrativ.

16. Më 3 maj 2012, parashtruesja ushtroi ankesë te Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit të Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit), për shkak të mospërfshirjes në listë.

17. Më 18 qershor 2012, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit e njoftoi parashtruesen se ankesa e saj është refuzuar, si e pabazuar.

18. Më 6 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në KPM kundër vendimit të Njësisë së Rekrutimit dhe Seleksionimit.

19. Në ankesën e saj, parashtruesja pretendoi se gjatë procesit përfundimtar të përzgjedhjes, komisioni i krijuar për përzgjedhjen e kandidatëve kishte shkelur dispozitat e legjislacionit në fuqi në lidhje me rekrutimin e shërbimit civil.

20. Më 27 korrik 2012, KPM-ja (Vendimi, A. nr. 02/175/2012) e refuzoi ankesën e parashtrueses, si të pabazuar.

21. KPM-ja konkludoi, pas shqyrtimit të të gjitha provave të paraqitura nga palët, që procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve ishin kryer në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

22. Më 7 shtator 2012, parashtruesja parashtroi padi në Gjykatën Supreme të Kosovës. Në padinë e saj, parashtruesja pretendoi se Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit veproi duke shkelur Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe se gjatë procedurës së rekrutimit ajo ishte diskriminuar.

23. Padia e parashtrueses i ishte referuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) pas hyrjes në fuqi të Ligjit për gjykatat (1 janar 2013), si organ kompetent në procedurën administrative për të adresuar pretendimin e parashtrueses u bë Gjykata Themelore në vend të Gjykatës Supreme.

24. Më 1 korrik 2013, Gjykata Themelore (Aktvendimi, A. nr. 1032/12, të 1 korrikut 2013) kërkoi nga parashtruesja e kërkesës prova shtesë.

25. Më 9 korrik 2013, parashtruesja dorëzoi në Gjykatën Themelore plotësimin e kërkuar dhe kërkoi anulimin e Vendimit të KPM-së (A. nr. 02/175/2012) dhe kompensimin e dëmit për shkak të parandalimit të punësimit.

26. Më 10 tetor 2013, Gjykata Themelore (Aktgjykimi A. nr. 1032/2012) e refuzoi kërkesën e parashtrueses, si të pabazuar.

27. Pas shqyrtimit të provave të paraqitura, Gjykata Themelore ka gjetur se KPM-ja ka konstatuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të drejtës materiale. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore konstatoi më tej se duke u bazuar në vlerësimin e Gjykatës, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit ka vepruar në pajtim me ligjin dhe i ka renditur ata kandidatë që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret për pozitën e shpallur.

28. Më 27 nëntor 2013, parashtruesja ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (A. nr. 1032/2012, të 10 tetorit 2013) duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale, vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave procedurale.

29. Më 25 mars 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi AA. nr. 1/2014) e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar dhe në këtë mënyrë e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

30. Pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar dhe administrimit të provave, Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Gjykata e Apelit e Kosovës konstatoi më tej se e aprovoi në tërësi qëndrimin e drejt dhe të bazuar ligjërisht të gjykatës së shkallës së parë, sepse aktgjykimi i kontestuar nuk është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e së drejtës materiale apo dispozitat procedurale.

31. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës në lidhje me vlerësimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e paraqitura dëshmoi se KPM-ja nuk ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil.

32. Më 6 maj 2014, parashtruesja parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ajo kërkoi rishqyrtimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (AA. nr. 1/2014, të 25 marsit 2014) duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale, konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave procedurale.

33. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendoi se gjatë procedurës së rekrutimit ajo ishte diskriminuar.

34. Më 30 shtator 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (ARJ-UZVP. nr. 13/2014), refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, si të pabazuar.

35. Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e shkallës më të ulët vendosën në mënyrë të drejtë duke refuzuar kërkesën e parashtrueses për anulimin e vendimit të KPM-së (A. nr. 02/175/2012).

36. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konsideroi se *"rekrutimi sipas konkursit të publikuar nga Ministria e Brendshme për pozitën Asistent administrativ është bërë në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil nenin 2 paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 - parimin e meritës dhe procedurave të rekrutimit në pajtim me Rregulloren nr. 02/2010 mbi procedurën e rekrutimit. Me nenin 11.1. dhe nenin 18.1 parashihet se pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues dhe mosdiskriminimin e kandidatëve dhe përfaqësimit të barabartë. Ankuesja është renditur e 49 (dyzetenënta) me 71.15% të pikëve, ndërsa janë përzgjedhur kandidatët që kanë realizuar prej 71.95% deri 77.95%, duke e përzgjedhur kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e kërkuara".*

37. Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e vendimeve të ligjshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Policia e Kosovës, KPM-ja dhe gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]. Parashtruesja, më tej, pretendon se këto autoritete publike kishin shkelur të drejtat e saj të garantuara me KEDNJ sipas nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenit 14 [Ndalimi i diskriminimit].

39. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës nga gjykatat e rregullta, parashtruesja saktëson se *"Gjykata Supreme nuk ka nxjerrë një vendim të arsyetuar që të më demonstrojë si palë ankuese se jam dëgjuar lidhur me ankesat e mia* [...]". Prandaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se "*Me aktgjykimet e gjykatave të rregullta pretendoj se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] e KEDNJ".*

40. Sa i përket pretendimeve të saj për diskriminim, parashtruesja pohon *"jam ankuar edhe për diskriminim si grua shtatzënë përshkruar në nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] i KEDNJ në bazë të ndonjë statusi tjetër personal. Punësimi është bërë në qershor 2012, unë kam lindur fëmijën më 28.07.2012. Gjykatat e rregullta do të duhej ta trajtonin në mënyrë specifike se pse kur kam dalur fizikisht para komisionit kam marrë më pak pikë se në test me shkrim për dallim prej kandidatëve tjerë"*.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Në mënyrë që të jetë në gjendje ta gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Gjykata vëren se parashtruesja është palë e autorizuar në bazë të Kushtetutës, ajo e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, se i ka shteruar mjetet e nevojshme juridike dhe se ka paraqitur kërkesën e saj brenda periudhës kohore prej 4 (katër) muajsh pas marrjes së aktgjykimit.

43. Parashtruesja e kërkesës i ka deklaruar në mënyrë të qartë të drejtat dhe liritë kushtetuese që pretendohen të jenë shkelur dhe vendimin e kontestuar siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

44. Përveç kësaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kishte plotësuar rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(2) "Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
>
> *(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
>
> *(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"*.

45. Gjykata vëren se përveç kërkesës së parashtrueses për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, parashtruesja në kërkesën e saj gjithashtu kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të KPM-së dhe vendimit për *"Renditjen përfundimtare të kandidatëve (30 kandidatët e parë) të 20 prillit 2012, në Polici të Kosovës, duke pasur parasysh përbërjen e Komisionit Përzgjedhës"*. Në këtë drejtim, ajo pretendonshkelje të nenit 24 dhe të nenit 31 të Kushtetutës.

46. Gjykata vëren se parashtruesja ngriti të njëjtat pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e Ligjit për Shërbimin Civil, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe se ajo ishte diskriminuar gjatë procedurës administrative nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Pretendimet e saj ishin adresuar nga gjykatat përkatëse dhe ishin arsyetuar si duhet.

47. Në kërkesën e saj për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, ajo pretendoi shkelje të drejtës materiale dhe procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se gjatë procedurës së rekrutimit ajo ishte diskriminuar. Prandaj, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme adresoi dhe vendosi për pretendimet e lartpërmendura, të cilat tanimë ishin ngritur në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Për këtë arsye, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është tani vendimi përfundimtar për këtë objekt çështjeje kontestuese.

48. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses se ajo ishte diskriminuar, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit konstatuan se procedura e rekrutimit ishte mbajtur në përputhje me parimet e Shërbimit Civil të përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj konfirmoi se procedura e rekrutimit është kryer në pajtim me ligjin në fuqi dhe se ajo ishte bazuar në *"parimet emeritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësi të komisionit testues dhe mosdiskriminimit të kandidatëve dhe përfaqësimit të barabartë".*

49. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur fakte dhe nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e saj për diskriminim. Kur pretendohet një shkelje e tillë kushtetuese, parashtruesja e kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës.

50. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës se gjykatat e rregullta nuk kanë nxjerrë vendime të arsyetuara, Gjykata i referohet vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme e cila në aktgjykimin e saj konkludoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.

51. Përveç kësaj, ajo gjithashtu pretendon, se Gjykata Supreme nuk nxori një vendim të arsyetuar *"i cili do të tregonte për mua si një palë që ankohet që unë jam dëgjuar në lidhje me ankesat e mia [...]",* duke e shkelur në këtë mënyrë nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

52. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj i adresoi çështjet thelbësore të ngritura në kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas së cilës neni 6 nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument që i ofrohet gjykatës gjatë mbajtjes së procedurës (Shih, *Van de Hurk kundër Holandës*, Nr. 16034/90, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 prillit 1994, para. 61).

53. Prandaj, Gjykata konstaton se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata ka gjetur se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

54. Si përfundim, Gjykata thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

55. Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese dhe se parashtruesja nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj.

56. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 8 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI147/15, Parashtrues SH.P.K. "SYRI", Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015

KI147/15, Vendim për refuzim të kërkesës i miratuar më 16 mars 2016 dhe i publikuar më 13 prill 2016.

Fjalët Kyç*: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshme, kërkesa e paplotë dhe e papranueshme.*

Parashtruesi e kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe pretendoi se i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm]. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, për më tepër, parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën pa informacione të nevojshme në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e tij.
Gjykata e refuzoi të papranueshme kërkesën me procedurë të shkurtër sepse ishte e paplotë për shqyrtim.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS
në
Rastin nr. KI147/15
Parashtrues
SH.P.K. "SYRI"
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është SH.P.K. "SYRI" nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 126/2013 të 9 tetorit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 198/2007, të 19 majit 2008.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së 3 (tre) aktgjykimeve, me të cilat pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6, nenin 13 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 dhjetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 2 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Gjithashtu, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe vendimet të cilat i konteston.

9. Parashtruesi nuk u përgjigj në kërkesën e Gjykatës.

10. Më 16 mars2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në Rastin KI147/15, Gjykata vërejti se parashtruesi ka dorëzuar kërkesën e cila përbëhet nga 2 (dy) faqe, në bazë të së cilave nuk mundet të konkludohet se cila është esenca e kontestit dhe si kishte ardhur deri te shkeljet e pretenduara mbi të cilat parashtruesi e ka ndërtuar kërkesën e tij.

12. Gjykata mund të vërej vetëm se parashtruesi i kërkesës i konteston këto aktgjykime:

    a) Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 198/2007, të 19 majit 2008;
    b) Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 126/2013, të 9 tetorit 2014; dhe
    c) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi në kërkesë theksoi: "*Çdo person fizik ose moral ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare*".

14. Parashtruesi kërkon: "*që vetë Gjykata të sigurojë të gjithë dokumentacionin nga Gjykata Themelore në Prishtinë lidhur me këtë rast*".

Pranueshmëria e kërkesës

15. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Në këtë kuptim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

17. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe *liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

18. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 29 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës:

"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës".

19. Si dhe rregullin 32 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

(5)"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze".

20. Në rastin konkret, Gjykata vërejti se parashtruesi në kërkesën e tij të 14 dhjetorit 2015, ka kërkuar në mënyrë eksplicite që Gjykata të sigurojë *ex officio* të gjithë dokumentacionin, si dhe aktgjykimet të cilat ai i konteston, nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

21. Gjykata thekson se përkundër kërkesës për dokumentacion mbështetës, të cilën ia kishte dërguar parashtruesit më 2 shkurt 2016 dhe në të cilën ka kërkuar që ai ta plotësojë kërkesën e 14 dhjetorit 2015 me dokumentacionin e nevojshëm, në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e tij, ai nuk e ka bërë një gjë të tillë.

22. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që të ndërtojë rastin dhe të dorëzojë në Gjykatë të gjithë informatat e nevojshme për të qenë në gjendje ta shqyrtojë rastin.

23. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se në këtë rast nuk mund të merr në shqyrtim një kërkesë, sepse nuk janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale të parashikuara me Rregulloren e punës.

24. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet në pajtim me rregullat 29 dhe 32 (5) të Rregullores së punës, sepse është e paplotë për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me rregullat29 dhe 32 (5) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 16 mars2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI110/15, Parashtruesja e kërkesës: Bedrije Rrahmani nga Prishtina, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, të 31 majit 2007.

KI110/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 marsit 2016, i publikuar më 13 prill 2016.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, e pambështetur, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Parashtruesja e kërkesës ishte në marrëdhënie pune në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

MPMS në një moment e ka sistematizuar parashtruesen e kërkesës në pozitë më të ultë nga ajo që e ka pasur më parë. Kundër Vendimit të MPMS-së, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK). KPMK aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e prishi Aktvendimin e Sekretarit të MPMS-së. Gjykata Komunale në Prishtinë sipas kërkesës së parashtrueses lejoi përmbarimin e vendimit të KPMK-së.

Parashtruesja e kërkesës është e kënaqur me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, por nuk është e kënaqur me mënyrën me të cilën ishte zbatuar ky Aktvendim, përkatësisht me pozitën në të cilën MPMS-ja e kishte sistematizuar pas zbatimit të Aktvendimit. Parashtruesja në kërkesë thekson se Gjykata Komunale në Prishtinë e kishte shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më saktësisht nenin 49[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].
Gjykata konsideron se nuk ka asnjë bazë objektive që të mbështesë pretendimet e parashtrueses se Aktgjykimi i kontestuar i ka shkelur të drejtën e punës apo ushtrimit të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës. Në fakt, me vetë nënshkrimin e kontratës së punës më 23 shkurt 2009, me të cilën parashtruesja transferohet në pozitën e re, parashtruesja e kërkesës i ka realizuar të gjitha të drejtat e saja të përcaktuara me nenin 49 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja në kërkesë nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë ose KEDNJ. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI110/15
Parashtrues
Bedrije Rrahmani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, të 31 majit 2007
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Bedrije Rrahmani, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuarështë Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, i 31 majit 2007.

3. Ky aktvendim i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 24 prill 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet që është shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 gusht 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 shtator 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 25 shtator 2015, Gjykata e informoi parashtruesen dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dhe Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojnë kopjen e fletëkthesës që tregon datën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 752/07, të 31 majit 2007.

9. Më 1 tetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi informacionin e kërkuar. Në përgjigje të Gjykatës Themelore shihet se më 24 prill 2015, parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

10. Më 8 mars2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës ishte në marrëdhënie pune nga viti 2003 deri më 30 dhjetor 2005, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) në pozitë infermiere përgjegjëse-terapeute medicinale.

12. Më 30 dhjetor 2005, Sekretari i MPMS [Aktvendimi nr. 6999], e ka sistematizuar parashtruesen e kërkesës në pozitë motër medicinale, përkatësisht në një pozitë më të ulët nga ajo që e ka pasur më parë.

13. Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Komisionin për Ankesa pranë MPMS-së kundër këtij Aktvendimi.

14. Më 28 shkurt 2006, Komisioni për Ankesa i MPMS-së, me Vendimin nr. 25/06 e refuzoi ankesën e parashtrueses dhe konfirmoi vendimin e Sekretarit të MPMS-së.

15. Më 22 mars 2006, parashtruesja e kërkesës, kundër Vendimit të Komisionit për Ankesa pranë MPMS-së, parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK).

16. Më 24 prill 2006, KPMK-ja, me Vendimin A, 02, 38/2006, e aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, e prishi Aktvendimin e Sekretarit të MPMS-së dhe Vendimin e Komisionit për Ankesa pranë MPMS-së si dhe e urdhëroi MPMS-në ta kthej parashtruesen në pozicionin e mëparshëm.

17. Më 17 maj 2007, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë propozim për përmbarimin e vendimit të KPMK-së.

18. Më 31 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 752/07, e lejoi përmbarimin e vendimit të KPMK-së, dhe kështu edhe kthimin e parashtrueses në pozicionin e mëparshëm.

19. Më 23 shkurt 2009, MPMS-ja dhe parashtruesja e kërkesës lidhën kontratë me të cilën parashtruesja u sistematizua në një pozicion të ri i cili ishte ekuivalent me pozitën e mëparshme dhe lartësinë e pagës.

20. Më 15 korrik 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë i dërgoi MPMS-së një urdhër për dërgimin e të dhënave për përmbarimin e Aktvendimit C. nr. 752/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

21. Më 18 gusht 2011, MPMS-ja dërgoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë dokumentacionin e kompletuar lidhur me mënyrën e përmbarimit të Aktvendimit C. nr. 752/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Në njoftimin e saj, MPMS-ja, ndër të tjera, theksoi:

> *"Bazuar në dosjen personale të punëtores Bedrije Rrahmani, ju informojmë së aktvendimi i GJ.K. në Prishtinë është ekzekutuar dhe punëtores i është ndërruar pozita nga Motër medicionale në Terapeut/e Shëndetsor për Edukim dhe Rehabilitim në Shtëpinë e Personave të Moshuar nga data 01.02.2009".*

22. Më 10 prill 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për pranimin e Aktvendimit C. nr. 752/07, të 31 majit 2007.

23. Më 24 prill 2015, parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktvendimin C. nr. 752/07 e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës konsideron se MPMS-ja, me moszbatimin e Vendimit të KPMK-së, A, 02, 38/2006, dhe Aktvendimit C. nr. 752/07, të Gjykatës Komunale të Prishtinës ia ka shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Për të qenë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, parashikon:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

28. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

29. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës është e kënaqur me Aktvendimin C. nr. 752/07 e Gjykatës Komunale në Prishtinë, por nuk është e kënaqur me mënyrën me të cilën ishte zbatuar ky Aktvendim, përkatësisht me pozitën në të cilën MPMS-ja e kishte sistematizuar pas zbatimit të Aktvendimit C. nr. 752/07.

30. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesja e kërkesës e kishte ndërtuar ankesën e saj kushtetuese mbi shkeljen e pretenduar të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

31. Gjykata thekson se e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit nga neni 49 i Kushtetutës është subjekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës, ku këto të drejta, më tej realizohen në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Ky ligj i garanton të drejtën e punës nëse një person është i kualifikuar dhe nëse ka punë në dispozicion. Mirëpo, nuk garanton të drejtën e punës në një pozitë specifike të punës.

32. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata gjeti se KPMK-ja, sipas ligjit, i shqyrtoi meritat e kërkesëpadisë së parashtrueses, me ç'rast e vërtetoi gjendjen faktike me rëndësi për nxjerrjen e vendimit të saj, duke përfshirë Aktvendimin C. nr. 752/07 e Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili lejon përmbarimin e vendimit të KPMK-së.

33. Gjykata konstaton se përmbarimi i Aktvendimit të Gjykatës Komunale, të cilin e konteston parashtruesja e kërkesës, në asnjë mënyrë nuk e pengon atë që të punojë të ushtrojë profesion apo të merr pagën e paraparë për vendin e punës. Për më tepër, me nënshkrimin e kontratës së punës më 23 shkurt 2009, parashtruesja në mënyrë specifike u pajtua që të transferohet nga një vend i punës në pozitë tjetër dhe pagë ekuivalente të përcaktuar në vendimin e KPMK-së, me çka u zbatua vendimi i KPMK-së nga MPMS-ja.

34. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asnjë bazë objektive që të mbështesë pretendimet e parashtrueses se Aktgjykimi i kontestuar i ka shkelur të drejtën e punës apo ushtrimit të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës. Në fakt, me pajtimin e saj specifik për transferimin e pozicioneve më 29 shkurt 2009, parashtruesja ka arritur të gjitha të drejtat e saja të përcaktuara me nenin 49 të Kushtetutës.

35. Gjykata thekson se mospajtimi i parashtrueses me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005)).

36. Gjykata, më tej, rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih Rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

37. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat36 (1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 8 mars2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI87/15, Parashtruesja e kërkesës: Bahrije Galica, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 277/2014, të 20 nëntorit 2014

KI-87/15, Aktvendim për papranueshmëri i 8 marsit 2016, i publikuar më 13 prill 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta e pronës, jashtë afatit*.

Më 20 nëntor 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 277/2014) përfundoi në formë të prerë kontestin e punës ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe Shoqatës së Zjarrfikësve të Komunës së Prishtinës.
Parashtruesja e kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën e saj për pronë, sepse ajo *"[. . .] ka pasur pritje legjitime që do të gëzojë dëmshpërblim [...] sipas të drejtës së kthimit në punë"*.
Gjykata konkludoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 277/ 2014, i 20 nëntorit 2014) i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 2 janar 2015, ndërsa ajo parashtroi kërkesën e saj në Gjykatë më 26 qershor 2015. Bazuar në këtë, rrjedh se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtrueses është e papranueshme sepse është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI87/15
Parashtrues
Bahrije Galica
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 277/2014, të 20 nëntorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Bahrije Galica, të cilën e përfaqëson z. Naim Krasniqi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 277/2014, i 20 nëntorit 2014.

3. Parashtruesja e kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar më 2 janar 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesja pretendon se i është shkelur e drejta e saj e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 qershor 2015, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI87/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI87/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 19 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 19 gusht 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë fletëkthesën, e cila tregon se kur i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 277/2014, i 20 nëntorit 2014.

10. Më 26 gusht 2015, Gjykata e pranoi fletëkthesën e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që tregon se aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 2 janar 2015.

11. Më 8 mars 2016, Kolegjishqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesja e kërkesës nga viti 1983 deri më 1999 kishte qenë në marrëdhënie pune në shoqatën e zjarrfikësve të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi).

13. Më 24 shtator 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte obliguar punëdhënësin që parashtruesen ta kthejë në punë në pozitë të njëjtë apo në një pozitë tjetër me detyra të ngjashme. Më 7 dhjetor 2007, aktgjykimi mori formën e prerë.

14. Si rezultat i këtij aktgjykimi, më 11 shkurt 2008, parashtruesja ishte kthyer në punë.

15. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, nëpërmjet të cilës kishte kërkuar kompensim për pagat e humbura nga 1 korriku 1999 deri në datën e kthimit të saj në punë.

16. Më 5 prill 2011, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C1. nr. 115/08) në Prishtinë aprovoi padinë e parashtrueses dhe detyroi punëdhënësin e saj t'ia kompensojë pagat e humbura për periudhën kohore: 1 korrik 1999 deri në datën e kthimit të saj në punë.

17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, punëdhënësi kishte paraqitur ankesë.

18. Më 13 qershor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 2517/2012) refuzoi ankesën e punëdhënësit dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

19. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, punëdhënësi kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme.

20. Më 20 nëntor 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 277/2014) aprovoi pjesërisht si të bazuar revizionin e parashtruar nga punëdhënësi dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

21. Nëpërmjet aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme vendosi që pjesërisht të pranojë si të bazuar padinë e parashtrueses, duke detyruar punëdhënësin që asaj t'ia kompensojë pagat e humbura vetëm për periudhën kohore prej 7 dhjetorit 2007 deri më 11 shkurt 2008. Në të njëjtën kohë, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të padisë së parashtrueses për kompensimin e pagave të humbura për periudhën kohore prej 1 korrikut 1999 e deri më 7 dhjetor 2007.

Pretendimet e parashtruesit

22. Ashtu si u përmend më lart, parashtruesja, në kërkesën e saj, pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën e saj për pronë.

23. Parashtruesja e kërkesës pohon se *"[...] ka pasur pritje legjitime që do të gëzojë dëmshpërblim në shumën e lartpërmendur sipas të drejtës së kthimit në punë"*.

24. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi"*.

27. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi [...]"*.

28. Për të përcaktuar nëse parashtruesja e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet ditës kur parashtrueses së kërkesës i

është dorëzuar vendimi përfundimtar dhe ditës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese.

29. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 277/2014, i 20 nëntorit 2014) i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 2 janar 2015, ndërsa ajo parashtroi kërkesën e saj në Gjykatë më 26 qershor 2015. Bazuar në këtë, rrjedh se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

30. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendim i 25 gushtit 2005).

31. Rrjedhimisht, Gjykatakonsideron se kërkesa e parashtrueses është e papranueshme sepse është e pasafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 8 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI72/15, Parashtruesi i kërkesës: Selim Hasani, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 51/2015, të 2 prillit 2014.

KI-72/15, Aktvendim për papranueshmëri i 15 marsit 2016, i publikuar më 13 prill 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi C. nr 146/10) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për anulimin e kontratës së shitblerjes dhe vërtetimin e bashkëpronësisë si të pabazuar.

Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr 51/2015) refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi se gjykatat e instancave më të ulëta, në bazë të vlerësimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën procedurale.
Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës së tij në pronë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe as nuk ka shpjeguar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e lartcekura kushtetuese.
Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai kundërshton janë të paraqitura në mënyrë të detajuar dhe se, në bazë të asaj që u tha, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësi, ishin të drejta. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI72/15
Parashtrues
Selim Hasani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 51/2015, të 2 prillit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Selim Hasani, i cili përfaqësohet nga z. Zef Delhysa, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 51/2015, i 2 prillit 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për revizion e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 542/2014, të 17 nëntorit 2014.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 maj 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe me nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 qershor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI72/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI72/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 18 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

9. Më 23 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.

10. Më 15 mars 2016, Kolegjishqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. I ati i parashtruesit të kërkesës kishte vdekur në vitin 1974. Në atë kohë, parashtruesi ishte banor i Shqipërisë. Në një ditë të pacaktuar, vëllai i parashtruesit të kërkesës ishte pranuar si trashëgimtar i vetëm dhe ai kishte trashëguar pronën e patundshme në fshatin Gërgoc.

12. Pas vdekjes së vëllait të parashtruesit në vitin 1997, pronën e paluajtshme në Prizren e trashëgoi bashkëshortja dhe fëmijët e tij. Pas vitit 1999, parashtruesi i kërkesës ishte kthyer në Kosovë.

13. Më 19 tetor 2004, në bazë të së drejtës në trashëgimi, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar konfirmimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme në Prizren. Parashtruesi pretendoi se kjo pasuri e paluajtshme në Prizren ishte blerë me të hollat e shitjes së pronës së paluajtshme në fshatin Gërgoc.

14. Më 8 nëntor 2004, parashtruesi paraqiti propozim në Gjykatën Komunale në Prizren për vendosje të masës së përkohshme, gjegjësisht të ndalojë palën e paditur (trashëgimtarët e vëllait të tij të vdekur) ta tjetërsojë pronën e paluajtshme derisa Gjykata Komunale në Prizren të nxjerrë vendim përfundimtar.

15. Më 25 janar 2005, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi C. nr. 1448/04) vendosi ta miratojë propozimin e parashtruesit për masë të përkohshme.

16. Më 24 maj 2006, trashëgimtarët e vëllait të parashtruesit lidhën kontratën e shitblerjes me një palë të tretë. Kjo kontratë e shitblerjes u vërtetua nga Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi Leg. nr. 2502/2006, i 24 majit 2006).

17. Më 13 korrik 2006, parashtruesi saktësoi kërkesëpadinë e tij, duke kërkuar nga Gjykata Komunale të anulojë kontratën e lartpërmendur të shitblerjes, të lidhur ndërmjet trashëgimtarëve të vëllait të tij dhe palës së tretë (pala e paditur) dhe të shpallë parashtruesin e kërkesës bashkëpronar të pasurisë së paluajtshme në Prizren.

18. Më 10 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 146/10) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për anulimin e kontratës së shitblerjes dhe vërtetimin e bashkëpronësisë si të pabazuar. Gjykata Themelore vendosi më tej se masa e përkohshme e vendosur me vendim (Aktvendimi C. nr. 1448/04, i 25 janarit 2005) mbetet në fuqi deri sa vendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë.

19. Gjykata Themelore, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi (neni 138 i Ligjit për Trashëgimi), konstatoi se *"[...] ai është kthyer në Kosovë nga Republika e Shqipërisë, menjëherë pas luftës, përkatësisht në mes të vitit 1999, për çka edhe del se ai në këtë kohë ka kuptuar për 'shitjen' e paluajtshmërive të të ndjerit [vëllait], përkatësisht për 'blerjen' e paluajtshmërisë kontestuese në Prizren, ndërsa padia e tij është paraqitur pranë kësaj gjykate në fund të vitit 2004, që i bie pas kalimit të afatit ligjor subjektiv 1-vjeçar. Përpos kësaj, me shikim në shkresat e lëndës, del se [parashtruesi i kërkesës] dhe i ndjeri [...] janë vëllezër, janë djemtë e të ndjerit [...], i cili ka ndërruar jetë në vitin 1974, që do të thotë se në këtë çështje kontestimore ka kaluar edhe afati objektiv 10-vjeçar, përkatësisht ai 20-vjeçar për poseduesin me keqbesim, sepse konform dispozitave ligjore të lartcituara, koha a llogaritjes për të kërkuar pasurinë trashëgimore për [parashtruesin] ka filluar të rrjedhë nga momenti i vdekjes së të atit të tij [...]"*.

20. Sa i përket kontratës së shitblerjes, të lidhur më 24 maj 2006, Gjykata Themelore konstatoi se blerësi ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese në mirëbesim dhe se *"[...] ky kontest nuk mund t'i bart pasojat apo keqkuptimet eventuale që ekzistojnë apo kanë ekzistuar në mes të [parashtruesit të kërkesës] dhe [trashëgimtarit të vëllait të parashtruesit të kërkesës]"*.

21. Në lidhje me çështjen e masës së përkohshme, Gjykata konkludoi se nuk është detyrë dhe obligim i palëve kontraktuese të jenë në dijeni për kufizimet e mundshme që mund të ekzistojnë në pasuritë e paluajtshme. Sipas Gjykatës Themelore, detyra dhe obligimi për të respektuar kufizime të tilla qëndron te autoritetet publike kompetente për vërtetimin e kontratave të tilla.

22. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij, parashtruesi pretendoi shkelje esenciale të ligjit procedural, vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

23. Më 17 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 542/2014) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

24. Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimet e parashtruesit, të ngritura në ankesën e tij, tashmë ishin adresuar nga gjykata e shkallës së parë, që rezultoi që Gjykata Themelore kishte vlerësuar drejt gjendjen faktike dhe kishte zbatuar drejt të drejtën procedurale dhe materiale.

25. Gjykata e Apelit, në aktgjykimin e saj, konfirmoi se *"blerësi i kësaj patundshmërie është blerës i ndërgjegjshëm dhe i njëjti e fiton të drejtën e pronësisë po qe se nuk ka ditë dhe nuk ka qenë dash të din se shitësi nuk është pronar. Blerësi në këtë patundshmëri ka fituar pronësinë në bazë të punës së vlefshme juridike në mënyrë të ndërgjegjshme. Në kontekst me këto, pretendimet ankimore paraqiten si relevante dhe të pabazuara në këtë çështje juridike"*.

26. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të së drejtës procedurale, vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përveç kësaj, parashtruesi ngriti çështjen e masës së përkohshme, për të cilën ai pretendonte se ishte ende në fuqi.

27. Më 2 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 51/2015) refuzoi revizionin e parashtruesit si të pabazuar.

28. Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancave më të ulëta, në bazë të vlerësimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën procedurale.

29. Sa i përket zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata Supreme, bazuar në dispozitat e Ligjit për Trashëgimi, konfirmoi se e drejta e parashtruesit të kërkesës për të kërkuar trashëgiminë ishte objekt i parashkrimit.

30. Prandaj, në lidhje me këtë, Gjykata Supreme konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët gjithashtu kanë zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

31. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me çështjen e masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata Komunale, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës më të ulët ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore, përkatësisht, nëse gjykata e shkallës së parë nuk e miraton kërkesëpadinë, masa e përkohshme mbetet në fuqi deri sa vendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë.

32. Në fund, Gjykata Supreme konkludoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm dhe se ai përmban arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se i ishte mohuar e drejta e tij për gjykim të barabartë. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij në pronë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe as nuk ka shpjeguar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e lartcekura kushtetuese.

34. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kryesisht ankohet për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta. Përveç kësaj, ai gjithashtu pretendon vlerësim të gabuar të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, ai pretendon se, në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, *"lidhur me refuzimin e ankesës sa i përket kërkesës për anulimit e kontratës së lartcekur* [kontrata e shitblerjes] *është edhe më i çuditshëm. Në vend të konstatimit të pandërgjegjësisë të të padituve, përgjegjësinë e tyre dhe të gjykatës, në kuptim të 'legalizimit' të kontratës të palejuar, gjykata e shkallës së dytë, të cilës i është besuar të kujdeset për ligjshmërinë dhe sundimin e ligjit, ajo 'i mbyllë sytë' para faktit të papranueshëm dhe të kundërligjshëm, duke shpallur blerësin të 'ndërgjegjshëm' [...]"* .

35. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata që të anulojë aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Themelore në Prizren, si antikushtetuese dhe ta kthejë lëndën për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

37. Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar në bazë të Kushtetutës, se e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht aktgjykimin e Gjykatës Supreme, se i ka shteruar mjetet e nevojshme juridike dhe ka parashtruar kërkesën brenda periudhës prej 4 (katër) mujor.

38. Parashtruesi i ka përmendur në mënyrë të qartë të drejtat kushtetuese dhe liritë që pretendohen se i janë shkelur dhe ka përmendur aktin e kontestuar, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

39. Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e Rregullores së punës, përkatësisht të rregullit 36 (2), i cili parasheh:

> "(*2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
>
> *[...]*
>
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

40. Siç u theksua më lart, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të së drejtës së tij në pronë.

41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk e ka dëshmuar pretendimin për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të së drejtës në pronë. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastin nr. KI198/13, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

42. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi nuk pajtohet me vlerësimin e fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale dhe ligjore nga gjykatat e rregullta. Vlerësimi i fakteve dhe ligji i zbatueshëm janë çështje të cilat bien brenda fushës së ligjshmërisë.

43. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit (ligjshmërinë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

44. Prandaj, Gjykata thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe

materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

45. Siç u theksua më lart, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, konkludoi se në bazë të vlerësimit të drejtë të gjendjes faktike, e drejta procedurale dhe materiale janë aplikuar në mënyrë të drejtë.

46. Përveç kësaj, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata ka gjetur se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

47. Në fund, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005)·

48. Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese dhe se parashtruesi nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

49. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI09/16 Parashtrues Behgjet Pacolli, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së moszbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, të 7 prillit 2011

Rastin KI09/16, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2016, publikuar më 13 prill 2016

Fjalët kyç. *E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, E Drejta për Mjete Juridike, Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të Kushtetutës, E drejta për një proces të rregullt, E drejta për zgjidhje efektive të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ratione materiae.*

Parashtruesi i kërkesës ishte nënshkrues i një Memorandum mirëkuptimi bashkë me dy partitë e tjera politike-parlamentare për dalje nga kriza institucionale. Në atë Memorandum mirëkuptimi ndërmjet partive politike, u vendos për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës kishte dërguar amandamentet kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar vlerësimin kushtetues të tyre.
Parashtruesi pretendoi se dështimi i Kuvendit për të miratuar amandamentet kushtetuese përbëjnë shkelje të drejtave të njeriut me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane. Parashtruesi pretendoi se i është shkelur edhe barazia para ligjit në frymën e nenit 24 të Kushtetutës, sepse me këtë rast parashtruesi si subjekt i marrëveshjes të mbështetur nga Rezoluta është vendosur në pozitë të anshmërisë dhe të pabarazisë, në raport me subjektet tjera të marrëveshjes.

Parashtruesi kërkoi nga Gjykata që të vërtetoj shkeljen e lirive dhe të drejtave të parashtruesit dhe ta obligoj Kuvendin ta zbatoj Rezolutën, do të thotë, të votojë amandamentet kushtetuese që rregullojnë zgjedhjen e Presidentit direkt nga populli.

Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk ishte palë e autorizuar që të ngre kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Po ashtu, Gjykata, vendosi se Rezoluta e Kuvendit nuk mund të jetë objekt shqyrtimi sepse nuk është *ratione materiae* në përputhje me juridiksionin e saj.
Gjykata konstatoi se parashtruesi vetëm kishte numëruar dispozitat kushtetuese dhe instrumentet tjera ndërkombëtare, por nuk kishte arsyetuar se si janë shkelur ato dispozita të përmendura. Gjykata Kushtetuese vendosi që kërkesën ta deklarojë të papranueshme pasi që është ngritur nga pala e paautorizuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin KI09/16
Parashtrues
Behgjet Pacolli
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së moszbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, të 7 prillit 2011
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Behgjet Pacolli, individ nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësim kushtetues të moszbatimit të Rezolutës (në tekstin e mëtejmë: Rezoluta) së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02 (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), të 7 prillit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së moszbatimit të Rezolutës së Kuvendit, të 7 prillit 2011, përkitazi me amendamentet kushtetuese dhe me legjislacionin e nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës.

4. Rezoluta në fjalë ishte nxjerrë nga Kuvendi në mbështetje të Memorandumit (në tekstin e mëtejmë: Memorandumi) ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të lidhur më 6 prill 2011.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 26 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Sekretariatit të Kuvendit.

8. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi (gjyqtarë).

9. Më 17 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve bazuar në dokumentet e përmbajtura në kërkesë

10. Më 6 prill 2011, parashtruesi i kërkesës, z. Behgjet Pacolli, lider i partisë politike Aleanca Kosova e Re (AKR), z. Isa Mustafa, lider i partisë politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe z. Hashim Thaçi, lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), nënshkruan Memorandum mirëkuptimi për dalje nga kriza institucionale e krijuar në vitin 2011. Në atë memorandum, të tre udhëheqësit e partive politike ishin pajtuar për krijimin e një komisioni *ad hoc* të Kuvendit që do të hartonte ndryshimet (amendamentet) kushtetuese dhe legjislacionin e nevojshëm për të zgjedhur Presidentin e Republikës së Kosovës drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës.

11. Më 7 prill 2011, Kuvendi miratoi Rezolutë me të cilën mbështeti memorandumin e lartpërmendur.

12. Më 22 prill 2011, Kuvendi miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nr. 04-V-12. Ky vendim ishte i bazuar edhe në Rezolutën e Kuvendit, e cila në atë rast nuk ishte zbatuar plotësisht.

13. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit i dërgoi amendamentet e propozuara në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar vlerësim kushtetues të amendamenteve të propozuara, përkatësisht nëse ato ishin në pajtueshmëri me Kapitullin II dhe me Kapitullin III të Kushtetutës.

14. Më 20 korrik 2012, Gjykata, në rastet KO29/12 dhe KO48/12, vlerësoi nëse amendamentet e propozuara ishin në pajtueshmëri me Kapitullin II dhe me Kapitullin III të Kushtetutës.

15. Amendamentet e propozuara kushtetuese që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës nuk ishin vënë në votim në Kuvend.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi pretendon se dështimi i Kuvendit për të miratuar këto amendamente të propozuara është shkelje e nenit 24 [Barazia para Ligjit], e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, e nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 25, pika a) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Kuvendi nuk e ka zbatuar plotësisht Rezolutën NR. 04-R-02, datë 7.4.2011, për faktin që asnjëherë nuk i ka vendosur në rend të ditës për votim amendamentet e propozuara kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, që janë vlerësuar nga Gjykata me Aktgjykimin nr. KO29/12 dhe KO48/12 të datës 20 korrik 2012. Me këtë rast, Kuvendi me mosveprim (heshtje) dhe moszbatim të Rezolutës NR. 04-R-02 ka shkelur të drejtat e pretenduara kushtetuese të parashtruesit të kërkesës*".

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Kuvendi me moszbatimin e Rezolutës NR. 04-R-02, nuk i ka dhënë rastin deputetëve, sidomos asaj të legjislaturës së kaluar, që e kanë mbështetur këtë rezolutë për të votuar draft amendamentet kushtetuese të propozuara për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës drejtpërdrejt nga populli*".

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"... nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë nga Kuvendi me subjektet e tjera politike dhe nënshkruesit e marrëveshjes, me rastin e moszbatimit të Rezolutës NR. 04-R-02 dhe mosvënies në votim të pakos së amendamenteve për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit dhe se ka pasur pritshmëri të arsyeshme që gjatë kësaj legjislature, por edhe legjislaturës së kaluar të Kuvendit, këto draft amendamente të procedohen për votim në Kuvend*".

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Me moszbatimin e plotë të rezolutës dhe mosprocedimin për votim të amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, atij si person fizik dhe AKR-së si person juridik i është shkelur edhe barazia para ligjit në frymën e nenit 24 të Kushtetutës, sepse me këtë rast parashtruesi si subjekt i marrëveshjes të mbështetur nga rezoluta është vendosur në pozitë të anshmërisë dhe të pabarazisë, në raport me subjektet tjera të marrëveshjes të mbështetur nga Rezoluta NR. 04-R-02, respektivisht z. Hashim Thaçi (PDK) dhe z. Isa Mustafa (LDK)*".

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Rezoluta NR. 04-R-02 e obligon Kuvendin që të respektojë afatet e parapara në marrëveshjen politike, ku përfshihet edhe ndryshimi i Kushtetutës për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit*".

22. Parashtruesi i kërkesës pohon se nuk ka ndonjë mjet juridik që ai do ta kishte shfrytëzuar për t'u ankuar ndaj moszbatimit të Rezolutës Nr. 04-R-02 në kuptimin e nenit 144.3 të Kushtetutës për të proceduar votimin e amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit.

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"...pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Rasti nr. KO29/11, ishte tërhequr nga posti i Presidentit të Republikës së Kosovës me qëllimin e zbatimit të rezolutës dhe votimit të amendamenteve të propozuara kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit*".

24. Parashtruesi pretendon se, në këtë rast, afatet kohore të përcaktuara me Ligj nuk mund të llogariten sepse bëhet fjalë për një "situatë të vazhdueshme", sepse Kuvendi me moszbatimin e Rezolutës ka krijuar "situatën e vazhdueshme". Për të mbështetur pretendimin e tij, parashtruesi i referohet rastit nr. KI47/10 *Naim Rrustemi dhe 31*

deputetë të tjerë, Aktgjykim i 29 shtatorit 2010 (në tekstin e mëtejmë: rasti i presidentit Sejdiu).

25. Parashtruesi pretendon: *"Si palë e marrëveshjes ka pasur pritshmëri të arsyeshme që zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 të organizohen sipas rregullave të reja kushtetuese të zgjedhjes së drejtpërdrejtë nga populli".*

26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata "*... që të vërtetojë shkeljet e lirive dhe të drejtave të parashtruesit dhe të obligojë Kuvendin që të zbatojë Rezolutën NR. 04-R-02, duke zbatuar procedurën e mëtutjeshme të votimit të amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, pa e paragjykuar rezultatin e votimit dhe duke respektuar mandatin e lirë të deputetëve dhe parimet e tjera kushtetuese".*

Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, përcakton:

"Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që presidenti i Republikës se Kosovës të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës për këtë qëllim, ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6-9 muajsh nga data e themelimit".

Vlerësimi i pranueshmërisë

27. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Gjykata i referohet nenit 113.1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës që përcakton:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

29. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

30. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës që parasheh:

(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar".

31. Gjykata duhet së pari të qartësojë çështjen e juridiksionit të saj, përkatësisht të përcaktojë nëse në rastin konkret bëhet fjalë për një procedurë të paraparë me

Kushtetutë dhe nëse kërkesa është dorëzuar nga një subjekt i autorizuar me Kushtetutë për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së çështjes së parashtruar.

32. Numri i subjekteve që mund të kontestojnë veprimet e Kuvendit është i kufizuar në paragrafët 3 dhe 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Neni 113.7 i Kushtetutës, nuk lejon procedurën *actio popularis* (Për shtjellim të mëtejmë të procedurës *actio popularis,* shih rastin nr. KI117/11, *Ridvan Hoxha,* Aktvendim për papranueshmëri i 24 korrikut 2012).

33. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me procedurën *actio popularis* kishte përcaktuar: *"Gjykata po ashtu ka nënvizuar se Konventa nuk parasheh parashtrimin e një actio popularis për interpretimin e të drejtave që ajo i përmban ose t'iu lejojë individëve që të ankohen për ndonjë dispozitë të së drejtës vendore thjeshtë sepse ata konsiderojnë, pa u cenuar drejtpërsëdrejti nga ajo dispozitë, se mund të jetë në kundërshtim me Konventën"* (Shih, *Aksu kundër Turqisë* [Dhoma e Madhe], Aplikacionet nr. 4149/04 dhe nr. 41029/04, Aktgjykim i 15 marsit 2012, paragrafi 50, dhe *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [Dhoma e Madhe], Aplikacioni nr. 13378/05, Aktgjykim i 29 prillit 2008, paragrafi 33).

34. Në këtë aspekt, Gjykata sërish vë në spikamë përmbajtjen e paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 113 të Kushtetutës:

> *"3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:*
>
> *(1)...*
>
> *(2) Përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;*
>
> *(4) Përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur*;
>
> *5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".*

35. Edhe nëse parashtruesi do të ishte palë e autorizuar, Gjykata po ashtu konsideron se ky lëshim nga ana e Kuvendit për ta vënë në votim ose për të mos zbatuar Rezolutën në fjalë zakonisht nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit sepse nuk është *ratione materiae* në përputhje me juridiksionin e saj, veçanërisht duke parë se nuk ka akt konkret dhe procedurë që duhet të ndiqet ashtu siç parashikohet me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

36. Gjykata vëren po ashtu se parashtruesi i kërkesës vetëm ka numëruar dhe ka përshkruar dispozitat kushtetuese dhe ato të instrumenteve të tjera ndërkombëtare përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë, për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për barazi para ligjit, mirëpo nuk ka arritur të arsyetojë se si janë shkelur ato dispozita (Shih rastin nr. KI109/14, *Ahmet Krasniqi dhe të tjerët,* Aktvendim i 20 shkurtit 2015, paragrafët 35 dhe 36).

37. Rrjedhimisht, kërkesa është paraqitur nga pala e paautorizuar dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.1 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe më tej siç specifikohet me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 17 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI148/15, Parashtrues i kërkesës: Xhafer Selmani, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001-C1265, të 11 dhjetorit 2015

KI148/15, aktvendim për papranueshmëri i 9 marsit 2016, i publikuar më 15 prill 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, e drejta në mjete juridike, moshsterimi i mjeteve juridike*
Më 11 dhjetor 2015, Kolegji i Specializuar me Aktvendimin (SCEL- 09-0001- C1265) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme, në lidhje me kërkesën e tij për kthim në gjendje të mëparshme në mënyrë që të realizojë 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes.
Parashtruesi kërkoi nga Gjykata *„...që sipas ligjit në fuqi që të ma paguaj AKP-ja 20 % për aq sa më .. takon [...]”.*

Gjykata më tej konstatoi se paditësi nuk ka vepruar në pajtim me rekomandimin për mjetin juridik, se ai e kishte në dispozicion mjetin juridik në gjykatat e rregullta i cili ishte efektiv, që ishte në dispozicion të parashtruesit dhe me të cilin kishte mundur të korrigjojë shkeljen në lidhje me kundërshtimet e tij, por parashtreusi i kërkesës nuk e ka shteruar këtë mjet efektiv juridik.
Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI148/15
Parashtrues
Xhafer Selmani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001-C1265, të 11 dhjetorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Xhafer Selmani nga fshati Dumnicë e Poshtme, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin SCEL- 09-0001-C1265, të 11 dhjetorit 2015 e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës konsideron se është "*diskriminuar dy herë[...] si nga serbët ashtu edhe nga shqiptarët*". Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur asnjë nen të veçantë të Kushtetutës i cili është shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 dhjetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 16 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të qartësojë nëse ka ushtruar ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave). Gjykata, po ashtu, informoi edhe Kolegjin e Specializuar për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 22 shkurt 2016, parashtruesi iu përgjigj kërkesës së Gjykatës dhe konfirmoi se ai nuk ka paraqitur asnjë ankesë në Kolegjin e Ankesave.

9. Më 9 mars2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatës njëzëri papranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 7 mars 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), e publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga të ardhurat nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku".

11. Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Kolegjin e Specializuar kundër atij vendimi përfundimtar ka skaduar më 27 mars 2009.

12. Më 13 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar duke kërkuar kthimin në gjendje të mëparshme.

13. Më 11 dhjetor 2015, Kolegji i Specializuar me Aktvendimin (SCEL- 09-0001-C1265) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme, sepse sipas nenit 118.2 i Ligjit për procedurën kontestimore 4/77-1478 RSFJ-së (i aplikueshëm në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24) *"... pas skadimit të afatit prej 3 (tre) muaj nga data e përcaktuar, kthimi në gjendje të mëparshme nuk mund të kërkohet".*

14. Për më tepër, Kolegji i Specializuar theksoi se:*"Kundër këtij Aktvendimi mund të paraqitet ankesa brenda 21 ditëve në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme. "[...] Periudha e parashikuar fillon në mesnatë në të njëjtën ditë, kur ankuesi e ka pranuar aktgjykimin me shkrim".*

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës pohon se me Aktvendimin e kontestuar "*është diskriminuar dy herë[...] si nga serbët ashtu edhe nga shqiptarët*", edhe pse nuk ka cekur asnjë dispozitë kushtetuese në të cilën e bazon pretendimin vet.

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*... Nga viti 1979 e deri më 28.02.199 ka qenë në marrëdhënie pune KNI 'Ramiz Sadiku' ... ku na kanë ... larguar nga puna pa*

vullnetin tim [...] Me këtë kanë bërë diskriminim ndaj meje dhe punëtorëve të tjerë shqiptarë. Në vitin 1999 pas lufte [...] unë u lajmërova, por ata nuk më pranuan në punë. Kur u privatizua KNI 'Ramiz Sadiku' nuk më kanë futur në regjistrin e 20% ...".

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

"Unë dëshiroj që sipas ligjit në fuqi që të ma paguaj AKP-ja 20 % për aq sa më takon [...]".

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

20. Gjykata thekson edhe nenin 47.2 të Ligjit, i cili përcakton:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

21. Për më tepër, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës, përcakton:

"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është ankuar as në Vendimin e AKP-së, të 7 marsit 2009, e as në Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar, të 11 dhjetorit 2015, siç është cekur edhe në këshillën për mjetin juridik të aktvendimit të fundit.

23. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përcakton:

"6. Pala ka të drejtë të apelojë ndaj aktgjykimit [...] Kolegjit të specializuar [...] duke parashtruar apelin tek Kolegji i apelit dhe duke dorëzuar atë parashtresë tek palët tjera brenda 21 (njëzetenjë) ditësh [...]. Ky afat fillon të llogaritet prej mesnatës në atë ditë kur [...] Kolegji i Specializuar apo gjykata i ka dorëzuar aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë palëve me shkrim. Kolegji i apelit refuzon apelin nëse pala dështon ta parashtrojë atë brenda periudhës së përcaktuar kohore".

24. Gjykata, më tej, rikujton se parashtruesi para Gjykatës Kushtetuese ka pretenduar diskriminimin ndaj tij. Megjithatë, Gjykata konsideron se diskriminimi i pretenduar do të duhej të ishte ngritur paraprakisht para Kolegjit të Specializuar.

25. Përkitazi me këtë, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit gjyqësor dhe detyra e tyre kushtetuese është që t'i interpretojë

çështjet faktike dhe ligjore të cilat janë të rëndësishme për rastet e parashtruara para tyre.

26. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, si në këtë rast, është që t'u ofrojë gjykatave të rregullta mundësinë për ta korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (Shih Aktvendimi për papranueshmërinë, *AAB-RIINVEST Universiteti LLC, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktvendimi i 28 korrikut 1999).

27. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, qoftë administrative apo gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore (Shih, Aktvendimi në Rastin Kl07/09, *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).

28. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund t'i vlerësoj shkeljet e pretenduara kushtetuese para se t'ua japë mundësinë gjykatave të rregullta për t'i përfunduar procedurat të cilat parashtrohen para tyre.

29. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj si kritere të paraqesë kërkesën e tij, dhe shih për këtë, kërkesa refuzohet si e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit si dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin36 (1) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 9 mars2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI59/15, Parashtruesi i kërkesës: Ljutfi Kačka, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Degës në Dragash, P. nr. 78/12, të 25 qershorit 2013.

KI 59/15, Aktvendim për papranueshmëri i 15 marsit 2016, i publikuar më 15 prill 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, mbrojtja e pronës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mosshterimi i mjeteve juridike.*

Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Themelore i ka shkelur të drejtën për ankesë, për arsye se kjo Gjykatë nuk i kishte dorëzuar edhe atij një kopje të Aktgjykimit. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se Aktgjykimi i lartpërmendur i ishte dorëzuar vetëm avokatit të tij, i cili nuk e kishte njoftuar me kohë atë për Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe si rezultat i dështimit të tij për të paraqitur ankesë me kohë, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore kishe marrë formën e prerë.
Gjykata iu referua praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka konstatuar që *"shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për gabimet e avokatit të caktuar për ndihmë juridike apo të zgjedhur nga i akuzuari".*
Gjykata konkludoi që kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore nuk është paraqitur ankesë, dhe për këtë arsye Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parashikuara me ligj.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI59/15
Parashtrues
Ljutfi Kačka
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 78/12, të 25 qershorit 2013
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu- Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ljutfi Kačka nga fshati Restelicë, komuna e Dragashit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson z. Rexhep Kabashi, avokat në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuarështë Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), P. nr. 78/12, i 25 qershorit 2013.

3. Parashtruesi i kërkesësAktgjykimin e kontestuar e ka pranuar në një datë të pasaktësuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, për të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 maj 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI59/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI59/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 14 gusht 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore.

9. Më 18 gusht 2015, parashtruesi i dërgoi Gjykatës dokumente shtesë.

10. Më 1 shtator 2015, parashtruesi sërish i dërgoi Gjykatës dokumente shtesë.

11. Më 15 mars 2016, Kolegjishqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 25 qershor 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi P. nr. 78/12) në kuadër të procedurës kontestimore miratoi kërkesëpadinë e tre paditësve dhe vërtetoi që të njëjtit ishin bashkëpronarë të një patundshmërie në fshatin Restelicë.

13. Përmes këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës i cili në këtë procedurë ishte në cilësinë e të padituri, ishte obliguar që paditësve t'ua njohë të drejtën e pronësisë.

14. Parashtruesi i kërkesës kishte autorizuar një avokat që ta përfaqësojë atë gjatë procedurave pranë Gjykatës Themelore dhe gjykatave tjera.

15. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (Aktgjykimi, P. nr.78/12, i 25 qershorit 2013), parashtruesi nuk kishte ushtruar ankesë. Si rrjedhojë, Aktgjykimi kishte marrë formën e prerë.

16. Në bazë të shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës në një datë të pasaktësuar kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

17. Më 8 gusht 2014, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (Njoftimi KMLC. nr. 70/14) përmes avokatit të tij e kishte njoftuar parashtruesin, që nuk kishte gjetur bazë ligjore për parashtrim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren.

18. Më 23 janar 2015, parashtruesi kundër avokatit të lartpërmendur kishte parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore te Prokurori Disiplinor pranë Odës së Avokatëve.

19. Më 23 janar 2015, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit sërish parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi pohoi se avokati i tij, të cilin e kishte autorizuar për ta përfaqësuar atë në çështjen e lartpërmendur kontestimore, e kishte humbur afatin për parashtrimin e kërkesës.

20. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, parashtruesi kërkoi që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Përveç kësaj, parashtruesi në kërkesën e tij pohon se atij i është mohuar e drejta për gjykim të drejtë pasi që avokati i autorizuar nga ai kishte humbur afatin për ankesë dhe si rrjedhojë, e kishte humbur të drejtën e pronës.

21. Më 28 janar 2015, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (Njoftimi KMLC Nr. 70/14) e njoftoi parashtruesin që *"[...] ka lexuar me vëmendje edhe këtë parashtresë tjetër (që konsiderohet si propozim për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë) dhe në fund ka vërtetuar se nuk ka bazë ligjore që kundër aktgjykimit të lartpërmendur të paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në këtë drejtim ka mbetur plotësisht pranë aktit të kësaj Zyre KMLC. nr. 70/14 më 05.08.2014"*.

22. Më 28 maj 2015, Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës përmes Vendimit, R. DK-nr. 17-3/15 avokatin e lartpërmendur e shpalli përgjegjës për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës së tij si avokat dhe e dënoi atë me një gjobë të caktuar monetare.

23. Në bazë të shkresave të lëndës, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, më 18 gusht 2015, Prokuroria Themelore në Prizren kundër të njëjtit avokat ngriti aktakuzë me arsyen se avokati gjatë ushtrimit të detyrës së tij si përfaqësues i autorizuar, duke mos ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore nuk i kishte përmbushur detyrat e tij zyrtare, dhe si rrjedhojë, me qëllim i kishte shkelur të drejtat e personit tjetër.

Pretendimet e parashtruesit

24. Ashtu siç u përmend më lart, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se Gjykata Themelore në Prizren kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë, të drejtën e tij për mjete juridike dhe të drejtën e tij në pronë të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ.

25. Parashtruesi, më tej, pretendon shkeljen e të drejtës për ankim nga ana e Gjykatës Themelore për arsye se kjo Gjykatë nuk i kishte dorëzuar personalisht atij një kopje të Aktgjykimit të kontestuar.

26. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të 25 qershorit 2013 dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrtonnëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

29. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Më tutje, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë vetëm nëse:*
>
> *[...] (b) janështeruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".*

31. Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është vendim i shkallës së parë në procedurë pranëGjykatës Themelore dhe se ndaj të njëjtit ishte e lejuar ankesa, e cila do të shqyrtohej nga Gjykata e Apelit.

32. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore nuk është paraqitur ankesë.

33. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Themelore i ka shkelur të drejtën për ankesë, për arsye se kjo Gjykatë nuk i kishte dorëzuar edhe atij një kopje të Aktgjykimit. Parashtruesi më tej pohon, se Aktgjykimi i lartpërmendur i ishte dorëzuar vetëm avokatit të tij, i cili nuk e kishte njoftuar me kohë atë për Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe si rezultat i dështimit të tij për të paraqitur ankesë me kohë, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore kishte marrë formën e prerë.

34. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte autorizuar avokatin e lartpërmendur që ta përfaqësojë atë gjatë procedurave pranë Gjykatës Themelore dhe gjykatave tjera. Gjykata konsideron që veprimet procedurale të ndërmarra nga përfaqësuesi juridik i palës, sipas autorizimit konsiderohen të jenë veprime të vetë palës. Në këtë rast, veprimet e tilla përfshijnë edhe pranimin e vendimeve gjyqësore (Shih rastet KI46/13, KI47/13, KI48/13 dhe KI68/13, Parashtrues *Naim Morina, Bukurije Drançolli, Avdi Imeri dhe Genc Shala*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 5 korrikut 2013).

35. Për më tepër, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka konstatuar që "*shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës*

për gabimet e avokatit të caktuar për ndihmë juridike apo të zgjedhur nga i akuzuari" (Shih *Kamasinski kundër Austrisë*, Nr. 9783/82, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1989, A. nr. 168). Në mënyrë analoge, Gjykata konsideron që autoritetet publike nuk mund të mbahen përgjegjëse për veprimet e avokatit, aq më tepër në rastin kur avokati është autorizuar nga vetë pala, në këtë rast parashtruesi.

36. Prandaj, bazuarnëfaktin që kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore nuk është paraqitur ankesë, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive.

37. Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që, para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit duhet t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, apo të korrigjojnë shkeljet eventuale të garantuara me Kushtetutë. Rregulli bazohet në supozimin, se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive ligjore kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Selmouni kundër Francës*, GJEDNJ, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999;dhe Rastin KI06/10, parashtrues i kërkesës *Valon Bislimi*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 30 tetorit 2010).

38. Rrjedhimisht, Gjykatakonsideron se kërkesa e parashtruesit është epapranueshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI 17/16, Parashtrues i kërkesës, Holding Company Inex Interexport a.d. - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit final të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 10/50, të 23 shtatorit 2015, dhe Vendimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 06/195, të 3 shtatorit 2014

KI 17/16, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2016, i publikuar më 15 prill 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, mosshterimi i mjeteve, e drejta për gjykim të drejtë, masë e përkohshme*

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të lartcekura. Qeveria e Republikës së Kosovës nxori vendimet e kontestuara me të cilat miratoi shpronësimin e pronave të paluajtshme nga pronarët e zonave të caktuara me qëllim të ndërtimit të qendrës turistike në Brezovicë.

Parashtruesi i kërkesës pastaj e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes vendimeve të saj, kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të suspendojë efektet juridike të vendimit paraprak dhe final të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të papranueshme sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte shteruar asnjë nga mjetet juridike në dispozicion. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi nuk e kishte apeluar as vendimin paraprak dhe as vendimin final të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkundër faktit se të dyja këto vendime mund të ishin apeluar sipas ligjit në fuqi dhe udhëzimeve për të drejtën e ankimit të dhënë në të dyja vendimet.

Duke pasur parasysh se parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata Kushtetuese gjithashtu e refuzoi edhe kërkesën e tij për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PA PAPRANUESHMËRI
në
Rastin KI17/16
Parashtrues
Holding Company Fond Inex Interexport a.d.
Vlerësim i kushtetushmërisë së Vendimit final të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 10/50, të 23 shtatorit 2015,
dhe
Vendimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 06/195, të 3 shtatorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Holding Company Fond Inex Interexport a.d. me seli në Beograd, Serbi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi). Parashtruesi përfaqësohet nga z. Marko Ketler, avokat nga Lubjana, Slloveni. Ky i fundit ka autorizuar 9 (nëntë) avokatë tjerë ta zëvendësojnë atë, përkatësisht z. Dragan Karanović, z. Dejan Nikolić, z. Milan Lazić, z. Nemanja Ilić, z. Senka Mihaj, z. Marko Milanović, z. Ognjen Bozović dhe znj. Milica Savić, nga Beogradi, Serbi dhe z. Veton Qoku, avokat nga Shkupi, Maqedoni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin final të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 10/50, të 23 shtatorit 2015 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi final) dhe Vendimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 06/195, të 3 shtatorit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi paraprak). Të dyja vendimet kanë të bëjnë me procedurën e shpronësimit me qëllim të ndërtimit të qendrës turistike në Brezovicë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Gjithashtu, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, konkretisht që "*të pezulloj efektin ligjor të vendimit paraprak dhe përfundimtar, deri me datën e dhënies së vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe të rregullit 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën nëpërmjet postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 19 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria).

9. Më 17 mars 2016, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme dhe të refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 3 shtator 2014, Qeveria lëshoi Vendimin paraprak duke miratuar shpronësimin e pronës së paluajtshme nga pronarët e përmendur në tabelat bashkëngjitur Vendimit paraprak. Vendimi paraprak thotë:

> *"1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i qendrës turistike Brezovica; [...]*
> *5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente".*

11. Parashtruesi nuk ka treguar se është ankuar ndaj Vendimit paraprak të Qeverisë.

12. Më 23 shtator 2015, Qeveria ka nxjerrë Vendimin final, për miratimin e shpronësimit të pronës së paluajtshme të paraqitur në tabelë. Vendimi përfundimtar thotë:

> *"[...] 4. Pjesa integrale e këtij vendimi është akt i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.*
> *5. Kundër këtij vendimi subjekti ka të drejtë ankese brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike ndaj gjykatës kompetente, vetëm për të kundërshtuar shumën e kompensimit të përcaktuara në këtë vendim [...]".*

13. Parashtruesi nuk ka treguar se është ankuar ndaj Vendimit final të Qeverisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi pretendon se vendimet e kontestuara të Qeverisë i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

15. Në përgjithësi, parashtruesi pretendon se Vendimi paraprak dhe ai final i Qeverisë janë "*të paligjshëm*" duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat e parashikuara me nenin 4 të Ligjit për Shpronësim dhe se Qeveria ka dështuar të shpjegojë se si ka konsideruar që ato kritere janë plotësuar.

16. Parashtruesi, gjithashtu, pretendon se vendimet e kontestuara janë "*një shembull i qartë i diskriminimit mbi bazën kombëtaredhe se seqëllimi kryesor i shpronësimit është diskriminimi i shtetasve dhe kompanive serbe"*.Si rezultat, parashtruesi pretendon se Qeveria i ka shkelur të drejtën për barazi, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.

17. Parashtruesi, më tej, pretendon se Qeveria ka dështuar të informojë parashtruesin dhe pronarët e tjerë për sa i përket qëllimit për shpronësim. Si rezultat, parashtruesi pretendon se Qeveria i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

18. Për më tepër, parashtruesi pretendon se nuk ka pasur *"mjete tjera juridike në dispozicion për kontestimin e ligjshmërisë dhe legjitimitetit të shpronësimit"* sepse "*një pjesë e pronës së tij [...] nuk ishte përfshirë në Vendimin paraprak (edhe pse ajo pjesë është përfshirë në Vendimin final)"*.Si rezultat, parashtruesi pretendon se Qeveria i ka shkelur të drejtën për mjete juridike, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës.

19. Parashtruesi ende pretendon se në lidhje me të drejtën e tij për mjete juridike, Qeveria ka shkelur të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës "*duke e privuar e drejta e tij për kontestimin e ligjshmërisë së shpronësimit"*.

20. Përfundimisht, parashtruesi pretendon se Qeveria "*i ka shkelur rregullat e procedurës së shpronësimit, duke e privuar arbitrarisht* [Parashtruesin] *nga prona e tij"*. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se Qeveria dështoi ta identifikonte atë "*si pronarin e pronës së shpronësuar*".Si rezultat, parashtruesi pretendon se Qeveria ia ka shkelur të drejtën e mbrojtjes së pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

21. Gjithashtu, parashtruesikërkon nga Gjykata "*vendosjen e masave të përkohshme me qëllim të suspendimit të efekteve juridike të Vendimit Paraprak dhe Final deri në ditën e marrjes së aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese*".

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata rikujton se parashtruesi konteston Vendimin paraprak (Nr. 06/195, të 3 shtatorit 2014) dhe Vendimin final (Nr. 10/50, të 23 shtatorit 2015) të Qeverisë që ka vendosur të shpronësojë një numër të pronave të paluajtshme për qëllim të ndërtimit të qendrës turistike në Brezovicë.

23. Parashtruesi pretendon se Qeveria i ka shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, mbrojtje ndaj diskriminimit; për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; për mjet efektiv juridik; për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe mbrojtje të pronës të garantuara me Kushtetutë.

24. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 7 të nenit 113. [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

26. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

4."[...] Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që ai/ajo të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

27. Për më tepër, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar [...]".

28. Gjykata vëren se parashtruesi nuk apeloi Vendimin paraprak e as nuk e ka apeluar Vendimin final të Qeverisë, edhe pse të dyja këto vendime mund të ishin apeluar sipas ligjit në fuqi dhe udhëzimet për të drejtën e ankimit të dhënë në të dyja vendimet.

29. Më konkretisht, Gjykata vëren se Vendimi paraprak do të mund të apelohej nga parashtruesi në lidhje me "*legjitimitetin e shpronësimit të propozuar"*, e cila është kryesisht ajo që parashtruesi pretendon për herë të parë para Gjykatës Kushtetuese. Vendimi paraprak parashihte 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për *"pronarët apo bartës të interesit"* të sfidojnë vendimin në tërësi apo ndonjë pjesë të tij.

30. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi, qoftë si pronar apo si bartës i interesit, mund të kishte ngritur para Gjykatës Supreme pretendimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese; por ai nuk ka përfituar nga ai mjet juridik i parashikuar me ligj.Edhe nëse parashtruesi nuk ishte i njohur si "*pronar*" i pasurive të caktuara të cilat pohon të jenë pronë e tij, ai ka mundur t'i ketë ngritur këto argumente si një "*bartës i një interesi"*, duke pasur parasysh se ligji ka parashikuar një mundësi të tillë.

31. Në fakt, Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se disa nga pronat e tij ishin pjesë e Vendimit final pa qenë pjesë e Vendimit paraprak. Për këtë arsye, parashtruesi ankohet se i është mohuar një mjet efektiv juridik dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave.

32. Për më tepër, Gjykata vëren se Vendimi final po ashtu mund të ishte ankimuar nga parashtruesi. Në mënyrë të ngjashme, Vendimi Final siguronte edhe 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për ankesat që do të paraqiteshin ndërsa kufizonte fushëveprimin e ankesës vetëm për sa i përket kompensimit në lidhje me pronën e paluajtshme e cila

do të shpronësohej. Megjithatë, pavarësisht këtij kufizimi, parashtruesi ka mundur të ngrejë para Gjykatës Supreme pretendimet e tij për shkelje të së drejtës së tij për mjet efektiv ligjor dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave duke siguruar kështu respektimin e parimit të subsidiaritetit dhe duke i dhënë mundësinë Gjykatës Supreme që të korrigjojë shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Parashtruesi nuk e ka shfrytëzuar as këtë mjet juridik.

33. Gjykata vëren se faktet e përshkruara më lart tregojnë se pavarësisht nga mundësitë e paraqitura nga ligji në fuqi, parashtruesi nuk ka shfrytëzuar asnjë nga mundësitë e dhëna për të sfiduar legjitimitetin e shpronësimit para Gjykatës Supreme, si një pronar të pretenduar ose si bartës i një interesi. Parashtruesi është duke ngritur këto pretendime për herë të parë para Gjykatës Kushtetuese, pa shteruar asnjë nga mjetet juridike në dispozicion.

34. Gjykata rikujton se parashtruesi nuk ka treguar të ketë apeluar Vendimin Final apo atë Paraprak të Qeverisë. Megjithatë, parashtruesi pretendon që e drejta e tij për një mjet efektiv juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tij është shkelur, pa bërë fare përpjekje që të ngrejë këto shkelje të pretenduara kushtetuese para Gjykatës Supreme, e cila ka juridiksion ekskluziv për të shqyrtuar procedurat e shpronësimit në rastet kur Qeveria është organ shpronësues.

35. Gjykata përsërit se mund të vendosë për pranueshmërinë e një kërkese, vetëm nëse parashtruesi tregon se i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

36. Më tej, Gjykata, vëren se mjeti juridik i cili është në dispozicion sipas ligjit në fuqi nuk mund të konsiderohet jo efektiv, nëse parashtruesi as nuk është përpjekur për ta shteruar atë dhe për të parë nëse ai jep ndonjë rezultat.

37. Gjykata rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e një të drejtave të tilla themelore.

38. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që t'u ofrojë gjykatave të rregullta, në këtë rast Gjykatës Supreme, mundësinë për ta korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih Aktvendimin për papranueshmërisë: AAB-RIINVEST *Universiteti LLC, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010 dhe shih *mutatis mutandis,* ECHR, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimit të 28 korrikut 1999).

39. Në fakt, si rregull i përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese do të ndërhyjë vetëm kur ka shkelje në interpretim të Kushtetutës, ose kur ligjet nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, por vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

40. Prandaj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47. (2) të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

41. Gjykata kujton se parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë efektin ligjor të vendimeve të kontestuara, deri sa Gjykata Kushtetuese të merr një vendim në lidhje me këtë kërkesë.

42. Parashtruesi pretendon se miratimi i Masës së përkohshme do të ishte në interes të publikut pasi që "*shpronësimi ilegal nga Qeveria e Kosovës kërcënon zbatimin e ligjit, të drejtat e minoriteteve etnike, dhe stabilitetin ekonomik dhe social*".

43. Në mënyrë që Gjykata të vendosë për Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) a) dhe (5) të Rregullores së punës, është e nevojshme që:

> *"4. [...]*
> *(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
> *[...]*
> *5. Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

44. Siç është përmendur më lart, parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, dhe rregullat 36 (1) (b), 55 (4) a) dhe (5), dhe 56 (3) dhe (5) të Rregullores së punës, më 17 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJ kërkesën për Masën e përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI40/15, Parashtrues i kërkesës, Fatlume Meta - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, P. nr. 35/10, të 4 prillit 2011

KI 40/15, Aktvendim për papranueshmëri i 6 korrikut 2015, i publikuar më 19 prill 2016
Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë jo e plotë, refuzim me procedurë të shkurtër, masë e përkohshme*

Parashtruesja e kërkesës ishte shpallur fajtore për vepër penale dhe ishte dënuar me 1 (një) vit burgim. Më vonë, Gjykata Komunale në Prishtinë (ED. nr. 51/2012) nxori një urdhër, me të cilin ishte kërkuar nga parashtruesja e kërkesës që të fillojë vuajtjen e dënimit me burgim. Pas këtij urdhri, parashtruesja e kërkesës u dërgoi letra Gjykatës Komunale në Prishtinë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar që t'i shtyhet vuajtja e dënimit me burgim.

Parashtruesja parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit dhe kërkoi nga Gjykata të nxjerrë vendim për masë të përkohshme. Parashtruesja e kërkesës nuk e ka dorëzuar vendimin e kontestuar dhe as nuk i ishte referuar ndonjë të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutë. Në vend të kësaj, ajo pohoi se ka pasur shkelje të nenit 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, sepse kërkesa e saj për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim nuk ishte miratuar.

Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën me procedurë të shkurtër, sepse parashtruesja e kërkesës nuk e kishte kompletuar kërkesën e saj. Ajo nuk kishte dorëzuar asnjë nga vendimet e gjykatave të rregullta dhe as nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi apo dokumente mbështetëse, edhe pasi që Gjykata Kushtetuese kërkoi nga ajo që ta plotësojë kërkesën. Duke pasur parasysh se parashtruesja e kërkesës nuk kishte treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata Kushtetuese e refuzoi edhe kërkesën e saj për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI40/15
Parashtrues
Fatlume Meta
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
P. nr. 35/10, të 4 prillit 2011
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Fatlume Meta nga Magura, komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga z. Safet Krasniqi gjithashtu nga Magura, komuna e Lipjanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (P. nr. 35/10, të 4 prillit 2011),të cilin ajo nuk e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Ajo pohon se Aktgjykimin e ka pranuar, më 12 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 20 [Shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim afatgjatë] të Ligjit, Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale).

4. Parashtruesja e kërkesës nuk i referohet ndonjë të drejte dhe lirie të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) që mund të jetë shkelur.

5. Parashtruesja e kërkesësgjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht ta shtyjë vuajtjen e dënimit me burg.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 27 dhe 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)dhe në rregullat 54,

55 dhe56tëRregullores së punës të GjykatësKushtetuese të RepublikëssëKosovës(në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 mars 2015, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 2 prill 2015, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi autorizimin për avokatin z. Safet Krasniqi, me të cilin e autorizoi atë që ta përfaqësojë në Gjykatë. Të njëjtën ditë, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një letër shtesë, me të cilën kërkoi nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme.

9. Më 4 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI40/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI40/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama Hajrizi.

10. Më 10 prill 2015, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një letër tjetër në Gjykatë duke kërkuar nga kjo e fundit *"[...] ta shtyjë vuajtjen e dënimit me burg, t'i shqiptojë dënim më të butë, apo ta zëvendësojë atë me dënim me kusht"*.

11. Më 14 prill 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ajo të dorëzojë vendimin e kontestuar dhe dokumentet e tjera relevante në Gjykatë.

12. Më 14 maj 2015, Gjykata i dërgoi një tjetër shkresë parashtrueses së kërkesës, me të cilën e informoi atë se në rast se ajo nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kësaj shkrese, Gjykata do të vazhdojë procedurën në bazë të shkresave ekzistuese të lëndës.

13. Më 1 qershor 2015, parashtruesja e kërkesës iu përgjigj shkresës së Gjykatës mirëpo nuk dorëzoi dokumentet e kërkuara. Në vend të tyre, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një raport shëndetësor të fëmijës së saj.

14. Në mënyrë që të vërtetohen pretendimet e parashtrueses lidhur me datën e dorëzimit të vendimit të kontestuar, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të paraqesë prova se kur gjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses.

15. Gjykata Themelore në Prishtinë është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës, mirëpo nuk dërgoi dokumentacionin e kërkuar por vetëm fletëkthesën e një vendimi tjetër të cilin nuk e konteston parashtruesja dhe, i cili nuk ekziston në shkresat e lëndës.

16. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Parashtruesja e kërkesës ishte akuzuar për vepër penale, ishte shpallur fajtore dhe ishte dënuar me 1 (një) vit burgim.

18. Më 12 mars 2015, GjykataKomunale në Prishtinë (ED. nr. 51/2012) nxori një urdhër, me të cilin ishte kërkuar nga parashtruesja e kërkesës që të fillojë vuajtjen e dënimit me burgim.

19. Më 20 mars 2015, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një letër Gjykatës Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkoi që t'ia shtyjë vuajtjen e dënimit me burgim.

20. Më 23 mars 2015, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një letër tjetër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar që t'i shtyhet vuajtja e dënimit me burgim, për një kohë të pacaktuar.

21. Më 26 mars 2015, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një letër të ngjashme Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së burgjeve, me të njëjtën kërkesë, përkatësisht që *"t'ia shtyjë vuajtjen e dënimit të saj me burgim deri në rritjen e fëmijës së saj."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës nuk i referohet ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë e cila mund t'i jetë shkelur. Ajo vetëm pretendon se ka pasur shkelje të nenit 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

23. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës pohon se Gjykata Komunale në Prishtinë i ka shkelur kërkesat procedurale të parashikuara me nenin 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, sepse kjo e fundit parasheh që *"shtyrja e dënimit duhet të bëhet deri sa fëmija të arrijë moshën 3 vjeçare dhe fëmija im [...] është vetëm 2 vjeç"*.

24. Në fund, parashtruesjae kërkesës konkludon duke kërkuar nga Gjykata si në vijim:

"[...] të më mundësohet pezullimi i dënimit për një kohë deri sa fëmija të bëjë një moshë më të madhe [...] por edhe fëmijët tjerë".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëseparashtruesja e kërkesësi kapërmbushurkushtet epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë mënyrë, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesës]

"4. Nëse kërkesa...nuk është ... e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, [...]".

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar [...]".

27. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

> *"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*
> *[...]*
> *(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës".*
>
> *"(5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën [...]."*

28. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, sepse ata nuk e kanë miratuar kërkesën e saj për të shtyrë vuajtjen e dënimit me burgim.

29. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesja e kërkesës nuk ka pretenduar asnjë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të cilat mund të jenë shkelur.

30. Në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës të dorëzojë vendimin e kontestuar dhe vendimet tjera të gjykatave të rregullta.

31. Megjithatë, brenda afatit të caktuar, Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta.

32. Gjykata konsideron se nuk mund të marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës pa dokumente mbështetëse dhe prova materiale, në pajtim me nenin 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

33. Gjykata më tej konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar një rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e të gjitha kërkesave procedurale për pranueshmëri.

34. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e përgjegjësisë mbi parashtruesen e kërkesës, që nuk ka arritur të përmbushë kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbushë kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejmë, për shkak të mos kompletimit të kërkesës me dokumentacion relevant, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.

36. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe prandaj është e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

37. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht *"t'ia shtyjë vuajtjen e dënimit të saj me burgim deri sa fëmijët e saj të rriten në moshë".*

38. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar vendimin e kontestuar ose ndonjë vendim tjetër të gjykatave të rregullta dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se, pse Masa e përkohshme duhet të aprovohet.

39. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të zbatohet pasi ajo nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligj dhe me Rregullore të punës.

40. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, nevojitet që:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; ose*
> *(...)*
>
> *Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës."*

41. Siç u konkludua më lart, kërkesa e parashtrueses është e papranueshme, dhe prandaj, nuk ka rast*prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 27 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 29 (2) (h), 32 (5), 55 (4) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI163/15, Parashtruese Božidarka Banović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3575/13, të 19 tetorit 2015

KI163/15 Aktvendim për papranueshmëri miratuar më 9 mars 2016 dhe publikuar më 25 prill 2016.

Fjalët kyç*: Kërkesë individuale, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Mbrojtja e Pronës, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesja kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 19 tetorit 2015, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Kosovës, për shkak se Gjykata nuk ka siguruar mbrojtje të barabartë të së drejtës pronësore të parashtrueses, ngase nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet sipas ligjit në fuqi dhe si rrjedhojë e kësaj kërkon anulimin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit.
Gjykata konsideroi se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e saj, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i shkelë të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ-në. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI163/15
Parashtrues
Božidarka Banović
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3575/13, të 19 tetorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesja e kërkesës është znj. Božidarka Banović nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga z. Naser Peci, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3575/13, të 19 tetorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 19 tetorit 2015, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 dhjetor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI163/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI163/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 8 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 9 mars2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesja e kërkesës dhe M. A. janë bashkëpronarë të pasurisë në përbërje prej ngastrës kadastrale nr. 4368/2, në sipërfaqe prej 04.74 ha, objektit të përbashkët të banimit i cili është ndërtuar në ngastrën kadastrale të lartpërmendur, me etazhitet P + 2 + NK, si dhe garazhit.

10. Më 27 qershor 2011, parashtruesja e kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore në Prishtinë propozimin e saj, me të cilin ka kërkuar që të bëhet ndarja dhe shfrytëzimi i pasurisë së përbashkët me bashkëpronarin M. A.

11. Më 4 shtator 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [N. nr. 185/2011], me të cilin përcaktoi që pasuria e përbashkët e bashkëpronarëve të ndahet si në vijim: "*Parashtruesja do të këtë në shfrytëzim katin përdhes dhe katin e I-rë, të shtëpisë dhe do të shfrytëzojë ngastër kadastrale nr. 4368/2 pjesën nga rruga kryesore. Bashkëpronari i dytë M. A., do të këtë në shfrytëzim katin II-të dhe nënkulmin e shtëpisë dhe do të shfrytëzoj ngastrën kadastrale nr. 4368/2 pjesën nga ana perëndimore, dhe garazhës nga pjesa perëndimore e ngastrës".*

12. Në përfundimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore theksohet: "*Gjykata duke pas për bazë deklarimin e të autorizuarit të propozueses dhe të autorizuarittë kundër propozuesit, skicat dhe mendimet e ekspertit të ndërtimtarisë dhe të gjeodezisë, dhe duke pas kujdes për interesat e veçanta dhe të përbashkëta të palëve vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi ...".*

13. Të dy bashkëpronarët e pasurisë paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore përmes përfaqësuesve të tyre, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje thelbësore të procedurës jokontestimore.

14. Më 19 tetor 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [Ac. nr. 3575/2013], me të cilin i refuzoi si të pabazuara ankesat e të autorizuarit të propozueses dhe të autorizuarit të kundër propozuesit dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [N. nr. 185/2011] të 4 shtatorit 2013.

15. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit theksohet: "*Gjykata e Apelit, vlerësoi pretendimet ankimore të të autorizuarit të propozueses dhe të autorizuarit të kundër propozuesit, dhe gjeti se janë të pabazuara për faktin se gjykata e shkallës*

së parë në qoftë se personat e interesuar nuk merren vesh, merr provat e nevojshme dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedurës e nxjerrë aktvendimin me të cilën rregullon mënyrën e administrimit dhe shfrytëzimit të sendit të përbashkët, duke pasur kujdes për interesat e tyre të veçanta dhe të përbashkëta e në kuptim të nenit 191. 1 të Ligjit të procedurës jo kontestimore"(në tekstin e mëtejmë: LPJ).

Ligji përkatës

Ligji Nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore

Neni 193

"193.1 Në qoftë se personat e interesuar nuk merren vesh, gjykata i merr provat e nevojshme dhe në bazë të rezultatit të të gjithë procedurës e nxjerrë aktvendimin me të cilin do të rregullojë mënyrën e administrimit dhe shfrytëzimit të sendit të përbashkët sipas dispozitave përkatëse të së drejtës materiale, duke pasur kujdes për interesat e tyre të veçanta dhe të përbashkëta.

193.2 Në qoftë se me anë të propozimit kërkohet rregullimi i shfrytëzimit të banesës së përbashkët ose të lokaleve afariste, gjykata posaçërisht do të rregullojë se cilat hapësira personat e interesuar do t'i shfrytëzojnë veçanërisht e cilat bashkërisht, dhe si do të paguhen shpenzimet e shfrytëzimit të hapësirave".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesja në kërkesë theksoi: "*Propozuesi konsideron se është shkelur e drejta në Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm (neni 31) dhe e Drejta e Pronës (neni 46), ngase Gjykata nuk ka siguruar mbrojtje të barabartë të të drejtës pronësore të propozueses, ngase nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet sipas nenit 193 të LPJK".*

17. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesë: "*Të anulohet AktvendimiAc. nr. 3575/12 i 19.10. 2015".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, parashikon:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

20. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit përcakton:

„*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

22. Gjykata duke analizuar pretendimet e parashtrueses për sa i përket shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), vërejti se parashtruesja ankesën e saj kushtetuese e ndërtoi mbi pretendimet "*se ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, sepse gjykatat e rregullta kanë marrë aktvendime në kundërshtim me dispozitën e nenit 193 të LPJ, pasi nuk i kanë vlerësuar të gjitha rrethanat, faktet dhe provat".*

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se me të njëjtat pretendime ankimore të parashtrueses është marrë edhe Gjykata e Apelit në aktvendimin e kontestuar, me ç'rast dha përgjigje konkrete dhe të qartë: "*Me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe kjo gjykatë në tërësi e pranon, kjo për faktin se propozuesja dhe kundër propozuesi janë bashkëpronar të ngastrës lëndore dhe se eksperti i ndërtimtarisë ka dhënë ekspertizën e tij lidhur me funksionalizimin sa më të mirë të shtëpisë ... "[...] andaj duke marr për bazë edhe ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë lidhur me gjendjen faktike në teren dhe duke marrë për bazë interesat e veçanta dhe të përbashkëta të palëve edhe kjo gjykatë konsideron se drejt është vendosur...".*

24. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës që gjykatat e rregullta nuk i kanë vlerësuar të gjitha provat, Gjykata rikujton se vlerësimi i provave është autorizim i përcaktuar me ligj të cilin e kanë ato, me detyrim që këtë vlerësim ta arsyetojnë në mënyrë të rregullt dhe të qartë. Gjykata Kushtetuese vlerëson se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit përmban të gjitha arsyet e nevojshme mbi të cilin është bazuar në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

25. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka dhënë shpjegim konkret për aplikimin e dispozitës përkatëse ligjore të nenit 193 LPJ, me aplikimin e së cilës, sipas pretendimeve të parashtrueses, ka pasur shkelje.

> *"... Në qoftë se personat e interesuar nuk merren vesh, gjykata i merr provat e nevojshme dhe në bazë të rezultatit të të gjithë procedurës e nxjerrë aktvendimin me të cilin do të rregullojë mënyrën e administrimit dhe shfrytëzimit të sendit të përbashkët sipas dispozitave përkatëse të së drejtës materiale, duke pasur kujdes për interesat e tyre të veçanta dhe të përbashkëta...".*

26. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës në tërësi (Gjykata Evropiane për të

Drejtat e Njeriut, *Barbera dhe Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, ankesat nr. 10588/83, 10589/83, 10590/83, paragrafi 68). E meta në një fazë të procedurës, duke përfshirë dyshimin për vlerësim të gabuar të provave dhe zbatimit të drejtës materiale, pala mund të kundërshtojë në pjesën e dytë, në fazën e ardhshme të procedurës, gjë që parashtruesja e bëri kur e kontestoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.

27. Duke vlerësuar arsyet e ankesës kushtetuese në lidhje me shkeljen e të drejtave sipas nenit 46 të Kushtetutës, përkatësisht nenit 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së, Gjykata i konsideron të pabazuara. Fakti i thjeshtë se ndarja e pronësisë së përbashkët nuk është bërë në përputhje me pritjet e parashtrueses të cilat i ka përmendur në propozimin e paraqitur në Gjykatën Themelore dhe që ajo i konsideron legjitime, vetvetiu nuk përbën bazë të vlefshme e cila do të justifikon pretendimet për shkelje.

28. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në bazë të nenit 1 të Protokollit 1, mbrohet vetëm pasuria ekzistuese, por jo edhe e drejta për fitimin e pronës në të ardhmen. Pritja legjitime në çdo "pronë", "asete" ose "kompensim", sipas kësaj pikëpamjeje duhet të jetë e bazuar në dispozitë ligjore apo akt ligjor, e cila ka bazë të vlefshme ligjore dhe ka ndikim në të drejtat pronësore (*Peter Gratzinger dhe Eva Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, Vendimi i Gjykatës Evropiane të 10 korrikut 2002, nr. 39794/98, paragrafi 69).

29. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtrueses me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

30. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e saj, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ-në (Shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013 të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

31. Gjykata, më tej, rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih Rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

32. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesja nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i shkel të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ-në.

33. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me rregullin36 (1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 9 mars2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI134/15, Parashtrues Ibrahim Alabaki, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit GSK-KPA-A-229/2013, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 29 shtatorit 2015

KI134/15 Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 16 mars 2016 dhe i publikuar më 25 prill 2016

Fjalët kyç*: Kërkesë individuale, e drejta e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar*.

Me Vendimin, KPCC/D/R/197/2013, u shpreh se R. I. ka verifikuar të drejtën e saj pronësore në lidhje me pronën e kontestuar dhe që R. I. gëzon të drejtën e posedimit të pronës në fjalë dhe, që kushdo që ka uzurpuar pronën duhet ta lirojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit.

Parashtruesi i kërkesës nuk u pajtua më vendimin e AKP-së dhe vendosi që ta apeloj vendimin më anë të ankesës tek Kolegji i Apelit. Parashtruesi, ndër të tjera, pretendonte se ka të drejtat ligjore mbi pronën e kontestuar dhe se ka mbështetur pretendimet e tij, duke ofruar *inter alia* deklaratat më shkrim nga palët e treta duke dëshmuar se R. I., ia ka shitur pronën parashtruesit në qershor të vitit 1999 dhe një faturë për pagimin e tatimeve në pronë. Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin, GSK-KPA-A-229/2013, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe mbështeti vendimin e KKPK-së me anë të të cilit nuk i jep të drejtë pretendimit të parashtruesit se ka të drejta ligjore mbi pronën e kontestuar, për shkak se parashtruesi nuk kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të vlefshme, për të dëshmuar pronësinë mbi pronën e kontestuar.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se Kolegji i Apelit iu ka përgjigjur të gjitha pretendimeve kryesore të paraqitura nga parashtruesi në lidhje më zbatueshmërinë e ligjit në fuqi. Gjykata vlerësoi se çështjet në lidhje me saktësinë dhe vlerësimin e provave dhe afateve të parashkrimit, janë çështje të ligjshmërisë dhe nuk bien në sferën e kushtetutshmërisë. Kërkesa u deklarua, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin KI134/15
Parashtrues
Ibrahim Alabaki
Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktgjykimit GSK-KPA-A-229/2013, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 29 shtatorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:
Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ibrahim Alabaki nga Pozharani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin GSK-KPA-A-229/2013, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të 29 shtatorit 2015, në lidhje me Vendimin KPCC/D/R/197/2013, e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KKPK), të 18 prillit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit GSK-KPA-A-229/2013, të Kolegjit të Apelit, të 29 shtatorit 2015.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy, Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 6 janar 2016, parashtruesi është njoftuar për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje i është dërguar Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP) dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 16 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë rezulton se në qershor të vitit 1999 pala e tretë, R. I., ia kishte besuar përgjegjësinë parashtruesit të kërkesës që në mungesë të saj të kujdeset për pronën e saj të banimit (banesës) në Pozharan. Më pas, si parashtruesi ashtu edhe R. I. kanë pretenduar të drejtat e pronësisë mbi pronën në fjalë.

10. Më 13 shkurt 2007, R. I. ka paraqitur kërkesë pronësore në AKP duke kërkuar verifikimin e të drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës banesore (banesës) në Pozharan. R. I. pretendoi se ajo kishte humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 dhe e mbështeti pretendimin e saj duke ofruar *inter alia,* kopje të kontratës së blerjes, kopje të vendimit mbi trashëgiminë dhe deklaratat me shkrim të palëve të treta.

11. Më 22 qershor 2007, parashtruesi ishte i njoftuar për kërkesën dhe ka pasur një konstatim se ai kishte uzurpuar pronën në fjalë.

12. Më 22 korrik 2007, parashtruesi pretendonte të drejtat ligjore mbi pronën e kontestuar dhe ka mbështetur pretendimet e tij, duke ofruar *inter alia* deklaratat me shkrim nga palët e treta duke dëshmuar se R. I. ia ka shitur pronën parashtruesit në qershor të vitit 1999 dhe një faturë për pagimin e tatimeve në pronë.

13. Më 18 prill 2013, me Vendimin KPCC/D/R/197/2013, u shpreh se R. I. ka verifikuar të drejtën e saj pronësore në lidhje me pronën e kontestuar, që R. I. gëzon të drejtën e posedimit të pronës në fjalë dhe, që kushdo që ka uzurpuar pronën duhet ta lirojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit. KKPK arsyetoi se R. I. kishte vërtetuar pretendimet e saj duke ofruar konkretisht kontratën e blerjes dhe vendimin për trashëgiminë nga njëra anë, ndërsa në anën tjetër, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të dokumentuar për të mbështetur pretendimet e tij.

14. Më 19 gusht 2013, parashtruesi parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit. Parashtruesi pretendon *inter alia* se Vendimi i KPKK-së është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, se R. I. kishte shprehur vullnetin e saj për t'ia shitur pronën

atij, se provat e parashtruara nga R. I. janë fiktive dhe se R. I. është e ndaluar nga afatet e parashkrimit për të bërë një kërkesë në pronën e kontestuar.

15. Më 29 shtator 2015, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin GSK-KPA-A-229/2013 hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe mbështeti Vendimin e KKPK-së. Kolegji i Ankesave vërtetoi qëndrimin e KKPK-së dhe arsyetoi, *inter alia* se R. I. ka parashtruar kërkesën pronësore brenda afatit të parashkrimit, se kontrata e blerjes dhe vendimi për trashëgimi si provë nga R. I. janë të vlefshme, se parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të vlefshme për të dëshmuar pronësinë mbi pronën e kontestuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: "*shkelja e së drejtës pronësore e paditësit nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës si e drejtë themelore shprehet në faktin se Gjykata Supreme në arsyetimin e paraqitur ndër të tjera paraqet arsye të cilat janë plotësisht në kundërthënie me provat materiale këtë çështje*".

18. Gjithashtu, parashtruesi pretendon se: "*Si vendimi i shkallës së parë (KPA-së) ashtu edhe Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i shkallës së dytë nuk përmbajnë arsye të plota ligjore për çështjen kontestuese të palëve ndërgjyqësore dhe nuk janë vendime meritore të cilat detajisht u përshkruan në paragrafin e mësipërm*".

19. Përfundimisht, parashtruesi pyet Gjykatën: "*Ne i propozojmë Gjykatës që për shkak të shkeljes së të drejtës së pronësisë dhe posedimit nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo kërkesë të pranohet me të cilën vlerësohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës GJSK-KPA-A-229-2013 është joligjore dhe si i tillë anulohet. Çështja rikthehet për gjykim Gjykatës Supreme të Kosovës (tani Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për çështjet administrative)*".

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

22. Më tej, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Në kërkesën e tij/saj, paditësi duhet saktësisht të qartësoj se cilat të drejta dhe liri ai/ajo pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

23. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili specifikon:

"(2) gjykata do të shpall kërkesën si të pabazuar kur bindet se:

...

(b) faktet e prezantuara nuk i justifikojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë ".

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit iu përgjigj të gjitha pretendimeve kryesore të paraqitura nga parashtruesi duke shpjeguar qartë në çështjet e vërtetësisë së provave, zbatueshmërisë së Ligjit në lidhje me provat e dorëzuara nga palët kundërshtare dhe nëse kërkesa pronësore është e parashkruar si rezultat i afatit të parashkrimit. Pra, kjo Gjykatë konsideron se pretendimet e parashtruesit mbi vendimet kontradiktore të paarsyeshme nga ana e Kolegjit të Apelit dhe të KKPK-së janë të paqëndrueshme.

25. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit, përkatësisht, lidhur me saktësinë e provave dhe afateve të parashkrimit janë çështje të ligjshmërisë të cilat janë adresuar mjaftueshëm nga Kolegji i Apelit, dhe si të tilla, nuk bien brenda sferës së kushtetutshmërisë.

26. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi thjesht i referohet një shkelje të së drejtës së pronës pa e shpjeguar me saktësi se si ka ndodhur ajo, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

27. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese dëshiron të ritheksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "Gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih Rastin KI86/11, parashtruesi i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

28. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Kolegji i Apelit dhe KKPK-ja kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat të cilat i kanë në dispozicion të tyre. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes se provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

29. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk i jep të drejtë të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 46 [E Drejta e Pronës] e garantuar nga Kushtetuta (Shih rastin *Mezotur Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

30. Duke pasur parasysh të gjitha sa u thanë më lart, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

31. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI119/15, Parashtruesja e kërkesës: Borka Stevanović nga Beogradi, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë - Dega në Istog, P. nr. 47/015, të 21 korrikut 2015

KI119/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 marsit 2016, i publikuar më 27 prill 2016.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë - Dega në Istog, masat e përkohshme, kërkesë për moszbulim të identitetit, e parakohshme.

Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, pas procedurës së zhvilluar për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, nxori Aktgjykimin në të cilin është vërtetuar se parashtrueses së kërkesës, si të gjithë trashëgimtarëve të tjerë ligjor të rendit të parë të trashëgimisë u takon nga 1/6 e dy parcelave kadastrale kontestuese.

Parashtruesja e kërkesës pretendon se për shkak të mungesës së udhëzimit për të drejtën e ankesës në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, i është mohuar e drejta për ankesë, dhe, rrjedhimisht edhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Përveç kësaj, parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme dhe të pezullojë përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, si dhe të mos e zbulojë publikisht identitetin e saj.

Gjykata vërteton se, në mënyrë që parashtruesja e kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike që janë të obligueshme për të, ajo duhet të tregojë se: mjeti juridik në të vërtetë ishte përdorur, mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e saj, dhe se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për lirimin e parashtrueses nga kërkesa për të shteruar të gjitha mjetet juridike. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se parashtruesja e kërkesës i plotëson kriteret për t'u liruar nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike në dobi të saj. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion. Siç u konkludua më lart, kërkesa është e papranueshme, dhe rrjedhimisht kërkesa për masë të përkohshme duhet të hidhet poshtë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI119/15
Parashtrues
Borka Stevanović
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P. nr. 47/015, të 21 korrikut 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Borka Stevanović, me vendbanim në Beograd (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P. nr. 47/015, i 21 korrikut 2015.

3. Ky aktgjykim i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 22 gusht 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102.5 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Të njëjtën kohë, parashtruesja kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), që të vendosë Masë të përkohshme dhe të pezullojë përmbarimin e vendimit të kontestuar, si dhe të mos e zbulojë identitetin e saj.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë:

Ligji) dhe në rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 14 dhjetor 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 6 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatëscaktoi gjyqtaren Snezhana Botusharovagjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 19 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që ta dorëzojë formularin e plotësuar zyrtar të Gjykatës Kushtetuese. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Istog për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 14 dhjetor 2015, parashtruesja dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 9 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Pas vdekjes së babait të parashtrueses së kërkesës, trashëgimtarët ligjorë iniciuan në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Istog, procedurën për vërtetimin e pronësisë ndaj dy ngastrave kadastrale nr. 00730/1 dhe nr. 00730/2, të cilat janë trashëgimia e babait të tyre të ndjerë.

13. Më 21 korrik 2015, Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, pas procedurës së mbajtur, nxori Aktgjykimin [P. nr. 47/015], me të cilin u vërtetua se të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të rendit të parë të trashëgimisë u takon nga 1/6 e parcelave kadastrale nr. 00730/1 dhe nr. 00730/2.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesja e kërkesës pretendon se për shkak të mungesës së udhëzimit për të drejtën e ankesës në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, P. nr. 47/015, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102.5 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Kosovës.

15. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme dhe të pezullojë përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, P. nr. 47/015, si dhe të mos e zbulojë publikisht identitetin e saj.

16. Parashtruesja kërkon nga Gjykata moszbulimin e identitetit të saj.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji për Procedurën Kontestimore
2009/03-L-006

DHËNIA, HARTIMI ME SHKRIM DHE DËRGIMI I AKTGJYKIMIT

[...]

Neni 160

160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: [...] udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.

[...]

Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi

Neni 182.

[...]

n) vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

[...].

Procedura sipas ankesës

Neni 185.

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

19. Gjykata, gjithashtu, i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

20. Për më tepër, Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

21. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se për shkak të mungesës së udhëzimit për të drejtën e ankesës në Aktgjykimin e kontestuar Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, i është mohuar e drejta për ankesë, dhe, rrjedhimisht edhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

22. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar ankesë apo kërkesë për korrigjimin e vendimit në gjykatën e cila nxori vendimin e kontestuar, siç parashihet me Ligjin për Procedurën Kontestimore.

23. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar mjetet e duhura juridike që i kishte në dispozicion dhe për këtë arsye, nuk ka respektuar format e parapara me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja nuk ka bërë çdo gjë që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej saj në lidhje me shterimin e mjeteve juridike (Shih rastin*D.H.dhetë tjerët kundërRepublikës Çeke*, nr.57325/00, GJEDNJ, aktgjykim inëntorit 2007, paragrafi116).

24. Gjykata konsideron se, në mënyrë që parashtruesja e kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike që janë të obligueshme për të, ajo duhet të tregojë se: mjeti juridik në të vërtetë ishte përdorur, mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e saj, dhe se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për lirimin e parashtrueses nga kërkesa për të shteruar të gjitha mjetet juridike. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se parashtruesja i plotëson kriteret për t'u liruar nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike në dobi të saj.

25. Gjykata, më tej, thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesja e kërkesës t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

26. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë organeve kompetente, duke përfshire gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih Aktvendimin përpapranueshmëri KI41/09,*AAB-RIINVEST D.O.O.Prishtinëkundër QeverisësëRepublikës së Kosovës*, të21 janarit2010, dheshih,*mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmounikundër Francës,* nr.25803/94, vendim i28 korrikut 1999).

27. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

28. Prandaj, rezulton se kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

29. Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesë kërkon nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme dhe të pezullon përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, P. nr. 47/015, derisa të vendosë për meritat e kësaj kërkese.

30. Në mënyrë që Gjykata të lejojë masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4 dhe 5) të Rregullores së punës, duhet të konstatohet:

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*
>
> *(c) Masa e përkohshme është me interes publik.*
>
> *Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

31. Siç u konkludua më lart, kërkesa është e papranueshme, dhe rrjedhimisht kërkesa për masë të përkohshme duhet të hidhet poshtë.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

32. Për sa i përket kërkesës për moszbulimin e identitetit, parashtruesja kërkoi aprovimin e një kërkese të tillë, pa i cekur shpjegimet dhe arsyet e veçanta për këtë kërkesë.

33. Megjithatë, Gjykata e refuzon kërkesën si të pabazuar, pasi që parashtruesja e kërkesës nuk shpjegoi dhe as nuk i argumentoi me dokumente mbështetëse meritat e kërkesës së saj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar;

III. TA REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit si të pabazuar;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Arta Rama-Hajrizi

KI30/15, Parashtruesit e kërkesës: Isa Nuza, Naxharije Polloshka, Naxhije Lleshi-Nuza, të cilët kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-II-12-0047, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 11 dhjetorit 2014

KI30/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 korrikut 2015, i publikuar më 4 maj 2016.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, masat e përkohshme, e pambështetur, qartazi e pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Më 8 shtator 1958, paraardhësi ligjor i parashtruesve, tani e ndjera N. N. nga Gjakova, në cilësinë e dhuratëdhënëses lidhi kontratën mbi dhurimin [Ov. nr. 458/58], me të cilën 8 (tetë) ngastra tokësore, në sipërfaqe të përgjithshme prej 9.705 ha, ia dhuroi Kooperativës Bujqësore në Gjakovë, e cila paraqitet në cilësinë e dhuratëmarrëses.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [AC II-12-0047], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë *"që gjykatat kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë aplikuar nenin e gabuar të ligjit, dhe rrjedhimisht aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Gjakovë [C. nr. 94/07], të 6 marsit 2009 dhe Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme [AC.II.-12-0047], të 11 dhjetorit 2014, janë kundërkushtetuese."*

Gjykata vëren se shpjegimi i dhënë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së në Aktgjykimin [AC-II-12-0047], të 11 dhjetorit 2014, si gjykatë kompetente, është argumentuar qartë dhe ligjërisht, dhe se procedura para Gjykatës Komunale nuk ishte e padrejtë dhe arbitrare. Gjykata, në bazë të asaj që u tha, vërteton se nuk ekziston rasti *prima facie*, dhe rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme, si vetë kërkesa, ashtu edhe kërkesa për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI30/15
Parashtrues
Isa Nuza
Naxharije Polloshka
Naxhije Lleshi-Nuza
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-II-12-0047, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 11 dhjetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Isa Nuza, Naxharije Polloshka, Naxhije Lleshi-Nuza (në tekstin e mëtejmë: Isa Nuza dhe të tjerët), që të gjithë me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit), të përfaqësuar nga avokati, z. Avni Q. Vula.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-II-12-0047] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS), të 11 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-II-12-0047] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 11 dhjetorit 2014, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të garantuara me Kushtetutë, nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Njëkohësisht, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, me të cilën procedura e likuidimit të patundshmërisë, e cila është objekt i kësaj ankese kushtetuese do të pezullohet deri sa Gjykata të vlerësojë kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 mars 2015, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

7. Më 14 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI30/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI30/15, caktoi Kolegjin Shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 20 prill 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI30/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i përfundoi mandati në Gjykatë më 26 qershor 2015.

10. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 8 shtator 1958, paraardhësi ligjor i parashtruesve, tani e ndjera N. N. nga Gjakova, në cilësinë e dhuratëdhënëses lidhi kontratën mbi dhurimin [Ov. nr. 458/58], me të cilën 8 (tetë) ngastra tokësore, në sipërfaqe të përgjithshme prej 9.705 ha, ia dhuroi Kooperativës Bujqësore në Gjakovë, e cila paraqitet në cilësinë e dhuratëmarrëses.

12. Më 6 shtator 2006, parashtruesit paraqitën padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), me të cilën kanë kërkuar që kontrata mbi dhurimin e patundshmërisë [Ov. br. 458/58], e 8 shtatorit 1958, e lidhur ndëmjet N. N. si paraardhës ligjor i parashtruesve dhe Ndërmarrjes shoqërore Ereniku (në tekstin e mëtejmë: NSH Ereniku), si pasardhëse ligjore e Kooperativës Bujqësore nga Gjakova, të shpallet e pavlefshme në tërësi.

13. Më 31 janar 2007, Dhoma e Posaçme nxori Aktvendimin [nr. SCC-06-0393], me të cilin padinë e parashtruesve ia dërgoi Gjykatës Komunale në Gjakovë për vendosje.

14. Më 6 mars 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktgjykimin [C. nr. 94/07], me të cilin refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesve me këtë arsyetim:

"[...]

Në bazë të parashkrimit fitues me kalimin e kohës prej më tepër se 20 vjet, sipas nenit 28 paragrafi 4 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore ka fituar të drejtën e pronësisë. Neni 20 paragrafi 1 i të njëjtit Ligj parasheh se e drejta e pronësisë fitohet në bazë të vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi. Paraardhësja juridike e të paditurës me punë të vlefshme juridike ka

fituar të drejtën e pronësisë, ka hyrë në posedim, janë bërë ndryshimet në librat kadastral...

Përveç kësaj në bazë të nenit 268 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar parashihet se po që se patundshmëria është bërë pronësi shoqërore pa bazë juridike, kthimi i së njëjtës mund të kërkohet në afat prej pesë vjetësh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, por më së voni në afat prej 10 vjetësh. Në këtë çështje nuk është kërkuar kthimi i patundshmërisë brenda afateve të theksuara më lartë dhe për shkak të skadimit të afateve nuk mund të vërtetohet e drejta e pronësisë të paditësve (parashtruesve)".

15. Më 22 qershor 2009, parashtruesit kanë paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme, në të cilën kërkuan prishjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë [C. nr. 94/07], të 6 marsit 2009, dhe aprovimin e kërkesëpadisë të 6 shtatorit 2006.

16. Më 17 shtator 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, pas procedurës së përcaktimit të statusit ligjor të të padituërës, nxori Vendimin [AC-I-14-0102] me të cilin ndërmarrjes "Ereniku" nga Gjakova i është njohur statusi i ndërmarrjes shoqërore (në tekstin e mëtejmë: NSH), dhe është vërtetuar: *"që në këtë lëndë është sqaruar se DHPGJS-ja ka jurisdiksionin e saj, me që e paditura si NSH është sqaruar se mund të kualifikohet si palë e paditur në procedurat pranë DHPGJS-së në bazë të nenit 5.2 të LDHP-së".*

17. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesit kanë dorëzuar një kërkesë në Dhomën e Posaçme, në të cilën kanë kërkuar përshpejtimin e procedurës dhe vendosjen e Masës së përkohshme të ndalimit të likuidimit të pronës kontestuese.

18. Më 11 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [AC II-12-0047], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar, me arsyetimin se: *[...] Neni 8a i Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Qarkullimin e Patundshmërive, i vitit 1987 i Republikës së Serbisë, në bazë të cilit mund të kërkohet anulimi i kontratave të përmendura, se janë lidhur nën ndikimin e kërcënimit, dhunës apo të mashtrimit, gjithashtu në këtë lëndë nuk është i zbatueshëm. Ky ligj edhe nëse ndonjëherë ka qenë i zbatueshëm në Kosovë, në bazë të nenit 296 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, i nxjerrur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më nuk është i zbatueshëm, pasi që në këtë nen shprehimisht thuhet se, "**të gjitha dispozitat e ligjeve të mëparshme që kanë rregulluar këtë materie, përveç në rastet kur me këtë ligj është paraparë ndryshe, pushojnë së vepruari".***

19. Në përfundimin e Aktgjykimit, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve për vendosjen e Masës së përkohshme, në lidhje me ndalimin e likuidimit të pronës lëndore, me arsyetimin se: *"Kosova ende nuk ka një ligj për kthimin e tokave ish-pronarëve, andaj nuk ka bazë ligjore e cila mund të aplikohet në bazë së cilës mund të kërkohet kthimi i tokave tek ish-pronarët, apo anulimi i kontratave të lidhura dhe të vërtetuara në gjykata, para 1 tetorit 1978, kur ka hy në fuqi LMD. Andaj padia nga Gjykata e shkallës së parë për këto arsye saktë është refuzuar si e pabazuar".*

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: "*që gjykatat kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë aplikuar nenin e gabuar të ligjit, dhe rrjedhimisht aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Gjakovë [C. nr. 94/07], të 06 marsit 2009 dhe Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme [AC.II.-12-0047], të 11 dhjetorit 2014, janë kundërkushtetuese".*

21. Parashtruesit i drejtohen Gjykatës me kërkesën që Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 6 marsit 2009 dhe atë të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 11 dhjetorit 2014, t'i shpallë kundërkushtetues dhe të pavlefshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë kuptim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe të lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

25. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*

26. Gjykata vëren se parashtruesit e kishin ndërtuar ankesën e tyre kushtetuese vetëm mbi pretendimet për shkeljen e nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. E drejta e pronës është e garantuar.*
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj".

27. Gjykata thekson se e drejta e pronës nga neni 46 i Kushtetutës është objekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës dhe përmbajtësisht korrespondon me të drejtën e pronës nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Kushtetuta e mbron këtë të drejtë në atë mënyrë që autoriteteve shtetërore iu ndalon kufizimin ose privimin nga kjo e drejtë, përveç nëse kufizimi ose privimi është i bazuar në ligj.

28. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Vendimin [AC-I-14-0102], të 17 shtatorit 2014, kishte përcaktuar statusin ligjor të të paditurit dhe është shpall kompetent në këtë kontest juridik, sepse sipas nenit 3, paragrafi 14 të Ligjit, nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme është parashikuar se: *"Kolegji i Apelit do të ketë kompetencë ekskluzive të apelit në shkallë të fundit mbi të gjitha apelet nga aktvendimet apo aktgjykimet e kolegjeve të specializuara, apo nga cilado gjykatë…".*

29. Rrjedhimisht, Gjykata më tej vëren se shpjegimi i dhënë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së në Aktgjykimin [AC-II-12-0047], të 11 dhjetorit 2014, si gjykatë kompetente, është i argumentuar qartë dhe ligjërisht, dhe se procedura para Gjykatës Komunale nuk ishte e padrejtë apo arbitrare.

30. Për më tepër, sa i përket pretendimeve të ankesës kushtetuese që tregojnë për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata thekson faktin se me rastin e vendosjes në lidhje me atë nëse është shkelur e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata me vlerësimin e saj nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e gjykatave të rregullta, sepse është detyrë e gjykatave të rregullta t'i vlerësojnë provat të cilat i administrojnë dhe mbi bazën e të cilave vërtetojnë faktet relevante për aplikimin e së drejtës materiale.

31. Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] parasheh që: *"të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut".*

32. Në bazë të kësaj, vet fakti se parashtruesit në çështjen juridike të vërtetimit e të drejtës së pronës e kanë humbur kontestin, nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, nëse nuk dëshmojnë se me vendimin gjyqësor janë privuar arbitrarisht apo padrejtësisht nga prona (Shih rastin, *mutatis mutandis, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ*,* Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

33. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (Shih, rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

34. Gjykata vëren se parashtruesit në kërkesë kërkojnë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, me të cilën procedura e likuidimit të patundshmërisë, e cila është objekt i kësaj ankese kushtetuese do të pezullohet, derisa Gjykata të vlerësojë kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar.

35. Në mënyrë që të miratojë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të konstatojë që:

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme.

[...]"

36. Siç është konkluduar më lart, kërkesa është e papranueshme dhe për këtë arsye nuk ekziston rasti *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (b) dhe 55 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI95/15, Parashtruesi i kërkesës: Xhevat Berbati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4312/2014, të 27 shkurtit 2015.

KI 95/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2016. godine, i publikuar më 5 maj 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, qartazi e pabazuar.*

Me 23 dhjetor 2013, Gjykata Themelore ne Peje (Vendimi E. nr. 1023/203) miratoi propozimin për përmbarim në bazë të kontratës së kredisë të nënshkruar nga parashtruesi dhe Banka, dhe në bazë të kontratës së hipotekës të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës, garantuesit e tij dhe nga Banka.
Kundër vendimit te lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës dhe garantuesit e tij kanë paraqitur prapësim në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar nga e njëjta të anulojë Vendimin e Gjykatës Themelore dhe të pezullojë procedurën e përmbarimit.
Më 27 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Vendimi Ac. nr. 4312/2014) refuzoi prapësimin e parashtruesit të kërkesës dhe të garantuesve të tij si të pabazuar dhe e vërtetoi Vendimin e gjykatës së shkallës së parë.
Parashtruesi i kërkesës konsideroi se Vendimi (Ac. nr. 4312/2014, i 27 shkurtit 2015) i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të garantuara me Kushtetutë.
Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit janë dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI95/15
Parashtrues
Xhevat Berbati
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4312/2014, të 27 shkurtit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Xhevat Berbati, me vendbanim në Nabërgjan, komuna e Pejës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin (Ac. nr. 4312/2014, e 27 shkurtit 2015) e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), të cilin parashtruesi pretendon që e ka pranuar më 1 prill 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili ka refuzuar prapësimin e parashtruesit kundër Vendimit (E. nr. 1023/2013, të 23 dhjetorit 2013) të Gjykatës Themelore në Pejë në lidhje me lejimin e inicimit të procedurës së përmbarimit kundër parashtruesit dhe garantuesve të tij.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) konkretisht "*neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 1; neni 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores

së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 gusht 2015, Kryetarja, me Vendimin GJR. KI95/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin, KSH. KI95/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 18 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

9. Më 16 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 27 shkurt 2012, parashtruesi nënshkroi një marrëveshje kredie, si autorizim për mbitërheqje, me Bankën Ekonomike SH. A. (në tekstin e mëtejmë: Banka Ekonomike). Të njëjtën ditë, parashtruesi, garantuesit e tij dhe Banka nënshkruan një marrëveshje për hipotekë si mjet për sigurimin e pagesës së kredisë.

11. Kredia iu lëshua parashtruesit të kërkesës. I njëjti i kishte paguar këstet, siç ishte dakorduar me Bankën, deri në një datë të caktuar. Pas disa vështirësive financiare, parashtruesi i kërkesës filloi të vonojë pagesat e planifikuara dhe në një kohë të caktuar e ndërpreu pagesën e kësteve të dakorduara.

12. Pas këtyre ngjarjeve dhe pasi që riprogramimi i kredisë dështoi të japë rezultate, Banka, në cilësinë e kreditorit, paraqiti propozim për përmbarim ndaj parashtruesit dhe garantuesve të tij, në cilësinë e debitorëve, në Gjykatën Themelore në Pejë. Banka kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë të detyrojë parashtruesin dhe garantuesit e tij që të paguajnë shumën e borxhit të mbetur apo si alternativë të autorizojë shitjen e hipotekës së lënë nga garantuesit, si mjet për të paguar borxhin e mbetur.

13. Më 23 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Pejë (Vendimi E. nr. 1023/203) miratoi propozimin për përmbarim në bazë të kontratës së kredisë të nënshkruar nga parashtruesi dhe Banka, dhe në bazë të kontratës së hipotekës të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës, garantuesit e tij dhe nga Banka.

14. Kundër vendimit të lartpërmendur, parashtruesi dhe garantuesit e tij kanë paraqitur prapësim në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar nga e njëjta të anulojë Vendimin e Gjykatës Themelore dhe të pezullojë procedurën e përmbarimit.

15. Më 27 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Vendimi Ac. nr. 4312/2014) refuzoi prapësimin e parashtruesit dhe të garantuesve të tij si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit vendosi se:

"Gjykata i refuzoi në tërësi si të pabazuara prapësimet e debitorëve [Parashtruesit dhe garantuesve të tij] *me arsyetimin se të njëjtit janë të pabazë dhe më shumë të paraqitur me qëllim të prolongimit të procedurës përmbarimore, ngase arsyet e theksuara në prapësim nuk përkojnë me asnjë nga shkaqet që e pengojnë përmbarimin e lejuar nga gjykatat të përcaktuara në dispozitën e nenit 71 LPP* [Ligji për Procedurën Përmbarimore] *[...].*
Pretendimet ankimore të debitorit Xhevat Berbati, kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Gjykata e Apelit e ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete efektive juridike dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

17. Në mbështetje të shkeljes së pretenduar nga neni 31, paragrafi 1 i Kushtetutës, parashtruesi pretendon se "*përkundër insistimit të vazhdueshëm lidhur me nxirjen e historisë së llogarisë nga kreditori-Banka asnjëherë nuk ka marrë informata lidhur me transaksionet bankare [...]".*

18. Në përgjithësi, parashtruesi gjithashtu thekson se marrëveshja e kredisë nuk ka mundur të përmbushet si pasojë e vështirësive të tij financiare, të cilat përfundimisht detyruan palët kontraktuese të bëjnë një marrëveshje tjetër. Megjithatë, sipas parashtruesit të kërkesës *"të gjitha propozimet e kreditorit* [Bankës] *ishin të papërballueshme për debitorin* [parashtruesin]".

19. Parashtruesi, më tej, pretendon se Banka *"ka inkasuar 150% kamata - interes më tepër se sa kësti mujor, kjo mund të vërtetohet nga historia e llogarisë e 6 qershorit 2015".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

22. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës i cili parasheh:

"(2 Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

24. Siç është përmendur më lart, parashtruesi pretendon se Vendimi (Ac. nr. 4312/2014, i 27 shkurtit 2015) i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike]; dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të garantuara me Kushtetutë.

25. Në lidhje me "*mjetet juridike*" dhe "*mbrojtjen gjyqësore të të drejtave*" parashtruesi thjesht u është referuar neneve përkatëse të Kushtetutës pa ofruar ndonjë arsyetim të mëtejshëm se si dhe pse këto të drejta janë shkelur nga Gjykata e Apelit.

26. Lidhur me të drejtën për "*gjykim të drejtë dhe të paanshëm*", parashtruesi nuk pretendoi ndonjë shkelje që mund të jetë kryer nga Gjykata e Apelit apo nga Gjykata Themelore në Pejë. Në vend të kësaj, parashtruesi i është referuar disa shkeljeve të pretenduara të kryera nga Banka, siç janë norma shumë e lartë e interesit dhe se nuk i është dhënë historia e llogarisë së tij pas kërkesës që kishte bërë. Ai nuk arriti të japë ndonjë arsyetim se si dhe pse e drejta e tij për gjykim të drejtë është shkelur nga gjykatat e rregullta.

27. Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Pejë dhe Gjykata e Apelit kanë arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi, duke hedhur poshtë prapësimin e parashtruesit kundër procedurës së përmbarimit. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se ajo që parashtruesi ngre është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

28. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në përgjigje të pretendimit të parashtruesit për shkelje të ligjit nga Gjykata Themelore në Pejë, kur refuzoi prapësimin e tij ndaj procedurës së përmbarimit. Gjykata e Apelit vendosi se: "*[...] përfundimi i gjykatës së shkallës së parë [...] është i bazuar dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore andaj edhe Aktvendimi i atakuar ka arsye të plota dhe bindëse". [...] gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale [...]".*

29. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

30. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* Nr. 30544/96, ECHR, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11, i parashtruesit *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese,

Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Fakti se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk ngre një pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë.

31. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi ta prezantojë rastin para gjykatave të rregullta. Çështja e drejtësisë së procedurës përmbarimore është trajtuar gjerësisht nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Kjo e fundit i është përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit lidhur me atë nëse procedura e përmbarimit mund të prolongohet ose jo. Gjykata e Apelit theksoi se parashtruesi nuk e ka mbështetur prapësimin e tij lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi vetëm kishte përmendur atë, por nuk ka ofruar argumente në atë drejtim. Ai kryesisht ishte interesuar në zgjatjen e procedurës së përmbarimit, gjë për të cilën Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë arsye për ta miratuar.

32. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesit kishin një gjykim të drejtë (Shih rastin, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

33. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi lidhur me prapësimin e parashtruesit përkitazi me procedurën e përmbarimit, në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat pranë Gjykatës Themelore në Pejë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).

34. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se parashtruesi ka dështuar të mbështesë pretendimet e tij lidhur me atë se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij nga Gjykata e Apelit.

35. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI27/15, Parashtrues Naser Peci, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015

KI27/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 14 mars 2016 dhe i publikuar më 11 maj 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë administrative, të drejtat e palëve të treta, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte miratuar vendimet e gjykatave të instancës së ulët përkitazi me refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës për t'u emëruar gjyqtar në gjyqësorin e Republikës së Kosovës.

Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese kryesisht për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse ai ishte eliminuar nga gara për t'u zgjedhur gjyqtar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore në fuqi.

Gjykata vlerësoi se parashtruesi i kërkesës vetëm sa përmend dispozitën kushtetuese që garanton gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa shpjeguar saktësisht dhe mbështetur me prova konkrete pretendimin e tij se është viktimë e cenimit të kësaj të drejte. Për më tepër, kërkesa nuk tregon në mënyrë të argumentuar që gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë, përkatësisht në shpërputhje me standardet e garantuara kushtetuese. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI27/15
Parashtrues
Naser Peci
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Naser Peci, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 321/2014, të 7 nëntorit 2014, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. nr. 746/2011, të 11 qershorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka cenuar atij të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë

Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 prill2015, Kryetari iGjykatës,caktoigjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, caktoiKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Altay Suroy, Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 26 qershor 2015, ka përfunduar mandati i gjyqtarit Kadri Kryeziu. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu.

8. Më 30 shtator 2015, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 14 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 shkurt 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), kishte shpallur konkurs për vende të lira pune për gjyqtar në disa komuna të Republikës së Kosovës.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi kishte konkurruar për pozitë të gjyqtarit.

12. Më 13 qershor 2011, KGJK-ja njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai nuk mund të jetë pjesë e procesit për t'u zgjedhur gjyqtar, për shkak se ai nuk kishte vijuar dhe përfunduar me sukses Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor (në tekstin e mëtejmë: PFAL). Parashtruesi, po ashtu, u njoftua se ai mund të sjellë informacion mbështetës deri më 17 qershor 2011, për të provuar se ai e plotëson kriterin në fjalë.

13. Më 15 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës iu drejtua KGJK-së, duke pretenduar, ndër të tjera, se ai meriton që kërkesa e tij të shqyrtohet në themelësi dhe jo të refuzohet, për shkak të mos vijimit dhe përfundimit me sukses të PFAL. Parashtruesi, po ashtu, pretendoi se ai kishte përvojë pune 30 vjeçare dhe se nuk kishte nevojë të vijonte PFAL.

14. Më 22 qershor 2011, KGJK-ja njoftoi parashtruesin e kërkesës se vijimi dhe përfundimi me sukses i PFAL ishte kriter ligjor dhe se për shkak të mos plotësimit të këtij kriteri, ai nuk mund të konsiderohej kandidat i mundshëm në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve.

15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës filloi konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër njoftimeve të KGJK-së, të 13 dhe 22 qershorit 2011.

16. Më 11 qershor 2014, Gjykata Themelore me Aktgjykimin, A. nr. 746/2011 refuzoi, të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të paraqitur kundër njoftimeve të KGJK-së.

17. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, përcakton:

> "*Me dt. 22. 06. 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i përgjigjet të njëjtit, duke e njoftuar se KGJK-së me dt. 23. 02.2011, shpall konkurs publik për pozita gjyqësore dhe kriteret për këto pozita kanë qenë të bazuara në rregulloret e UNMIK-ut në fuqi dhe Rregullores mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve. Neni 5 i Rregullores mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, kërkon që kandidatët duhet të kenë vijuar dhe përfunduar me sukses këtë program, në mënyrë që të trajtohen si kandidat potencial. Prandaj, në mungesë të këtij kriteri, në bazë të nenit 2.3 dhe nenit 5 të Rregullores mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, ju nuk mund të trajtoheni në këtë proces, si kandidat potencial, për pozita gjyqësore.*
>
> *Po ashtu, gjykata iu referua edhe Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, nenit 5.1 të të njëjtës, i cili përcakton se " KGJK-së në bashkëpunim me IGJK-në, për pozita gjyqësore do të organizoj provim pranues, për Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor. Kandidatët që nuk e kalojnë provimin pranues, apo nuk kalojnë me sukses Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor, nuk do të merren për shqyrtim të mëtejshëm për emërim".*

18. Më 11 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të ligjit për konflikt administrativ. Parashtruesi pretendoi se "*Gjykata Themelore kishte për obligim që ta detyronte të padituri (KGJK-në) që të nxjerrë vendim në rastin e tij dhe jo të vendosë për themelësinë e padisë së tij (duke e refuzuar atë) dhe se atij i ishte cenuar e drejta për t'u emëruar gjyqtar bazuar në një rregullore që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin".*

19. Më 7 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin, A. A. nr. 321/20 14, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit miratoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se aktgjykimi i kontestuar është i bazuar në ligj dhe prova, dhe se vijimi dhe përfundimi i PFAL është kriter i paraparë me ligj, që duhet plotësuar nga të gjithë kandidatët që konkurrojnë për t'u zgjedhur gjyqtar në gjykatat e Republikës së Kosovës.

20. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të ligjit procedural dhe të dispozitave materiale. Parashtruesi, po ashtu, propozoi anulim të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe që çështja të kthehet për rivendosje. Parashtruesi, ndër të tjera, përsëriti pretendimet e tij, se gjykatat e

instancës më të ulët kishin obligim që ta detyronin të padituri (KGJK-në), që të nxjerrë vendim në rastin e tij dhe se njoftimet e KGJK-së në të vërtetë ishin heshtje administrative dhe jo akte apo vendime administrative.

21. Më 21 janar 2015, Gjykata Supreme me Aktgjykimin KRJ. nr. 1/2015,refuzoi të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur nga parashtruesi kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme miratoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike, zbatimin e dispozitave procedurale dhe materiale të ligjit administrativ dhe kriterin ligjor që duhet plotësuar për t'u konsideruar kandidat për gjyqtar në Republikën e Kosovës.

22. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton:

> *"Në pajtim me dispozitën e lartpërmendur të nenit 6 të Rregullores për procedurën e emërimit të gjyqtarëve, Gjykata Supreme konsideron se gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë vepruar me rastin e refuzimit si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit për shkak të mos nxjerrjes së vendimit nga ana e organit administrativ të shkallës së dytë, heshtjes administrative. Në të vërtetë, Gjykata Supreme gjen se vendimi -lajmërimi i Panelit për vlerësim, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ZVVGJP/11/dr/163, të datës 13.06.2011, me të cilin paditësi është informuar se sipas nenit 6.2 të Rregullores për procedurën e emërimit, nuk i plotëson kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar, duke marrë parasysh se nuk ka vijuar dhe kryer me sukses programin fillestar për arsimim ligjor, konsiderohet si vendim i organit administrativ të shkallës së parë, kurse vendimi–lajmërimi ZVVGJP/11/dr/240, i datës 22.06.2011 i Panelit për vlerësim, i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i nxjerrë në bazë të kundërshtimit të paditësit, konsiderohet si vendim administrativ i organit të shkallës së dytë kundër të cilit mund të udhëhiqet konflikt administrativ. Nga të lartpërmendurat, kjo Gjykatë konsideron se në këtë çështje administrative nuk mund të bëhet fjalë për mos nxjerrje të vendimit nga organi i shkallës së dytë, heshtje e administratës, për shkak të cilës gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë vepruar kur kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

24. Parashtruesithekson se*"përmbajtja e vendimeve të gjykatave të rregullta i referohet vetëm aspektit ligjor por jo edhe atij material. Asnjë nga vendimet e gjykatave vendore nuk ka trajtuar në përmbajtje faktin se a i ka plotësuar kushtet për konkurrim parashtruesi i kërkesës sipas ligjit dhe kushtetutës apo nuk i ka plotësuar".*

25. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që "*të vërtetohet se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe se eliminimi nga gara për gjykatës ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin".*

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

28. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, që përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

29. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

30. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që "*të vërtetohet se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe se eliminimi nga gara për gjykatës ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin".*

31. Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsye të mjaftueshme e bindëse në mbështetje të përfundimeve të tyre sepse kanë shpjeguar: (i) çështjen e kritereve ligjore që duhen plotësuar nga kandidatët që konkurrojnë për t'u zgjedhur gjyqtarë, (ii) mandatin kushtetues dhe ligjor të KGJK-së përkitazi me propozimin e kandidatëve për emërim në pozita gjyqësore, (iii) natyrën detyruese të kriterit për arsimim ligjor (PFAL) pavarësisht nga përvoja e kandidatëve dhe (iv) kanë vlerësuar se njoftimet e KGJK-së janë vendime administrative dhe jo heshtje administrative siç kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës.

32. Gjykata thekson se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si "*gjykatë e shkallës së katërt*" në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjykata nuk merret me gabimet në konstatimin e faktit apo interpretimin e ligjit (ligjshmërinë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,*

Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu, *mutatis mutandis,* në Rastin nr. KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

33. Gjykata vëren se pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe të fakteve dhe jo të kushtetutshmërisë.

34. Gjykata, po ashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm sa e përmend dispozitën kushtetuese që garanton gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa shpjeguar saktësisht dhe mbështetur me prova konkrete pretendimin e tij se është viktimë e cenimit të kësaj të drejte. Për më tepër, kërkesa nuk tregon në mënyrë të argumentuar që gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë, përkatësisht në shpërputhje me standardet e garantuara kushtetuese.

35. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave të zhvilluara nga gjykatat e rregullta, nuk përbën themel për të ndërtuar kërkesë të argumentuar për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të garantuar me Kushtetutë (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

36. Si përfundim, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 14 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI131/15, Parashtrues Selvinaz Top dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr 60/2015, i 25 majit 2015

KI131/15, Aktvendim për papranueshmëri i 15 marsit 2016, publikuar më 17 maj 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar*.

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 60/2015, të 25 majit 2015, refuzon kërkesën e parashtruesve për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, po ashtu zyra e Kryeprokurorit refuzon kërkesën e parashtruesve për mbrojtje të ligjshmërisë.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se Gjykata Supreme i kishte shkelur atyre të drejtën për proces të rregullt dhe mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, dhe për më tepër, shtuan se gjykatat e rregullta nuk i kishin administruar të gjitha provat në rastin e tyre.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të një të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut në vendimin e kontestuar. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI131/15
Parashtrues
Selvinaz Top dhe të tjerët
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60/2015, të 25 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë znj. Selvinaz Top, z. Hilmi Top, z. Bajram Top, znj. Sevim Zaimi (e lindur Top), z. Hysni Top, znj. Sehar Kitmiri (e lindur Top), z. Adnan Top dhe znj. Sejlan Damka, të gjithë nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i fundit i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 60/2015, i 25 majit 2015, të cilin parashtruesit e kanë pranuar më 2 korrik 2015. Parashtruesit kanë kontestuar gjithashtu në mënyrë specifike edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5045/12, të 4 nëntorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara gjyqësore, për të cilat parashtruesit pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sipas nenit 31 (Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm), sipas nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) dhe sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 tetor 2015, nëpërmjet postës, parashtruesit e dërguan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

6. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës me vendim, caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan, Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 21 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe Gjykatës Supreme i dërgoi një kopje të kërkesës.

8. Më 15 mars 2016, Kolegjishqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoiGjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 3 maj 1962, paraardhësi i parashtruesve, A. T., kishte lidhur kontratë për dhurim me Komunën e atëhershme të Prizrenit (Leg. nr. 190/62), me të cilën paluajtshmërinë, pronar i të cilës ishte specifikuar si në të dhënat kadastrale në kontratë, ia dhuronte Komunës.

10. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës, në cilësi të pasardhësve të A. T., kanë parashtruar padi për anulimin e kontratës mbi dhuratën në Gjykatën Komunale të Prizrenit, me pretendimin që kontrata ishte lidhur pa vullnetin e parardhësit të tyre dhe nën kushtet e presionit të vazhdueshëm të pushtetit të atëhershëm.

11. Më 15 tetor 2015, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 133/07, ka aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesve si të bazuar dhe ka shpallur NUL kontratën mbi dhurimin e paluajtshmërisë të lidhur ndërmjet A. T. dhe Komunës së Prizrenit. Gjykata kishte obliguar Komunën që parashtruesve të kërkesës "*t'i kthejë në pronësi, posedim dhe shfrytëzim të lirë"* paluajtshmëritë e paraardhësit të tyre në cilësinë e bashkëpronarëve, duke i shpallur ata trashëgimtarë legjitimë të asaj pasurie.

12. Gjykata Komunale, në aktgjykimin e vet, ndër të tjera, ka theksuar: "*Pas administrimit të gjithë këtyre provave secilës veç e veç dhe të gjitha bashkërisht gjykata në rastin konkret me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar të cilat përputhen në tërësi me njëra-tjetrën dhe vërtetojnë faktin se kontrata mbi dhuratën e paluajtshmërisë nuk ka qenë e lidhur me vullnet të lirë të dhuratëdhënësit por e njëjta është lidhur me presion të bërë nga ana e pushtetit të atëhershëm respektivisht dhuratëmarrësit të cilën gjë e kanë bërë aktivistët e atëhershëm shtetëror dhe si e tillë kjo kontratë është absolutisht nul"*.

13. Më 12 dhjetor 2012, Avokati Publik i Komunës së Prizrenit paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

14. Më 4 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin AC. nr. 5045/12 me të cilin ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur që padinë e parashtruesve ta refuzojë si të pabazuar.

15. Gjykata e Apelit, duke iu referuar qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me kontratën mbi dhuratën, ka theksuar: *"Një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm nga se, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e tillë faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale... dhe...sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile kontrata e tillë do të ishte relativisht e pavlefshme dhe se anulimi i saj, për arsye të tilla mund të kërkohej në afat prej një viti, nga dita e marrjes në dijeni të shkakut të rrëzueshmërisë, pushimit të shkakut të*

kërcënimit (afati subjektiv) ndërsa e drejta e tillë humbet në afat prej 3 vjetësh (afati objektiv)".

16. Gjykata e Apelit, në arsyetimin e vet, më tej theksoi: "*Në prani të faktit se kanë kaluar të gjitha afatet për kërkimin e nulitetit relativ të kontratës, të cilat afate janë prekluzive, në rastin konkret juridiko-civil nuk mund të kërkohet nuliteti i kontratës pas skadimit të afatit prej rreth 40 vjetësh, sikur kanë vepruar paditësit në rastin konkret",* andaj ka konstatuar se aktgjykimi i atakuar duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia si e tillë të refuzohet.

17. Më 20 janar 2015, parashtruesit parashtruan kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC. nr. 5045/12, të 4 nëntorit 2014, si dhe të njëjtën ditë kundër po këtij aktgjykimi i paraqitën Prokurorit të Shtetit të Kosovës propozim për mbrojtje të ligjshmërisë.

18. Më 18 shkurt 2015, Zyra e Kryeprokurorit nxori njoftimin KMLC nr. 9/15, me të cilin i njoftoi parashtruesit që "*konsideron se nuk ka bazë ligjore për inicimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë".*

19. Më 25 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin Rev. nr. 60/2015, me të cilin hedh poshtë revizionin e parashtruesve, sepse "s*ipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, revizioni i paditësve i paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është i palejuar për shkak të vlerës së kontestit",* duke argumentuar se parashtruesit, në kohën e ushtrimit të padisë, kishin paraqitur vlerën e kontestit dukshëm më të vogël se vlera e lejuar për kërkesën për revizion në bazë të ligjit në fuqi të asaj kohe, ndërsa precizimin e padisë e kishin bërë pas afateve të lejuara me ligj.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit e kërkesës kanë pretenduar se me vendimet e kontestuara u janë shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së), sepse *"Gjykata e Apelit nuk i kishte analizuar mirë të gjitha shkresat e lëndës"* e të cilat,sipas parashtruesit, po të administroheshin të plota do të qonin tek përfundimi real i drejtë dhe i favorshëm i tërë procesit gjyqësorpër parashtruesit.

21. Neni 46 i Kushtetutës (Mbrojtja e Pronës), sipas parashtruesve është shkelur sepse ata me vendime gjyqësore në mënyrë arbitrare janë privuar nga e drejta e pronës mbi patundshmërinë të cilën ndryshe do të duhej ta gëzonin në bazë të trashëgimisë.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

23. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Më tej, Gjykata merr në konsideratë nenin 48 të Ligjit (Saktësimi i kërkesës) i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

25. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores, ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojënjë kërkesë nëse:

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

dhe

(2) Gjykata do të refuzojënjë kërkesë si qartazi tëpabazuar, nëse bindet se:

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

26. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesit, Gjykata vëren që kontestohet Aktvendimi Rev. nr. 60/2015, i 25 majit 2015, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5045/12, i 4 nëntorit 2014.

Dispozitat relevante kushtetuese lidhur me rastin

Neni 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

[...]

27. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktvendimit të kontestuar mbi bazën e pretendimeve të parashtruesit dhe të fakteve të prezantuara nga ai, Gjykata konstaton

se këto pretendime janë mbështetur në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjegjësisht në vlerësimin e gabuar të provave të prezantuara nga parashtruesit nga ana e gjykatave të rregullta.

28. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se nuk është kompetencë e saj që me vlerësimin e vet të fakteve të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga ana e gjykatave të rregullta, sepse, sipas rregullave të përgjithshme, është detyrë e atyre gjykatave të vlerësojnë faktet të cilat gjenden para tyre (Shih Rastin KI47-48/15, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057, të 12 marsit 2015, parashtrues *Beqir Koskoviku e Mustafë Lutolli*) dhe se detyrë e kësaj gjykate është të vlerësojë nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së (Shih, ndër të tjera, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* 16 dhjetor 1992, f. 34, Seria A, nr. 247 dhe B. *Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992, f. 33, Seria A, nr. 235).

29. Për Gjykatën, në parim, janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të së drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesit. (Shih,*mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë,* 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

30. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih *Fc Metrebi v Georgia*, par. 31, Aktgjykim i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007), e që gjykuar sipas rrethanave të rastit qëllimi primar i parashtruesve duket të ketë qenë pikërisht kontestimi i rezultatit të procesit gjyqësor.

31. Asgjë në rastin e prezantuar nga parashtruesit nuk provon se procesi gjyqësor në rastin konkret, si tërësi, ka qenë i padrejtë apo arbitrar në mënyrë që ta bindë Gjykatën Kushtetuese se është cenuar vetë esenca e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

32. Bazuar në atë që u tha, i ka takuar gjykatave të rregullta të vlerësojnë nëse kontrata e kontestuar mbi dhuratën ka qenë dashur të vlerësohet nga prizmi i nulitetit relativ apo absolut, dhe jo i kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykatës nuk iu ofrua asnjë provë për shkelje në trajtimin e barabartë të palëve në procedurë apo provë që do ta kishte vënë në një situatë aq të pafavorshme parashtruesin në raport me palën oponente për aq sa ta degradojë thelbësisht procesin gjyqësor në tërësinë e tij (Shih *Dombo Beheer kundër Holandës*, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, Serie A, nr. 274), andaj në këto rrethana Gjykata nuk gjen se në vendimet e kontestuara ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

33. Gjykata më tejkonstaton se Gjykata Supreme gjithashtu kishte arsyetuar plotësisht aktvendimin e saj lidhur me revizionin, duke sqaruar në mënyrë të detajuar se pse kërkesa për revizion është e palejuar duke argumentuar qartazi bazën ligjore për palejushmëri dhe duke u bazuar në Ligjin për Procedurën Kontestmore të kohës kur ishte ngritur padia e parashtruesve, andaj nuk ka elemente arbitrariteti në aktvendimin e lartpërmendur dhe rrjedhimisht as shkelje të nenit 31 të Kushtetutës apo të nenit 6 të KEDNJ-së.

34. Sa i përket pretendimit tjetër të parashtruesve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës (Mbrojtja e Pronës), Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit në mënyrë të gjerë dhe të plotë e ka arsyetuar vendimin e vet dhe kjo gjykatë nuk mund të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 3, neni 46, të Kushtetutës, sepse çështja e diskutueshme e pronësisë ishte përcaktuar me vendim gjyqësor dhe nuk ishte arbitrare.

35. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të një të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut në vendimin e kontestuar dhe në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika b dhe d, gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, me shumicë votash.

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI114/15, Parashtrues Feride Aliu – Shala, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 95/2015, të 12 majit 2015

Rastin nr. KI114/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 8 mars 2016 dhe i publikuar më 17 maj 2016.

Fjalët kyç*:Barazia para Ligjit, E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, E Drejta për Mjete Juridike dhe Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave.*

Parashtrueses së kërkesës i është ngritur aktakuzë nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për veprën penale të "vjedhjes", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Pas rikthimit të rastit në gjykim në shkallën e parë nga Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore në Mitrovicë konstatoi se parashtruesja e kërkesës është fajtore, për shkak të kryerjes së veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 i KPK-së dhe u dënua me 1 (një) vit burgim. Gjykata e Apelit pas ankesës së parashtrueses e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë, duke e dënuar parashtruesen më 4 (katër) muaj burgim, i cili nuk do të ekzekutohet brenda 1 (një) viti me kusht që parashtruesja të mos kryej ndonjë vepër tjetër brenda periudhës së caktuar.
Parashtruesja e kërkesës pretendoi se vendimi i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës është i padrejtë, prandaj është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.
Gjykata konsideron se edhe pse neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, ato nuk përcaktojnë ndonjë rregull mbi pranueshmërinë e provave të tilla, të cilat, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë janë kryesisht çështje të ligjshmërisë. Po ashtu, Gjykata theksoi se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI114/15
Parashtrues
Feride Aliu - Shala
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. Nr. 95/2015,
të 12 majit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Feride Aliu-Shala nga Mitrovica (në tekstin e mëtejmë:parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 95/2015, të 12 majit 2015, i cili i është dorëzuar asaj më 21 maj 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 95/2015, të 12 majit 2015.

4. Parashtruesja pretendon se janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin113.7të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenet 47 dhe 48 tëLigjit përGjykatënKushtetuese të Republikëssë Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 shtator 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 tetor2015,KryetarjaeGjykatës caktoigjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dheKolegjin shqyrtues,të përbërënga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues),Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 8 dhjetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që ta plotësojë formularin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 8 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 16 gusht 2011, parashtruesja e kërkesës, me profesion police, në ndërtesën e Stacionit Policor në pjesën jugore të Mitrovicës, në mënyrë që të përvetësojë fitim material për vete në mënyrë të paligjshme, vodhi shumën prej 12 euro nga palët e dëmtuara N. A. dhe H. N.

11. Më 24 prill 2012, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ngriti aktakuzë kundër parashtrueses së kërkesës nën dyshimin se ka kryer veprën penale të "vjedhjes", siç parashihet me nenin 325 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

12. Më 25 korrik 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktvendimin P. nr 40/12 konstatoi se: (i) provat në të cilat mbështetet aktakuza e Prokurorit Publik nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme, (ii) vërtetimi për konfiskimin e objekteve (kartëmonedhës) dhe deklaratat e palëve të dëmtuara dhe të parashtrueses së kërkesës janë shpallur të papranueshme, (iii) provat të papranueshme duhet të veçohen nga shkresat e lëndës dhe (iv) propozimi i parashtrueses së kërkesës për hedhjen e aktakuzës do të vendoset me një vendim të veçantë. Gjykata e shkallës së parë arsyetoi se provat duhet të deklarohen të papranueshme për shkak se Prokurori Publik dhe Policia e Kosovës kanë vepruar pa urdhër të gjykatës dhe në këtë mënyrë kanë shkelur Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) dhe Ligjin për Policinë.

13. Më 1 gusht 2013, Prokurori Publik parashtroi ankesë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë - në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Prokurori Publik u ankua se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale, përveç vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

14. Më 4 tetor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin P. nr. 573/2013: (i) aprovoi ankesën e Prokurorit Publik në lidhje me pranueshmërinë e provave dhe e ktheu rastin për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë dhe (ii) vërtetoi gjetjen e gjykatës së faktit në lidhje me konfiskimin e sendeve.

15. Sa i përket pranueshmërisë së provave, në pjesën përkatëse të Vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës thuhet:

> *"Me ankesën e prokurorisë aktvendimi ankimohet për shkak të vendimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se në bazë të deklaratave që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se intervistimi është bërë për veprën penale të dt. 16.08.2011, e jo në mënyrë selektive sikur ka vepruar*

gjykata sa i përket përqëndrimit me prova për konfiskimin e kartëmonedhës, ashtu që në bazë të autorizimeve të cilat i ka policia në kuptim të nenit 70 të KPPK i përkasin një mori autorizimesh, duke precizuar aktivitetin në nenin 70 par.3 pika 1.13 të KPPK "të ndërmerr hapa dhe veprime tjera të nevojshme sikurse përcaktohet me ligj". E duke ndjekur këtë dispozitë ligjore, në mënyrë të qartë vihet te përfundimi se pas pranimit të informatës për një vepër penale të dyshuar, policia ndërmerr të gjitha veprimet në kuadër të autorizimeve të veta. duke vepruar gjithnjë brenda autorizimeve ligjore".

16. Përkitazi me konfiskimin e sendeve (kartëmonedhës), në pjesën përkatëse të vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës theksohet:

"Kolegji ka vlerësuar ankesën si dhe shkresat tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha veprimet e ndërmarra janë të pranueshme në këtë fazë të procedurës, përveç çështjes sa i përket vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve të dt. 17.08.2011, nr. 2011-BC-1696, për të cilën gjykata ka vepruar që të njëjtën ta shpall si provë të papranueshme, nga se ndjekja e procedurës nuk është bërë konform dispozitave përkatëse ligjore, andaj është shkelur dispozita e nenit 105, par.5 të KPPK, e cila me aktvendim është shpallur e papranueshme".

17. Më 25 korrik 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin P. nr. 40/2012 konstatoi se:

"*PROPOZIM AKUZA REFUZOHET sepse më 16 gusht 2011 në lokalet e stacionit policor jugor-Mitrovicë (parashtruesja e kërkesës) me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm të dëmtuarave N.A. dhe H.N. ua ka marrë shumën e parave prej 12 euro ashtu që duke shfrytëzuar rastin derisa të dëmtuarat nuk gjindeshin në zyrën e tyre".*

ËSHTË SHPALLUR FAJTORE sepse (parashtruesja e kërkesës) më 17 gusht 2011 në orën 10:00 në stacionin policor jugor-Mitrovicë duke shfrytëzuar rastin derisa personeli për pastrim nuk ishte në zyrë i ka marrë shumën prej 5 euro me numrin serik X25186104209 nga çanta personale e të dëmtuarës H.N.".

18. Gjykata Themelore në Mitrovicë konstatoi se parashtruesja e kërkesës është fajtore, për shkak të kryerjes së veprës penale të vjedhjes nga neni 325 i KPK-së dhe u dënua me 1 (një) vit burgim, ekzekutimi i të cilit është shtyrë për 3 (tre) vjet me kusht që parashtruesja nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër brenda periudhës së caktuar.

19. Më 20 tetor 2014, parashtruesja parashtroi ankesë kundër vendimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë - në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Parashtruesja e kërkesës, *inter alia*, pretendoi para Gjykatës së Apelit shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale dhe materiale, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe dënimit të parashtrueses së kërkesës.

20. Më 10 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin PA1. nr. 1407/2014 aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me dënimin e parashtrueses duke dënuar parashtruesen e kërkesës me 4 (katër) muaj burgim, i cili nuk do të ekzekutohet brenda 1 (një) viti me kusht që parashtruesja të mos kryejë ndonjë vepër tjetër brenda periudhës së caktuar.

21. Sa i përket pranueshmërisë së provave, në pjesën përkatëse të vendimit të Gjykatës së Apelit thuhet:

"Pretendimi i mbrojtësit të të pandehurës se gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike aktgjykimin e ka mbështetur vetëm në deklaratën e të dëmtuarës NA e pjesërisht edhe në atë të pandehurës Feride Shala, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pretendimi se aktgjykimi mbështetet vetëm në dëshmi të të dëmtuarës, dhe të dëshmitarëve, e në deklaratën e të pandehurës, sepse këto nuk janë prova të vetme në këtë çështje juridiko penale, por gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur edhe në prova tjera e në radhë të parë në deponimet e dëshmitarit, SR dhe AR, por edhe në një mori provash tjera materiale te cilat gjenden ne shkresat e lëndës".

22. Sa i përket ndryshimit të dënimit, në pjesën përkatëse të Vendimit të Gjykatës së Apelit theksohet:

"Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt i ka konstatuar rrethanat lehtësuese, mirëpo qasja, vlerësimi ndaj tyre nuk ka qenë i drejtë, meqë të pandehurës i është shqiptuar dënimi mbi limitin e paraparë ligjor për këtë vepër penale, prandaj, duke pasur parasysh këtë si dhe faktin se që nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë, kjo gjykatë të pandehurës i shqiptoj dënimin si në dispozicion të këtij aktgjykimi me bindje se dënimi i shqiptuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurës si ekzekutore dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit të 41 të KPRK-së ".

23. Më 31 mars 2015, parashtruesja parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Parashtruesja pretendoi shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale dhe materiale nga gjykatat e instancës më të ulët. Parashtruesja u ankua, *inter alia*, që: (i) ka një kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet arsyetimit të vendimeve të marra nga gjykatat e ulëta dhe përmbajtjes së procesverbalit në lidhje me deklaratat e bëra në këtë çështje penale (ii) se vendimet e kontestuara janë të bazuara në prova të papranueshme dhe nuk përmbajnë arsye për faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale dhe (iii) gjykata e instancës më të ulët nuk ka ftuar dëshmitarët e propozuar nga parashtruesja e kërkesës.

24. Më 12 maj 2015, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Pml. nr. 95/2015 refuzoi kërkesën e parashtrueses për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar kundër vendimeve të gjykatave të shkallës më të ulët.

25. Përkitazi me pranueshmërinë e provave, në pjesën përkatëse të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme thuhet:

"Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, qëndron fakti se prova e lartcekur është shpallur e papranueshme dhe si e tillë është veçuar nga shkresat e lëndës, mirëpo me shikimin në shkresat e çështjes e sidomos në procesverbalet e seancave gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, kjo Gjykatë vërtetoi se vërtetimi mbi konfiskimin e kartëmonedhës prej 5 eurove me numër serik X25186104209 nuk është nxjerrë si provë dhe aktgjykimi nuk është bazuar fare në këtë provë, por aktgjykimi është bazuar në një mori provash tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Po ashtu, qëndron fakti se gjykata e shkallës së parë asnjëherë nuk ka vendosur për vlefshmërinë e provave të lartcekura, pasi që Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin Ap.nr.573/13 të datës 4.10.2013, ka vendosur që vendimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket deklaratave të dëshmitarëve HN, NA dhe të dënuarës Feride Shala të dhëna në polici me datën 17.8.2011. të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, mirëpo këto deklarata më asnjëherë nuk janë lexuar dhe nuk janë nxjerrë si prova në shqyrtimet gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, mirëpo dëshmitarët dhe e dënuara janë dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor andaj nga këto deklarata dhe nga provat tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar gjendja faktike".

26. Sa i përket marrjes në pyetje të dëshmitarëve, në pjesën relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme theksohet:

"Kjo Gjykatë konsideron se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është bazuar në provat e administruara në shqyrtime gjyqësore dhe se deklaratat e dëshmitarëve janë dhënë konform dispozitave të procedurës penale, ndërsa fakti se ato kanë ndërmarrë veprime të cilat pastaj kanë shërbyer si prova kundër të dënuarës nuk mund të merren si të kundërligjshme sepse janë ngjarje të cilat i kanë parapri vet rrjedhës së veprimeve inkriminuese të të dënuarës. Se gjykata nuk ka ftuar dëshmitarë tjerë të cilët kanë qenë në dijeni për tërë këtë ngjarje, nuk do të thotë se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur prova të mjaftueshme për vërtetimin e fajësisë për të dënuarën".

27. Sa i përket shkeljes së ligjit në dëm të parashtrueses së kërkesës, në pjesën relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme theksohet:

"*Duhet të theksohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin. ka bërë shkelje në dëm të të dënuarës, me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, duke e kushtëzuar me 3 (tre) vjet, meqenëse për veprën penale për të cilën është shpallur fajtore të vjedhjes nga neni 325 par. 2 i KPK, maksimumi i dënimit të paraparë është dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Mirëpo, gjykata e shkallës së dytë duke miratuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarës dhe duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe duke ia shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, në qoftë se e dënuara nuk kryen vepër të re penale ne afat prej 1 (një) viti , ka revokuar këtë shkelje andaj ky pretendim se është shkelur ligji në dëm të të dënuarës nuk është më i qëndrueshëm".*

28. Lidhur me atë se a ka qenë vepra e papërfillshme në mënyrë që të kërkohet aktgjykim lirues në dobi të parashtrueses së kërkesës, në pjesën relevante të aktgjykimit të Gjykatës Supreme theksohet:

"Pretendimi se është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarës, meqenëse e njëjta është shpallur fajtore për veprën penale të vjedhjes nga neni 325 par. 2 te KPK, ku shuma e parave te vjedhura është 5 euro, dhe kemi të bëjmë me vepër penale të rëndësisë së vogël nga neni 7 të KPK, nuk qëndron, në fakt është shkelur ligji penal në favor të dënuarës nga gjykata e shkallës së parë me rastin e ricilësimit të veprës penale", dhe e shpalljes fajtore për veprën penale të vjedhjes nga neni 325 par 2 të KPK, për faktin se nga çanta e të dëmtuarës përvetëson shumën prej 5 euro. dhe nuk bëhet fjalë për vepër të rëndësisë së vogël, sepse cilësimi juridik i kësaj vepre penale varet nga mënyra e kryerjes e jo nga sasia e të hollave të përfituara në mënyrë të kundërligjshme. Në momentin e përvetësimit e të hollave nga çanta e të dëmtuarës, e dënuara nuk ka pasur mundësi të dijë për sasinë e të

hollave të cilat ishin në çantë, andaj në rastin konkret është irelevante sasia e të hollave për kryerjen e kësaj veprës penale".

Ligji

Në pjesën relevante të Kodit Penal të Republikës së Kosovës thuhet:

Neni 325
Vjedhja

"Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj".

Në pjesën relevante të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës theksohet:

Neni 70
Veprimet hetimore të policisë

"Pas pranimit të informatës për një vepër penale të dyshuar, policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës të jetë kryer.

Policia heton veprat penale dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.

Për të kryer detyrat nga ky nen, policia është e autorizuar që:

[...]

të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe të urdhërojë testimin mjeko-ligjor të atyre provave nga laboratori i mjekësisë ligjore në pajtim me nenin 71 të këtij Kodi;

të merr në pyetje dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm në pajtim me nenin 73 të këtij Kodi;

të ndërmerr hapa dhe veprime tjera të nevojshme siç përcaktohet me ligj".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesja e kërkesës pretendon se janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: *"Aktgjykimin Gjykata e ka bazuar në prova të pa pranueshme, siç ishte vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve ku monedha prej 5*

euro, me numër serik X25186104209 e cila edhe me vendimin e Gjykatës së shkallës së parë të datës 25.07.2013 është shpallur provë e papranueshme".

31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: "*Në vendimet e gjykatave të rregullta është përmendur se janë lexuar raportet policore të policëve ZX dhe AZ, megjithatë ata është dashur ti ftoj këta që të deklarohen sipas nenit 329 paragrafi 4 të KPPK-së".*

32. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: *"Gjykata e Apelit, gjatë vendosjes lidhur me ankesën e të pandehurës, nuk e pa të udhës që të hynte në më shumë detaje lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike".*

33. Parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës është i padrejtë dhe prandaj është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.

34. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme, (ii) të konstatojë shkelje të neneve 21, 24, 31, 33, 54 të Kushtetutës, nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ) dhe nenin 6 të Konventës dhe (iii) të përcaktojë ndonjë të drejtë apo përgjegjësie për palët në këtë kërkesë të cilat kjo Gjykatë e nderuar i konsideron si ligjërisht të bazuara dhe të arsyeshme.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i kapërmbushurkriteret epranueshmërisë,të përcaktuarame Kushtetutë dhe të specifikuaramë tejnëLigj dhe në Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

37. Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

38. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 2 (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

39. Sa i përket pretendimeve të pranueshmërisë së provave, Gjykata konsideron se, edhe pse neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, ato nuk përcaktojnë ndonjë rregull mbi pranueshmërinë e provave të tilla, të cilat, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë, janë kryesisht çështje të ligjshmërisë. Në veçanti, nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat

dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (Shih rastin e *Schenk kundër Zvicrës*, [GC], kërkesa nr. 10862/84, Aktgjykimi i 12 korrikut 1988, par. 45-46).

40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se detyra e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë provat (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

41. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 6 § 3 (d) të Konventës, Gjykata rikujton se si rregull i përgjithshëm, gjykatat e rregullta duhet të vlerësojnë provat përpara tyre, si dhe rëndësinë e dëshmive të cilat të pandehurit kërkojnë që t'i sjellin. Neni 6 § 3 (d) ua lë atyre, përsëri si një rregull i përgjithshëm, që të vlerësojnë nëse është e përshtatshme që të ftohen dëshmitarët. Nuk kërkon praninë dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të akuzuarit; Qëllimi i tij thelbësor, siç tregohet nga fjalët "*me të njëjtat kushte"*, është *"barazia e plotëe armëve"* në këtë çështje. Në pajtim me këtë, nuk është e mjaftueshme që parashtruesja të ankohet se asaj nuk i është lejuar të merren në pyetje disa dëshmitarë; ajo duhet, përveç kësaj, të mbështesë kërkesën e saj duke shpjeguar se pse është e rëndësishme që dëshmitarët në fjalë të dëgjohen, dhe dëshmitë e tyre duhet të jenë të domosdoshme për përcaktimin e së vërtetës dhe të drejtat e mbrojtjes (Shih, midis autoriteteve të tjera, *Perna kundër Italisë*, [GC], kërkesa nr. 48898/99, Aktgjykim i 6 majit 2003, para. 29).

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja pretendon: "*në vendimet e gjykatave të rregullta është përmendur se raportet e policëve ZX dhe AZ ishin lexuar, megjithatë ata duhet të ishin ftuar për të deklaruar vetë*".

43. Në lidhje me pretendimin e lartpërmendur, Gjykata i referohet arsyetimit të Gjykatës së Apelit:"*... nuk qëndron pretendimi i të pandehurit sepse këto nuk janë prova e vetme në këtë çështje juridiko penale, por gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur edhe në prova tjera e në radhë të parë në deponimet e dëshmitarit SR dhe AR, por edhe në një mori provash tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës".*

44. Në dritën e pretendimeve të parashtrueses dhe arsyetimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata duhet të shqyrtojë dy çështje kryesore: (i) nëse parashtrueses i është dhënë mundësia adekuate për të kontestuar deponimet e dëshmitarëve Z. X. dhe A. S. dhe (ii) nëse deklarata e dëshmitarëve Z. X. dhe A. S. janë prova e vetme apo vendimtare kundër parashtrueses (Shih për shembull, *rasti Luca v. Italisë* [GJEDNJ] Kërkesa nr. 33354/96, Aktgjykimi i 27 shkurtit 2001, paragrafi 40 dhe gjithashtu shih *mutatis mutandis* rastin *Shcoler v. Gjermanisë* [GJEDNJ], Kërkesa nr. 14212/10, Aktgjykimi i 18 marsit 2015, paragrafët 48-49).

45. Gjykata konsideron se përmbajtja e kërkesës zbulon se: (i) parashtrueses i është dhënë mundësia të kontestojë deponimet e dëshmitarëve Z. X. dhe A. S. në të gjitha procedurat gjyqësore dhe ankimore në gjykatat e rregullta; dhe (ii) deklaratat e dëshmitarëve Z. X. dhe A. S. ishin të rëndësishme por jo të vetmet apo vendimtare për rezultatin e rastit të parashtrueses për shkak se gjykatat e rregullta, përveç kësaj, gjithashtu kanë bazuar konkluzionet e tyre në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë dhe në një mori provash tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

46. Për më tepër, Gjykata vëren se në kontekstin e këtij rasti, mungesa e dëshmitarëve Z. X. dhe A. S. si dhe pranimi i deponimeve të tyre si prova nuk do të rezultojë në mënyrë automatike në shkelje të nenit 6 § § 1dhe 3 të Konventës (Shih *Scholer v. Gjermanisë*).

47. Gjykata vëren se gabimet e faktit dhe të ligjit, që pretendohen të jenë kryer gjatë procedurave të rregullta në gjykatat e faktit, më vonë ishin korrigjuar në procedurën e ankesës nga Gjykata e Apelit dhe Gjykatës Supreme respektivisht, duke i adresuar deri në një masë të konsiderueshme çështjet e pranueshmërisë së provave, marrjes në pyetje të dëshmitarëve, natyrës së veprës së kryer nga parashtruesja dhe lartësisë së dënimit të parashtrueses së kërkesës që ishin të gjitha çështje qendrore për atë rast.

48. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

49. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

50. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

51. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Konventë apo DUDNJ, sepse faktet e paraqitura nga ajo në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar asaj të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

52. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 8 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI62/15, Parashtrues Xhavit Shala, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4332/2012, të 26 nëntorit 2014

KI62/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 15 mars 2016 dhe publikuar më 17 maj 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, mbrojtja e pronës, kërkesë e paafatshme*

Gjykatat e rregullta kishin refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit për kompensim për shkak të shpronësimit.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtën e tij për mbrojtje të pronës.

Gjykata vlerësoi e kërkesa ishte dorëzuar pas afatit ligjor 4 (katër) mujor të përcaktuar me ligj. Kërkesa u deklarua e papranueshme sepse ishte e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI62/15
Parashtrues
Xhavit Shala
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4332/2012, të 26 nëntorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Xhavit Shala nga fshati Mushtisht, komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Ismet Islami, avokat në Suharekë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), Ac. nr. 4332/2012, të 26 nëntorit 2014, i cili i ishte dorëzuar atij më 11 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 24 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 29 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prizren e njoftoi Gjykatën se kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i kontestuar.

9. Më 28 janar 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë dokumente shtesë të nevojshme për të plotësuar kërkesën e tij.

10. Më 15 shkurt 2016, parashtruesi i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

11. Më 15 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 26 tetor 2005, Gjykata Komunale në Suharekë (Aktgjykimi C. nr. 55/05) e aprovoi padinë e parashtruesit dhe e obligoi Komunën e Suharekës që t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës një shumë për tokën e shpronësuar. Komuna e Suharekës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër vendimit të 26 tetorit 2006.

13. Më 22 shtator 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ec. nr. 510/05), anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 26 tetorit 2006 dhe e ktheu rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

14. Më 17 shtator 2010, Gjykata Komunale në Suharekë (Aktgjykimi C. nr. 285/2006), e refuzoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës.

15. Më 5 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 598/2010) e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të 17 shtatorit 2010.

16. Më 16 tetor 2012, Gjykata Komunale në Suharekë e refuzoi kërkesën për revizion të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi parashtroi ankesë.

17. Më 26 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 4332/2012) e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale të 16 tetorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit ishte shkelur e drejta e tij për mbrojtje të pronës.

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e privoi atë nga e drejta e tij për mbrojtje të pronës, sepse sipas tij ajo *"nuk e njoftoi parashtruesin lidhur me rregullat që janë paraparë në dispozitat e nenit 218 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e Apelit theksoi se kërkesa për revizion është e palejuar dhe se në shkresat e lëndës vlera e kontestit në padinë e paditësit është caktuar në shumën prej 100 € dhe revizioni nuk është i lejuar dhe se është dashtur të ceket vlera e kontekstit në shumën prej 3.000 € dhe revizioni është hedhur poshtë si i palejuar që d.m.th që Gjykata është dashur ta njoftojë palën paditëse lidhur me pasojat e kontestit të caktuar në shumën prej 100 € e jo ta hedhë poshtë revizionin si të palejuar".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

22. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

"*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".*

23. Gjykata, më tej, merr parasyshrregullin36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
...
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".

24. Gjykata vëren se Aktvendimi, Ac. nr. 4332/2012, i Gjykatës së Apelit është nxjerrë më 26 nëntor 2014 dhe i është dorëzuar parashtruesit më 11 dhjetor 2014, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas më shumë se 5 (pesë) muaj, përkatësisht më 15 maj 2015.

25. Rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë pas skadimit të 4 (katër) muajve, që nga dita kur Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

27. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe prandaj, është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI48/14 dhe KI49/14, Parashtrues Komuna e Vushtrrisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri: (1) CP. nr. 46/14, të 6 marsit 2014, (2) CP. nr. 49/14, të 6 marsit 2014, (3) CP. nr. 53/14, të 6 marsit 2014, (4) CP. nr. 52/14, të 11 marsit 2014, (5) CP. nr. 54/14, të 11 marsit 2014 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014

KI48/14 dhe KI49/14, Aktvendim për papranueshmëri i 15 marsit 2016, publikuar më 17 maj 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për ankesë, çështje pa objekt, kërkesë e parakohshme, masa të përkohshme*

Gjykata Komunale në Vushtrri, kishte lejuar përmbarimin e të gjithë propozuesve lidhur me shumën e kompensimit monetar në emër të pronave të eksproprijuara e në dëm të parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit bazuar në ankesat e parashtruesit në çështje identike juridike kishte nxjerrë vendime të ndryshme.

Parashtruesi pretendoi se me këto vendime është shkelur neni 31 [E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe neni 102, paragrafi 5 [E drejta e ankesës] i Kushtetutës së Kosovës. Parashtruesi po ashtu kërkoi vënien e masave të përkohshme.
Gjykata konstatoi se sa u përket çështjeve të ngritura lidhur me lëndët në procedurën e iniciuar nga Prokurori i Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme kishte nxjerrë vendime përfundimtare në favor të parashtruesit dhe rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës së parashtruesit ishte çështje pa objekt.
Kurse për pjesën tjetër të kërkesës së parashtruesit, Gjykata konstatoi se është e parakohshme sepse procedura në gjykatat e rregullta ishte në zhvillim e sipër dhe se akoma nuk kishte vendim përfundimtar. Kërkesa u deklarua e papranueshme për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike. Po ashtu, kërkesa për masa të përkohshme u refuzua.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastet e bashkuara
nr. KI48/14 dhe nr. KI49/14
Parashtrues
Komuna e Vushtrrisë
Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri:
(1) CP. nr. 46/14, të 6 marsit 2014,
(2) CP. nr. 49/14, të 6 marsit 2014,
(3) CP. nr. 53/14, të 6 marsit 2014,
(4) CP. nr. 52/14, të 11 marsit 2014,
(5) CP. nr. 54/14, të 11 marsit 2014
dhe
të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14,
të 27 qershorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja), e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, z. Idriz Muzaqi.

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën e bashkuar parashtruesja i konteston këto vendime të nxjerra në procedurën përmbarimore nga Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), Aktvendimi CP. nr. 46/14, Aktvendimi CP. nr. 53/14 dhe Aktvendimi CP. nr. 49/14, të 6 marsit 2014, Aktvendimi CP. nr. 52/14 dhe Aktvendimi CP. nr. 54/14, të po kësaj gjykate, të 11 marsit 2014. Me parashtresën për zgjerimin e kërkesës, parashtruesi ka kontestuar edhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014, me të cilin u vërtetua aktvendimi i kontestuar CP. nr. 53/14, të cilin e kishte pranuar ndërkohë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së 5 (pesë) aktvendimeve të lartpërmendura të nxjerra në procedurën përmbarimore nga Gjykata Themelore si dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të cilat, sipas parashtrueses i kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë sipas nenit 31 (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe nenit 102.5 (Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor-e drejta e ankesës).

4. Parashtruesja e kërkesës pretendon, *inter alia*, se çdo aktvendim është nxjerrë me shkelje të "*... nenit 102, paragrafi 5, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse Komunës nuk i është mundësuar e drejta në ankesë në procedurë jashtëkontestimore".*

5. Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të vendosë Masë të përkohshme në pjesën ku vendimet në procedurë përmbarimore ishin përfundimtare, duke kërkuar veçanërisht pezullimin e përmbarimit të Aktvendimit Ac. nr. 1369/14, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 27 qershorit 2014.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22, 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 mars 2014, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të cilat u regjistruan me numrat vijues: KI48/14 dhe KI49/14.

8. Më 24 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesave KI48/14 dhe KI49/14, si dhe ia dërgoi kopjet e kërkesave Gjykatës Themelore.

9. Më 16 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, urdhëroi bashkimin e kërkesës KI48/14 me kërkesën KI49/14. Me këtë urdhër ishte vendosur që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë, siç ishte vendosur me Vendimin nr. KSH. KI49/14.

10. Më 22 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Themelore për bashkimin e kërkesave.

11. Më 25 qershor 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës informata shtesë lidhur me kërkesat KI48/14 dhe KI49/14. Në letër, Gjykata, *inter alia*, kërkoi nga parashtruesja e kërkesës "*Nëse Komuna e Vushtrrisë ishte ankuar kundër vendimeve të kontestuara*".

12. Më 3 korrik 2014, Gjykata pranoi kopjet e ankesave kundër të 5 (pesë) aktvendimeve të kontestuara, të dorëzuara nga parashtruesja e kërkesës në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

13. Më 29 korrik 2014, parashtruesja e kërkesës zgjeroi një pjesë të kërkesës KI48/14, me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014.

14. Më 3 tetor 2014, Gjykata, e njoftoi Gjykatën e Apelit të Kosovës për zgjerimin e një pjese të kërkesës KI48/14, si dhe i dorëzoi një kopje të kërkesës kësaj Gjykate.

15. Më 20 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me vendim caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

16. Më 21 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues.

17. Më 15 prill 2015, Gjykata e aprovoi, me shumicë votash, kërkesën e gjyqtares Arta Rama-Hajrizi për përjashtim nga vendosja lidhur me kërkesën, pasi që ishin përmbushur kushtet sipas nenit 18 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

18. Më 26 qershor 2015, gjyqtarët Enver Hasani e Kadri Kryeziu përfunduan mandatin në Gjykatë dhe, duke marrë parasysh vendimin për tërheqje nga rasti të një gjyqtari, Gjykata nuk mund të procedonte më tej me kërkesën për shkak të mungesës së kuorumit, të paraparë me nenin 19.2 të Ligjit.

19. Më 30 dhjetor 2015, Presidentja e Kosovës dekretoi gjyqtaret: Gresa Caka-Nimani dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, kështu që ishin përmbushur kushtet ligjore për vazhdimin e procesit të shqyrtimit të kërkesës.

20. Më 21 janar 2016, Gjykata i kërkoi Komunës së Vushtrrisë të njoftojë Gjykatën lidhur me ndryshimet eventuale statusore të kërkesave si dhe të dërgojë në Gjykatë dokumente të tjera shtesë, nëse të tilla posedon.

21. Më 5 shkurt 2016, Gjykata pranoi një përgjigje me shkrim nga komuna dhe gjithashtu edhe kopjet e vendimeve të reja gjyqësore lidhur me rastet.

22. Më 15 mars 2016, Kolegjishqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

23. Më 10 tetor 1986, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë nxori Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ekspropriimin e tri parcelave kadastrale (gjegj. parcelat: Nr. 2238/2, Nr. 2239/2 dhe Nr. 2240/2, të cilat gjenden në Komunën Kadastrale të Vushtrrisë) për ndërtimin e stacionit të ri të autobusëve për nevojat e Organizatën Themelore të Punës së Bashkuar (OTHPB) “Kosovatrans”.

24. Në vitin 1987 (data e paspecifikuar), OTHPB “Kosovatrans” e informoi Drejtorinë Komunale për marrëdhënie pronësoro-juridike se ata i kishin siguruar mjetet financiare për kompensim monetar të pronarëve të mëparshëm të tokës së eksproprijuar. Në bazë të kësaj, Drejtoria komunale nxori një Aktvendim lidhur me shumën e kompensimit.

25. Të pakënaqur me shumën e akorduar për kompensim, pesë pronarë të mëparshëm (gjegjësisht SH. P., F. P., T. P., A. P. dhe B. Zh.) iniciuanprocedurën jashtëkontestimore në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me kërkesë për përcaktim të shumës së kompensimit, në përputhje me Ligjin e aplikueshëm për procedurën jashtëkontestimore.

26. Përderisa rasti ishte në pritje në Gjykatën Komunale në Vushtrri, në Kosovë kishte filluar lufta. Lokaleve të Drejtorisë Komunale për Çështje Pronësore në Vushtrri iu vu zjarri, ndërsa shkresat e rastit të Gjykatës Komunale, sipas parashtrueses së kërkesës, ishin transferuar në Kralevë, Republika e Serbisë.

27. Pas kërkesave të pronarëve të mëparshëm, më 14 shtator 2005, Gjykata Komunale në Vushtrri nxori Aktvendimin, Nr. 344/2005 dhe urdhëroi përtëritjen e shkresave të lëndës në Gjykatën Komunale në Vushtrri (Rasti nr. 579/1989).

28. Më 13 janar 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri nxori Aktvendimin nr. 344/2005 lidhur me kërkesën e pesë pronarëve të mëparshëm për kompensimin e pronës së shpronësuar, duke aprovuar kërkesën e tre prej tyre (gjegjësisht, F. P., T. P. dhe A. P.) në lidhje me kundër propozuesin NT "Kosovatrans", ndërsa për dy prej tyre SH. P. dhe B. ZH, Gjykata kishte vendosur që në bazë të nenit 333, par 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të hedhë poshtë kërkesën e tyre për shkak se lënda e tyre tashmë ishte vendosur me Vendim të Gjykatës Supreme të Serbisë, sepse këta dy parashtrues kishin vazhduar procedurat gjyqësore edhe në gjykatat e atëhershme. Megjithatë, këta dy parashtrues, udhëzohen që kompensimin për tokën e eksproprijuar mund ta realizojnë në procedurë përmbarimore.

29. Me vendimin e lartpërmendur ishte përcaktuar se NT "Kosovatrans" ishte përgjegjëse për kompensimin e tre pronarëve të mëparshëm të patundshmërive (F. P., T. P. dhe A. P.), dhe në vendim, Gjykata kishte përcaktuar shumën reale monetare e cila duhet t'u kompensohet ish pronarëve.

30. Me të njëjtin vendim u refuzua kërkesa e tre pronarëve të mëparshëm (F. P., T. P. dhe A. P) në lidhje me parashtruesen e kërkesës (komunën). Në vendim ishte theksuar si në vijim: "*Sa i përket kundër propozuesit - Komuna e Vushtrrisë, ... propozimi i F.P., T.P. dhe A.P. është refuzuar si i pa bazë, pasi që [d.m.th. komunës] i ka munguar legjitimacioni pasiv".*

31. Kundër propozuesit, NT "Kosovotrans" dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (që menaxhonte këtë kompani në atë kohë) kishin ushtruar ankesë kundër Aktvendimit nr. 344/2005, të 13 janarit 2006.

32. Komuna e Vushtrrisë nuk ishte ankuar, pasi që ishte theksuar se Komuna nuk kishte pasur statusin e palës në procedurë.

33. Më 5 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 409/12 dhe "*hedhet poshtë si e paafatshme (e vonuar) ankesa e kundër propozueses NT 'Kosovatrans' në Vushtrri, përkatësisht Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, nr. 344/2005, të dt. 13.1.2006".*

34. Pas këtij Aktvendimi, pesë pronarët e mëparshëm iniciuan procedurë përmbarimore në Gjykatën Themelore. Të gjithë ata kërkuan përmbarimin kundër parashtrueses së kërkesës, Komunës së Vushtrrisë, dhe jo kundër NP "Kosovatrans".

35. Gjykata Komunale në Vushtrri, me aktvendimet CP. nr. 46/14, CP. nr. 49/14, CP. nr. 52/14, CP. nr. 53/14 dhe CP. nr. 54/14, lejoi përmbarimin e të gjithë propozuesve.

36. Kundër të gjitha aktvendimeve në mënyrë individuale parashtruesi paraqiti kundërshtim në Gjykatën Themelore.

37. Më 6 mars 2014, përkatësisht më 11 mars 2014, Gjykata Themelore refuzoi, si të pabazuara kundërshtimet e parashtruesit.

38. Më 17 mars 2014, parashtruesi paraqiti ankesa me pretendime të njëjta ankimore në Gjykatën e Apelit kudër të pesë aktvendimeve, me të cilat u refuzuan kundërshtimet e tij për shkak të shkeljes së dispozitave të akteve materiale dhe të dispozitave procedurale.

39. Gjykata e Apelit bazuar në ankesat e parashtruesit në çështje identike juridike kishte nxjerrë vendime të ndryshme. Në Rastin CP. nr. 53/14 dhe CP. nr. 54/14 ka refuzuar ankesat e parashtruesit dhe ka vërtetuar aktvendimet e Gjykatës së shkallës së parë, në rastet CP. nr. 46/14, CP. nr. 49/14 dhe CP. nr. 52/14 ka prishur aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

40. Kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1365/14 dhe Ac. nr. 1369/14, me të cilat ishin refuzuar ankesat e Komunës dhe ishin vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë parashtruesi kishte paraqitur propozim për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Prokurorit të Shtetit.

41. Më 22 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin CML. nr. 3/14 në procedurën e iniciuar për mbrojtje të ligjshmërisë ka vendosur të ndryshojë Aktvendimin e Gjykatës se Apelit, Ac. nr. 1369/14, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore, CP. nr. 53/14, dhe ka refuzuar si të pabazuar kërkesat e kreditorit.

42. Më 22 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin CML. nr. 4/14, ka ndryshuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1365/14, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore, CP. nr. 54/14, duke refuzuar si të pabazuara, kërkesat e kreditorit.

43. Gjykata Supreme në të dy aktvendimet saj, duke iu referuar vendimeve të gjykatave të instancës së shkallës së parë dhe të dytë të nxjerra në procedurë përmbarimore, theksoi ndër të tjera: *"Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të pranoj një përfundim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë e të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar gabimisht te dispozitat procedurale dhe të drejtën materiale dhe është dashtë të ndryshohen aktvendimet e goditura".*

44. Më 5 shkurt 2016, parashtruesi zyrtarisht e ka informuar Gjykatën se lënda lidhur me Vendimin CP. nr. 52/14 është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së kreditorit, lënda CP. nr. 46/14 gjendet për herë të dytë në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së parashtruesit, ndërsa lënda lidhur me Vendimin CP. nr. 49/14, gjendet në rishqyrtim në Gjykatën e shkallës së parë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

45. Sa i përket të gjitha vendimeve të kontestuara, parashtruesi i kërkesës pretendon që *"me rastin e vendosjes së lëndës në procedurë përmbarimore, Gjykata ka bërë shkelje*

esenciale të dispozitave materiale dhe atë: 1) Shkelje të nenit 102, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse Komunës nuk i është mundësuar e drejta në Ankesë në procedurë jashtë kontestimore".

46. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se lidhur me të gjitha aktvendimet e kontestuara ka pasur shkelje të dispozitave të Ligjit për Eksproprijim, Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore.

47. Ndërsa, parashtruesi i kërkesës pretendon se kishte jokonsistencë në vendimmarrje, pasi që gjykatat në raste identike dhe me objekt të njëjtë shqyrtimi, kishin vendosur në mënyra të ndryshme herë duke aprovuar e herë duke refuzuar ankesat.

Pranueshmëria e kërkesës

48. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

49. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

dhe

Nenit 21.4 të Kushtetutës i cili përcakton:

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

50. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

51. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 32 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të ... nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest dhe nuk ka ndonjë rrethanë të veçantë lidhur me të drejtat e njeriut dhe ose interesin publik në mënyrë që Gjykata ta shqyrtojë kërkesën".

52. Gjykata konstaton se parashtruesit kishin kontestuar aktvendimet e Gjykatës Themelore si, Aktvendimi CP. nr. 46/14, Aktvendimi CP. nr. 53/14, dhe Aktvendimi CP. nr. 49/14 të 6 marsit 2014 dhe aktvendimet CP. nr. 52/14, dhe aktvendimet CP. nr. 54/14, të po kësaj Gjykate të 11 marsit 2014 dhe Ac. nr. 1369/14 të Gjykatës së Apelit.

53. Gjykata konstaton se natyra shumë komplekse e rastit, dokumentacioni i vazhdueshëm plotësues që gjykata ka pranuar pas dorëzimit të kërkesës, zhvillimi i vazhdueshëm i procedurave tjera gjyqësore në kohën kur kërkesa tashmë gjendej në këtë gjykatë e të cilat qenësisht kanë ndikuar në gjykimin Kushtetues të këtij rasti, e gjithashtu edhe çështjet të natyrës objektive lidhur me vet gjykatën, dhe të gjitha këto së bashku kanë diktuar drejtpërsëdrejti afatin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se dy herë radhazi me 14 dhe 15 prill 2015, gjykata ka shqyrtuar kërkesën pa mundur të nxjerrë një vendim përfundimtar për shkaqet e përmendura më lart.

54. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se dokumentacioni i dorëzuar në gjykatë pasi që kërkesa është regjistruar, por gjithsesi para se gjykata ta marrë një vendim përfundimtar dhe përdorimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike (në rastin konkret të cilësuara si efektive juridike) deri sa kërkesa ishte në pritje të vendosjes në masë të konsiderueshme e kishin ndryshuar natyrën juridike të rasteve në krahasim me fazën fillestare dhe Gjykata duhet të marrë parasysh dhe të shqyrtojë edhe këto vendime, si pjesë përbërëse e kërkesës.

55. Gjykata vëren se, sa u përket çështjeve të ngritura lidhur me lëndët CP. 53/14 dhe CP. 54/14, në procedurën e iniciuar nga Prokurori i Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë në këto lëndë Gjykata Supreme me aktvendimet CML. nr. 3/14 dhe CML. nr. 4/14, të 22 dhjetorit 2014, të njëjtat i kishte vendosur me vendim përfundimtar në favor të parashtruesit andaj, më nuk ekziston shkaku për të cilat ishte ngritur kërkesa e parashtruesit në Gjykatën Kushtetuese dhe rrjedhimisht nuk ka as merita të rastit për t'u shqyrtuar .

56. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas nenit 22, par 1, pika 2, të Kushtetutës së Kosovës zbatohet drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, në pjesën relevante e të aplikueshme në këtë rast parashikon si në vijim:

Neni 37
Çregjistrimi i kërkesave

"Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundim se:

...

b. çështja është zgjidhur...".

57. Si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk duhet të nxjerrë vendime për raste ku çështja nuk ekziston dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Gjykata nuk merret me raste hipotetike apo akademike. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbajtjes gjyqësore.

58. Për më tepër, Gjykata tashmë ka përcaktuar (në Rastin KI11/09, vendimi i 30 majit 2011, paragrafi 46, dhe rastet KI58/66 dhe KI94/12, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të Komunës së Mitrovicës, Gjilanit dhe Vitisë për kushtëzimin e shërbimeve komunale për qytetarët) se *"Koncepti i të qenit pa objekt shqyrtimi është koncept i mirënjohur ligjor. Mund të paraqitet në një rast kur një çështje abstrakte*

apo hipotetike paraqitet për t'u vendosur në Gjykatë. Ka baza të mira që një Gjykatë të mos merret me situata hipotetike. Pa pasur një çështje të vërtetë, të menjëhershme apo konkrete për të cilën duhet të vendoset". Gjykata, në fakt, çfarëdo vendimi që do të merrte tani lidhur me meritat eventuale të kërkesave nuk do të kishte një efekt praktik.

59. Duke marrë parasysh aktvendimet e Gjykatës Supreme lidhur me aktvendimet e kontestuara, CP. nr. 53/14 dhe CP. nr. 54/14, dhe ndryshimin e këtyre aktvendimeve, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës tani nuk kanë më rast për këtë pjesë të kërkesës apo kontest të pazgjidhur dhe, në raport me këtë pjesë të kërkesës, janë përmbushur të gjitha kushtet që në përputhje me rregullin 32 të Rregullores, ajo të hedhet poshtë.

60. Në shqyrtimin e mëtutjeshëm të kërkesës, Gjykata vëren se procedurat lidhur me tri lëndët e mbetura është akoma duke u zhvilluar në gjykatat e rregullta dhe atë:

lënda CP. nr. 46/14, në Gjykatën e Apelit
lënda CP. nr. 49/14, në Gjykatën e Apelit dhe
lënda CP. nr. 52/14, në Gjykatën Themelore
dhe për këto lëndë, akoma nuk ka një vendim përfundimtar.

61. Gjykata rikujton, që në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesja e kërkesës është e obliguar që të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç parashihet me nenin 113.7 dhe dispozitat tjera ligjore, siç u përmendën më lart.

62. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull, bazohet në supozimin, se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, ndër shumë të tjerë, Aktvendimin për papranueshmëri: *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 21 janarit 2010, Rastin KI24/11, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011 dhe, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

63. Prandaj, në lidhje me tri vendimet e lartpërmendura, parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, pasi që procedurat në Gjykatën themelore dhe/ose në Gjykatën e Apelit janë ende në pritje.

64. Nga kjo rrjedh, se pjesa e kërkesave që kanë të bëjnë me këto lëndë (CP. nr. 46/14, CP. nr. 49/14 dhe CP. nr. 52/14) janë të parakohshme dhe duhet të deklarohen të papranueshme.

65. Në rrethanat e tilla të rastit, kur një pjesë e kërkesës qartazi duhet të refuzohet për shkak të mungesës së objektit për shqyrtim dhe pjesa tjetër e parakohshme. Gjykata nuk gjen arsye për të vlerësuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës, sepse për dy vendimet e para të kontestuara, edhe po të ketë pasur shkelje të tilla, ato janë përmirësuar me vendimet përfundimtare të Gjykatës Supreme ndërsa, për tri vendimet tjera, përderisa procedurat janë në zhvillim e sipër, Gjykata nuk mund të

vlerësojë ekzistimin eventual të shkeljeve të supozuara sepse ajo vlerëson procesin në tërësi.

Masa e përkohshme

66. Siç u përmend më lart, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë Masën e përkohshme për kërkesën KI48/14 lidhur me pezullimin e aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014, sepse *"përmbarimi i aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri dhe përkatësisht të Gjykatës së Apelit të Kosovës, do të mund të pësojë dëme të pariparueshme dhe gjithashtu të rrezikojë interesin publik"*.

67. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata vëren se pjesa për të cilën parashtruesja ka kërkuar aplikimin e Masës së përkohshme, tashmë është zgjidhur me aktvendimet e përmendura si më lart të Gjykatës Supreme dhe, më nuk ekzistojnë meritat e rastit e rrjedhimisht, as arsyeja për Masën e përkohshme andaj, si e tillë kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA HEDHË poshtë kërkesën KI48-49/14 (në lidhje me aktvendimet: CP. nr. 53/14);

III. TA DEKLAROJË kërkesën KI48-49/14 (në lidhje me aktvendimet CP. nr. 46/14, CP. nr. 49/14 dhe CP nr. 52/14) si të parakohshme;

IV. TA REFUZOJË kërkesën për vendosjen e Masës së përkohshme;

V. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI93/15, Parashtruesi i kërkesës: Ahmet Tërnava, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 12/2015, të 4 shkurtit 2015.

KI-93/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 prillit 2016, i publikuar më 18 maj 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, qartazi e pabazuar.*

Parashtruesi i kërkesës në vitin 2003, parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës. Në këtë procedurë gjyqësore, në cilësinë e të paditurës, ishte Korporata Energjetike e Kosovës, Kompania e thëngjillit "Kosova" (në tekstin e mëtejmë: KEK).

Kontesti është përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, e cila konstatoi se KEK-u nuk mund të jetë palë në procedurë për arsye se nuk ka legjitimitet pasiv.
Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe tërësisht shpjegon pse ka vërtetuar se gjykata e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se KEK-u në cilësinë e të paditurës nuk ka legjitimitet pasiv. Kësisoj, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata konstatoi se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI93/15
Parashtrues
Ahmet Tërnava
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2015, të 4 shkurtit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ahmet Tërnava nga fshati Lismir, komuna e Fushë-Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2015, i 4 shkurtit 2015.

3. Parashtruesi i kërkesës aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 20 mars 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 14 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

9. Më 14 shtator 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë fletëkthesën, e cila tregon se kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2015, i 4 shkurtit 2015.

10. Më 3 mars 2016, Gjykata e pranoi fletëkthesën e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që tregon se parashtruesi i kërkesës, aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar më 20 mars 2015.

11. Më 14 prill2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune si elektricist në Mihjen Sipërfaqësore, ish-Elektroekonomia (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi).

13. Më 11 gusht 1993, me arsyetimin se parashtruesi kishte shkaktuar dëm në vendin e punës, Komisioni Disiplinor i punëdhënësit nxori Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës. Kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin e Ankesave.

14. Më 8 shtator 1993, Komisioni i Ankesave refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin e Komisionit Disiplinor.

15. Më 20 mars 1996, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi K. nr. 2137/94) parashtruesin e kishte liruar nga akuza për shkaktimin e dëmit në punë.

16. Bazuar në shkresat e lëndës, në vitin 2003, parashtruesi i kërkesës, parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës. Në këtë procedurë gjyqësore, në cilësinë e të padituruës, ishte Korporata Energjetike e Kosovës, Kompania e thëngjillit "Kosova" (në tekstin e mëtejmë: KEK).

17. Më 4 korrik 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi, C1. nr. 36/03) miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës, anuloi si të kundërligjshme vendimet e dy organeve disiplinore të punëdhënësit dhe detyroi KEK-un ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës.

18. KEK-u parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 7 dhjetor 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 62/2006), refuzoi si të pabazuar ankesën e KEK-ut dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

20. KEK-u paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke pretenduar shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 15 maj 2008, Gjykata Supreme (Aktvendimi, Rev. nr. 61/2007) miratoi revizionin e KEK-ut, prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe atë të Gjykatës Komunale, duke e kthyer lëndën në rigjykim në shkallën e parë.

22. Gjykata Supreme, vendimin e saj për kthimin e lëndës në rigjykim e arsyetoi duke konstatuar se gjykatat e shkallës më të ulët për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike. Në lidhje me këtë, Gjykata gjeti se gjykatat e shkallës më të ulët nuk kanë marrë për bazë pretendimet e KEK-ut lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, përkatësisht zbatimin e Rregullores së KEK-ut për marrëdhënien e punës. Kjo Rregullore kishte pranuar cilësinë e marrëdhënies së punës punëtorëve të ish-Elektroekonomisë, të cilëve u kishte ndërpre marrëdhënia e punës mbi çfarëdo baze. Në bazë të kësaj Rregulloreje ishin ftuar punëtorët që të paraqiten në punë më së largu deri më 1 korrik 2000. Sipas Gjykatës Supreme, parashtruesi nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, duke mos u paraqitur në punë në afatin e caktuar.

23. Më 15 dhjetor 2011, në procedurë të rigjykimit, Gjykata Komunale në Prishtinë (C1. nr. 268/08) refuzoi, si të pabazuar padinë e parashtruesit, përmes të cilës kishte kërkuar anulimin e vendimeve të punëdhënësit të vitit 1993 dhe kompensimin për pagat e papaguara për periudhën 10 mars 1993 deri më 11 mars 2009.

24. Gjykata Komunale në Prishtinë gjeti se më 6 tetor 2000, KEK-u ishte regjistruar në regjistrin e përkohshëm të bizneseve të UNMIK-ut. Kjo Gjykatë, më tej, konstatoi se: *"fakti se Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e cila është themeluar dhe regjistruar pas luftës në Kosovë, në të njëjtat asete që i ka pasur ish Elektroekonomija e Kosovës me seli në Prishtinë, e pastaj në të ish Elektroekonomija e Serbisë, nuk nënkupton se e njëjta është trashëgimtare-suksesore e Ndërmarrjes Publike 'Elektroekonomija e Serbisë'"*.

25. Prandaj, Gjykata Komunale në Prishtinë konstatoi se KEK-u nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj paditësit dhe si rrjedhojë nuk ka detyrim për t'i kompensuar pagat e humbura, të saktësuara në padinë e tij.

26. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje të procedurës, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

27. Më 8 korrik 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi CA. nr. 4228/12) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

28. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj konfirmoi qëndrimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke konstatuar se parashtruesi *"[...] nuk provoi deri në përfundimin e*

shqyrtimit kryesor të çështjes e as në procedurë sipas ankesës se e paditura [KEK] *ka legjitimacion real pasiv në këtë çështje juridike […]".*

29. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Në vazhdim, parashtruesi pretendoi se KEK-u ishte trashëgimtare e ish-Elektroekonomisë dhe si rrjedhojë është e obliguar që t'i paguaj atij kompensimin për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës.

30. Më 4 shkurt 2015, Gjykata Supreme (Rev. nr. 12/2015) revizionin e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.

31. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se KEK-u nuk mund të jetë palë në procedurë për arsye se nuk ka legjitimitet pasiv.

32. Kësisoj, Gjykata Supreme i vlerësoi si të papranueshme pretendimet e parashtruesit se KEK-u si trashëgimtare e ish-Elektroekonomisë ka trashëguar edhe detyrimet në raport me ish-punonjësit e ish-Elektroekonomisë. Në fund, Gjykata konstatoi se KEK-u nuk është trashëgimtare e ish- ish-Elektroekonomisë dhe si rrjedhojë *"[…] nuk mund të marrë ndonjë detyrim nga marrëdhënia e punës së punëtorit të ish-Ndërmarrjes Publike Elektroekonomia […]".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar se si dhe pse janë shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

34. Në vijim, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të *"[…] të vlerësoj çështjen juridike se KEK-u ka legjitimitetin pasiv dhe e njëjta duhet të përgjigjet për obligimet e subjektit juridik – Elektroekonomia e Kosovës më vonë ndërron emrin në Elektroekonominë e Serbisë e pas luftës në Korporatë Energjetike e Kosovës që është një subjekt i njëjtë juridik".*

35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohen aktgjykimet e Gjykatës Supreme (Rev. 12/2015, të 4 shkurtit 2015), të Gjykatës së Apelit (Ca. nr. 4228/2012, të 8 korrikut 2014) dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë (C. nr. 268/2008, të 15 dhjetorit 2011) dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, parashikon:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në bazë të Kushtetutës, ai e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, se i ka shteruar mjetet e nevojshme juridike dhe se ka paraqitur kërkesën e tij brenda periudhës kohore prej 4 (katër) muajsh pas marrjes së aktgjykimit.

39. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 48 të Ligjit që përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

40. Përveç kësaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi ka plotësuar kriteret e përcaktuara me rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

42. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht deklaron se ka pasur shkelje të së drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa shpjeguar si dhe pse faktet e paraqitura nga ai përbëjnë shkelje të së drejtës së tij kushtetuese në të cilën ai është thirrur.

43. Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte konstatuar se Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se KEK-u, në cilësinë e të padituërs nuk mund të jetë palë në procedurë për arsye se nuk ka legjitimitet pasiv. Gjykata Supreme kishte përfunduar se KEK-u nuk është trashëgimtare e ish-Elektroekonomisë dhe, si rrjedhojë nuk ka

detyrim ndaj parashtruesit për pagesën e kompensimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës nga ana e ish-Elektroekonomisë.

44. Kësisoj, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe tërësisht shpjegon pse ka vërtetuar se gjykata e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se KEK-u në cilësinë e të paditurës nuk ka legjitimitet pasiv. Kësisoj, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjeti se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendim i 30 qershorit 2009).

45. Prandaj, Gjykata konsideron se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban të gjitha arsyet e nevojshme në të cilat është bazuar, në pajtim me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

46. Gjykata, thekson më tej, se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga Gjykata Supreme për mungesën e legjitimitetit pasiv të paditurës. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

47. Në fund, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).

48. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, nëpajtim me nenin 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin36 (2) (b) dhe (d) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 14 prill2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI132/15, Parashtrues Manastiri i Deçanit - Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

KI132/15, Aktgjykim i 19 majit 2016, i publikuar më 20 maj 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e pranueshme, res judicata, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës*

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme kishte vendosur në një kontest pronësor ndërmjet parashtruesit dhe palëve të treta në favor të parashtruesit dhe ai vendim kishte marrë formë të prerë *res judicata*. Palët e treta, ndërkohë, paraqitën ankesë tek Kolegji i Apelit që e pranoi ankesën e palëve të treta dhe konstatoi se ankesa ishte bazuar, anuloi vendimet e mëparshme për atë çështje dhe konstatoi se Dhoma e Posaçme nuk ishte kompetente për ta gjykuar atë çështje. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Kushtetuese, kryesisht për shkelje të parimit *res judicata* nga Kolegji i Apelit, asnjë nga palët e treta nuk kishte të drejtë ankimi pasi që ata në instancën e fundit ishin deklaruar si persona të cilët nuk ishin të autorizuar në procedurë dhe se Kolegji i Apelit nuk kishte të drejtë të shqyrtonte parashtresat e tyre.

Gjykata Kushtetuese së pari vlerësoi çështjet paraprake procedurale të këtij rasti përfshirë dhe sfondin e tij. Gjykata Kushtetuese, më pastaj, vlerësoi rastin në themelësi me ç'rast, ndër të tjera, konstatoi se Kolegji i Ankesave ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe i ka mohuar parashtruesit një gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse ka përdorur procedurën e ankesës për të anuluar vendimet e mëhershme dhe kishte referuar kontestin origjinal të pronësisë përsëri në gjykatat e rregullta. Gjykata Kushtetuese konkludoi se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për një proces të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31, paragrafi 2, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM
në
rastin nr. KI132/15
Parashtrues
Manastiri i Deçanit
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Manastirit i Deçanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e prezantuar nga Dragutin (Sava) Janjić, kryemurg i Manastirit të Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston dy vendime, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, që të dyja të 12 qershorit 2015, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të cilat parashtruesit i janë dorëzuar më 9 korrik 2015.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të lartpërmendura, me të cilat pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, respektivisht të pezullohet çdo procedurë gjyqësore, veprim apo vendim i autoriteteve publike në lidhje me këtë ankesë kushtetuese deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës përkitazi me këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4, 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 4 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI132/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, me Vendimin KSH. KI132/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 4 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Po të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Dhoma e Posaçme t'i sigurojë Gjykatës një listë të caktuar të dokumenteve shtesë.

9. Më 5 nëntor 2015, Dhoma e Posaçme dorëzoi dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

10. Më 9 nëntor 2015, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

11. Më 12 nëntor 2015, me Vendimin nr. ref. VMP865/15, të publikuar më 3 dhjetor 2015, Gjykata njëzëri miratoi masën e përkohshme, konkretisht çdo vendim gjyqësor, veprim ose vendim i autoriteteve publike në lidhje me këtë ankesë kushtetuese të pezullohet dhe që kjo masë e përkohshme të zgjasë deri më 29 shkurt 2016.

12. Më 25 janar 2016, përfaqësuesi juridik i ndërmarrjeve shoqërore (NSH) "Iliria" dhe "APIKO" (në tekstin e mëtejmë: "Iliria" dhe "APIKO"), ka parashtruar një kërkesë në Gjykatëku ai kërkonte t'i jepej mundësi për të paraqitur komente në kërkesën e parashtruesit.

13. Më 2 shkurt 2016, Gjykata iu përgjigj përfaqësuesit ligjor të "Iliria"-s dhe "APIKO"-s dhe i ofroi atij mundësinë që të paraqesë komentet në lidhje me kërkesën, duke i dhënë një afat deri më 16 shkurt 2016.

14. Më 10 shkurt 2016, me Vendimin nr. ref. VMP889/16, të publikuar më 12 shkurt 2016, Gjykata njëzëri miratoi vazhdimin e masës së përkohshme, në mënyrë që të lejohet paraqitja e komenteve shtesë në lidhje me kërkesën. Vazhdimi i masës së përkohshme deklaronte se çdo vendim gjyqësor, veprim ose vendim i autoriteteve publike në lidhje me këtë ankesë kushtetuese të pezullohet dhe që vazhdimi i kësaj mase të përkohshme të zgjasë deri më 31 maj 2016.

15. Më 16 maj 2016, tre muaj pas afatit, Gjykata pranoi komentet në lidhje me kërkesën të paraqitura nga përfaqësuesi ligjor i të dy NSH-ve: "Iliria" dhe "APIKO". Gjykata nuk mund të marrë këto komente parasyshpër shkak se ishin dorëzuar tre muaj pas skadimit të afatit dhe përfaqësuesi ligjor i NSH-ve asnjëherë nuk ka kërkuar zgjatje të afatit.

16. Më 19 maj 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë shkeljen.

17. Më 19 maj 2016, Gjykata aprovoi me shumicë votash pranueshmërinë e kërkesës. Gjyqtari Bekim Sejdiu votoi kundër pranueshmërisë.

18. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi me shumicë votash për gjetjen e shkeljes. Gjyqtari Bekim Sejdiu votoi kundër gjetjes së shkeljes.

19. Aktgjykimi mund të plotësohet me mendime konkurruese.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve

20. Më 28 qershor1946, duke u bazuar në paragrafin 2, neni 18 i Ligjit mbi Reformën Agrare dhe Kolonizimin të Brendshëm të Serbisë, "*Këshilli Ekzekutiv Populllor i Rrethit për Kosovë e Metohi*", me seli në Prizren, i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë së atëhershme, nxori Vendimin nr. 2649, duke i shpronësuar parashtruesit të kërkesës disa ngastra toke.

21. Më 5 nëntor 1997, Qeveria e Republikës së Serbisë lidhi Marrëveshje mbi Dhurimin, nr. 04 nr. 464-2914-97, me parashtruesin e kërkesës. Me këtë Marrëveshje mbi Dhurimin, një pjesë e tokës së konfiskuar iu kthye parashtruesit të kërkesës dhe u regjistrua në kadastër me numër 464-2914/97.

22. Më 26 prill 2000, të dy NSH-të: "Iliria" dhe "APIKO", ushtruan padi në Gjykatën Komunale të Deçan kundër parashtruesit të kërkesës, Komunës së Deçanit Republikës së Serbisë, duke kërkuar anulimin e Marrëveshjes së Dhurimit, të 5 nëntorit 1997.

23. Më 7 dhjetor 2007, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) aplikoi për heqjen e rastit nga Gjykata Komunale në pajtim me nenin 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2002/13, bazuar në juridiksionin ekskluziv të AKM-së mbi Ndërmarrjet Shoqërore dhe asetet e tyre.

24. Në vitin 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) i mori dy raste lidhur me pronën në fjalë. Njëri rast kishte të bënte me padinë e NSH "APIKO", e përfaqësuar nga AKM-ja dhe parashtruar me numër SCC-08-0226. Rasti tjetër kishte të bënte me padinë e NSH "Iliria", përfaqësuar nga AKM-ja dhe regjistruar me numër SCC-08-0227.

25. Më 17 nëntor 2008, Dhoma e Posaçme mbajti seancat e para lidhur me këto dy raste: me AKM-në, që përfaqësonte palët "APIKO" dhe "Iliria", dhe Republikën e Serbisë, me

Komunën e Deçanit dhe me parashtruesin e kërkesës, që paraqitej si palë e paditur në të dy rastet.

26. Më 24 nëntor 2008, në procedurat pranë Dhomës së Posaçme, AKM-ja paraqiti propozimin për përjashtimin e Republikës së Serbisë dhe të Komunës së Deçanit, si të paditur në procedurë. Komuna e Deçanit dhe Republika e Serbisë, që të dyja, u pajtuan me këtë përjashtim, duke lënë parashtruesin e kërkesës si të vetmen palë të paditur.

27. Komuna e Deçanit, me parashtresë të veçantë, kërkoi nga Dhoma e Posaçme që ta lejojë të jetë e përfshirë në të dy rastet, por kësaj radhe në anën e paditësit. Dhoma e Posaçme nuk e pranoi këtë kërkesë. Me refuzimin e kësaj kërkese, Komuna e Deçanit u hoq si palë nga procedura.

28. Më 26 nëntor 2008, përfaqësuesi i autorizuar i "Iliria"-s dhe "APIKO"-s paraqiti një parashtresë, duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të konstatonte se AKM-ja nuk ishte e autorizuar të përfaqësonte këto dy ndërmarrje, pasi që e njëjta nuk kishte legjitimitet aktiv dhe, për më tepër, nuk përfaqësonte ndërmarrjet në pajtueshmëri me interesat e tyre.

29. Më 10 mars 2009, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme (në tekstin e mëtejmë: Trupi gjykues) vendosi në Vendimin nr. SCC-06-0484, që:

> *"a) Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK e ka kapacitetin juridik në këtë rast si përfaqësues i AKM"; dhe*
>
> *"b) ajo ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar interesat e Ilirisë dhe APIKO-s pranë Dhomës së Posaçme veçanërisht në këtë rast."*

30. Në maj 2009, Trupi gjykues e ftoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) që të merrte pjesë në procedurë si palë potencialisht e interesuar për shkak të ndonjë interesi eventual që mund të kishte në këtë rast.

31. Më 12 maj 2009, AKM-ja (e përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut) paraqiti parashtresë lidhur me të dy rastet, SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227, dhe bëri kërkesë për dëgjim. Në parashtresë thuhej se AKM-ja pranonte që parashtruesi i kërkesës kishte të drejta të plota të pronësisë mbi parcelat kadastrale kontestuese që gjendeshin në Zonën e Veçantë të Mbrojtur të krijuar me Vendim Ekzekutiv të UNMIK-ut Nr. 2005/05, dhe se AKM-ja do të hiqte dorë, në emër të paditësve në rastet, nga çdo pretendim për të drejta pronësore që mund të kenë në raport me këto parcela. Trupi gjykues nuk pranoi këtë zgjidhje, pasi që nuk ishte në formën përkatëse të cilën e kërkonte Trupi gjykues për vendimin e tij.

32. Më 19 maj 2009, në seancën e mbajtur në të dy rastet, SCC-09-0226 dhe SCC-08-0227, në prani të Trupit gjykues, AKM-ja (e përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut) dhe parashtruesi nënshkruan një ujdi sipas së cilës paditësi (AKM) i njeh të padituri (parashtruesit) pronësinë mbi ngastrat në fjalë në kontestin ndërmjet "Iliria"-s dhe "APIKO"-s, ndërsa i padituri (parashtruesi), në shenjë të vullnetit të mirë, ia dha si dhuratë Komunës së Deçanit dy ngastrat e pronës së paluajtshme të cilat gjenden në qendër të Deçanit.

33. Në një datë të paspecifikuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) paraqiti ankesë kundër këtij vendimi, duke pretenduar se ishte e vetmja përfaqësuese e autorizuar e këtyre dy ndërmarrjeve shoqërore, AKM-ja (e përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut) nuk ishte e autorizuar.

34. Më 24 korrik 2010, me Vendimin nr. ASC-09-0025, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit) hodhi poshtë ankesën e AKP-së dhe konfirmoi vendimin e Trupit gjykues, të 10 marsit 2009, përkitazi me konfirmimin se Zyra për Çështje Ligjore të UNMIK-ut kishte qëndrim ligjor në këtë rast si përfaqësuese e AKM-së.

35. Më 1 janar 2012, hyri në fuqi Ligji i ri nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me të cilin u themeluan Dhomat e Specializuara të Dhomës së Posaçme. Dy rastet në lidhje me pronën e parashtruesit iu caktuan Dhomës së Specializuar për Kontest Pronësor të Dhomës së Posaçme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji Pronësor).

36. Më 16 tetor 2012, në përputhje me kërkesën e Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dhe pas opinionit të Kolegjit të Ankesave, Kolegji Pronësor mbajti seancë. Palët, AKM-ja (e përfaqësuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut) dhe parashtruesi, siç ishin përcaktuar në vendimin e Kolegjit të Apelit të 24 korrikut 2010, ishin të ftuara në këtë seancë. Palëve u ishte urdhëruar që Gjykatës t'i siguronin dokumentacion që do të konfirmonte autoritetin e tyre për të përfaqësuar palët në arritjen e ujdisë së pretenduar.

37. Më 27 dhjetor 2012, Kolegji Pronësor vendosi në dy aktgjykimet, nr. SCC-0226 dhe nr. SCC-0227, me tekst identik, me të cilin kërkesëpadia e "Iliria"-s dhe e "APIKO"-s ishte refuzuar si e pabazuar. Sa i përket pyetjes së palëve të autorizuara në procedurë, Kolegji Pronësor deklaroi:

> *"Në një aktvendim tjetër të Kolegjit të Ankesave, datë 27 dhjetor 2011, lënda me nr, ASC-II-0038, në ankesën kundër Aktvendimit të Trupit Gjykues të datës 9 shkurt 2011 në lëndët me nr, SCC08-0226 dhe SCC-08-0227, është përsëritur se përfaqësimi i NSH-së nga AKM-ja dhe Zyra për çështje Ligjore e UNMIK-ut është përfundimtar dhe si i tillë i detyrueshëm dhe se nuk mund të vihet në pikëpyetje me dhe bile të konsiderohet si res judicata nga Kolegji i Apelit. Në kohën e lëshimit të atij Aktvendimi, Ligji i ri mbi AKP-në nr. 04/1.-034 veçse ishte në fuqi.*
>
> *Nuk është relevante nëse përbërja aktuale e Kolegjit të Specializuar pajtohet me atë konstatim ose jo, aktvendimet e formës së prerë janë detyruese jo vetëm për palët, por edhe për ato, veç nëse një ligj i ri e rregullon këtë fushë ndryshe, pas adaptimit të një aktvendimi të tillë të formës së prerë në një çështje procedurale. Parashikimi dhe parimet e sigurisë ligjore kërkojnë që aktvendimet/aktgjykimet e formës së prerë nuk mund të kundërshtohen me tutje, pa marrë parasysh nëse janë të saktë apo jo, veç nëse ekziston një mjet tjetër juridik i jashtëzakonshëm (që akoma i nënshtrohet afatit kohor specifik). Nuk ka asnjë dëshmi apo njoftim në dosje që tregon se ndonjë palë apo person i tretë që pretendon ndonjë interes në këtë lëndë e ka kundërshtuar kushtetutshmërinë e aktvendimeve të Kolegjit të Apelit apo që ka aplikuar për mjete juridike të jashtëzakonshme në këtë lëndë.*

Për lëndën në fjalë, Kolegji i Apelit, në aktvendimin e vet të datës 24 korrik 2010, ka vendosur se Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut, e cila ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar NSH-në në kohën kur Ligji mbi AKP-në dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës kanë qenë në fuqi. […]"

38. Më 23 janar 2013, AKP-ja ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit ndaj aktgjykimeve nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227. Në ankesën e saj, AKP-ja deklaroi se pretendimet e parashtruesit mbi pronësinë ishin bazuar në praktika diskriminuese dhe se AKM-ja nuk ishte e autorizuar e as kompetente që të përfaqësonte ndërmarrjet "APIKO" dhe "Iliria".

39. Më 24 janar 2013, përfaqësuesi ligjor i "Iliria"-s dhe "APIKO"-s ushtroi ankesë ndaj aktgjykimeve nr. SCC-0226 dhe nr. SCC-0227. Ankesa thoshte se AKM-ja nuk ishte e autorizuar për të përfaqësuar Ndërmarrjet, se Ndërmarrjet ishin përfaqësuar në kundërshtim me interesin e tyre, se pretendimet e parashtruesit mbi pronësinë ishin bazuar në praktika diskriminuese.

40. Më 29 janar 2013, Komuna e Deçanit gjithashtu u ankua në aktgjykimet nr. SCC-0226 dhe nr. SCC-0227. Kishte deklaruar se në mënyrë të padrejtë ishte përjashtuar nga procedurat, pasi kishte pasur interes ligjor mbi pronën dhe se AKM-ja nuk ishte e autorizuar për të përfaqësuar Ndërmarrjet.

41. Në të gjitha përgjigjet e veta në këto tri ankesa, parashtruesi ka përsëritur: (1) Vendimi për përfaqësuesit e autorizuar ishte vendosur në instancën e fundit dhe ishte çështje *res judicata* nga ana e Kolegjit të Ankesave; (2) Asnjë nga ankuesit nuk kishte të drejtë ankimi pasi që ata në instancën e fundit ishin deklaruar si persona të cilët nuk ishin të autorizuar në procedurë; dhe, (3) Kolegji i Apelit nuk kishte të drejtë të shqyrtonte parashtresat e tyre.

42. Më 12 qershor 2015, Kolegji i Apelit nxori vendimin përfundimtar, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, duke vendosur:

(1) Ankesat ishin të bazuara;
(2) Anulohen aktgjykimet e Kolegjit të Pronësisë, nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227; dhe,
(3) Dhoma e Posaçme nuk ishte kompetente të gjykonte këtë çështje.

43. Në pajtueshmëri me këtë konkludim, Kolegji i Ankesave ktheu këtë rast dhe çështjet në kontest në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Deçan.

44. Në vendimin e vet, Kolegji i Apelit theksoi se ankesat e parashtruesit ishin të bazuara dhe se Dhoma e Posaçme nuk është kompetente për të gjykuar këtë çështje, sepse asnjëra nga palët e paditura në këtë rast nuk hyn në definicionin e palës së të padituës të autorizuar në kërkesat para Dhomës së Posaçme, siç definohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4. Në mënyrë të veçantë, Kolegji i Ankesave aplikoi një interpretim të ndryshëm të kuptimit të dispozitave që përmbajnë nenet 4 dhe 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, si e ndryshuar, lidhur me atë se cilat palë mund të pranohen si "palë të paditura" në kërkesat para Dhomës së Posaçme.

45. Në bazë të këtij interpretimi të ndryshuar të ligjit, Kolegji i Apelit tani gjeti se vetëm një ndërmarrje shoqërore ose AKM-ja (ose më pas AKP-ja) mund të autorizohen të veprojnë si "palë të paditura" në rastet para Dhomës së Posaçme. Kolegji i Apelit vërejti se parashtruesi i kërkesës është institucion i religjionit, përderisa Komuna e Deçanit dhe AKM-ja janë autoritete publike, andaj asnjëra prej tyre nuk mund të veprojë në cilësinë e "palës së paditur" në procedurat para Dhomës së Posaçme. Me fjalë të tjera, vetëm kur parashtruesi i kërkesës do të vepronte në cilësinë e "palës paditëse", por jo edhe në cilësinë e "palës së paditur", Dhoma e Posaçme do të mund të kishte juridiksion në këtë rast.

46. Vendimet nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009 po ashtu përmbajnë mendimin mospajtues të përbashkët të dy gjyqtarëve. Mendimi mospajtues sheh vendimin si të gabuar, pasi:

a. baza juridike dhe qëndrimi për interpretimin e dispozitave relevante të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, në kohën kur çështja u mor nga Dhoma e Posaçme ishte e atillë që ishte e mundur që palët të cilat do të vepronin në cilësinë e "palës paditëse" në procedura do të mund të ishin AKM-ja dhe parashtruesi; dhe

b. që në këtë rast kemi vendimet përfundimtare dhe të detyrueshme të Kolegjit të Apelit lidhur me atë se kush janë palët në procedurë dhe se këto vendime kanë karakter *res judicata*.

Kërkesat e parashtruesit dhe kërkesa për masë të përkohshme

47. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetshmërisë së dy vendimeve, me numrat AC-I-13-0008 dhe AC-I-13-0009, të dyja të 12 qershorit 2015, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Parashtruesi pretendon se këto vendime kanë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe nenin 13 [E drejta për mjete juridike] të KEDNJ-së.

48. Lidhur me të drejtën përgjykim të drejtë, parashtruesi argumenton se ajo është shkelur në dy mënyra, respektivisht:

(1) E drejta e sigurisë ligjore është shkelur në dy mënyra, sepse:

(a) Kolegji i Apelit ka pranuar palë të caktuara për të paraqiturankesë ku i njejti Kolegj i Apelit më parë kishte vendosur që vetëm parashtruesi dhe AKM-ja ishin palë të autorizuara në këtë rast. Kolegji i Apelit e pranoi këtë ankesë dhe e gjykoi atë në bazë të meritave, pavarësisht nga fakti se këto palënuk ishinautorizuara për të paraqitur këtë ankesë; dhe

(b) për shkak se Kolegji i Apelit ka aplikuar një interpretim të ri të ligjeve në fuqi me anë të të cilit është vendosur që Dhoma e Posaçme nuk kishte asnjëherë juridiksion mbi rastin, pavarësisht nga fakti se Dhoma e Posaçme, në të gjitha nivelet (në nivel të Trupit gjykues, Kolegjit të Specializuar për Pronësi dheKolegjit të Apelit), kishte pranuar paraprakishtjuridiksionin e saj dhe kishte marrë vendime në këtë rast që nga viti 2008.

(2) E drejta për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile brenda një afati të arsyeshëmishte shkelur për shkak se procedurat kanë marrë gati më shumë se 15 vjet dhe tani Dhoma e Posaçme e ka referuar lëndën përsëri në Gjykatën Themelore ku duhet rinisur*de novo*.

49. Në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke theksuar: *"E drejta për siguri juridike si një prej garancive fondamentale të cilën e ofron parimi i të drejtës për gjykim të drejtë, garanton që vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk mund të jenë objekt i rishqyrtimit në procedurën e rregullt* (Ryabykh kundër Rusisë, 52854/99)*, përkatësisht që me qëllim të ruajtjes së sigurisë juridike të gjykohet sipas ligjeve dhe praktikës gjyqësore që kanë qenë në fuqi në kohën e inicimit të kontestit* (Maširević kundër Serbisë, 30671/08). *Për më tepër, sistemet juridike që karakterizohen me rishqyrtimin e pakufizuar të aktgjykimeve të formës së prerë dhe në të cilat ekziston rreziku i vazhdueshëm i anulimit të aktgjykimeve të formës së prerë, sigurisht e shkelin nenin 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore* (Sovransavto Holding kundër Ukrainës, 48553/99)*"*.

50. Përkitazi me të drejtën e barazisë para ligjit, parashtruesi argumenton se kjo ishte shkelur për shkak se palët të cilat ishin përjashtuar nga procedura me vendimin *res judicata* tëKolegjit të Apelit, më pas u lejuan të parashtrojnë ankesë, ndërsa parashtruesi ishte përjashtuar nga procedura mbi bazënse ishte një "institucion religjioz".

51. Përfundimisht, parashtruesi pohon se ka vepruar në përputhje me obligimin për të shteruar të gjitha mjetet juridike para se të parashtronte një kërkesë në Gjykatë. Parashtruesi i kërkesës pohon:

"Me vendimin e tij, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme e kishte kthyer çështjen në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Deçan. Megjithatë, ne konsiderojmë se janë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parashtruesit të ankesës kushtetuese. Me fjalë të tjera, sipas interpretimeve juridike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (McFarlane kundër Irlandës, 31333/06; El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, 39630/09) *shprehimisht kërkohet që mjetet juridike të jenë 'mjaft të sigurta', jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, si dhe efikase edhe në ligj edhe në praktikë në mënyrë që të konsiderohen si 'mjete juridike në dispozicion' në kuptimin e shterimit të mjeteve juridike.*

Duke pasur parasysh se e tërë procedura zgjat pesëmbëdhjetë vjet, se lënda ka qenë një herë në Gjykatën e atëhershme Komunale në Deçan dhe se procedura para marrjes së lëndës nga ana e Dhomës së Posaçme është zhvilluar për tetë vjet, si dhe që në Gjykatën Komunale në Deçan të drejtat e parashtruesit të ankesës kushtetuese tashmë janë shkelur, konsiderojmë se të gjitha mjetet juridike efikase në këtë lëndë janë shteruar me vendimin e pritur të shkallës së dytë të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme. Mendojmë se për ndonjë efikasitet të kthimit të procedurës as që mund të flitet në një situatë kur procedura nga instanca më e lartë gjyqësore – Gjykata Supreme, pas pesëmbëdhjetë vjetësh, kthehet në instancën më të ulët – Degën e Gjykatës Themelore.

Në bazë të asaj që u tha, konsiderojmë se kërkesat për shterimin e mjeteve juridike në dispozicion nga neni 113.7 i Kushtetutës janë plotësuar në këtë rast, dhe i propozojmë Gjykatës Kushtetuese të marrë lëndën në shqyrtim".

52. Parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të:

"Miratohet masa e përkohshme në këtë lëndë dhe të ndalohet çfarëdo procedure e cilësdo gjykatë apo organi publik në lëndët e lidhura me këtë ankesë kushtetuese, deri në përfundimin e procedurës para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

53. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari shqyrton nëse ankesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

54. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre *individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

55. Gjykata vëren se, në pajtim në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili parashikon se "*të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme"*, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke kërkuar të drejtat themelore të cilat vlejnë për individë por edhe për persona juridikë (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimi i 27 janarit 2010, rasti KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST LLC, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*).

56. Gjykata vëren se parimi dhe ankesa themelore që gjendet në këtë kërkesë është se e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë është shkelur nga Kolegji i Apelit në vendimet e saj nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13 -0009, kur ka pranuar ankesën nga AKP-ja dhe nga dy NSH-të kundër Aktgjykimeve të Kolegjit të Pronësisë, nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227. Parashtruesi pretendon se, duke pranuar këtë apel, Kolegji i Apelit nuk ka trajtuar aktgjykimet e Kolegjit të pronësisë si të formës së prerë dhe të detyrueshme, në shkelje të parimit *res judicata,* të themeluar qe një kohë të gjatë.

57. Gjykata vëren se, në vendimet e tij nr. AC-I-13-0008 dhe AC-I-13-0009, të 12 qershorit 2015, Kolegji i Apelit ka deklaruar Dhomën e Posaçme si jokompetentepër të vendosur në kërkesat pronësore dhe kishte referuarkontestin në lidhje me pronësinë e pronave përsëri në gjykatat e rregullta për rishqyrtim *ab initio*. Si të tilla, këto vendime të Kolegjit të Apelit sugjerojnë se kontesti i parashtruesit në lidhje me pronësinë e pronës nuk është përfunduar ende me vendim gjyqësor të formës së prerë.

58. Megjithatë, siç vërehet më lart, kjo kërkesë kryesisht ka të bëjë me pretendimin për gjykim të drejtë. Çështja që duhet të adresohet është nëse Kolegji i Ankesave kishte ose jo juridiksion për të dëgjuar ankesat e palëve kundërshtare AKP, "Iliria" dhe "APIKO", dhe për të marrë vendimet e tij nr. I-13-0008 dhe AC-I-13-0009, duke pasur parasysh se i njëjtiKolegj i Apelit, më 24 korrik 2010, me Vendimin nr. ASC-09-0025, kishte përcaktuar paraprakisht se këto palëkundërshtare: AKP, "Iliria" dhe "APIKO" nuk ishin palë të autorizuara në këtë rast.

59. Gjykata vëren që parashtruesi pretendon seishte refuzuar si palë në atë ankesë nga ana e Kolegjit të Apelit dhe rrjedhimisht nuk ka mundur t'i mbrojë pretendimet e veta. Për më tepër, parashtruesi pretendon se Kolegji i Apelit nuk ishte kompetent për të dëgjuar ankesat e AKP-së, "Iliria"-s dhe "APIKO"-s, sepse vendimi i Kolegjit të Apelit, i24korrikut 2010,ishte bërë*res judicata* dhe për këtë arsye nuk i nënshtrohet ndonjë shqyrtimi të mëtejshëm gjyqësor. Parashtruesi pretendon se kjo është konfirmuar nga Paneli i Pronësisë në vendimet nr. SCC-0226 dhe nr. SCC-0227, të 27 dhjetorit 2012.

60. Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në lidhje me çështjen e shterimit të mjeteve juridike, ku ka deklaruar se duhet të shterohen vetëm ato mjete juridike të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të të drejtave. Në mënyrë të veçantë, Gjykata rikujton aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 28 korrikut 1999, nr. 25803/94, *Selmouni kundër Francës*, ku GJEDNJ-ja ka deklaruar, ndër të tjera:

> *"75. […] Të vetmet mjete të cilat Neni 35 i Konventës kërkon të shteren janë ato që kanë të bëjnë me* shkeljet *e pretenduara dhe në të njëjtën kohë janë në dispozicion dhe të mjaftueshme. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori por edhe në praktikë, me dështimin e të cilave do të kenë mungesë të qasjes sëduhur dhe efektivitetit;[…]*
>
> *77. Gjykata do të theksojë se aplikimi i këtij rregulli duhet të bëjë kompensim të duhur, për* kontekstin. *[…] Është e njohur më tej se rregulli i shterimit të mjeteve [juridike] nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet automatikisht […]".*

61. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton aktgjykimin e saj, të 20 majit 2014, në rastin nr. KI10/14, *Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank SH.A. në Kosovë*, ku Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka shteruar të gjitha mjetet juridike me qëllim për të konstatuar shkeljen e të drejtave kushtetuese ku Gjykata Supreme, pa njoftuar parashtruesin apo pa i dhënë parashtruesit mundësinë përt'u dëgjuar, në mënyrë të njëanshme dhe *ex parte*ka kthyer rastin e parashtruesit në Gjykatën Themelore për rigjykim.

62. Në aktgjykimin e vet, Gjykata u shpreh se parashtruesi nuk kishte nevojë për të rihapur rastin në Gjykatën Themelore, e cila nuk kishte autoritet për të gjykuar nëse Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit, para se shkelja e saj e pretenduar kushtetuese do të mund të dëgjohej nga kjo Gjykatë.

63. Në kërkesën e tanishme,Kolegji i Apelit nuk ka lejuar parashtruesin, një palë me interes të veçantë në këtë rast, që të marrë pjesë në procedurë, por në mënyrë të njëanshme ka injoruar faktin se aktgjykimi i saj i mëhershëm, i 24 korrikut 2010, në lidhje me palët e autorizuara, ishte *res judicata*.

64. Ngjashëm me rastin KI10/14, Gjykata thekson se parashtruesi nuk e ka të nevojshme të ri-gjykojë rastin në gjykatat e rregullta, të cilat nuk kanë autoritet për të gjykuar nëse Kolegji i Apelit ka shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit, para se shkelja kushtetuese e pretenduar e parashtruesit të mund të dëgjohet nga kjo Gjykatë.

65. Si citohet më lartnë Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane në *Selmouni kundër Francës,* kërkohet të shterohen vetëm ato mjete juridike që përmbushin që të triparimet në vijim:

a. mjeti juridik ka të bëjë me shkeljen e pretenduar;
b. mjeti juridik është në dispozicion të parashtruesit (parimi i qasjes); dhe
c. mjeti juridik është i mjaftueshëm për të riparuar shkeljen (parimi i efektivitetit).

66. Si e tillë, Gjykata konstaton se në rrethanat e kërkesës së tanishme, rifillimi i procedurave gjyqësore për kontestin pronësor nuk i përmbush kërkesat e "mjaftueshmërisë" dhe të "efektivitetit" për t'u konsideruar mjete juridike të cilat parashtruesi i kërkesës është e nevojshme t'i shterojëpara se të sjellkërkesën në Gjykatë, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, për shkak se këto procedura ligjore nuk mund të adresojnë pretendimin e parashtruesit për shkeljen e së drejtës në gjykim të drejtë nga ana e Kolegjit të Apelit.

67. Për më tepër, neni 48 i Ligjit, përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

68. Pas ekzaminimit të vëzhgimeve të parashtruesit në substancë të ankesave të tij, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të kompleksitetit të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Kërkesa nuk mundet, prandaj, të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

69. Gjykata vëren sepretendimi parësor i parashtruesit ka të bëjë me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë, siç mbrohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

70. Parashtruesi pretendon se Kolegji i Apelit ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë duke:

a. rihapur një vendim të mëhershëm që është bërë *res judicata*;
b. mos lejuar qëllimisht parashtruesin, një palë e autorizuar me një interes të veçantë pronësor në procedurë, që të marrë pjesë në procedura; dhe
c. duke lejuar palët e deklaruara më parë si të "paautorizuara" nga e njëjta gjykatë që pastaj të marrin pjesë në ato procedura.

71. Në mënyrë të veçantë, parashtruesi pretendon se në vendimet e tij, nr. AC-I-13-0008 dhe AC-I-13-0009, të dyja të 12 qershorit 2015, Kolegji i Apelitrihapi një rast që tashmë ishte bërë i formës së prerë, si rezultat i vendimit të tij të mëhershëm të 24 korrikut 2010 (nr. ASC-09-0025). Në atë vendim të mëhershëm, Kolegji i Apelit, në instancën e fundit, kishte përcaktuar palët e autorizuara për rastin. Parashtruesi pretendon se ky përcaktim përfundimtar për palët e autorizuara ishte konfirmuar nga Paneli i Pronësisë në vendimet e tij nr. SCC-0226 dhe SCC-0227, të 27 dhjetorit 2012, ku Kolegji i Pronësisë kishte deklaruar përcaktimine palëve tëautorizuarasi*res judicata*. Për më tepër, parashtruesi deklaron se Kolegji i Apelit ia kishte refuzuar parashtruesit të drejtën që të njihet si palë në apel, duke i mohuar kështu parashtruesit të kërkesës të drejtën që të paraqesë rastin e tij.

72. Gjykata rikujton nenin 31, paragrafi 2, të Kushtetutës, i cili thotë:

"2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që grihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

73. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, i cili thotë, ndër të tjera:

"1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht […]".

74. Në këtë kërkesë, çështje kryesore është nëse Kolegji i Apelit ishte i autorizuar të pranonte ankesën nga AKP-ja dhe të dy NSH-të. Kolegji i Apelit kishte përcaktuar më parë në instancën e fundit se cilat ishin saktësisht palët e autorizuara në këtë rast, e megjithatë Kolegji i Apelit pranoinjë ankesë nga të njëjtat palë, të cilat i kishte deklaruar paraprakisht si të paautorizuara. Në të njëjtën kohë, Kolegji i Apelit ia ka refuzuar parashtruesit statusin e palës së autorizuar, të cilën e kishte konfirmuar paraprakisht në instancën e fundit.

75. Si e tillë, Gjykata konsideron se çështja që do të adresohet është nëse rihapja e një vendimi të gjykatës që është bërë *res judicata* është ose jo në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

76. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton aktgjykimin e saj, të 12 prillit 2012, në rastin nr. KI103/10, *Shaban Mustafa*, ku gjeti shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë, ku Gjykata Supreme e Kosovës kishte vepruar në lidhje me të drejtat kontraktuale të parashtruesit pa e njoftuar më parë dhe pa i dhënëparashtruesit të kërkesës mundësinë për t'u dëgjuar.

77. Standardi i njëjtë vlen në kërkesën e tanishme, ku parashtruesit i ishte mohuar e drejta për t'u dëgjuar si palë para Kolegjit të Apelit dhe për këtë arsye nuk ka pasur mundësinë për të paraqiturargumentet e veta për çështjen e juridiksionit të Dhomës së Posaçme. Kjo është pjesë fondamentale e barazisë së palëve në një rast që parashtruesit i është ofruar mundësia që të dëgjohet në të gjitha fazat e proceseve gjyqësore.

78. Gjykata gjithashtu rikujton aktgjykimin e saj të 19 qershorit 2012, në rastin nr. KI51/11, *Rexhep Rahimaj,* ku u shpreh se Gjykata e Qarkut në Gjilan ka vepruar në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, duke mos ekzekutuar një vendim të mëparshëm *res judicata* që ndikonte në të drejtat e parashtruesit për pronën e paluajtshme.

79. Në atë aktgjykim, Gjykata konsideroi që autoritetet kompetente kanë një obligim pozitiv për të krijuar një sistem të zbatimit të vendimit, i cili është efektiv si edhe kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme. Ekzekutimi i një vendimi të nxjerrë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi nuk do të duhej të ishte privuar nga përfitimi prej vendimit, i cili kishte marrë formë *res judicata*, në favorin të

tij (Shih, *mutatis mutandis,* aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 6 nëntorit 2002, *Sovtransavto Holding v. Ukraine,* nr. 48553/99).

80. Për më tepër, Gjykata rikujton aktgjykimin e saj të 17 dhjetorit 2010, në rastin nr. KI08/09, *Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të IMK Çelikut Fabrika Ferizaj*. Ai aktgjykimkishte të bënte me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë që ishte bërë *res judicata*. Në atë çështje, Gjykata deklaroi në paragrafët 61-62, ndër të tjera:

> *"61. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson që e drejta e inicimit të procedurës gjyqësore në raste civile, siç parashihet me Nenin 31 te Kushtetutës se Kosovës, si dhe Nenin 6 në lidhje me Nenin 13 te Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut (KEDNJ), do te ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Do te ishte e pakuptueshme që këto nene t'i përshkruajnë në hollësi garancitë procedurale që i ofrohen palëve në procedurë -procedura që janë të drejta, publike dhe ekspeditive -pa mbrojtjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Interpretimi i neneve të lartpërmendura si ekskluzivisht të lidhura me qasjen ndaj gjykatës dhe administrimi dhe efektshmëria e procedurave do të kishte mundësi të çonte në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit te ligjit, të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, mutatis mutandis, aktgjykimin e ECtHR-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtresa nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004).*
>
> *62. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën res judicata. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull Sovransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik ne sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. [...]."*

81. Gjykata gjithashtu rikujton aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut (GJEDNJ), të 3 prillit 2008, *Ponomaryov kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 3236/03, ku GJEDNJ-ja ka theksuar në paragrafin 40, ndër të tjera:

> *"40. Gjykata rithekson se e drejta për një gjykim të drejtë nga një gjykatë siç garantohet me nenin 6 § 1 të Konventës duhet të interpretohet në dritën e preambulës së Konventës, e cila deklaron, në pjesën e saj përkatëse, që sundimi i ligjit të jetë pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese. Një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit të res judicata, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit. [...] Një shmangie nga ky parim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose bindës (shih, mutatis mutandis, Ryabykh v. Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003- X)."*

82. Për më tepër, Gjykata rikujton aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 24 korrikut 2003, *Ryabykh kundër Rusisë,* kërkesa nr. 52854/99, ku GJEDNJ-ja ka elaboruar lidhur me

parimin e sigurisë juridike në raport me të drejtën për një gjykim të drejtë, në paragrafët 52-57:

"52. Siguria juridike presupozon respektimin e parimit të res judicata (ibid. § 62), që është parimi i plotfuqishmërisë së aktgjykimeve. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit. Fuqia e rishikimit nga ana e gjykatave më të larta duhet të ushtrohet për të korrigjuar gabimet gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë, por jo për të kryer një ekzaminim të sërishëm. Rishikimi nuk duhet të trajtohet si një apel i fshehur, dhe mundësia e thjeshtë e ekzistimit të dy pikëpamjeve mbi këtë lëndë nuk është një bazë për rishqyrtim. Shmangia nga kyparim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose bindës.

53. Në rastin e parashtruesit, megjithatë, aktgjykimi i 8 qershor 1998 u anulua më 19 mars të vitit 1999 nga ana e Presidiumi i Gjykatës Rajonale Belgorod me arsyetimin se gjyqtari Lebedinskaya i Gjykatës së Qarkut të Novooskolskiy kishte keqinterpretuar ligjet përkatëse. Presidiumi hodhi poshtë pretendimet e ankuesit dhe e mbylli çështjen, duke vendosur kështu të pavlefshëm një proces të tërë gjyqësor i cili kishte përfunduar në një vendim që juridikisht është i detyrueshëm sipas nenit 208 të Kodit të Procedurës Civile dhe në lidhje me të cilat kishin filluar procedurat e ekzekutimit.

54. Gjykata vëren se shqyrtimi mbikëqyrës i aktgjykimit të 8 qershorit 1998 ishte vënë në lëvizje nga Kryetari i Gjykatës Rajonale Belgorod - i cili nuk ishte palë në procedurë - mbi të cilin pushteti i tillë i është dhënë nga nenet 319 dhe 320 të Kodit të Procedurës Civile. Ashtu si dhe me situatën sipas ligjit të Rumanisë të ekzaminuar në Brumarescu, të cituar më lart, ushtrimi i këtij pushteti nga Presidenti nuk i është nënshtruar ndonjë afati kohor, në mënyrë që aktgjykimet ishin të mundshme për t'u kontestuar për një kohë të pacaktuar.

56. Gjykata konsideron se e drejta e palës ndërgjyqëse në një gjykatë do të jetë po aq iluzore nëse sistemi ligjor i një Shteti Kontraktues ka lejuar një vendim gjyqësor i cili ishte bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm qëtë anulohet nga një gjykatë më e lartë në një kërkesë të bërë nga një zyrtar shtetëror.

57. Duke përdorur procedurën e rishqyrtimit mbikëqyrës për të lënë mënjanëaktgjykimin e 8 qershorit 1998, Presidiumi i Gjykatës Rajonale Belgorod ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe "të drejtën e parashtruesit për t'iu drejtuar gjykatës" në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës."

83. Rasti i vetë Gjykatës, *Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të IMK Çelikut Fabrika Ferizaj*, i cituar më lart, ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë që ishte bërë *res judicata*. Rasti *Ryabykh kundër Rusisë*ka të bëjë me rihapjen e një vendimi të formës së prerë nga një zyrtar publik. Të dyja rastet, si dhe rasti i cituar *Ponomaryov kundër Ukrainës*, në mënyrë të qartë dhe eksplicite theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë, sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe sipas nenit 31 të Kushtetutës, përfshin parimin e sigurisë juridike, që ngërthen në vete parimin se vendimet e plotfuqishme gjyqësore të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave.

84. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave, në vendimin e vet të 24korrikut 2010, ka përcaktuar në instancën e fundit palët e autorizuara për rastin. Prandaj, ky vendim ishte bërë *res judicata*.

85. Në veçanti, Gjykata vëren se palët që nuk janë pranuar si palë të autorizuarapërrastin me vendimin e Kolegjit të Apelit, të 12 korrikut 2010, përkatësisht AKP-ja, dy NSH-të: "APIKO" dhe "Iliria", dhe Komuna e Deçanit, kishin mundësi në atë kohë për të paraqitur kërkesë në këtë Gjykatë për të pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese si rezultat i këtij vendimi. Asnjë nga këto palë nuk kishte adresuar ndonjë ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Si pasojë e këtij dështimi, ky vendim i Kolegjit të Apelit nuk pati mundësi të kontestohet më.

86. Kolegji i Pronësisë, në instancën e parë, ka konsideruar veten të detyruar nga ky vendim i plotfuqishëm i Kolegjit të Apelit dhe në mënyrë eksplicite thuhet në aktgjykimet e tij të 27 dhjetorit 2012 (nr. SCC-08-0226 dhe nr. 08-SCC-0227) se vendimi i Kolegjit të Apelit për palët e autorizuara ishte *res judicata* dhe se, për këtë arsye "*Nuk është relevante, nëse përbërja aktuale e Kolegjit të Specializuar [për Pronësinë] bie dakord me këtë përfundim ose jo. Vendimet e plotfuqishme janë të detyrueshme jo vetëm për palët por edhe për të gjitha Gjykatat përveç nëse ndonjëLigji i ri rregullon këtë fushë ndryshe pas miratimit të një Vendimi të tillë të plotfuqishëm përfundimtar për një çështje procedurale*".

87. Gjykata vëren se në vendimet e kontestuara të Kolegjit të Apelit nuk përmendeshin vendimet e mëparshme të Kolegjit të Apelit në këtë rast. Për më tepër, Kolegji i Apelit fillimisht ka pranuar ankesën nga palët paraprakisht të deklaruara si të paautorizuara, ka refuzuar të pranojë parashtruesit si palë në këto procedura dhe më pas e shpalli Dhomën e Posaçme jokompetente për të vendosurkontestin.

88. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime që rasti i tij të ishte vendosur në instancën e fundit nga Paneli i pronësisë dhe se ajo nuk ka mundur të rihapet para Kolegjit të Apelit. Si i tillë, parashtruesi duhet të ketë parë aktgjykimet e Kolegjit të Pronësisë të ekzekutuara.

89. Siç citohet më lart, Gjykata rithekson se, "*Një nga aspektet fondamentale të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit res judicata, që është parimi i plotfuqishmërisë së aktgjykimeve. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit.*"

90. Duke u bazuar në këto konsiderata dhe në praktikën e vet gjyqësore, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se aktgjykimet e Kolegjit të Apelit, të 27 dhjetorit 2012 (nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227), ishin bërë *res judicata* në bazë të vendimit të mëparshëm të formës së prerë dhe të detyrueshëm të Kolegjit të Apelit, të 24 korrikut 2010, në lidhje me palët e autorizuara.

91. Duke përdorur procedurën e ankesës për të anuluar këto aktgjykime të Panelit të Pronësisë dhe për të referuar kontestin origjinal të pronësisë përsëri në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se, me vendimet e tij të 12 qershorit 2015 (nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009), Kolegji i Ankesave ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe i ka mohuar parashtruesit një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

92. Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për një proces të drejtë dhe të paanshëm, siç është i mbrojtur me nenin 31, paragrafi 2, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

93. Gjykata vëren se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me vendimet e kontestuara të Kolegjit të Apelit, të 12 qershorit 2015, dhe në asnjë mënyrë, qoftë në mënyrë të favorshme apo të pafavorshme, nuk reflekton mbi ligjshmërinë e procedurave të shumta dhe të ndryshme të cilat u zhvilluan para vendimeve e kontestuara, sepse kjo është jashtë fushëveprimit të juridiksionit të kësaj Gjykate.

94. Me gjetjen e shkeljes së të drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme për të ekzaminuar pretendimet e mëtejshme të parashtruesit në lidhje me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe me nenin 13 [E drejta për mjete juridike] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 maj 2016, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 tëKonventës Evropianepër të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË që nuk është e nevojshme të ekzaminojë nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të Konventës Evropianepër të Drejtat e Njeriut;

IV. TË KONSTATOJË që dy vendimet eKolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, janë të pavlefshme, dhe se dy vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen më Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 27 dhjetorit 2012, nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227, janë përfundimtare të detyrueshme dhe, si të tilla, janë *res judicata*;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI124/15, Parashtrues Arif Kryeziu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërfshirjes në procesin e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Liria"

Rastin nr. KI124/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 9 mars 2016 dhe publikuar më 23 maj 2016.

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë e papranueshme, mos shterim i mjeteve juridike, procesi i privatizimit*

Parashtruesi i kërkesës nuk e kontestoi asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon të përfshihet në listën e punëtoreve të cilët përfitojnë nga një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" nga Prizreni. Por, parashtruesi i kërkesës ankohet për shkak të mospërfshirjes së tij në listën e punëtoreve nga privatizimi i ndërmarrjes NSH “Lria”.

Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti; por ai thekson: *"Bazohem tek ju, sepse kam arsye. Nuk më jep të drejtën time askush, pos jush"*. Ai nuk kishte paraqitur asnjë vendim të ndonjë institucioni që ka prekur të drejtat e tij. Parashtruesi nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi se ai ishte ankuar në pajtim më njoftimin e AKP-së apo me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u ankuar më tej dhe në këtë mënyrë nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike pasi që ky rregull bazohet në supozimin, se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese në bazë të argumenteve të përmendura e deklaroi kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI124/15
Parashtrues
Arif Kryeziu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërfshirjes në procesin e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Liria"
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Arif Kryeziu nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon të përfshihet në listën e punëtorëve të cilët përfitojnë nga një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: NSH "Liria").

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet për shkak të mospërfshirjes së tij në listën e punëtorëve që përfituan 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes NSH "Liria".

4. Parashtruesi ka parashtruar më parë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) një kërkesë identike (KI19/15).

5. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në asnjë shkelje kushtetuese.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

7. Më 16 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI124/15.

8. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe në pajtim me rregullin 29 të Rregullores së punës, kërkoi nga ai që ta plotësojë kërkesën e tij. Një kopje e kërkesës i ishte dorëzuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

10. Më 28 janar 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të sqarojë nëse ai ka parashtruar ndonjë ankesë. Megjithatë, parashtruesi nuk iu përgjigj kësaj kërkese.

11. Më 9 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 23 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI19/15, e cila ishte hequr nga lista më 23 shtator 2015.

13. Më 6 tetor 2015, parashtruesi parashtroi kërkesë në AKP në lidhje me mospërfshirjen e tij në listën e punëtorëve që përfitojnë nga një pjesë e të ardhurave nga shitja e NSH "Liria".

14. Më 6 tetor 2015, AKP-ja e njoftoi parashtruesin e kërkesës se të gjithë punëtorët që nuk ishin përfshirë në listë për të përfituar nga shitja e NSH "Liria" kanë të drejtë ankese.

15. Pjesa përkatëse e njoftimit të lartcekur të AKP-së thekson se *"(...) data e fundit për ankim kundër listës fillestare ishte dt. 24.12.2011"* dhe "*data e fundit për ankimin kundër listës përfundimtare ishte dt. 31.03.2012"*.

16. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës nuk është përgjigjur lidhur me sqarimin e kërkuar më 28 janar 2016 dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai ka parashtruar ankesa në AKP apo në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, dhe as ushtruar të drejtën e tij për ankesë, në pajtim me udhëzimin e AKP-së dhe me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti; por ai thekson: *"Bazohem tek ju, sepse kam arsye. Nuk më jep të drejtën time askush, pos jush"*.

18. Parashtruesi ka renditur vendimin për heqjen e kërkesës nga lista në Rastin nr. KI19/15, si vendim të fundit në rastin e tij. Megjithatë, ai nuk thekson asnjë ankesë në lidhje me atë vendim.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjykata i referohet edhe nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës i cili saktëson:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *(a)...*
>
> *(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.*

23. Gjykata vlerëson se kërkesa KI19/15 ishte hequr nga lista, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar *"aktin konkret të autoritetit publik"* dhe nuk kishte ofruar *"dokumente mbështetëse dhe prova materiale"*, siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit, dhe rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.

24. Gjykata vëren se në kërkesën e tanishme KI124/15, parashtruesi ishte pyetur nëse ai kishte ushtruar të drejtën e tij për ankesë, siç ishte udhëzuar me njoftimin e AKP-së të 6 tetorit 2015. Parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai ishte ankuar në pajtim me njoftimin e AKP-së apo me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

25. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u ankuar më tej dhe në këtë mënyrë nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e zbatueshëm në Kosovë (Shih, për shembull, Rastin nr. KI07/09, *Demë dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010, paragrafët 28-29 shih gjithashtu *mutatis mutandis* Rasti nr. KI39/11, *Tomë Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2013, paragrafi 44).

26. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen

e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih Rastin nr. KI116/14, *Fadil Selmanaj,* Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015, paragrafi 48).

27. Nga sa u tha më lart, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe të specifikuara më tej në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 9 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI112/15, Parashtruesit e kërkesës: Feride, Nezaqete, Smajl, Veton, Mirvete, Agim dhe Merita Bulliqi, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 1/2015, të 10 prillit 2015.

KI-112/15, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2016, i publikuar më 23 maj 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, legjitimiteti pasiv, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Parashtruesit e kërkesës kanë iniciuar kontestin për kompensimin e dëmit kundër Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) dhe Autotransportit. Kontesti është përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 1/2015, e cila e refuzoi kërkesëpadinë për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të padituërës.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se me aktgjykimin e kontestuar ishin shkelur të drejtat e tyre, sepse *"Gjykata Supreme e Kosovës mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale".*

Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i arsyetuar. Në fakt, ai tërësisht shpjegon pse revizioni ishte refuzuar si i pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të padituave dhe, rrjedhimisht, aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta ishin ndryshuar. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë shpjeguar si dhe pse përfundimi i Gjykatës Supreme për mungesë të legjitimitetit pasiv kishte shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI112/15
Parashtrues
Feride Bulliqi dhe të tjerët
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 1/2015, të 10 prillit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Feride, Nezaqete, Smajl, Veton, Mirvete, Agim dhe Merita Bulliqi me banim në Prishtinë, komuna e Prishtinës - Kosovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës përfaqësohen nga z. Selatin Ahmeti, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 1/2015, të 10 prillit 2015, i cili u është dorëzuar atyre më 4 qershor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 gusht 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 shtator 2015, Kryetarja caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 23 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata të dorëzojnë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.

8. Më 12 tetor 2015, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë autorizimin e kërkuar.

9. Më 15 tetor 2015, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë një kopje të fletëkthesës, që tregon ditën në të cilën parashtruesve të kërkesës u është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar.

11. Më 20 tetor 2015, Gjykata pranoi dokumentin e kërkuar, që tregon se parashtruesve të kërkesës u është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 4 qershor 2015.

12. Më 13 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Fehmi Bulliqi, paraardhësi i parashtruesve të kërkesës, ishte punonjës i Elektroekonomisë së Kosovës, përkatësisht Elektroekonomisë së Serbisë, Mihja Sipërfaqësore në Bellaqevc (në tekstin e mëtejmë: Elektroekonomia).

14. Më 22 nëntor 1993, Fehmi Bulliqi dhe të punësuarit e tjerë vdiqën si pasojë e një aksidenti të trafikut në rrugën për në punë, që kishte ndodhur më 23 gusht 1993.

15. I ndjeri Fehmi Bulliqi la pas gruan e tij, parashtruesen e kërkesës Feride, dhe fëmijët e tij, parashtruesit e kërkesës: Nezaqete, Smajl, Veton, Mirvete, Agim dhe Merita Bulliqi.

16. Më 25 gusht 1993, ishte lidhur një marrëveshje në mes të Kompanisë së Sigurimeve "Kosova" në Prishtinë dhe Elektroekonomisë për kompensimin e dëmeve familjeve të personave të vdekur në aksident.

17. Më 17 korrik 1996, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, pasi që Elektroekonomia nuk e pagoi kompensimin e kontraktuar. Rasti është regjistruar me numër C. nr. 1066/96, por kishte humbur dhe nuk ishte përfunduar.

18. Në atë kohë, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar padi kundër "Autotransportit", që ishte Njësi punuese e Elektroekonomisë.

19. Më 6 korrik 2005, parashtruesit e kërkesës kërkuan përtëritjen dhe vazhdimin e rastit. Rasti i ri është regjistruar atëherë me numrin C. nr. 1535/05.

20. Parashtruesit e kërkesës e zgjeruan padinë në këtë procedurë për të përfshirë edhe Elektroekonominë si të paditur, si trashëgimtare ligjore të ish-Elektroekonomisë (në tekstin e mëtejmë: KEK-u). Parashtruesit konsideruan se të dy subjektet, KEK-u dhe "Autotransporti", kishin përgjegjësi të përbashkët për të kompensuar dëmin.

21. Më 9 shkurt 2010, Gjykata Komunale (C. nr. 1535/2005) konkludoi se KEK-u ishte përgjegjës për të kompensuar dëmin, pasi që KEK-u ishte trashëgimtar dhe pasardhës ligjor i Elektroekonomisë së Kosovës. Padia kundër "Autotransportit" u refuzua për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv.

22. Në një datë të pacaktuar, KEK-u parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se "*për të gjitha shkaqet ankimore të parapara me dispozitat e nenit 181 par. 1 pika a), b) dhe c) të LPK* [Ligji për Procedurën Kontestimore]".

23. Më 4 shtator 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 1984/2012) refuzoi si të pabazuar ankesën e KEK-ut dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke konkluduar se "*kompensimi i dëmit (...) është i drejtë dhe i arsyeshëm*".

24. KEK-u parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar "*shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*".

25. Më 10 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 1/2015) aprovoi revizionin e KEK-ut dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Apelit.

26. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme konstatoi si në vijim:

> *"Në vitin 1990, subjekti Elektroekonomia e Kosovës dhunshëm është integruar në Elektroekonominë e Serbisë dhe nga ai moment ka pushuar të ekzistojë si person juridik (...). Ndërsa e paditura e dytë* [Autotransporti] *është regjistruar si shoqëri aksionare më datë 10.3.2006 pa ndonjë specifikë tjetër".*
>
> *"Në shkresat e lëndës nuk ka prova se të paditurat kanë trashëguar edhe obligimet nga EES dhe "Autotransporti" nga koha e masës së dhunshme e kohës së paraluftës, d.m.th. se ky subjekt nuk ka kontinuitet juridik me subjektin e mëparshëm i cili ka marrë obligimin e kompensimit të dëmit për pasojat e fatkeqësisë së komunikacionit që ka ndodhur më 23.8.1993. Të paditurat nuk mund të trajtohen si përgjegjëse për pasojat e shkaktuara në kohën kur ato nuk kanë ekzistuar si subjekt juridik në Kosovë".*
>
> *"Të paditurat [...] nuk kanë legjitimitet pasiv, ngase pala ka legjitimitet lëndor vetëm nëse është pjesëmarrëse e marrëdhënies materialo-juridike, nga e cila ka lindur kontesti, andaj të paditurat nuk kanë detyrim për kompensimin e dëmit sipas kërkesëpadisë së paditësve, ngase të paditurave u mungon legjitimiteti pasiv".*
>
> *"Nuk ekziston asnjë bazë juridike për ekzistimin e ndonjë sukcesioni juridik në mes të paditurave dhe ish subjektit i cili është paditur në vitin 1996. Të paditurat nuk*

kanë trashëguar detyrimet nga ish subjekti dhe si të tilla nuk kanë legjitimitet pasiv".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktgjykimin e kontestuar ishin shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës.

28. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktgjykimin e kontestuar ishin shkelur të drejtat, sepse *"Gjykata Supreme e Kosovës mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale".*

29. Parashtruesit e kërkesës, më tej, arsyetojnë se "*e paditura – KEK-u dhe 'Autotransporti' kanë trashëguar të gjitha pasuritë e tyre, dhe për këtë arsye është obligim i tyre për t'i kompensuar paditësit për dëmet për shkak se ata përdorin thëngjillin e Elektro Ekonomisë së Kosovës, mjetet themelore, ndërtesën dhe të gjithë pronën, pa marrë parasysh kur ajo ishte regjistruar dhe ndryshoi emrin si një subjekt i ri".*

30. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të konfirmojë se aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtën kushtetuese të parashtruesve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe t'i deklarojë si të drejtë dhe të paanshëm aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

33. Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

34. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

35. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, "*sepseGjykata Supreme e Kosovës mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale".*

36. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës thjeshtë deklarojnë se ka pasur shkelje të së drejtës së tyre kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa shpjeguar si dhe pse faktet e paraqitura nga ata përbëjnë shkelje të së drejtës së tyre kushtetuese në të cilën ata ishin thirrur. Ata nuk kishin dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie,* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).

37. Gjykata rithekson se, për të ekzistuar një rast në lidhje me shkelje kushtetuese, parashtruesit duhet të dëshmojnë dhe të provojnë se procedurat në Gjykatën Supreme, të shikuara në tërësinë e tyre, nuk janë kryer në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kërkesat e një gjykimi të drejtë, ose shkelje të tjera të të drejtave kushtetuese janë bërë nga Gjykata Supreme (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

38. Gjykata vëren se Gjykata Supreme konkludoi se "*në shkresat e lëndës nuk ka prova se të paditurat kanë trashëguar edhe obligimet nga EES dhe "Autotransporti" [...]. Të paditurat nuk mund të trajtohen si përgjegjëse për pasojat e shkaktuara në kohën kur ato nuk kanë ekzistuar si subjekt juridik në Kosovë".*

39. Gjykata konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i arsyetuar. Në fakt, ai tërësisht shpjegon pse revizioni ishte refuzuar si i pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të paditurave dhe, rrjedhimisht, aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta ishin ndryshuar. Parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse përfundimi i Gjykatës Supreme për mungesë të legjitimitetit pasiv kishin shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

40. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar dhe provuar pretendimin e tyre mbi një bazë kushtetuese; përkundrazi, ata kanë mbyllur diskutimin për zbatimin e të drejtës materiale bazuar në gjendjen e vërtetuar gabimisht të gjendjes faktike, të cilat janë të natyrës së ligjshmërisë dhe bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta.

41. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

42. Prandaj, Gjykata konsideron se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban të gjitha arsyet e nevojshme në të cilat është bazuar, në pajtim me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

43. Gjykata, edhe pse pranon rezultatin e pafavorshëm për parashtruesit e kërkesës, thekson më tej se ajo nuk është e autorizuar dhe as që është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga Gjykata Supreme për mungesën e legjitimitetit pasiv të të padituarave. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, dhe shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

44. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur dhe provuar mjaftueshëm pretendimin e tyre dhe, për këtë arsye, kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) dhe 2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 13 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI76/15, Parashtruesja e kërkesës: Dušanka Mitić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0114-A0001, të 11 dhjetorit 2014.

KI 76/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2016, i publikuar më 23 maj 2016

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, qartazi e pabazuar.*

Më 21 prill 2008, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar), për anulimin e kontratave të shitblerjes për dy parcela kadastrale që gjenden në Llapna Sellë.
Më 11 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-13-0114-A0001 e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.
Parashtruesja e kërkesës pretendoi se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat e saj për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe rrjedhimisht për mbrojtjen e pronës.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtrueses, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit janë dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ajo e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI76/15
Parashtrues
Dušanka Mitić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0114-A0001, të 11 dhjetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Dušanka Mitić-Simić nga fshati Llapna Sellë, komuna e Graçanicës(në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga z. Visar Vehapi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0114-A0001 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të 11 dhjetorit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 12 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëaktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 qershor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), e cila u pranua në Gjykatë më 15 qershor 2015.

6. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 4 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.

8. Më 16 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 prill 2008, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar), për anulimin e kontratave të blerjes për dy parcela kadastrale që gjenden në Llapna Sellë.

10. Parashtruesja e kërkesës pretendoi se kontratat e shitjes së këtyre parcelave janë nënshkruar nën trysninë e autoriteteve shtetërore të asaj kohe.

11. Më 20 qershor 2013, Kolegji i Specializuar (Aktgjykimi SCC-08-0105) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës.

12. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, thuhet se *"Paditësja i ka bazuar veprimet e veta në nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 dhe nenin 8A të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme të vitit 1981. Megjithatë, neni 1106 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë eksplicite e përjashton efektin retroaktiv të dispozitave ligjore, prandaj nuk mund të zbatohet për tapitë e 1960-ës të lidhura nga paraardhësja e paditëses(...) Kur jemi te neni 8 i Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, gjykata është e mendimit se ky ligj asnjëherë nuk ka qenë në fugi në Kosovë. Ligji ishte miratuar më 1981 në Serbi nga Kuvendi i Serbisë (Gazeta zyrtare e Serbisë 45/81) dhe në të njëjtin vit në Kosovë nga Kuvendi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Kosovës (45/81). Që të dy ligjet kanë titullin" Ligji mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme. Më 23.07.1987 ligjvënësit e Serbisë e ndryshuan ligjin sa i përket nenit 8a. Legjislativi i Serbisë gjithashtu nuk kishte fuqi të ndryshoj ligjet e një legjislativi tjetër. Pra, Ligji i Kosovës mbi Qarkullimin kurrë nuk e kishte përvetësuar dispozitën si neni 8 i ligjit të Serbisë".*

13. Më 11 korrik 2013, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë për shkak të: "*shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, verifikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të të drejtës materiale*".

14. Më 11 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.

15. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së deklaron:

> *"... Kolegji i Ankesave konkludon njejtë si gjykata e shkallës së parë se Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 dhe nenin 8A të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme të vitit 1981. Megjithatë, neni 1106 i Ligjit mbi*

Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë eksplicite e përjashton efektin retroaktive të dispozitave ligjore, prandaj nuk mund të zbatohet për tapitë e 1960-ës të lidhura nga paraardhësja e paditëses (...).
Ndryshimet e këtij neni Serbia i kishte bërë njëanshëm pas vitit 1987 përkundër faktit se ajo ende nuk kishte fuqi legjislative për të ndryshuar ligjet e në Kosovë, andaj ajo dispozitë nuk ka qenë e vlefshme asnjëherë në Kosovë, pos kur përfundimisht ishte suprimuar autonomia substanciale e Kosovës".

16. Për më tepër, Kolegji i Apelit gjeti se *"ligji i zbatueshëm lidhur me kërkesat e tilla është Ligji i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 04/L-033, i cili në nenin 11, paragrafi 2, e zgjidh dilemën e kërkesave të tilla".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat e saj për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe rrjedhimisht për mbrojtjen e pronës.

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit e privoi atë nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak se "*ka nxjerrë aktgjykime krejtësisht politike dhe jo juridike, nga se nuk është në kompetencën e Gjykatës që të merret me shfuqizimin e ndonjë ligji, (...) nga se nuk është në kompetencën e Gjykatës që të merret me shfuqizimin e ndonjë ligji".*

19. Parashtruesja e kërkesës, më tej, pretendon se Kolegji i Apelit *"ka shkelur edhe nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (...) e ka trajtuar në mënyrë të pa barabartë përpara ligjit në krahasim me atë mijëra praktika gjyqësore përpara vitit 1999 dhe ato mijëra të tjera pas vitit 1999".*

20. Përveç kësaj, parashtruesja konkludon se *"duke i shkelur dispozitat e lartcekura DHPGJSK-ja e ka shkelur edhe nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila e garanton mbrojtjen e të drejtës së pronës".*

21. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata *"TA SHPALL të pavlefshëm*" aktgjykimin e kontestuardhe *"të kthejë Aktgjykimin (...) për rishqyrtim".*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:
"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

25. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.
2)Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Gjykata rikujton se argumenti kryesor i parashtrueses ka të bëjë me zbatueshmërinë e nenit 8 a) të Ligjit për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme të Republikës së Serbisë "*në tërë territorin e Republikës së Serbisë, çka do të thotë se ka qenë në aplikim edhe në Kosovë".*

27. Në të vërtetë, parashtruesja pretendon se *"dispozitat e caktuara (në atë kohë) janë rregulluar në mënyrë unike sipas nenit 300 të Kushtetutës së Serbisë për tërë territorin e ish Republikës, - çka do të thotë edhe të ish KSAK. dhe atë për të u pru një dispozitë e tillë dhe për të aplikuar edhe ish KSAK".*

28. Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit kishte analizuar tërësisht pretendimet e bëra nga parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar në mënyrë të hollësishme se pse ankesa e saj ishte refuzuar si e pabazuar.

29. Në të vërtetë, Kolegji i Apelitshpjegoi se *"Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 dhe nenin 8A të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme të vitit 1981. Megjithatë, neni 1106 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë eksplicite përjashton efektin retroaktiv të dispozitave ligjore, prandaj nuk mund të zbatohet për tapitë e 1960-ës të lidhura nga paraardhësja e paditëses".*

30. Për më tepër, Kolegji i Apelit konkludoi më tej se *"në rastin konkret nuk ka pasur asnjë kundërshti ndërmjet ligjit të Kosovës dhe të Serbisë".*

31. Gjykata konsideron se pretendimi për zbatimin e gabuar të dispozitave të caktuara ligjore në vend të tjerave ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë, e cila bie nën prerogativat e gjykatave të rregullta. Për më tepër, ky pretendim përbënë një parashtresë ankimore të "shkallës së katërt".

32. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria)(Shih, për shembull, Rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, para. 65).

33. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

34. Gjykata Kushtetuese rikujton se roli i saj është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

35. Gjykata rithekson se, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë çështje vetëm për instancat e rregullta, të gjeturat dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën

Kushtetuese. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në pikëpyetje (Shih *Sisojeva dhe të tjerë kundër Letonisë* [DHM], kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, para. 89).

36. Gjykata konsideron se procedurat para Kolegjit të Apelit nuk ishin arbitrare; procedurat ishin të drejta dhe aktgjykimi ishte plotësisht i justifikuar dhe i arsyetuar, përkatësisht shpjegon se pse legjislacioni në të cilin thirret parashtruesja e kërkesës nuk është i zbatueshëm në rastin e saj (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, KEDNJ, vendim i 30 qershorit 2009).

37. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka ndërtuar pretendimet e saj mbi baza kushtetuese. Në të vërtetë, parashtruesja nuk ka mbështetur dhe dëshmuar se Kolegji i Apelit ia kishte mohuar asaj të drejtat, kur ka vendosur se përjashtohet fuqia prapavepruese.

38. Përkundrazi, Gjykata vëren se parashtruesja e bazoi ankesën e saj në *"aplikim të gabuar të së drejtës materiale – ligjit"*, që ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si e tillë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

39. Përveç kësaj, fakti se parashtruesja nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

40. Rrjedhimisht, kërkesaështë qartazi e pabazuar në baza kushtetutese dhe është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d) dhe 2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Arta Rama-Hajrizi

KI43/16, Parashtrues Mehdi Kryeziu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015

KI43/16, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 14 prill 2016 dhe publikuar më 23 maj 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit, mjet efektiv juridik, masa të përkohshme, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të rregullta që kishin shpallur parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale, lëndim i rëndë trupor.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se atij i ishte shkelur e drejta e barazisë para ligjit, e drejta për mjete efektive juridike dhe parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale. Parashtruesi po ashtu kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata konkludoi se e drejta e parashtruesit në mjet efektiv juridik ishte respektuar. Ai parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Pretendimet e paraqitura nga ai ishin shqyrtuar dhe ishte vendosur se nuk ishte bërë asnjë shkelje e ligjit. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me konkluzionin e Gjykatës se Apelit apo të Gjykatës Supreme nuk e bën joefektiv mjetin e tillë juridik. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar. Gjykata po ashtu refuzoi kërkesën për masa të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI43/16
Parashtrues
Mehdi Kryeziu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Mehdi Kryeziu nga Suhareka (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Ai përfaqësohet nga z. Naim Qelaj, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015, me të cilin u vërtetuan aktgjykimet e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 606/14, i 25 shkurtit 2015, dhe i Gjykatës Themelore në Prizren P. nr. 11/13,i 11 shtatorit 2014,me të cilat parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për një vepër penale.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 33, paragrafi 1 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], siç garantohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht "*të pezullojë ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P. Nr. 11/13 i datës 11.09.2014 [...]*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 shkurt 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën nëpërmjet shërbimeve postare në Gjykatë.

7. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 31 mars 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta dorëzojë autorizimin, në rast se ai vendos të përfaqësohet nga z. Naim Qelaj, siç është përcaktuar në kërkesën e tij.

9. Më 13 prill 2016, parashtruesi e dorëzoidokumentin e kërkuar në Gjykatë. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 14 prill 2016, Gjykata e shqyrtoi rastin dhe vendosi ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe të refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Pas një përleshjeje në mes të tri familjeve, Prokuroria Publike në Prizren ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës nën dyshimin se ka kryer veprën penale të *"dëmtimit të rëndë trupor"*.

12. Më 11 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi P. nr. 11/13) e shpalli parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar dhe e dënoi atë me 2 (dy) vjet burgim.

13. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të *"shkeljeve esenciale të së drejtës procedurale, shkeljes esenciale të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe dënimit të shqiptuar"*.

14. Më 25 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. Nr. 606/14) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren. Gjykata e Apelit arsyetoi si më poshtë:

> *"[...] Aktgjykimi i kontestuar [...] është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale. [...] gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike përkitazi me këta të pandehur në këtë çështje penale, nga e cila rezulton se në veprimet e të pandehurve përmbahen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilat ata janë shpallur fajtor, prandaj, janë të pabazuara edhe pretendimet ankimore [...]"*.

15. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar *"shkelje esenciale të së drejtës procedurale dhe materiale"*.

16. Më 6 nëntor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 181/15) e aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Ajo vendosi se ka pasur shkelje substanciale të së drejtës materiale pasi që parashtruesit të kërkesës nuk i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim kur i është shqiptuar dënimi. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme ndryshoi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga parashtruesi. Nga ana tjetër, Gjykata Supreme hodhi poshtë të gjitha pretendimet tjera të paraqitura nga parashtruesi.

17. Në mënyrë më të detajuar, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është konstatuar që *"[...] mbrojtësi i të dënuarit Mehdi Kryeziu ka theksuar se i dënuari ka qëndruar në paraburgim prej datës 02.08.2012. [...]. Pasi që koha e kaluar në paraburgim nuk është llogaritur në dënimin e shqiptuar, është i bazuar pretendimi për shkeljen e ligjit penal i cili pretendim u aprovua dhe aktgjykimet u ndryshuan si në dispozitivin e këtij aktgjykimi"*.

18. Në anën tjetër, Gjykata Supreme vëren se *"[...] në dispozitivin 1.4. të aktgjykimit të shkallës së parë janë përshkruar veprimet e të dënuarit Mehdi Kryeziu"*.

19. Gjykata Supreme konsideroi që *"fakti se nuk është precizuar se cili mjet i fortë është përdorur nga i dënuari Mehdi Kryeziu nuk paraqet paqartësi sepse në rastin konkret është shkaktuar lëndimi i rënd trupor, pra, pa marrë parasysh se konkretisht cili ka qenë mjeti i përdorur"*.

20. Gjykata Supreme gjithashtu i konsideroi si të *"pabazuara dhe të paargumentuara"*, dyshimet e pretenduara në objektivitetin e trupit gjykues, pasi që *"nuk i përket as bazës së shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkeljes së ligjit dhe si i tillë nuk u aprovua [...]"*.

21. Në fund, Gjykata Supreme konkludoi se vlerësimi i rrethanave të lëndimeve të marra si rrethanë lehtësuese, *"nuk paraqet as shkelje procedurale e as shkelje të ligjit penal. Është në diskrecionin e gjykatës/ave se cilat rrethana i konsideron të rëndësishme për vendimmarrje, cilat si rënduese ose lehtësuese në secilin rast konkret"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjete juridike dhe parimin e legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale.

23. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës konsideron se ai është ballafaquar me *"gjykim të njëanshëm"* dhe si rezultat i kësaj, ai pretendon se është shkelur e drejta e tij për barazi para ligjit. Parashtruesi më tej konsideron se *"në procedurën gjyqësore në shkallë të I-rë të akuzuarit* [parashtruesi i kërkesës] *i është mohuar e drejta që të paraqitet edhe si palë e dëmtuar"*.

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren ishte *"kontradiktorë, i paqartë dhe konfuz"* dhe se *"i gjithë procesi gjyqësor në të gjitha fazat"* është kryer në kundërshtim me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Kolegji i Apelit ishte i njëanshëm *"pasi që Gjykata e Apelit ka kërkuar ndryshimin e trupit gjykues në rigjykim kur ka pranuar të bazuar ankesën për tre të akuzuarit të parë"*, përderisa për të dhe të akuzuarit e tjerë nuk e ka bërë këtë. Ai konsideron se Gjykata e Apelit ka aprovuar *"drejtësinë selektive"* në rastin e tij penal.

26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është *"i paqartë dhe konfuz"* pasi është nxjerrë në dëm të tij *"përkundër faktit se e konsideron si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë"*.

27. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

28. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar ankesën e tij dhe pretendimet e parashtruara prej tij. Ai më tej thotë se pretendimet e tij *"fare nuk janë analizuar, duke vërtetuar se të akuzuarit* [parashtruesit të kërkesës] *i është privuar e drejta në ankesë që të trajtohet si mjet efikas juridik"*. Si rezultat i kësaj, parashtruesi pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e tij për mjet efektiv juridik.

29. Parashtruesi, më tej, pretendon se atij nuk i ishte ofruar një gjykim i drejtë, në pajtim me *"parimin e legalitetit"*, për shkak se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij të mbrojtur me parimin e legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale.

30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme në mënyrë që të pezullojë përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

33. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

34. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

35. Gjykata rikujton se parashtruesi e konteston Aktgjykimin (Pml. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015) të Gjykatës Supreme, me të cilin ishte vërtetuar Aktgjykimi (PAKR. nr. 606/14, i 25 shkurtit 2015) i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi (P. nr. 11/13, i 11 shtatorit 2014) i Gjykatës Themelore në Prizren. Me të gjitha këto aktgjykime ishte konstatuar se parashtruesi ishte fajtor për veprën penale për të cilën ishte akuzuar dhe, se ai duhet të vuajë dënimin me burgim prej 2 (dy) vjetësh.

36. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjet efektiv juridik dhe parimin e legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale.

37. Gjykata vëren se parashtruesi pretendon shkeljen e *"të drejtës për barazi para ligjit"* dhe *"parimit të mbrojtjes së legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale"*. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës thjesht i referohet nenit 22 dhe 33 të Kushtetutës, duke pretenduar se procedurat ishin *"të njëanshme"* dhe se ai nuk kishte pasur një gjykim të drejtë siç *"kërkohet"* me "*parimin e legalitetit*". Në të vërtetë, ai nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të mëtejshëm apo argumente kushtetuese për atë se si dhe pse të drejtat dhe parimet e tilla janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Me fjalë të tjera, parashtruesi nuk i ka mbështetur dhe dëshmuar pretendimet e tij mbi baza kushtetuese, edhe pse është barrë e parashtruesit të kërkesës për ta bërë këtë.

38. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendoi shkelje të së drejtës së tij për *"gjykim të drejtë dhe të paanshëm",* duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren ka qenë *"kontradiktor, i paqartë dhe konfuz"*. Ai më tej pohoi se atij i ishte mohuar e drejta që të *"paraqitet si palë e dëmtuar",* edhe pse edhe ai ishte një nga individët të cilët pësuan lëndime në përleshjen në mes të familjeve. Parashtruesi i kërkesës në fund pretendoi se trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Prizren ishte i njëanshëm dhe se Gjykata e Apelit miratoi *"drejtësi selektive"* duke urdhëruar ndryshimin e trupit gjykues për disa të pandehur e jo edhe për të.

39. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë arsyetuar vendimet e tyre në mënyrë të kuptueshme dhe të detajuar duke iu referuar dispozitave të ligjit të zbatueshëm. Për më tepër, gjykatat e rregullta i kanë trajtuar pretendimet për shkelje të së drejtës procedurale dhe materiale që ishin paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se ajo që parashtruesi ngre është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

40. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtës materiale dhe procedurale që pretendohen të jenë kryer nga Gjykata e Apelit, kur ka refuzuar ankesën e tij. Gjykata Supreme, në lidhje me pretendimet e parashtruesit se

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren është pretenduar të jetë kontradiktor, i paqartë dhe konfuz, ka theksuar se *"[...] në aktgjykimin e shkallës së parë janë përshkruar veprimet e të dënuarit Mehdi Kryeziu [...]. Fakti se nuk është precizuar se cili mjet i fortë është përdorur nga [ai] nuk paraqet paqartësi"*.

41. Për më tepër, Gjykata vëren se, në lidhje me pretendimet e parashtruesit se pse atij nuk iu njoh statusi i palës së dëmtuar, Gjykata Supreme arsyetoi se *"[...] pothuajse të gjithë të dënuarit në këtë ngjarje edhe vet kanë pësuar lëndime trupore ashtu që janë edhe të dëmtuar. Andaj, fakti se te i dënuari* [parashtruesi i kërkesës]*, me rastin e vendosjes për dënimin kjo rrethanë (marrja e plagëve) nuk është vlerësuar si rrethanë lehtësuese, nuk paraqet as shkelje procedurale e as shkelje të ligjit penal. Është në diskrecionin e gjykatës/ave se cilat rrethana i konsideron të rëndësishme për vendimmarrje, cilat si rënduese ose lehtësuese në secilin rast konkret*".

42. Gjykata më tej vëren se në lidhje me *"drejtësinë selektive"* të pretenduar, të aplikuar nga Gjykata e Apelit në lidhje me ndryshimet e urdhëruara për trupin gjykues për disa të pandehur, Gjykata Supreme pohoi se "*aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar për pjesën e veprës penale të vrasjes për të cilët të akuzuarit* [tre të akuzuarit e tjerë] *dhe është kërkuar që në rigjykim lënda ti jepet trupit tjetër gjykues. Lidhur me këtë, mbrojtësi i të dënuarit* [parashtruesi i kërkesës] *pretendon se gjykata e shkallës së dytë ka pas dyshime në objektivitetin e trupit gjykues dhe duhej që lënda të anulohet në tërësi, pra edhe sa i përket të dënuarve tjerë. Mirëpo, ky pretendim është i pabazuar dhe i paargumentuar, nuk i përket as bazës së shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkeljes së ligjit dhe si i tillë nuk u aprovua"*.

43. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit apo Gjykata Komunale në Prizren, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

44. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave të tij, të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.

45. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij në Gjykatën Themelore në Prizren, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale dhe procedurale janë trajtuar gjerësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse nga të gjitha gjykatat e rregullta. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës nëse Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren ka qenë i drejtë ose jo. Të dyja gjykatat, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, theksuan se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i qartë, jo kontradiktor, i paanshëm dhe se të gjitha faktet vendimtare janë vërtetuar në mënyrë të drejtë.

46. Në të vërtetë, Gjykata vëren më tej se Gjykata Supreme pranoi një prej pretendimeve të parashtruesit për shkelje esenciale të së drejtës materiale, kur vendosi për të korrigjuar llogaritjen e kohës së kaluar nga parashtruesi i kërkesës në paraburgim. Megjithatë, ajo konkludoi se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore në Prishtinë nuk kanë bërë asnjë shkelje tjetër të ligjit. Në pajtim me këtë, pretendimi i parashtruesit se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte në dëm të tij, pavarësisht nga fakti se ajo e miratoi kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, është gjithashtu i pabazuar. Është i pabazuar për shkak se Gjykata Supreme pranoi vetëm pjesërisht kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me llogaritjen e dënimit duke e bërë të qartë se të gjitha pretendimet e tjera të parashtruesit janë *"të pabazuara*".

47. Në këtë drejtim, është me rëndësitë ceket se Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991).

48. Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, që i referohet pretendimeve të parashtruesit për shkelje të ndryshme të ligjit, është i qartë dhe Gjykata gjen se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendim i 30 qershorit 2009).

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës më tej pretendon shkelje të *"të drejtës për mjet efektiv juridik",* sepse *"pretendimet e tij nuk janë analizuar fare"* nga Gjykata e Apelit dhe kështu atij i *"i është privuar e drejta që ankesa e tij të trajtohet si mjet efikas juridik"*. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se të pasurit e një mjeti efektiv juridik nuk do të thotë që mjeti domosdoshmërisht të jetë i suksesshëm për parashtruesin e kërkesës, që është ajo për çka parashtruesi i kërkesës kryesisht ankohet. Gjykata e Apelit në të vërtetë i ka adresuar pretendimet e ngritura nga parashtruesi dhe ka vendosur që *"[...] aktgjykimi i kontestuar [...] është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale*".

50. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut ka vendosur standardet lidhur me atë se çfarë përbën mjet efektiv juridik. Këto standarde në parim nuk kërkojnë që çdo pretendim i ngritur nga një parashtrues duhet të trajtohet. Ajo që është me e rëndësishme, këto standarde nuk duhet të përkthehen ashtu që të nënkuptohet se një mjet efektiv juridik është ai i cili dëshmohet të jetë i suksesshëm për parashtruesin e kërkesës. Përkundrazi, ky nuk është një kusht i kërkuar as nga KEDNJ dhe as nga Kushtetuta. Në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është e obliguar që të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

51. Gjykata konkludon se e drejta e parashtruesit në mjet efektiv juridik ishte respektuar. Ai parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Pretendimet e paraqitura nga ai ishin shqyrtuar dhe ishte vendosur se nuk ishte bërë asnjë shkelje e ligjit. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk

pajtohet me konkluzionin e Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme nuk e bën joefektiv mjetin e tillë juridik.

52. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar saktësisht si dhe pse janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, dhe nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij në baza kushtetuese.

53. Prandaj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

54. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme, përkatësisht të pezullojë ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren (P. nr 11/13, të 11 shtatorit 2014), deri sa të vendosë për këtë çështje.

55. Parashtruesi nuk ka ofruar argumente apo arsye se pse masa e përkohshme duhet të lejohet nga Gjykata. Ai thjesht e ka kërkuar atë në kërkesën e tij.

56. Në mënyrë që Gjykata të lejojë një masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, ajo duhet të përcaktojë se

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie (...), nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*
>
> *[...]*
>
> *Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do ta rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

57. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) d) dhe (2) d), 55 (4) a) dhe (5) dhe 56 (3) dhe (5) të Rregullores së punës, më 14 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI03/16, Parashtruesja e kërkesës: Remzie Duga, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 226/2015, të 14 shtatorit 2015

KI 03/16, aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2016, i publikuar më 23 maj 2016

Fjalët kyçe*: kërkesë individuale, e drejta e punës, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për barazi para ligjit, qartazi i pabazuar.*

Më 20 korrik 2011, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër MPB-së, duke kërkuar kthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe pagesën e të gjitha pagave mujore prej momentit kur është larguar nga puna.
Më 14 shtator 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 226/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës dhe e përfundoi kontestin ligjor të punës me vendim të formës së prerë.

Parashtruesja e kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
Gjykata konstatoi se parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ajo i konsideroi relevante për rastin e saj. Të njëjtën kohë asaj i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare, si të interpretuara gabimisht në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme në procedurën e rregullt gjyqësore. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI03/16
Parashtrues
Remzie Duga
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 226/2015, të 14 shtatorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Remzie Duga nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson z. Naim Haliti,avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 226/2015, të 14 shtatorit 2015, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtrueses kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1176/2013, të 30 marsit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 janar 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 shkurt 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 29 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesenpërregjistrimin ekërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 13 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 8 janar 2001, parashtruesja e kërkesës ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB).

10. Më 30 korrik 2007, parashtruesja dorëzoi kërkesë në MPB për lejimin e pushimit pa pagesë.

11. Parashtruesja e kërkesës thotë se ajo nuk e ka pritur përgjigjen e MPB-së lidhur me kërkesën për lejimin e pushimit pa pagesë, por u largua nga Kosova për të shkuar në Zvicër për trajtim mjekësor dhe nuk u paraqit në vendin e saj të punës.

12. Më 14 dhjetor 2007, pas hetimeve të ndërmarra, MPB-ja (Vendimi ref. 10070/D), ia ndërpreu marrëdhënien e punës parashtrueses, për shkak të "*shkeljes së parimit P-1.16, IV-C, D, që ka të bëjë me paraqitjen në detyrë dhe mungesa nga detyra, shkelje të parimit P/3.20 III-A, IV, D, G, që ka të bëjë me kërkesat për pushim, shkelje të parimit P.1.30 aneks H, mungesa e pa autorizuar nga puna mbi 15 ditë dhe shkelje të parimit P-4.16, III, E, që ka të bëjë me standardet profesionale të Shërbimit Policor të Kosovës".*

13. Në vitin 2010, parashtruesja u kthye në Kosovë dhe parashtroi kërkesë për ri-punësim në MPB. Kërkesa e saj u refuzua sipas nenit 65.3 të Ligjit për Polici.

14. Më 20 korrik 2011, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër MPB-së, duke kërkuar kthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe pagesën e të gjitha pagave mujore prej momentit kur është larguar nga puna.

15. Më 11 shtator 2012, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 1676/11) refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses, duke arsyetuar se vendimi iShërbimit Policor i Kosovës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës është *"i drejtë dhe i ligjshëm".*

16. Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për shkak të "*shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale".*

17. Më 30 mars 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 1176/13) refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

18. Parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të "*shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*".

19. Më 14 shtator 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 226/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion sepse *"... gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur "*Neni 31, e drejta për një proces të rregullt lidhur me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut si dhe të drejtës për punë"* si dhe, përveç kësaj *"me aktgjykimet paraprake* [të gjykatave të rregullta] *janë shkelur dhe e drejta në jo diskriminim si kategori kushtetuese"*.

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e saj, "*sepse gjykatat kanë dhënë një vlerësim kontradiktor dhe me vlerësim të kundërt të gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës materiale"*.

22. Parashtruesja e kërkesës, pretendon, se vendimi me të cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës "*asnjëherë nuk i është dorëzuar të njëjtës"* dhe "*nuk ka fakte se e njëjta* [parashtruesja e kërkesës] *ka nënshkruar"*.

23. Parashtruesja e kërkesës, më tej, pretendon se "*gjykatat e instancave më të ulta nuk kanë vërtetuar drejtë rrethanat gjatë marrjes së këtyre vendimeve", "faktet që kanë të bëjnë me deklaratat e njerëzve të dhëna nën betim në shërbimin noterial por që nuk janë përfshirë"*.

24. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që "*t'i anulojë aktgjykimet e mëparshme gjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe rasti t'i kthehet gjykatës kompetente për rishqyrtim dhe rivendosje"*.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

28. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili saktëson:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]
d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

29. Gjykata rikujton se parashtruesja pretendon që me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (i) dhe e drejta për të punuar dhe për të mos u diskriminuar (ii).

(i) E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

31. Për më tepër, Gjykata merr parasysh nenin 6.1 të KEDNJ-së:

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet nga [...] një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

32. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të "*shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale".*

33. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm "*sepse gjykatat kanë dhënë një vlerësim kontradiktor dhe me vlerësim të kundërt të gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës materiale".*

34. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme konsideroi se "*gjykata e shkallës së dytë (...) ka dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë (...), gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar".*

35. Gjykata, më tej, vëren se Gjykata Supreme gjeti se parashtruesja e kërkesës "*ka lëshuar vendin pa paralajmërim dhe nuk ka pritur përgjigjen në kërkesë për pushim papagesë"* dheprandaj, *"i pushon marrëdhënia e punës pa pëlqimin e tij në qoftë se nuk ka ardhur ne pune pa arsye 5 ditë pune të njëpasnjëshme",* në pajtim me dispozitën e nenit 75, par. 3, të Ligjit mbi të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës.

36. Përfundimi i Gjykatës Supreme është në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila vërteton që kontestet për ndërprerjen e shërbimit të nëpunësve publikë që kanë të bëjnë me "*aktivitetet specifike të shërbimit publik për aq sa ky i fundit vepron si depozitar i autoritetit publik, që është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit ose të autoriteteve të tjera publike"* përjashtohen prej përmbajtjes së nenit 6.1 të Konventës. "*Një shembull i shprehur qartë i aktiviteteve të tilla parashihet (...) policinë"* (shih rastet: *Pellegrin kundër Francës,* paragrafi 66, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 8 dhjetorit 1999; *Massa kundërItalisë*, paragrafi 26, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 23 qershorit 1993; *Glasenapp dhe Kosiek kundër Gjermanisë,* paragrafi 49, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 28 gushtit 1986).

37. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka analizuar hollësisht, ka shpjeguar dhe arsyetuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljet e procedurës kontestimore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

38. Në të vërtetë, Gjykata thekson se detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ose kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, paragrafi 16, Vendim i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, i 30 qershorit 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992; *Barbera Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, paragrafi 68, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 6 dhjetorit 1988).

39. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e të gjeturave faktike ose të ligjit të zbatueshëm, që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Një parashtrues duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës, kur pretendon se një autoritet publik i ka shkelur të drejtat dhe liritë e saj/tij të mbrojtura me Kushtetutë.

40. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu thekson se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* paragrafi 65, Aktgjykim GJEDNJ-së, i 16 shtatorit 1996, shih gjithashtu, *mutatis mutandis,* në rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës*Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

41. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e saj dhe nuk ka shpjeguar se si dhe pse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në vërtetimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e së drejtës materiale përbëjnë shkelje të së drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Për më tepër, ajo nuk ka arritur të tregojë se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme, ishin të padrejta apo arbitrare apo që të drejtat dhe liritë e saj janë shkelur.

42. Gjykata rikujton se parashtruesja gjithashtu pretendoi se *"faktet që kanë të bëjnë me deklaratat e njerëzve të dhëna nën betim në shërbimin noterial por që nuk janë përfshirë"* nuk ishin përfshirë në vlerësimin e gjendjes faktike. Megjithatë, Gjykata vëren se këto deklarata janë dhënë në nëntor dhe dhjetor 2015 dhe aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i 14 shtatorit 2015. Prandaj, këto deklarata nuk kanë mundur të shqyrtohen nga Gjykata Supreme pasi ato ishin dhënë pas përfundimit të procedurave dhe nuk mund të merren parasysh as nga Gjykata.

43. Gjykata, më tej, rikujton se në mënyrë që të kthehet në vendin e mëparshëm të punës dhe që t'i merr pagat e kërkuara, parashtruesja parashtroi padi në Gjykatën Komunale, ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit dhe parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Kërkesa e saj u refuzua si e pabazuar në të gjitha këto shkallë.

44. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi që ta paraqesë kërkesën dhe pretendimet e saj në gjykatat e rregullta. Faktet dhe ligji i zbatueshëm janë vlerësuar gjerësisht dhe tërësisht në të gjitha vendimet. Për më tepër, parashtruesja në përgjithësi ka pasur qasje në shkallën e parë, të apelit dhe atij të revizionit, ku ajo ka mundur t'i paraqesë argumentet dhe provat në lidhje me kërkesat e saj.

45. Gjykata, më tej, konsideron se parashtruesja nuk pajtohet me përfundimin e Gjykatës Supreme për vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e të drejtës materiale. Megjithatë, mospajtimi i thjeshtë i parashtrueses me rezultatin e procedurave të kryera nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* paragrafi 21, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005).

(ii). E drejta e punës dhe për të mos u diskriminuar

46. Më tej, Gjykata rikujton se parashtruesja në Gjykatën Kushtetuese pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta është shkelur e drejta e saj e punës dhe se ajo ishte diskriminuar.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit], i cili parasheh:

> *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
>
> *2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes*

me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".

48. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], i cili përcakton:

"1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës".

49. Gjykata konsideron se parashtruesja nuk i ka mbështetur pretendimet e saj për shkelje të së drejtës së punës dhe për të mos u diskriminuar; ajo vetëm thekson se e drejta e saj për të punuar dhe për të mos u diskriminuar janë shkelur si rezultat i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë, pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese.

50. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesja nuk i ka ngritur këto pretendime në Gjykatën Supreme; ajo i paraqet ato për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese.

51. Gjykata thekson se parashtruesja duhej t'i kishte ngritur këto pretendime në gjykatat e rregullta që ato të mund t'i kishin shqyrtuar ato. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimi për shkeljen e të drejtës së punës dhe për të mos u diskriminuar do të ishte pasojë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

52. Gjykata sapo ka gjetur se pretendimi i parashtrueses për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është i papranueshëm si i pabazuar në baza kushtetuese.

53. Prandaj, Gjykata konsideron se është e panevojshme për ta shqyrtuar ndarazi, në mënyrë të hollësishme shkeljen e pretenduar të së drejtës së parashtrueses për të punuar dhe për të mos u diskriminuar në bazë të neneve 24 dhe 49 të Kushtetutës.

54. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe është e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI118/15, Parashtrues Dragiša Stojković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-129/13, të 3 qershorit 2015

KI118/15, Aktvendim për papranueshmëri i 12 prillit 2016, publikuar më 27 maj 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, gjuhët, mosshterje e mjeteve juridike*

Kolegji i Apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës i Gjykatës Supreme të Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin me të cilin kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, e parashtruar kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës.
Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës-Gjykatës Supreme të Kosovës i ka shkelur të drejtën e tij të mbrojtur me Kushtetutë, respektivisht neni 5 [Gjuhët], dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se Kolegji i Apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës-Gjykatës Supreme të Kosovës, me Aktgjykimin e saj vërtetoi faktin se ai ka treguar se prona e kërkuar nuk është humbur për shkak të rrethanave të ndërlidhura me konfliktin në vitin 1998/1999. Parashtruesi, më tutje, pretendon se fakti i vërtetuar është plotësisht i pavërtetë dhe mund të jetë vetëm rezultat i përkthimit të gabuar, të qëllimshëm apo të paqëllimshëm.
Gjykata konstatoi se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk janë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe të specifikuara më tej në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI118/15
Parashtrues
Dragiša Stojković
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-129/13,
të 3 qershorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Dragiša Stojković, me banim në qytetin e Smederevës, në Serbi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës-Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), GSK-KPA-A-129/13, të 3 qershorit 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, e parashtruar kundër Vendimit KPCC/D/A/180/2012 të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KKPK), të 14 dhjetorit 2012.

3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 30 qershor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 shtator 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 tetor 2015, Kryetarja caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 2 nëntor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dorëzoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.

9. Më 12 prill 2016, Kolegji shqyrtues, pasi e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 11 janar 2007, parashtruesi kërkoi nga Agjencia Kosovare e Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP-ja) konfirmimin e të drejtës pronësore të nënës së tij dhe riposedimin e një ngastre të tokës në fshatin Petrovë, komuna e Prizrenit.

11. Më 14 dhjetor 2012, KKPK-ja (Vendimi grupor KPCC/D/A/180/2012) refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës. KKPK-ja më tej konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk tregoi se kërkesa e tij përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë rezultat i konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999.

12. Më 15 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë te Kolegji i Apelit, duke pretenduar *"vërtetim të gabuar të gjendjes faktike"* dhe *"zbatim të gabuar të së drejtës materiale"*.

13. Më 3 qershor 2015, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi, GSK-KPA-A-129/13) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, duke arsyetuar si në vijim:

> *"KKPK ka kompetencë për të zgjidhur kërkesat pronësore që janë të ndërlidhura me konfliktin, lidhur me pronën e paluajtshme private [...] që përfshijnë rrethanat të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. [...]*
> *Prandaj, KKPK në mënyrë të ligjshme vendosi të hedhë poshtë kërkesën".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar është shkelur neni 5 [Gjuhët] të Kushtetutës, dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit vërtetoi faktin se *"ai ka treguar se prona e kërkuar nuk është humbur për shkak të rrethanave të ndërlidhura me konfliktin në vitin 1998/1999"*. Ai konkludon se fakti i vërtetuar *"është plotësisht i pavërtetë dhe mund të jetë vetëm rezultat i përkthimit të gabuar, të qëllimshëm apo të paqëllimshëm"*.

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se asnjë nga gjyqtarët dhe as procesmbajtësi "*gjuhën serbe nuk e ka gjuhë amtare",* dhe se fakti i vërtetuar nga Kolegji i Apelit, është për shkak të "*përkthimit plotësisht të gabuar"* të deklaratës së tij, i cili ka "*kuptim krejtësisht të kundërt"*. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai ka të drejtë *"që në procedurë (...) të përdori gjuhën time amtare serbe"*.

17. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"është shkelur e drejta ime për gjykim të drejtë e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore"*.

18. Parashtruesi i kërkesës konkludon, duke kërkuar nga Gjykata që "*të vërtetojë jokushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-129/13, të datës 03.06.2015 dhe të udhëzojë mënjanimin e këtyre shkeljeve"*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

22. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar"*.

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtën e tij për përdorim të gjuhës dhe për gjykim të drejtë, për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve, për shkak të përkthimit të gabuar të deklaratës së tij.

24. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij pretendon se Kolegji i Apelit *"pretendimi nga arsyetimi* [i KPKK-së] *se unë nuk kam treguar se kërkesa ime i përmban rrethanat të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë apo janë pasojë e konfliktit të vitit 1998-1999. Posedimin mbi pronën në fjalë e kam humbur për shkak të rrethanave që janë rezultat i konfliktit të vitit 1998-1999*".

25. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon në ankesën e tij se *"vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike pasqyrohet në atë se Agjencia Kosovare e Pronës nuk ka vërtetuar se unë jam trashëgimtari ligjor i bartësit të së drejtës pronësore"* dhe "*kjorezultoi edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, respektivisht zbatimin e dispozitës e cila e definon kompetencën e Agjencisë Kosovare të Pronës"*.

26. Gjykata konsideron se Kolegji i Apelit kishte analizuar tërësisht provat e paraqitura dhe pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës, duke shpjeguar dhe arsyetuar në detaje pse është refuzuar ankesa e tij.

27. Në të vërtetë, Kolegji i Apelit vërejti se KPKK-ja kishte sqaruar *"se prona e kërkuar ishte blerë në vitin 1970 nga familja Çovanaj dhe ishte shfrytëzuar nga ata gjatë konfliktit"*. Kolegji i Apelit gjithashtu theksoi se "*në reagimin ndaj Urdhrit të Gjykatës, Ankuesi nuk e dëshmoi që është i pavërtetë fakti se familja Çovanaj posedonte pronën e kërkuar para dhe gjatë konfliktit të armatosur"*. Përveç kësaj, Kolegji i Apelit vërejti se "*që nga 1986 një rast ishte në pritje në gjykatën e Prizrenit në mes të palëve lidhur me pronën e kërkuar*".

28. Prandaj, Kolegji i Apelit konkludoi ashtu sikurse KPKK-ja "*se kërkesa nuk ndërlidhet me rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur dhe KKPK vendosi në mënyrë të ligjshme se KKPK nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me kërkesën. Prandaj, KKPK në mënyrë të ligjshme vendosi të hedhë poshtë kërkesën"*.

29. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit para Kolegjit të Apelit janë të lidhura me konstatimin se ai ka të drejtë që ta riposedojë pronën e kontestuar dhe si të tilla janë të natyrës së ligjshmërisë dhe bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta.

30. Gjykata, gjithashtu vëren se parashtruesi për herë të parë pretendon shkelje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të të drejtave të tij për përdorimin e gjuhës dhe për gjykim të drejtë, për shkak të përkthimit të gabuar të deklaratës së tij. Si pasojë e këtij përkthimi të pasaktë, ka ndodhur një vërtetim i gabuar i fakteve dhe zbatim i ligjit.

31. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës, në procedurat e rregullta, as nuk e ka ngritur, konkretisht dhe në esencë, shkeljen e pretenduar të "*së drejtës që në procedurë (...) të përdor gjuhën time amtare serbe"* dhe as që ka shpjeguar se përse pranë gjykatave të rregullta nuk është thirrur në të drejtën e garantuar me nenin 5 të Kushtetutës, në mënyrën siç e ka prezantuar në Gjykatë.

32. Në fakt, Gjykata thekson se parashtruesi duhet të ketë paraqitur këtë pretendim të paktën në ankesën e tij në Kolegjin e Apelit, sepse jo vetëm që ka pasur të drejtë por e ka pasur edhe obligim ta bëjë këtë në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

33. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta duhet t'u jepet mundësia që përfundimisht të vendosin për çështjen që është duke u shqyrtuar nga ato. Kjo do të thotë që një shkelje e pretenduar kushtetuese në përgjithësi nuk duhet të lejohet të arrijë në Gjykatën Kushtetuese, pa u shqyrtuar më parë nga gjykatat e rregullta.

34. Parimi i shterimit të mjeteve juridike, që kanë të bëjnë me parimin e subsidiaritetit, kërkon që parashtruesi t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurat e gjykatave të rregullta para se të vijnë në Gjykatën Kushtetuese.

35. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u ankuar më tej dhe në këtë mënyrë nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e zbatueshëm në Kosovë (Shih, për shembull, rastin nr. KI07/09, *Demë dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 28-29).

36. Ky vlerësim është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka vërtetuar se "*parashtruesja u ankua se nuk i ishte mundësuar që procedura të zhvillohej në hungarisht – gjuhë e saj amtare – pasi që ajo nuk e fliste rrjedhshëm serbishten. Gjykata vëren se (...) parashtruesja kurrë nuk e ngrehu këtë ankesë në nivel vendës. Prandaj, kjo ankesë duhet të refuzohet për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike vendëse (...)*". (GJEDNJ, vendim përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës 44694 nga *Erzebet PAP kundër Serbisë*, i 21 qershorit 2011, kapitulli Ligji, paragrafi 3).

37. Gjykata vëren se vendime të tjera të GJEDNJ-së për të njëjtën çështje janë nxjerrë, mes tjerash, në rastet si në vijim: *Cardot kundër Francës*, kërkesa nr. 11069/84, Aktgjykim i 19 marsit 1991, paragrafi 34; Vendim në Kërkesën nr. 40521/06, *Aleksandr Mikhaylovich Gorbatenko kundër Rusisë*, paragrafët 43 dhe 44; Vendim përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave nr. 33088/96, 52236/99, 52451/99 - 52453/99, 52455/99, 52457/99 - 52459/99 nga *Anton Jazvinsky kundër Republikës Sllovake*, i 7 shtatorit 2000, kapitulli Ligji, paragrafët 3, 5, 7 b), 9, 11, 14, 15, 19 dhe 20 a); Vendim në kërkesën nr. 36367/09, *Ziyavdi Deniyevich Kagirov kundër Rusisë*, i 27 gushtit 2013, paragrafi 45; Vendim në kërkesën nr. 56783/11, *Miroslav Kral kundër Sllovakisë*, i 2 dhjetorit 2014, paragrafët 60 deri 65; Vendim në kërkesën nr. 59703/13, *Lee Anthony Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 5 janarit 2016, paragrafët 42 deri 45.

38. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih rastin nr. KI116/14, *Fadil Selmanaj,* Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015, paragrafi 48).

39. Nga sa u tha më lart, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk janë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe të specifikuara më tej në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 56 b) të Rregullores së punës, më 12 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI67/15 dhe KI68/15, Parashtrues Mykereme Hoxha dhe Mërgim Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2012, të 7 nëntorit 2014

KI67/15 dhe KI68/15, Aktvendim për papranueshmëri i 8 marsit 2016, publikuar më 27 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e bashkuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, liria e shprehjes, e drejta e qasjes në dokumente publike, mbrojtja e pronës, kërkesë e paafatshme.*

Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. nr. 116/2012, i 7 nëntorit 2014, duke refuzuar kërkesën për revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 313/2010, të 9 nëntorit 2011, me arsyetimin se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është i drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike.
Parashtruesit, ndër të tjera, pretendojnë se Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, lirinë e shprehjes, të drejtën e qasjes në dokumente publike si dhe të drejtën në pronë. Parashtruesit, më tutje, pretendojnë se atyre nuk u është lejuar qasja në shkresat e lëndës dhe asnjëherë nuk u janë dorëzuar vendimet e gjykatave të rregullta.
Gjykata konstatoi se kërkesaduhet të hidhet poshtë si e papranueshme sepse është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI67/15 dhe KI68/15
Parashtrues
Mykereme Hoxha dhe Mërgim Hoxha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2012, të 7 nëntorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Mykereme Hoxha dhe z. Mërgim Hoxha, me vendbanim në Pejë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2012, i 7 nëntorit 2014 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, AC. nr. 313/2010, të 9 nëntorit 2011 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. 90/03, të 9 janarit 2008.

3. Sipas shkresave të lëndës, vendimi i kontestuar i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesëve, më 27 janar 2015.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesit parashtruan kërkesa të ndara në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), duke pretenduar se aktgjykimet e lartpërmendura shkelin të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 40 [Liria e Shprehjes], nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 6 par. 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt], lidhur me nenin 10 par. 1 [Liria e Shprehjes] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ.

5. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore lidhur me rastin e tyre.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 27 dhe 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 28 maj 2015, parashtruesit e kërkesës ndaras dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatë.

8. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI67/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI67/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 15 korrik 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë informata shtesë, që dëshmojnë se kur parashtruesit e kanë pranuar Aktgjykimin e kontestuar.

10. Më 20 gusht 2015, Gjykata Themelore në Pejë dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

11. Më 2 shtator 2015, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja, urdhëroi që kërkesa KI68/15 të bashkohet me kërkesën KI67/15 dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues, për të dy rastet (KI67/15 dhe KI68/15) të jenë të njëjtë, ashtu siç ishte vendosur në kërkesën KI67/15.

12. Më 10 shtator 2015, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesave KI67/15 dhe KI68/15 dhe bashkimin e tyre.

13. Më 29 tetor 2015, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një dokument, ku kërkon që t'i dërgohet Urdhri për bashkimin e kërkesave (KI67/15 dhe KI68/15).

14. Më 4 nëntor 2015, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dërgoi në Gjykatë një dokument në bazë të të cilit kërkon rishqyrtimin e vendimit të Gjykatës për bashkimin e lëndëve (KI67/15 dhe KI68/15).

15. Më 11 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës z. Mërgim Hoxha, dërgoi në Gjykatë një dokument në bazë të të cilit kërkon rishqyrtimin e Vendimit të Gjykatës për bashkimin e lëndëve (KI67/15 dhe KI68/15).

16. Më 17 nëntor 2015, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dërgoi në Gjykatë një dokument ku kërkoi "*eliminimin e pengesave kushtetuese*", si dhe dërgimin e të gjitha vendimeve për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues në rastet KI27/12, KI31/12, KI32/12 dhe KI33/12, si dhe Urdhrin për bashkimin e këtyre kërkesave.

17. Më 18 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës z. Mërgim Hoxha, dërgoi në Gjykatë një dokument, ku kërkoi "*eliminimin e pengesave kushtetuese*" si dhe dërgimin e të gjitha vendimeve për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues në rastet KI27/12, KI31/12, KI32/12 dhe KI33/12, si dhe Urdhrin për bashkimin e këtyre kërkesave.

18. Më 25 nëntor 2015, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një shkresë në bazë të së cilës kërkon që kryetarja, Arta Rama-Hajrizi dhe zëvendëskryetari, Ivan Čukalović të përjashtohen nga shqyrtimi i rastit të saj.

19. Më 16 dhjetor 2015, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë (Plotësim të kërkesës).

20. Më 22 dhjetor 2015, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një kërkesë në bazë të së cilës kërkoi që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore lidhur me rastin.

21. Më 29 dhjetor 2015, Gjykata i dërgoi parashtruesve, Urdhrin për bashkimin e kërkesave (KI67/15 dhe KI68/15), në bazë të kërkesave të tyre.

22. Më 6 janar 2016, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një kërkesë, ku kërkoi "*dërgimin e 5 (pesë) shtojcave të Urdhrit për bashkimin e kërkesave (KI67/15 dhe KI68/15)*".

23. Më 12 janar 2016, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë sërish kërkesë për "*rishqyrtimin e vendimit për bashkimin e lëndës (KI67/15 dhe KI68/15)".*

24. Më 15 janar 2016, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një kërkesë, ku kërkoi që lënda me numër KI67/15 të shqyrtohet ndaras nga lënda KI68/15.

25. Më 27 janar 2016, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi një shkresë në Gjykatë, ku sërish kërkoi që kryetarja, Arta Rama-Hajrizi dhe zëvendëskryetari Ivan Čukalović, të përjashtohen nga shqyrtimi i rastit të saj.

26. Më 9 shkurt 2016**,** parashtruesja e kërkesësznj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë (Plotësim të kërkesës).

27. Më 7 mars 2016, parashtruesja e kërkesës znj. Mykereme Hoxha, dorëzoi në Gjykatë një kërkesë, ku sërish kërkoi që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore lidhur me rastin.

28. Më 7 mars 2016, Gjykata në pajtim me nenin 7 të Rregullores së punës e shqyrtoi kërkesën e parashtrueses lidhur me përjashtimin e kryetares, Arta Rama-Hajrizi dhe zëvendëskryetarit Ivan Čukalović nga shqyrtimi i rastit dhe unanimisht vendosi që kërkesën mos ta marrë në konsideratë, pasi që nuk i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 18 të Ligjit.

29. Më 8 mars2016,Kolegji shqyrtues e shqyrtoiraportin egjyqtarit raportuesdhe i rekomandoiGjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

30. Përkitazi me pretendimet e ngritura dhe faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës, të cilat kanë të bëjnë me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. 90/03, të 9 janarit 2008 dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, AC. nr. 313/2010, të 9 nëntorit 2011, dhe të cilat janë plotësisht të njëjta edhe në kërkesën e tanishme, Gjykata ka vendosur tashmë në rastet: KI27/12, KI31/12, KI32/12 dhe KI33/12.

Përmbledhja e fakteve për rastet e mëparshme

31. Kërkesat e parashtruesve kishin të bëjnë me një kontest pronësor, lidhur me pronën e cila gjendet në Pejë. H. D. (e cila është motër e parashtrueses së parë dhe teze e parashtruesit të dytë) kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Pejë, për vërtetimin e pronësisë mbi banesë, kundër të padituritM. H. (i cili është bashkëshort i

ndjerë i parashtrueses së parë dhe i ati i ndjerë i parashtruesit tjetër). Në vitin 2002 M. H., vdiq.

32. Më 9 janar 2008, Gjykata Komunale në Pejë nxori Aktgjykimin, C. nr. 90/03, duke vërtetuar se H. D., është pronare e banesës dhe duke detyruar parashtruesit e kërkesës që H. D. t'ia pranojnë të drejtën e pronësisë.

33. Më 9 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, nxori Aktgjykimin, AC. nr. 313/2010, duke refuzuar ankesën e parashtruesve si të pabazuar.

34. Më 19 mars 2012, Mykereme Hoxha, parashtroi në Gjykatë kërkesën me numër KI27/12.

35. Më 26 mars 2012, z. Mërgim Hoxha parashtroi në Gjykatë kërkesën me numër KI32/12. Kërkesa me numër KI31/12 e parashtruar nga znj. Merita Hoxha, ndërsa kërkesa me numër KI33/12 parashtruar nga z. Blerim Hoxha, që të tre fëmijë të parashtrueses së kërkesës znj. Mykereme Hoxha.

36. Më 4 korrik 2012, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari, urdhëroi që kërkesatKI31/12, KI32/12 dhe KI33/12 të bashkohen me kërkesën me numër KI27/12.

37. Më 5 korrik 2013, Gjykata vendosi lidhur me kërkesën e parashtruesve në rastet e mëparshme duke e shpallur kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve për Rastin KI67/15 dhe KI68/15

38. Sipas kërkesës së parashtruesve, për Rastin KI67/15 dhe KI68/15 rezulton se në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan Gjykatës Supreme me kërkesën për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut AC. nr. 313/2010, të 9 nëntorit 2011, duke pretenduar se Aktgjykimi i lartpërmendur ka qenë i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

39. Më 7 nëntor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 116/2012), e refuzoi kërkesën për revizion. Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme theksohet: "*Gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditëses është bazuar, dhe si të tillë ankesën e të padituve-kundërpaditësve e ka refuzuar*".

40. Siç u theksua më lart, më 28 maj 2015, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan ndaras Gjykatës.

41. Më 20 gusht 2015, Gjykata Themelore në Pejë, përmes shkresës me numër GJA. nr. 289/2015 njoftoi Gjykatën se parashtruesit e kërkesës kanë refuzuar që të pranojnë vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat atyre u janë dorëzuar në mënyrë të rregullt, përveç Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 116/2012, të 7 nëntorit 2014.

42. Përmes shkresave të lëndës (fletëkthesës) vërehet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2012, të 7 nëntorit 2014, i është dorëzuar përfaqësuesit të cilin

parashtruesit e kanë pasur para Gjykatës Supreme, z. Blerim Hoxha, më 27 janar 2015.

43. Në bazë të shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Supreme kanë qenë të përfaqësuar nga z. Blerim Hoxha (i cili ishte njëkohësisht parashtrues i kërkesës KI33/12 dhe i cili nga shkresat e lëndës rezulton të jetë djali i znj. Mykereme Hoxha dhe vëllai i z. Mërgim Hoxha, të cilët janë parashtrues në rastin aktual).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, C. 90/03, i 9 janarit 2008, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut AC. nr. 313/2010 i 9 nëntorit 2011, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 115/2012, i 7 nëntorit 2014, shkelin të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], lidhur me nenin 40 [Liria e Shprehjes], nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], si dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt], lidhur me nenin 10 par. 1 [Liria e Shprehjes] të KEDNJ, lidhur me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ.

45. Parashtruesit e kërkesëspretendojnë se atyre nuk u është lejuar qasja në shkresat e lëndës dhe asnjëherë nuk u janë dorëzuar vendimet e gjykatave të rregullta.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

47. Gjykata rikujton se për Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. 90/03, të 9 janarit 2008 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, AC. nr. 313/2010, të 9 nëntorit 2011, të cilat kontestohen përsëri nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata ka vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri KI27/12, KI31/12, KI32/12 dhe KI33/12 të 5 korrikut 2013. Gjykata thekson se nuk ka juridiksion të vendosë për çështjet e njëjta juridike për të cilat një herë ka vendosur përveç nëse ka pretendime apo fakte të reja.

48. Në këto rrethana, Gjykata do të vlerësojë pretendimet e të dy kërkesave vetëm sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 115/2012, të 7 nëntorit 2014

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*

50. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet*

e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

51. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, [...]".

52. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 27 (3) të Rregullores së punës, i cili qartëson se:

"*Kur periudha kohore shprehet në muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilën duhet të llogaritet periudha kohore*"..

53. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht bazuar në fletëkthesën e dorëzuar nga Gjykata Komunale e Pejës, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 115/2012, i 7 nëntorit 2014, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës më 27 janar 2015.

54. Gjykata rikujton se çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet parashtruesit/parashtruesve të kërkesës (Shih, *Bekauri kundër Gjeorgjisë,* Nr. 14102/02 GJEDNJ, Aktgjykimi 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih, *mutatis mutandis,* Rasti nr. KI02/10, Aktvendim për papranueshmëri, *Roland Bartezko,* paragrafët 25-28, 21 mars 2011 dhe *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë,* Nr. 58511/13 GJEDNJ,Aktvendim i 27 janarit 2014).

55. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se afati prej 4 (katër) muajsh fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit ose përfaqësuesit të tij i është dorëzuar vendimi gjyqësor, edhe nëse parashtruesi vet është informuar më vonë për vendimin(Shih, *Otto v. Germany Nr. 21425/06,* GJEDNJ, Vendimi i 10 nëntorit 2009 dhe shih, *mutatis mutandis, Celik v. Turkey, GJEDNJ, Nr. 52991/99, shih po ashtu* rastin *Benet Praha, SPOL. S R.O kundër Republikës Çeke*, Nr. 38354/06, GJEDNJ, Vendimi i 28 shtatorit 2010).

56. Për të vërtetuar nëse parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur kërkesën brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajsh, Gjykata si datë të pranimit të vendimit e merr datën e pranimit të Aktgjykimit të lartpërmendur nga përfaqësuesi i parashtruesve, pra 27 janarin 2015. Gjykata vëren se parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën e tyre në Gjykatë, më 28 maj 2015 (ditë e enjte). Kjo do të thotë, se kërkesa është paraqitur një ditë pas skadimit të afatit të paraparë. Rrjedhimisht, kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores.

57. Gjykata rikujton se parashtruesit në kërkesën e tyre pretendojnë se atyre kurrë nuk u është dorëzuar Aktgjykimi i lartpërmendur si dhe nuk u është lejuar qasja në shkresat e lëndës. Ky pretendim përbënë thelbin e kërkesës së parashtruesëve për mbrojtje të të drejtave të tyre kushtetuese. Sidoqoftë, parashtruesit nuk sqarojnë më tej dhe nuk

mbështesin me argumente bindëse pretendimet e tyre se u është shkelur e drejta për qasje në dokumentet e lëndës, gjegjësisht nuk u është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme. Për më tepër, Gjykata vëren se këto pretendime të parashtruesve nuk janë në përputhje me shkresat e lëndës të cilat i ka dërguar Gjykata Themelore në Pejë.

58. Gjykata dëshiron të përkujtojë se vetëm referimi i thjeshtë në dispozita të Kushtetutës, si dhe pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur fakte bindëse që dëshmojnë një shkelje të tillë nga ana e autoritetit publik dhe pa sqaruar rrethanat që kanë çuar në një shkelje të tillë të pretenduar, nuk ofron bazë të mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së.

59. Sa i përket kërkesëssë parashtruesve për të mbajtur seancë dëgjimore, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*
>
> *2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, Gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".*

60. Gjykata konsideron, që shkresat e lëndës të këtyre kërkesave janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast, sipas formulimit të paragrafit 2, të nenit 20 të Ligjit.

61. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses për mbajtje të seancës dëgjimore hedhet poshtë si e pa bazë.

62. Si përfundim, Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës është që të promovojë sigurinë juridike, duke garantuar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

63. Prandaj, kërkesaduhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 8 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI163/14, Parashtrues Enis Beqiri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 181/2014, të 8 korrikut 2014

KI163/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2015, publikuar më 3 qershor 2016

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi pretendonte se gjykatat e rregullta ia shkelën të drejtën për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtën e punës dhe ushtrimit, e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës, si dhe mbrojtjen gjyqësore e të drejtave, e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, të gjitha për faktin se gjykatat e rregullta nuk morën në konsideratë përmbajtjen e parashtresave të parashtruesit përkitazi me ushtrimin e kërkesëpadisë, por e hodhën poshtë atë për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor, respektivisht për shkak se kërkesëpadia ishte ushtruar para kohe.

Gjykata, pasi vlerësoi të gjitha pretendimet dhe argumentet e ngritura në kërkesë nga parashtruesi i kërkesës, erdhi në përfundim se kërkesa duhej deklaruar, si qartazi e pabazuar për arsye se Gjykata Kushtetuese nuk mund të lëshohej në çështjet e faktit dhe të interpretimit të ligjit material dhe procedural. Gjykata, më tutje, arsyetoi se detyrë e saj, sipas Kushtetutës, është të vlerësojë tërësinë e procedurave të ndjekura në gjykatat e rregullta, nëse ato gjykata kanë përmbushur standardet e garantuara të cilat mbrohen me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI163/14
Parashtrues
Enis Beqiri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 181/2014 të 8 korrikut 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Enis Beqiri, me vendbanim në Gjilan, Kosovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Ai përfaqësohet nga z. Avdullah Ismajli, avokat në Gjilan, Kosovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme (Rev. nr. 181/2014, i 8 korrikut 2014), Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 4275/12, i 18 nëntorit 2013) dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë (C. nr. 2505/2010, i 13 majit 2011).

3. Me vendimet e kontestuara është refuzuar padia e parashtruesit për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës në ProCredit Bank.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet shkelja e të drejtave të parashtruesit të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të drejtat e garantuara me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI163/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI163/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 18 dhjetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, nga një kopje të kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme dhe ProCredit Bank.

9. Më 27 janar 2014, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë shkresat e lëndës së parashtruesit të kërkesës C. nr. 2505/2010.

10. Më 30 janar 2015, ProCredit Bank, në cilësinë e palës së interesuar, dorëzoi në Gjykatë komentet e saj përkitazi me kërkesën.

11. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin KSH. KI163/14, e zëvendësoi anëtarin e Kolegjit shqyrtues Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015.

12. Më 16 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi edhe një letër në Gjykatë, me të cilën kërkoi që kërkesa të vendoset me urgjencë.

13. Më 18 dhjetor 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi për papranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, në përputhje me rregullin 44 (4) të Rregullores së punës caktoi gjyqtarin Robert Carolan, si kryesues të Kolegjit shqyrtues, të përgatisë Aktvendimin për Papranueshmëri duke marrë parasysh se gjyqtari raportues nuk ishte pjesë e shumicës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 25 tetor 2005, parashtruesi i kërkesës themeloi marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me ProCredit Bank, Dega në Gjilan.

15. Më 11 nëntor 2010, ProCredit Banka, nëpërmjet Njoftimit nr. 11-517, e informoi parashtruesin për shkëputjen e kontratës së punës. Në njoftim thuhet:

"*Sipas vlerësimit të performancës suaj të bërë më 10 nëntor 2010 është konstatuar se ju keni dështuar të tregoni performancë të kënaqshme të punës. Duke u bazuar në këtë që u tha më lart, ProCredit Bank-a rezervon të drejtën të ndërpres marrëdhënien e punës bazuar dhe në përputhje me paragrafin 7. c) dhe d) të kontratës së punësimit dhe në pajtim me nenin 5.10.1, seksionin g) të Politikës së Personelit. [...] Ju keni të drejtë ligjore që të lajmëroheni tek organet e punësimit për të shikuar mundësi të punësimit në institucionet tjera dhe në mbrojtjen e interesave tuaja.*"

16. Më 22 nëntor 2010, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Bankës ProCredit, me të cilën kërkoi anulimin e Njoftimit të lartcekur, kthimin në vendin e tij të mëparshëm të punës dhe kompensimin e pagave. Ndër pretendimet e tjera, parashtruesi deklaroi se *"ProCredit Bank nuk më jep të drejtën e ankesës, jamë i detyruar që drejtën time të realizoj përmes Gjykatës [...]."*

17. Në ndërkohë, parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtroi ankesë tek Inspektorati i punës, duke theksuar se Banka ProCredit e ka larguar nga puna në mënyrë të paligjshme.

18. Më 24 dhjetor 2010, Inspektorati i punës (Raporti nr. 003665) arriti në përfundim se me aktin e brendshëm të Bankës ProCredit nuk ishte e paraparë procedura e ankesave në shkallë të dytë ku punonjësit do të mund t'i parashtronin ankesat apo pretendimet e tyre, dhe rekomandoi që Banka t'i rregullojë lëshimet e tilla në mënyrë që të jenë në pajtim me dispozitat e ligjit të zbatueshëm për kontestet e punës.

19. Më 13 maj 2011, Gjykata Komunale (Aktvendimi C. Nr. 2505) hodhi poshtë, si të palejuar padinë e parashtruesit të kërkesës. Ajo arsyetoi se parashtruesi duhet të kishte paraqitur ankesë kundër njoftimit të lartpërmendur në Bankën ProCredit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, siç parashihet me ligjin e zbatueshëm. Gjykata Komunale konkludoi se pasi parashtruesi i kërkesës nuk e shfrytëzoi këtë mundësi, padia ishte e parakohshme dhe si e tillë ishte e papranueshme.

20. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Apelit duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës procedurale dhe materiale. Ai ka kërkuar nga Gjykata e Apelit ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Komunale si të paligjshëm dhe ta kthejë lëndën në rigjykim. Përveç kësaj, parashtruesi përsëriti edhe një herë se me Njoftimin e Bankës ProCredit ishte dhënë një kështillë e gabueshme, për shkak të së cilës ai parashtroi kërkesë drejtpërdrejt në gjykatat e rregullta, si mjet i vetëm për të mbrojtur të drejtat e tij.

21. Më 18 nëntor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 4275/12), hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë. Gjykata e Apelit konstatoi se:*"gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur me aktvendimin e atakuar e ka hedhur si të palejuar padinë e paditësit , meqë nuk janë plotësuar dy prezumimet e parapara me nenin 83 të ligjit mbi te drejtat themelore nga marrëdhënia e punës [...]."*

22. Më 5 shkurt 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të mosshqyrtimit të parashtresave nga gjykatat e instancës më të ulët.

23. Më 8 korrik 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 181/2014) e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi se:

> *"Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vlerësuar kur kanë gjetur se padia e paditësit është e palejuar [...]. Në rastin konkret, paditësi nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij para organit kompetent tek e paditura, prandaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, për faktin se paditësja nuk ka kërkuar mbrojtje juridike interne, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore kur kanë gjetur se padia duhet të hedhet si e palejuar. Gjykata Supreme e Kosovës, thëniet e revizionit i vlerësoi si të pabazuara se aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me shkelje procedurale, përkatësisht me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, sepse në fakt nuk kemi të bëjmë me zbatimin e të drejtës materiale, kur padia hidhet për shkak të mungesës se prezumimeve procedurale për paraqitjen e padisë, përkatësisht zhvillimin e procedurës."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtat e garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe të drejtën e garantuar me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

25. Sa i përket të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk i ka shqyrtuar të gjitha parashtresat e parashtruesit, që ishin të rëndësishme për rezultatin e vendimit të tyre. Në mënyrë të veçantë, parashtruesi thekson se raporti i Inspektoratit të punës, "*ku gjenden shkelje të shumta të kryera nga ProCredit Bank",* nuk është marrë parasysh nga Gjykata Supreme.

26. Në lidhje me të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, si dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e tillë pretendohet të jetë kryer nga gjykatat e rregullta, kur ato refuzuan që të vlerësojnë meritat e kërkesës së tij. Sipas tij, Banka ProCredit *"nuk i kishte dhënë të drejtë ankese";* prandaj, "*në mungesë të ndonjë mjeti tjetër në dispozicion, ai iu drejtua gjykatës kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës"*. Duke mos marrë parasysh kërkesat e tij, parashtruesi pretendon se ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 dhe 54 të Kushtetutës.

27. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se: "*[...] Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e ka shqyrtuar lëndën, por është bazuar në aktvendimin e shkallës së parë dhe të dytë [...]"*. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se "*[...] Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, i cili në mënyrë të qartë dhe zyrtare potencon parregullsitë, paligjshmërinë dhe padrejtësinë e të paditurës ProCredit Bank, dega në Gjilan, ku konstaton se e paditura ProCredit Bank, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit Enis Beqiri përdor një paragraf 'FANTOM' i cili fare nuk ekziston, [...] dhe nuk i ka dhënë të drejtën e ankesës."*

28. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata që të konstatojë se "*[...] është shkelur neni 49 dhe 54 i kushtetutës së Republikës Kosovës, kur parashtruesit të*

kërkesës [...] i janë shkelur të drejtat elementare të njeriut: të drejtën në punë në momentin e përmbylljes së kontratës së punës pa të drejtë, dhe të drejtën në mbrojtje gjyqësore të drejtave, kur nuk i është lejuar që të mbroj të drejtën e vet subjektive të garantuara me kushtetutën e Republikës Kosovës, Konventën Ndërkombtare mbi te Drejtat e Njeriut dhe Ligjet pozitive ne fuqi.".

Komentet e dorëzuara

29. Më 30 janar 2015, Banka ProCredit, në cilësinë e palës së interesuar, dorëzoi në Gjykatë, komentet e saj ndaj pretendimeve të ngritura nga parashtruesi në kërkesën e tij. Banka ProCredit kërkoi nga Gjykata, që t'i refuzojë si të papranueshme pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për arsye se *"faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës ne asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e te drejtave kushtetuese, në të cilat thirret ai dhe njëherit ai nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me pretendimin e tij."*

Pranueshmëria e kërkesës

30. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e nevojshme të pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në pajtim me Kushtetutën; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme; se i ka shteruar mjetet e nevojshme juridike; dhe se ka parashtruar kërkesën e tij brenda katër (4) muajve pas parnimit të vendimit të kontestuar.

32. Parashtruesi i kërkesës ka deklaruar në mënyrë të qartë të drejtat dhe liritë konkrete kushtetuese dhe aktin e kontestuar, të cilat pretendohet se i janë shkelur, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

33. Përveç kësaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës e ka plotësuar kriterin e paraparë në Rregulloren e punës, përkatësisht rregullin 36 (2), i cili parasheh:

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

34. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi (Rev. Nr. 181/2014, të 8 korrikut 2014) i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me *"të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit; dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave"* siç garantohet me Kushtetutë dhe KEDNJ. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Aktvendimi (Ac. Nr. 4275/12, i 18 nëntorit 2013) i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi (C. nr 2505/2010, i 13 majit 2011) i Gjykatës Komunale në Prishtinë gjithashtu janë nxjerrë me shkeljen e të drejtave të tilla.

35. Në lidhje me të drejtën e tij të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk i ka marrë parasysh parashtresat e tij të parashtruara në kërkesën për revizion. Sipas parashtruesit, nëse këto parashtresa do të merreshin parasysh, rezultati i vendimit do të ishte në favor të tij. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kryesisht merret me atë se pse parashtresat e tij në lidhje me gjetjet e Inspektoratit të Punës nuk janë shqyrtuar nga Gjykata Supreme.

36. Në lidhje me kërkesën e lartcekur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme janë vërtetuar të dy aktvendimet, ai i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Komunale në Prishtinë, me të cilët ishte vendosur se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhej të refuzohej si e parakohshme, për shkak të mos inicimit të ndonjë procedure të brendshme ankimore në Bankën ProCredit. Prandaj, Gjykata vëren se të gjitha shkallët e gjykatave të rregullta e kanë refuzuar kërkesën e parashtruesit në baza procedurale dhe pa hyrë në vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës së parashtruesit. Ato e kanë arritur këtë përfundim duke u bazuar në faktin se kërkesa e parashtruesit ishte shpallur e papranueshme për arsye procedurale për shkak të mosshterimit të mjeteve të brendshme juridike të cilat, si një çështje e ligjit të zbatueshëm, mund t'i kishte shfrytëzuar në Bankën ProCredit. Gjykatat e rregullta gjithashtu konkluduan se Banka ProCredit nuk kishte detyrim të njoftojë parashtruesin për ndonjë të drejtë ligjore që mund ose nuk mund të ketë pasur në lidhje me kontestin e tij gjyqësor me Bankën.

37. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk është në një gjendje që të deklarojë se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit siç pretendohet nga ai, vetëm sepse ato nuk kishin hyrë në meritat e kërkesës së tij. Gjykatat e rregullta kanë vendosur të mos vlerësojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, sepse ato konsideruan se ai nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike të përcaktuara me ligj dhe kanë arsyetuar vendimet e tyre, duke iu referuar dispozitave të ligjit të zbatueshëm. Gjykata Kushtetuese nuk mund të zëvendësojë arsyetimin e tyre në këtë drejtim pasi ato janë në pozitë më të mirë për të interpretuar ligjin material dhe procedural.

38. Përkitazi me të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 dhe 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur e kishin refuzuar kërkesën e tij si të papranueshme dhe të parakohshme. Ai konsideron se gjykatat e rregullta është dashur të shqyrtojnë meritat e kërkesës, kryesisht për shkak se Banka ProCredit nuk i ka dhënë *"të drejtën për ankesë"* me Njoftimin (Nr. 11-517, të 11 nëntorit 2010), përmes së cilës ai ishte shkarkuar nga puna.

39. Gjykata vëren se në njoftimin e lartcekur nuk ishte dhënë një këshillë ligjore, dhe se kjo ka qenë pretendim kryesor i parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij të

kryera nga ana e Bankës ProCredit. Parashtruesi e ka ngritur këtë çështje në të gjitha parashtresat e tij në gjykatat e rregullta dhe konsideroi se duhej të ishte vendosur për meritat e kërkesës së tij, sepse ai pretendon se ishte *"udhëzuar gabimisht"* për shkak të mungesës së këshillës ligjore nga Banka ProCredit.

40. Gjykata rikujton se, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, detyra e saj kryesore është që të vlerësojë vendimin (et) e një autoriteti publik, në këtë rast të gjykatave të rregullta dhe të konstatojë nëse një vendim (et) i tillë është nxjerrë në përputhje me të drejtat kushtetuese të parashikuara në të. Prandaj, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë Njoftimin e Bankës ProCredit dhe të vlerësojë gjendjen faktike, siç kërkohet nga parashtruesi i kërkesës.

41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është shqyrtuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Të gjitha këto shkallë kanë arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit të zbatueshëm, kur refuzuan kërkesën e parashtruesit si të papranueshme dhe të parakohshme. Gjykatat e rregullta vendosën se kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme dhe e papranueshme, sepse parashtruesi nuk është ankuar në Njoftimin e Bankës ProCredit brenda vetë institucionit. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se ajo që parashtruesi ngre është çështje e ligjshmërisë, dhe jo e kushtetutshmërisë.

42. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigje ndaj pretendimit të parashtruesit për shkelje të ligjit, që pretendohet të jetë bërë nga Gjykata e Apelit, kur refuzoi ankesën e tij të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Gjykata Supreme konstatoi se: *"[...] gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vlerësuar kur kanë gjetur se padia e paditësit është e palejuar [...]. Në rastin konkret, paditësi nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij para organit kompetent* [Banka ProCredit] *[...].[...] për faktin se paditësja nuk ka kërkuar mbrojtje juridike interne, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore kur kanë gjetur se padia duhet të hedhet si e palejuar."*

43. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit apo Gjykata Komunale në Prishtinë, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.

44. Gjykata Kushtetuese po ashtu ripërsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e te drejtave të tij, të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.

45. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta ta paraqesë rastin e tij në gjykatat e rregullta. Çështja e ligjit të zbatueshëm është trajtuar gjerësisht nga të gjitha gjykatat e rregullta. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme u janë përgjigjur pretendimeve të parashtruesit se pse kërkesa e tij është konsideruar si e parakohshme dhe në këtë mënyrë e papranueshme nga gjykata e instancës më të ulët.

46. Në këtë drejtim, është me rëndësi te ceket se Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

47. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi që i referohet kërkesës së parashtruesit për shqyrtim të meritave të rastit në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

48. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese në të cilat ai thirret.

49. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 18 dhjetor 2015, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Kryesues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI01/15, Parashtruesi i kërkesës: Fahredin Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. Pml. Kzz 157/2014, të 2 tetorit 2014.

KI 01/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 marsit 2016, i publikuar më 3 qershor 2016.
Fjalët kyç: *kërkesë individuale, krime të luftës, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, qartazi e pabazuar.*

Më 23 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës u dënua nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës (Aktgjykimi P. nr. 371/10) për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile nga nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe neni 4 i Protokollit II të 8 qershorit 1977. Gjykata e dënoi parashtruesin me dënim prej 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim, në të cilin ishte llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 14 korriku 2010 deri më 18 gusht 2010 dhe në paraburgim që nga 19 gushti i vitit 2010.
Më 2 tetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. Kzz 157/2014, vërtetoi dënimin e parashtruesit të kërkesës për krime lufte kundër popullsisë civile.

Gjykata konkludoi se Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë dhënë konstatime të detajuara faktike në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe provat mbështetëse në favor të vendimit për dënim dhe se është dëshmuar se parashtruesi është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullsisë civile.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI01/15
Parashtrues
Fahredin Gashi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. Pml Kzz. 157/2014, të 2 tetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fahredin Gashi, me vendbanim në Shtime (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Tahir Rrecaj, avokat në Prishtinë, Kosovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. Kzz 157/2014, të 2 tetorit 2014, dhe, rrjedhimisht, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR 1175/2012, të 10 marsit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 371/2010, të 23 nëntorit 2011.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Kzz 157/2014, të 2 tetorit 2014.

5. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 2 të Protokollit VII të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), dhe nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë:

Ligji) dhe në rregullin 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregulloja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 9 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI01/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH. KI01/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 27 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai ta dorëzojë autorizimin.

10. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dorëzoi kopjen e kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës, Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës.

11. Më 1 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin.

12. Më 5 maj 2015, Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dorëzoi përgjigjen në Gjykatën Kushtetuese ndaj kërkesës së parashtruesit.

13. Më 6 maj 2015, Gjykata ia dorëzoi parashtruesit të kërkesës kopjen e parashtresës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

14. Më 1 korrik 2015, me Vendimin KSH. KI01/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit në Gjykatën Kushtetuese kishte përfunduar më 26 qershor 2015.

15. Më 15 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 15 qershor 1999, në fshatin Vorigovc, në komunën e Lipjanit, S. G. ishte vrarë derisa ishte duke fjetur në shtëpinë e tij. Parashtruesi i kërkesës ishte shoqëruar nga N. B. dhe ishte dënuar për veprën penale Krime të luftës kundër popullsisë civile për vrasjen e S. G.

17. Më 23 nëntor 2011, parashtruesi u dënua nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës (Aktgjykimi P. nr. 371/10) për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile, nga nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe neni 4 i Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë i Konventave të Gjenevës. Gjykata dënoi parashtruesin me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim, në të cilin ishte llogaritur në dënim koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 14 korriku 2010 deri më 18 gusht 2010 dhe në paraburgim që nga 19 gushti i vitit 2010.

18. Në lidhje me dëshminë e të bashkëpandehurit të parashtruesit, përkatësisht dëshmitarit bashkëpunues N. B., Gjykata e Qarkut bëri gjetje të detajuara dhe të qarta.

19. Më 16 maj 2012, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit në Gjykatën kompetente të instancës së dytë në atë kohë, Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të: *(i)* shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale (neni 403, paragrafi 1, nënparagrafi 12 dhe paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës - 2004 (në tekstin e mëtejmë: KPPK); *(ii)* vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (neni 405, paragrafi 3, i KPPK-së); Shkelje të ligjit penal (neni 404, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i KPPK-së në lidhje me nenin 2, paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës - 2004 (në tekstin e mëtejmë: KPK)); dhe *(iv)* vendimit për sanksionin penal (në ankesë nuk është përmendur asnjë nen i KPPK-së). Në këtë kontekst, mbrojtësi propozoi që ankesa të aprovohej, aktgjykimi i kontestuar të ndryshohej ashtu që i akuzuari të lirohej nga të gjitha akuzat, apo, në mënyrë alternative, që aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

20. Më 10 shkurt 2014, Gjykata e Apelit, tani gjykata kompetente e shkallës së dytë, pas mbajtjes së seancës për dëgjim të argumenteve të avokatit mbrojtës të parashtruesit të kërkesës dhe prokurorit në lidhje me ankesën kundër aktgjykimit.

21. Pas kësaj, Gjykata e Apelit pranoi pjesërisht ankesën e parashtruar në emër të parashtruesit të kërkesës, dhe reduktoi dënimin nga 18 (tetëmbëdhjetë) në 14 (katërmbëdhjetë) vjet burgim.

22. Gjykata e Apelit, në shqyrtimin e vendimit për dënim dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nxori konkluzionet e detajuara dhe eksplicite si në vijim në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues N. B. dhe mjaftueshmërinë e provave në këtë rast.

23. Më 5 qershor 2014, avokati mbrojtës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për shkak të: *(i)* shkeljes së ligjit penal (neni 404, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në lidhje me nenet 22 dhe 142 të KPK); dhe *(ii)* shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale neni 403, paragrafi 1, nënparagrafët 3, 8 dhe 12, dhe paragrafi 2 i KPPK-së).

24. Më 2 tetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. Kzz 157/2014, vërtetoi dënimin e parashtruesit për Krime lufte kundër popullsisë civile, por e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit për të përfshirë dhe llogaritur në dispozitiv edhe kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 14 korrikut 2010 deri më 18 gusht 2010, dhe në paraburgim që nga 19 gushti 2010 do të llogaritet në dënim.

25. Gjykata Supreme duke vlerësuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, shqyrtoi me kujdes drejtësinë e procedurave të gjykimit dhe trajtimit të provave dhe gjeti se ka pasur prova thelbësore për të mbështetur aktgjykimin dhe se procedura ishte e drejtë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij në pajtim me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, nenin 6 dhe nenin 2 të Protokollit VII të KEDNJ-së, dhe nenin 14 të KNDCP-së nga gjykatat e rregullta të Kosovës në aktgjykimin e 23 nëntorit 2011, me të cilin e kishte shpallur atë fajtor për krime të luftës kundër popullsisë civile.

27. Ai në mënyrë specifike pretendon se atij i është mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse:

    a. Konfirmimi i aktakuzës është bërë pa u mbajtur asnjë seancë formale për konfirmimin e aktakuzës;
    b. Vendimit dhe aktgjykimit të gjykatës i mungonte arsyetimi;
    c. Shkelja e parimit të "kontradiktoritetit";
    d. Shkelja e dispozitave esenciale të Kodit të Procedurës Penale;
    e. Prania e të akuzuarve të tjerë përderisa parashtruesi i kërkesës ishte intervistuar në procedurë;
    f. Shkelja e parimit të barazisë së armëve;
    g. Shkelja e parimit *dubio pro reo*;
    h. Mosadministrimi i provave të dorëzuara;
    i. Mbajtja e seancës përkundër gjendjes shëndetësore/mendore të parashtruesit të kërkesës;
    j. Mungesa e shqyrtimit të tërësishëm të ankesës;
    k. Argumentimi i Aktgjykimit vetëm në deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues; dhe
    l. Ai nuk ka marrë vendimin me shkrim në një periudhë të arsyeshme kohore.

28. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:

    a. Ta deklarojë kërkesën e parashtruesit të pranueshme;
    b. Të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore, në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe
    c. Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si rezultat i shkeljeve nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Përgjigja e Kryeprokurorit të Shtetit

29. *"Prokurori i Shtetit pohon se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 29, paragrafin 2, pikat (e), (f) dhe (g) të Rregullores së punës. Prokurori i Shtetit pretendon se është plotësisht e paqartë se cili vendim kontestohet nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatë. Kërkesa nuk flet për të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat parashtruesi pretendon se i janë shkelur. Parashtruesi nuk arrin të japë hollësi të qarta dhe koncize të fakteve themelore dhe nuk arrin të demonstrojë lidhjen midis këtyre fakteve dhe shkeljes së pretenduar. Në fund, Prokurori i Shtetit pretendon se në kërkesë nuk është saktësuar asnjë mjet lehtësues".*

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> "*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

> *"*Parashtruesi *i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

33. Përveç kësaj, Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat parashohin se:

> *"(1) Gjykata* mund *ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
>
> *(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

34. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit lidhen kryesisht me mënyrën në të cilën ishin trajtuar provat e paraqitura nga dëshmitari bashkëpunues N.B. Parashtruesi konsideron se dëshmitari bashkëpunues nuk ishte i besueshëm dhe se nuk kishte prova të mjaftueshme të tjera për të vërtetuar këtë dëshmi. Parashtruesi pretendon se gjykatat nuk kanë shqyrtuar në mënyrë adekuate besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues në arritjen e aktgjykimeve të tyre, dhe nuk ka marrë parasysh argumentet e tij për këtë besueshmëri.

35. Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili, *inter alia*, thekson:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me* vendimet *për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
>
> *[...]*
>
> *4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë* paraqitjen *e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
>
> *5. Çdokush i* akuzuar *për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
>
> *[...]"*

36. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 6 të KEDNJ-së, i cili, *inter alia*, thekson:

> *"1. Çdo person ka* të *drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj [...].*
>
> *2. Çdo person i* akuzuar *për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*
>
> *3. Çdo i akuzuar për një* vepër *penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
>
> *[...]*
>
> *d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*
>
> *[...]"*

37. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, që ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë, në thelb merret me faktin nëse parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta parashtrojë rastin e tij dhe të kontestojë prova që ai i konsideronte të rreme. E drejta për gjykim të drejtë, e mishëruar në Kushtetutë dhe KEDNJ nuk kanë të bëjnë me çështjen nëse gjykatat vendase kishin nxjerrë një vendim të drejtë apo të gabuar në lidhje me faktet e vërtetuara apo ligjin.

38. Gjykata konsideron se për të konstatuar se parashtruesi nuk ka pasur një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës ose të nenit 6 të KEDNJ-së, kjo Gjykatë do të duhej të konstatojë se vendimi për dënim dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishin të arsyetuara. Përveç kësaj, Gjykata do të duhet të konstatojë se dëshmitë e dëshmitarit bashkëpunues nuk ishin mbështetur sa duhet në mënyrë që ajo të jetë mjaft e besueshme, për të mbështetur përtej dyshimit të arsyeshëm vendimin për dënim dhe aktgjykimin.

39. Gjykata rikujton se nëse aktgjykimi për dënim nuk është i arsyetuar, ekziston supozimi se i pandehuri nuk ka pasur gjykim të drejtë. Gjykata, gjithashtu, vëren se aktgjykimi për dënim nuk mund të bazohet vetëm në dëshminë e pambështetur të dëshmitarit bashkëpunues.

40. Megjithatë, kjo Gjykatë nuk mund të zëvendësojë gjykimin e saj me atë të Gjykatës së Qarkut në lidhje me atë se çfarë dëshmuan apo nuk dëshmuan provat në rastin e parashtruesit të kërkesës. Për të gjetur se ka pasur shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë në këtë rast në lidhje me mjaftueshmërinë e provave, kjo Gjykatë do të duhej të gjejë se jo vetëm arsyetimi i Gjykatës së Qarkut, por edhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit, si dhe ai i Gjykatës Supreme në lidhje me mbështetjen e dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunues, kishte aq të meta sa që nuk kishte asnjë mbështetje dhe se aktgjykimet e tyre nuk ishin të arsyetuara.

41. Kjo Gjykatë nuk mund ta bëjë këtë konstatim në këtë rast. Në të vërtetë, Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë dhënë konstatime të detajuara faktike në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe provave shtesë mbështetëse në favor të vendimit për dënim dhe se është dëshmuar se parashtruesi është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullsisë civile.

42. Prandaj, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si i papranueshëm.

43. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Procedurës Penale, parimit të barazisë së armëve dhe lëshimit të pretenduar të Gjykatës së Qarkut që t'i pranojë disa nga provat e propozuara, refuzimi nga gjykata i mbrojtjes së alibisë së parashtruesit dhe fakti se ai nuk ka pranuar një aktgjykim me shkrim për fajësi në periudhën e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale, parashtruesi nuk ka arritur të tregojë se si cilado nga këto shkelje të pretenduara, në qoftë se ato kanë ndodhur, ka rezultuar me shkeljen e së drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë. Prandaj, këto pretendime duhet gjithashtu të refuzohen si të papranueshme.

44. Sa i përket asaj nëse problemet e pretenduara shëndetësore të parashtruesit të kërkesës mund t'ia kenë mohuar atij të drejtën për ta ndihmuar në mënyrë efektive avokatin e tij në mbrojtjen e tij gjatë gjykimit, Gjykata vëren se nuk ka prova se parashtruesi ose avokati i tij kanë ngritur ndonjëherë formalisht këtë çështje në kohën e duhur në Gjykatën e Qarkut para ose gjatë gjykimit. Madje, nuk ka asnjë dëshmi se parashtruesi i kërkesës ka vuajtur nga ndonjë problem shëndetësor në atë masë sa që ai nuk ka mundur ta ndihmojë avokatin e tij në përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate gjatë gjykimit të tij.

45. Gjykata thekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e nxjerra nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

46. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka gjetur se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* GJEDNJ Aktvendim për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009*).*

47. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, me vendimin e kontestuar.

48. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 mars 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;

III. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Arta Rama-Hajrizi

KI159/15 Parashtrues Sabri Ferati, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 499/2015, të 29 shtatorit 2015

KI159/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 12 prill 2016 dhe publikuar më 14 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, ratione materiae*

Parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, i cili konsideroi se aktgjykimet e atakuara janë të kundërligjshme, sepse përpos që aktgjykimet ai i shkallës së parë dhe shkallës së dytë përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën për barazi para ligjit.
Gjykata vlerësoi se kërkesa e parashtruesit ka të bëj me rishqyrtimin e procedurës. Gjykata vërejti se në këtë procedurë gjykatat e rregullta vendosen vetëm për plotësimin e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës dhe jo për meritat e rastit, i cili përfundoi me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme.
Gjykata vlerësoi se e drejta për gjykim të drejtë dhe dëgjim publik nuk zbatohet për këto procedura. Prandaj, ankesa e parashtruesit të kërkesës u refuzua e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI159/15
Parashtrues
Sabri Ferati
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 499/2015, të 29 shtatorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Sabri Ferati nga Podujeva, Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Mahmut Halimi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 499/2015, të 29 shtatorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 29 shtatorit 2015, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 2 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit përregjistrimin ekërkesës.

8. Më 12 prill2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues,Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 19 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës ka shkaktuar aksident të komunikacionit në të cilin 7 (shtatë) persona kanë marrë lëndime të rënda trupore, për shkak të cilave 2 (dy) persona kanë vdekur në vend.

10. Më 21 nëntor 2013, Prokuroria Themelore ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378, paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

11. Më 17 mars 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) nxori Aktgjykimin [P. nr. 969/13] me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh. Në dispozitivin e Aktgjykimit theksohet:

> *"[...] Duke u bazuar në analizën dhe konstatimet lidhur me këtë aksident grupi i ekspertëve ka dhënë mendimin përfundimtar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të drejtuesit të automjetit 'Toyota Land Cruiser' (parashtruesi i kërkesës), i cili ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit pa u siguruar se rruga ka hapësirë të mjaftueshme për realizimin e plotë të tejkalimit (duke pasur parasysh distancën dhe shpejtësinë ndaj automjetit nga kahu i kundërt).*
> *[...]*
>
> *Gjykata me rastin e marrjes së vendimit në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e të akuzuarit të ushtruar nga mbrojtësi i tij...*
> *[...]*
> *Gjykata në bazë të vërtetimit të detajuar të gjendjes faktike, deklaratave të dëshmitarëve, provave të administruara, ekspertizës profesionale dhe duke marrë parasysh pretendimet dhe provat e mbrojtjes, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi ... ".*

12. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [P. nr. 969/13], të Gjykatës Themelore.

13. Më 23 shtator 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PA. 1. nr. 769/2014], me të cilin pjesërisht i aprovoi pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, kështu që dënimin me burg prej 6 (gjashtë) vitesh e ndryshoi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh. Në arsyetimin e Aktgjykimit theksohet:

> *"[...]*

Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës që gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike, gjykata e vlerëson si të pabazuar, sepse gjykata i ka ndërmarr të gjitha veprimet të cilat janë të nevojshme për të nxjerrë Aktgjykimin.
[...]
Sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës lidhur me lartësinë e dënimit me të cilin ai u dënua, gjykata i konsideron pjesërisht të bazuara ... sepse gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të parashtruesit të kërkesës ...".

14. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [P. nr. 969/13] të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PA. 1. nr. 769/2014] të Gjykatës së Apelit.

15. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Pml. nr. 11/2015] me të cilin kërkesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar. Në përfundim të Aktgjykimit theksohet:

"[...] të gjitha ato me të cilat parashtruesi e ka bazuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Themelore dhe pastaj edhe Gjykata e Apelit kanë analizuar në mënyrë të detajuar dhe të gjerë; arsyetimet janë të plota, shumë të qarta, të drejta dhe të ligjshme, dhe të cilat i pranon edhe Gjykata Supreme dhe rrjedhimisht nuk e sheh të nevojshme që të bëjë edhe një herë vlerësimin e tyre".

16. Më 18 maj 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me të cilën kërkoi rishikimin e procedurës penale.

17. Më 21 gusht 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktvendimin me të cilin kërkesën për rishikimin e procedurës e refuzoi si të pabazuar, me arsyetimin:

"Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në kërkesën e parashtruar për Rishikim të Procedurës Penale, nuk është prezantuar ndonjë fakt apo provë ere, e cila ka qenë e panjohur për gjykatën në momentin e marrjes se aktgjykimeve të lartpërmendura e cila vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale siç parashihet me nenin 423 par 1 pika 1.3 të KPPRK-së, andaj faktet dhe provat në të cilat është thirrur mbrojtësi i të dënuarit nuk ofrojnë arsye për lejim të Rishikimit të Procedurës Penale".

18. Në afatin ligjor, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale.

19. Më 29 shtator 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [PN. nr. 499/2015], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin: *"Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore të dënuarit për rishikimin e procedurës penale gjeti se: Ankesa është e pabazuar. Sepse i dënuari në kuptim të nenit 425 par. 2 lidhur me nenin 423 par 1. nënp. 1.3 të KPPK-së, nuk ka afrua prova të reja të cilat janë baze ligjore për lejimin e rishikimit të procedurës penale të aktgjykimit të formës së prerë... ."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi në kërkesë theksoi: "*Konsideroj se aktgjykimet e atakuara janë të kundërligjshme, sepse përpos që aktgjykimet ai i shkallës se parë dhe shkallës së dytë përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, në veçanti nuk janë respektuar as dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 24 "barazinë para ligjit", neni 31, "E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm", neni 54, "mbrojtja gjyqësore"), si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, dhe, të gjitha këto të drejta, liri themelore dhe garanci procedurale të garantuara me Kushtetutë, me Kodin penal, do të duheshin të interpretohen në harmoni me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare*".

21. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me propozimin "*që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës t'i shpallë si kundërkushtetuese të gjitha aktvendimet dhe aktgjykimet, dhe të urdhëroi që të gjitha ato aktgjykime dhe aktvendime të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje pranë gjykatës së shkallës së parë (Gjykatës Themelore-Departamenti i Krimeve të përgjithshme-Dega në Podujevë)".*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të qenë në gjendje për të gjykuar ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, neni 113.7 i Kushtetutës, parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Gjithashtu, neni 49 i Ligjit, parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

25. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullave 36 (1) (c) dhe (3) (e) të Rregullores së punës, të cilat parashohin:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi.*

(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...]

(e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën".

26. Në rastin konkret, duke i shqyrtuar shkresat e lëndës Gjykata gjeti se parashtruesi kishte dy procedura në gjykatat e rregullta në të cilat vendimet ishin marrë për çështje të ndryshme.

27. Procedura e parë kundër parashtruesit të kërkesës është iniciuar nga Prokuroria Themelore Publike më 21 nëntor 2013. Kjo procedurë kishte përfunduar më 12 shkurt 2015 me Aktgjykimin [PML. Nr. 11/2015] të Gjykatës Supreme, me të cilin refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, me të cilin Aktgjykimi [PA. 1. nr. 769/2014] i Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte shpallur fajtor, mori formën e prerë.

28. Gjykata vëren se në procedurën e lartpërmendur u vendos për meritat e pretendimeve të prokurorisë se parashtruesi e kishte kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378, paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, për të cilat ai u dënua me vendim të formës së prerë.

29. Përcaktimi i akuzës penale të parashtruesit u mbyll me vendim të formës së prerë më 12 shkurt 2015, ndërsa kërkesa e parashtruesit është dorëzuar më 29 dhjetor 2015, që është më shumë se 4 (katër) muaj pas vendimit të formës së prerë.

30. Prandaj, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, kërkesa në lidhje me grupin e parë të procedurave duhet të refuzohet si e paafatshme.

31. Gjykata rithekson se afati prej 4 (katër) muajsh është i natyrës prekluzive dhe është themeluar për të siguruar parimin e sigurisë juridike duke siguruar, që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim kushtetues (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët* kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

32. Sa i përket procedurës së dytë, Gjykata vëren se kjo ka të bëjë me një kërkesë të parashtruar nga parashtruesi për rishqyrtimin e procedurës. Parashtruesi e ka iniciuar atë më 21 gusht 2015, kur ai parashtroi kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore.

33. Ajo procedurë përfundoi më 29 shtator 2015, kur Gjykata e Apelit nxori vendimin [PN. nr. 499/2015], me të cilin hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për rishikim të procedurës, në pajtim me nenin 423, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i KPPK-së, i cili përcakton standardet që duhet të plotësohen si bazë për rishikimin e procedurës.

34. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në këtë procedurë gjykatat e rregullta vendosen vetëm për plotësimin e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës, dhe jo për meritat e rastit, i cili përfundoi me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme më 12 shkurt 2015.

35. Gjykata thekson nenin 31 të Kushtetutës, i cili parasheh se *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike"*.

36. Grupi i dytë i procedurave lidhur me rishikimin e çështjes, në fakt, nuk përcakton ndonjë vepër penale, pasi këto ishin vendosur në shkallën e fundit nga Gjykata Supreme më 12 shkurt 2015.

37. Si e tillë, e drejta për gjykim të drejtë dhe dëgjim publik nuk zbatohet për këto procedura. Prandaj, ankesa e parashtruesit të kërkesës për grupin e dytë të procedurave duhet të refuzohet si e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, për shkak se një kërkesë për rishikim të procedurës penale nuk mund të përcaktojë një vepër penale sipas Kushtetutës (Shih, me analogji, *Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të 10 prill 2001, nr. 36445/97, paragrafi 86*).

38. Për arsyet e lartpërmendura në paragrafët 28 dhe 35, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) dhe (3) (e) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullat36 (1) (c) dhe (3) (e) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 12 prill2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI145/15, Parashtrues Florent Muçaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nr. 321/2015, të 5 nëntorit 2015

KI145/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 14 mars 2016 dhe publikuar më 14 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, kërkesë e parakohshme, mosshterim i mjeteve juridike, masë e përkohshme*

Gjykata Themelore në Prishtinë kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit për vënien e masave të përkohshme ndaj Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për zgjedhjen e një anëtari të ri.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi po ashtu kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, theksoi se kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme, sepse ai nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike, siç kërkohet me ligj dhe me Kushtetutë. Kërkesa u deklarua e papranueshme për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike. Kërkesa për masë të përkohshme po ashtu u refuzua si e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI145/15
Parashtrues
Florent Muçaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nr. 321/2015, të 5 nëntorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Florent Muçaj, me banim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin nr. 321/2015, të Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), të 5 nëntorit 2015, për shpalljen e vendeve të lira për zgjedhjen e anëtarit të shoqërisë civile në përbërjen e KPK-së dhe Konkursin nr. 322/2015, të publikuar më 21 nëntor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe të neneve 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 25 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejmë: KNDCP).

4. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht ta pezullojë procedurën e zgjedhjes së një anëtari të ri nga ana e KPK-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 dhjetor 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 17 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 17 dhjetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës KPK-së.

9. Më 30 dhjetor 2015, Organizatat e Shoqërisë Civile dorëzuan një letër mbështetëse për parashtruesin e kërkesës.

10. Më 14 janar dhe 12 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata shtesë në lidhje me kërkesën.

11. Më 14 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 9 shtator 2014, parashtruesi u zgjodh anëtar i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile (Vendimi nr. 260/2014), me një mandat 5 (pesë) vjeçar, siç parashihet me Ligjin për KPK-në. Sipas parashtruesit të kërkesës, nga KPK-ja, nuk u pranua asnjë ankesë zyrtare me të cilën do të kontestohej procedura apo ndonjë aspekt tjetër i zgjedhjes së tij.

13. Më 15 korrik 2015, hyri në fuqi Ligji nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

14. Neni 3 i Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ndryshoi procedurën me të cilën zgjidhen 3 (tre) anëtarë jo-prokurorë të KPK-së. Në bazë të këtij neni, anëtari i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile do të zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës pas një konkursi publik të shpallur nga KPK-ja.

15. Më 5 nëntor 2015, KPK-ja (Vendimi nr. 321/2015), në pajtim me nenin 3 të Ligjit për KPK-në vendosi të shpallë konkursin për zgjedhjen e anëtarit jo-prokuror nga radhët e shoqërisë civile.

16. Më 21 nëntor 2015, KPK-ja publikoi Konkursin nr. 322/2015 për zgjedhjen e anëtarit jo-prokuror nga radhët e shoqërisë civile.

17. Më 23 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore duke kërkuar anulimin e Vendimit nr. 321/2015 të KPK-së, të 5 nëntorit 2015, dhe një konfirmim të mandatit të tij 5 vjeçar në përputhje me kontratën e tij të punës. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht, pezullimin ose shtyrjen e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të ri të KPK-së.

18. Më 24 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi A. nr. 1992/2015) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme, duke theksuar:

"Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, gjen se i njëjti propozimit të tij nuk i ka bashkangjitur ndonjë fakt të bazuar në ndonjë provë që kishte mundur të bëjë të besueshëm pretendimet e tij, se si ekzekutimi i vendimit të goditur me padi, të njëjtit do t'i sillte dëm, se dëmi vështirë do të riparohej dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, që pastaj kjo gjykatë të mund vendos për shtyje të ekzekutimit të aktvendimit".

19. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore të 24 nëntorit 2015, me të cilën u refuzua kërkesa e tij për masë të përkohshme.

20. Më 12 shkurt 2016, parashtruesi e njoftoi Gjykatën se Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të Gjykatës Themelore të 24 nëntorit 2015, lidhur me kërkesën e tij për të vendosur masë të përkohshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pohon se me vendimin për shpalljen e konkursit dhe me konkursin e KPK-së janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht, me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"në rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 321/2015 i datës 05.11.2015 nga përbërja e mësipërme vetëm 5 (pesë) anëtarë kanë pasur mandat të natyrshëm 5 vjeçar, ndërsa tre prej tyre ky mandat 5 vjeçar u kishte përfunduar apo pushuar. Sipas kësaj logjike, KPKnë rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 321/2015 nuk e kishte arritur kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e takimit të datës 05.11.2015 edhe pse ai ishte mbajtur".*

23. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se vendimi i kontestuar për shpalljen e konkursit është në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (ai i referohet në mënyrë specifike rasteve: KO29/12, KI48/12, KI99/14 dhe KI100/14).

24. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, parashtruesi pretendon se "*procedurat në Gjykatën Themelore zgjasin mesatarisht dy vite dhe kështu në rastin e parashtruesit të kërkesës për shkak të urgjencës së çështjes e bëjnë këtë mjet jo efektiv*".

25. Parashtruesi kërkon nga Gjykata si në vijim:

"Të vërtetojë shkeljen dhe cenimin e të drejtave të tij sipas pretendimeve më lart, të parapara me Kushtetutë (nenet 22, 24, 31, 32, 45, 54 dhe 53), KEDNJ (nenet 6 dhe 13), KNDCP (neni 25) dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ, rasteve KO29/12 dhe KO48/12 të datës 20.07.2012 dhe rasteve Nr. KI99/14 dhe KI100/14 të datës 08.07.2014.;
Të anuloj Vendimin e KPK-së nr. 321/2015 të datës 05.11.2015 dhe të anuloj Konkursin e datës 21.11.2015, nr. 322/2015 dhe procesin e zgjedhjes së anëtarit të shoqërisë civile në KPK sipas këtij konkursi, dhe
Të vërtetojë mandatin e tij 5 (pesë) vjeçar si anëtarë i shoqërisë civile në KPK dhe te ndaloj shkurtimin e këtij mandati 27 përmes Vendimit nr. 321/2015 ose edhe përmes ndonjë akti tjetër, sikur në rastet KO29/12 dhe KO48/12".

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

28. Gjykata, gjithashtu, i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

29. Për më tepër, Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".*

30. Gjykata vëren se rasti i parashtruesit është ende në pritje të vendimit për meritën, në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore (janë shteruar vetëm mjetet juridike në lidhje me kërkesën për masë të përkohshme). Prandaj, rrjedh se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka mjete juridike në dispozicion të tij, të cilat ai mund t'i shterë në mënyrë efektive në gjykatat e rregullta. Argumenti i tij kryesor në këtë drejtim është se "*procedurat në Gjykatën Themelore zgjasin mesatarisht dy vite dhe kështu në rastin e parashtruesit të kërkesës për shkak të urgjencës së çështjes e bëjnë këtë mjet jo efektiv*".

32. Gjykata konsideron se në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike që janë të obligueshme për të, ai duhet të tregojë se: i) mjeti juridik në të vërtetë ishte përdorur, ii) mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e tij, dhe iii) se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për lirimin e parashtruesit nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike (Shih, rastin nr. KI116/14, *Parashtrues i kërkesës Fadil Selmanaj,* Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 janarit 2015).

33. Gjykata i referohet interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), ku theksohet rëndësia e ndarjes së drejtësisë pa vonesë e cila mund ta rrezikojë efikasitetin dhe besueshmërinë e saj (Shih, ndër të tjera, *H. kundër Francës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 tetorit 1989).

34. Megjithatë, Gjykata thekson se kohëzgjatja e procedurave, në vetvete, nuk e bën joefektiv mjetin juridik. "Arsyeshmëria" e kohëzgjatjes së procedurave duhet të

vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kritereve si në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e parashtruesit dhe e autoriteteve relevante si dhe çfarë ka qenë në shqyrtim për parashtruesin në atë kontest (Shih *Frydlender kundër Francës*, Aktgjykim i GJEDNJ i 27 qershorit 2000).

35. Gjykata vëren se parashtruesi thjesht supozon se mjeti juridik është joefektiv. Megjithatë, ai nuk mbështet mjaftueshëm supozimin e tillë me prova konkrete. Vetëm pretendimi i thjeshtë i parashtruesit për një kohëzgjatje të mundshme të procedurave paraprakisht, nuk mund të shërbejë si argument për të vlerësuar efektivitetin e mjeteve juridike në dispozicion.

36. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të konkludon se mjetet juridike në dispozicion të parashtruesit të kërkesës nuk mund të sigurojnë satisfaksion, në pajtim me rezultatet përfundimtare të procedurës në gjykatat e rregullta.

37. Gjykata përsërit se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë organeve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih: Aktvendimin përpapranueshmëri:*AAB-RIINVESET SH.P.K.Prishtinëkundër QeverisësëRepublikës së Kosovës*, KI41/09të21 janarit2010, dheshih:*mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmounikundër Francës,* nr.25803/94, vendim i28 korrikut 1999).

38. Duke iu referuar rasteve KI99/14 dhe KI100/14, Gjykata rithekson arsyetimin e saj të shprehur në ato raste se ekziston vetëm një pozitë për Kryeprokuror të Shtetit në krahasim me pozitat e shumta për emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (si dhe organe tjera publike kolektive). Në ato raste tjera ka pasur pozita të shumta dhe gjykatat e rregullta kanë mundur të korrigjojnë shkeljet, në qoftë se shkelja do të vërtetohej muaj më vonë. Për më tepër, në rastet e përmendura më lart, Gjykata nuk ishte e bindur se kishte kohë të mjaftueshme që ndonjë gjykatë tjetër ta adresojë atë mjet para emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

39. Gjykata rikujton arsyetimin e saj në një numër të aplikimeve tjera që ka pranuar nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk janë emëruar ose riemëruar. Në këto raste, Gjykata ka vendosur se parashtruesit nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike sipas ligjit të Kosovës (Shih Rastin KI114/10, *Vahide Badivuku*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2011).

40. Në fund, Gjykata konsideron se KPK-ja është një organ kolektiv dhe anëtari i tij nga shoqëria civile është vetëm një nga anëtarët e tij. Kontestimi në gjykatat e rregullta i mandatit të një prej anëtarëve të tij nuk e pengon funksionimin normal të KPK-së.

41. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës. Për më tepër, Gjykata thekson se parashtruesi tashmë ka dorëzuar një rast në Gjykatën Themelore në Prishtinë, i cili është ende në pritje të vendimit për meritat.

42. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkeses gjithashtu kërkon nga Gjykata të nxjerrë "*vendim për masë të përkohshme ndaj konkursit të KPK-së*".

44. Siç është theksuar më lart, parashtruesi nuk ka arsyetuar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullit 55 (4) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 14 mars 2016, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI23/15, Parashtrues: Miladin Anđelković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN nr. 550/2014, të 31 tetorit 2014

KI23/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 13 prill 2016 dhe publikuar më 14 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata e Apelit e Kosovës kishte vërtetuar vendimin e gjykatës së instancës më të ulët për ndërprerjen e procedurës penale ndaj palës së tretë që kishte vrarë babanë e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimet e kontestuara kane shkelur te drejtat e tij kushtetuese për barazi para ligjit, për gjykim te drejte dhe te paanshëm dhe për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Gjykata, mes tjerash, theksoi se neni 113.7 i Kushtetutës u ofron garanci individëve për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore kur ato cenohen nga autoritetet publike; derisa në rastin në fjalë, vepra penale nuk mund t'i atribuohet autoriteteve publike d.m.th ato nuk mbajnë përgjegjësi për shkak se babai i parashtruesit është vrarë nga një palë e tretë. Kërkesa u shpall qartazi e pabazuar sepse parashtruesi i kërkesës nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI23/15
Parashtrues
Miladin Anđelković
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN nr. 550/2014, të 31 tetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Miladin Anđelković (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Kragujevci, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN nr. 550/2014, të 31 tetorit 2014, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, K. nr. 29/14, të 10 shtatorit 2014.

3. Vendimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara, me pretendimin se është cenuar neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan, Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 27 mars 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

9. Më 26 qershor 2015, përfundoi mandati i gjyqtarit Enver Hasani. Më 1 korrik 2015, gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani.

10. Më 18 janar 2016, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit të Kosovës.

11. Më 13 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se babai i parashtruesit të kërkesës ishte vrarë nga një palë e tretë, A. D., për shkak të një mosmarrëveshje pronësore.

13. Më 26 shkurt 2014, Prokurori Publik në Mitrovicë ngriti aktakuzë kundër të pandehurit A. D. për shkak të veprës penale, vrasje e rëndë të sanksionuar me Ligjin penal të Republikës së Kosovës. Prokurori Publik dha një përshkrim të detajuar të veprës penale të të pandehurit A. D. me ç'rast konstatoi se aktakuza është e arsyetuar dhe e bazuar në ligj, sepse ekzistojnë të gjitha elementet esenciale të veprës penale.

14. Më 10 shtator 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi K. nr. 29/14) kishte vendosur:

> *"I. I pandehuri A. D. është i paaftë që të përcjell gjykimin.*
>
> *II. PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit A. D. për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179, paragrafi 1, pika 1.3 KPRK, për shkak të paaftësisë për përcjelljen e gjykimit gjatë procedurës për shkak të sëmundjes së përhershme psikike.*
>
> *III. Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, shkresat e lëndës t'i dorëzohen Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit për çështje gjyqësore me qëllim të pranimit të të pandehurit nga ndonjë institucion shëndetësor i Kujdestarisë sipas Ligjit të aplikueshëm për Procedurën jashtë gjykimit".*

15. Gjykata Themelore kishte arsyetuar dispozitivin e cituar më lart, duke shpjeguar se pas shqyrtimit të raportit nga ekspertët mjekësorë, deklaratat e prokurorisë dhe të mbrojtjes, se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore dhe se ishte vërtetuar që i pandehuri A. D. nuk është në gjendje për t'iu nënshtruar gjykimit, dhe se procedura penale për atë lëndë ndërpritet.

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të ligjit procedural dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi i kërkesës kryesisht kishte vënë në pikëpyetje profesionalizmin dhe vërtetësinë e ekspertizave përkitazi me gjendjen shëndetësore të të pandehurit A. D.

17. Më 31 tetor 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN nr. 550/2014), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit vërtetoi Vendimin e Gjykatës Themelore, duke shpjeguar se kishte prova të mjaftueshme që vërtetonin se i pandehuri A. D. ishte i paaftë që të përballet me procesin gjyqësor, çka rezultoi në ndërprerjen e procedurës penale, dhe se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ishin me karakter të përgjithshëm dhe nuk përmbanin asgjë konkrete.

18. Gjykata e Apelit konkludoi se pretendimet ishin të pabazuara *"meqë gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka pushuar procedurën penale kundër të pandehurit A. D., (...për shkak të pamundësisë së nënshtrimit të gjykimit gjatë procedurës dhe për shkak të sëmundjes së përhershme psikike"*.

19. Në pjesën relevante të vendimit të Gjykatës së Apelit, thuhet: "*gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme rreth provave për ndërprerjen e procedurës, duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës si: raporti i ekspertit mjekësor, deklarata e Prokurorit dhe e mbrojtësit se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe është vërtetuar që i pandehuri A. D. nuk është i aftë që të përballet me gjykim, prandaj procedura për këtë lëndë penale është ndërprerë"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e kontestuara kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykata Themelore ka nxjerr Vendimin për pushimin e procedurës pa e vërtetuar nëse i akuzuari ka kryer veprën penale apo nëse e ka marr përgjegjësinë e personit tjetër"*.

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Në procesin e ekspertimit ka marr pjesë i biri i të akuzuarit që është në kundërshtim me ligjin (neni 508) dhe sjell në dyshim njëanshmërinë"*.

23. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu pretendon se "*Nuk është provuar se kush është përgjegjës për vdekjen e babait tim"*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëseparashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

27. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (c) të Rregullores së punës që specifikon:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë të si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë".*

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me vendimet e gjykatave të rregullta për ndërprerjen e procedurës penale ndaj A. D., dhe nga pretendimet e tij, në substancë, vërehet vullneti i tij për çuarje deri në fund të procedurës penale ndaj A. D. dhe, po ashtu, shton se "*nuk është vërtetuar se kush është përgjegjës për vrasjen e babait të tij".*

29. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës vë në pikëpyetje opinionet profesionale të ekspertëve përkitazi me gjendjen shëndetësore të të pandehurit A. D. për t'u përballë me proces gjyqësor.

30. Në këtë drejtim, Gjykata ka për detyrë që së pari të vërtetojë nëse kërkesa e parashtruesit për vazhdim të procedurës penale ndaj palës së tretë dhe zbulimin e kryesit të vrasjes së babait të tij është e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

31. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtruesi nuk ka fajësuar autoritetet publike të Kosovës për vdekjen e babait të tij; e as nuk është sugjeruar që autoritetet kanë ditur apo është dashur të dinë që jeta e babait të parashtruesit ka qenë në rrezik nga pala e tretë si dhe, që kanë dështuar të ndërmarrin masat e duhura për të mbrojtur babanë e parashtruesit nga ai rrezik. (Shih, GJEDNJ, Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës nr. 47916/99, *Menson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 6 majit 2003). Pra, rasti i parashtruesit duhet dalluar nga rastet që kanë të bëjnë me përdorimin e supozuar të forcës vdekjeprurëse nga agjentët shtetëror ose nga palët private në bashkëpunim kriminal me agjentët shtetëror. (Shih, për shembull, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë se Bashkuar,* Aktgjykim i 27 shtatorit 1995, Seria A nr. 324; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 24746/94, Aktgjykim i 4 majit

2001, ECHR 2001-II1 (ekstrakte)*; Shanaghan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 37'715/97, Aktgjykim i 4 majit 2001, KEDNJ 2001-III (ekstrakte).

32. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit për vazhdim të procedurës penale ndaj A. D., Gjykata vëren se Kushtetuta nuk akordon ndonjë të drejtë, në kuptimin e saktë të fjalës, për t'i ndjekur ose dënuar palët e treta përkitazi me një vepër penale. Në mënyrë që të hyjë në fushëveprimin e Kushtetutës, ajo nuk mund të ngrehet në mënyrë të mëvetësishme: duhet të jetë e pandashme nga e drejta e parashtruesit për të paraqitur padi civile të bazuar në ligjin e zbatueshëm, madje edhe nëse bëhet fjalë për riparim simbolik ose të mbrojë një të drejtë civile siç është e drejta për "reputacion të mirë". (Shih, për shembull, rastin e *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), aplikacioni nr. 12686/03,[DHM], Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 24, dhe po ashtu, *mutatis mutandis,* shih rastin *Perez kundër Francës,* aplikacioni nr. 47287/99, [DHM], Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafët 70, 71).

33. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit për vërtetimin e personit përgjegjës për vrasjen e babait të tij, Gjykata vëren se autoritetet publike kanë vepruar në kuadër të kompetencave të tyre ligjore dhe kushtetuese, dhe nuk kanë qëndruar pasive sepse kanë paditur A. D. për kryerje të veprës penale të vrasjes së rëndë; veçse gjatë zhvillimit të procedurës penale kanë konstatuar, pas marrjes së opinioneve të ekspertëve, se A. D. nuk është në gjendje të përballet me proces gjyqësor.

34. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të zbatuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me hetimet që në radhë të parë përcaktojnë se mungesa e konkluzioneve në cilindo hetim, nuk do të thotë hetimi si i tillë ka qenë joefektiv: obligimi për të hetuar "*është obligim që të ndërmerren hapat e duhur dhe nuk përbën obligim për të arritur një rezultat të caktuar"*. (Shih, për shembull, rastin nr. KI98/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 korrikut 2013, dhe, *mutatis mutandis,* shih *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, § 71, ECHR 2002 – II).

35. Gjykata konsideron se neni 113.7 i Kushtetutës u ofron garanci individëve për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore kur ato cenohen nga autoritetet publike; derisa në rastin në fjalë, vepra penale nuk mund t'i atribuohet autoriteteve publike d.m.th ato nuk mbajnë përgjegjësi për shkak se babai i parashtruesit është vrarë nga një palë e tretë.

36. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se mënyra sesi zhvillohet apo ndërpritet procedura penale, dënohen të pandehurit apo zbulohen kryesit e veprave penale është diskrecion dhe prerogativë e gjykatave të rregullta dhe organeve të ndjekjes që atyre u është akorduar me ligj dhe me Kushtetutë. Prandaj, çdo ndërhyrje e Gjykatës në atë fushëveprim përbën cenim të autonomisë së tyre. (Shih rastin nr. KI98/12).

37. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (c) të Rregullores së punës, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (c) të Rregullores së punës, më 13 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI10/16, Parashtrues Sanija Bajrami, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2014, të 16 dhjetorit 2014

KI10/16, Aktvendim për papranueshmëri i 12 prillit 2016, publikuar më 14 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar*

Më 14 janar 2016, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë, me të cilën kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të korrigjojë aktvendimin e saj për papranueshmëri të rastit KI64/15, dhe përsëri të vlerësoj kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 297/2014].

Parashtruesi pretendoi se Gjykata ka marrë vendim jo të drejtë dhe të njëanshëm. Ai konsideroi se janë shkelur dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës, pra të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese vendosi ta refuzoj kërkesën si të papranueshme me arsyetimin se kërkesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë sepse nuk ka treguar konkretisht cilat të drejta i janë shkelur me vendimin e kontestuar. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI10/16
Parashtrues
Sanija Bajrami
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 297/2014, të 16 dhjetorit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesën KI10/16 e dorëzoi z. Sanija Bajrami, nga fshati Pojatishtë, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Fatmir Bajraktari.

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën KI10/16, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të korrigjojë Aktvendimin e saj për papranueshmëri në rastin KI64/15, dhe përsëri ta vlerësoj kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 297/2014] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 dhjetorit 2014, i cili i është dorëzuar më 20 janar 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është korrigjimi i Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI64/15 dhe rivlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 297/2014] të Gjykatës Supreme, të 16 dhjetorit 2014.

Baza juridike

4. Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenet 20 dhe 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 24 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme përregjistrimin ekërkesës.

Procedura në Gjykatë lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme

8. Gjykata Kushtetuese më 15 tetor 2015, nxori vendimin në rastin KI64/15, ku gjeti se parashtruesi nuk e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe për këtë arsye e deklaroi kërkesën të papranueshme (Shih, Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, rasti KI64/15 i 15 tetorit 2015).

9. Më 14 janar 2016, parashtruesi paraqiti kërkesë shtesë në Gjykatë, e cila është në thelb kërkesë për kthimin e rastit të tij për rishqyrtim.

10. Me kërkesën e re, parashtruesi paraqiti edhe provën e re (dëftesën), me të cilën përpiqet të vërtetojë se kërkesën KI64/15 e ka dërguar në Gjykatë brenda afatit të paraparë ligjor.

11. Më 12 prill2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Vlerësimi i kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme

12. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit për kthimin e rastit të tij në gjendjen e mëparshme, Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e parapara në nenin 50 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj".*

13. Parashtruesi në kërkesën e re të 14 janarit 2016 në Gjykatë dorëzoi provë, duke dëshmuar se Aktgjykimi [Rev. nr. 297/2014] i Gjykatës Supreme të Kosovës i 16

dhjetorit 2014 i është dorëzuar më 20 janar 2015, ndërsa ai e dërgoi kërkesën në Gjykatë përmes postës më 19 maj 2015, gjë që është në pajtim me rregullin 29.8 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(8) Kërkesa mund të parashtrohet personalisht në zyrën e Sekretariatit të Gjykatës, gjatë orarit të rregullt të punës, ose nëpërmjet postës apo mjeteve të komunikimit elektronik".*

14. Pas shqyrtimit të përmbajtjes së kërkesës së re, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit të 20 janarit 2015, është dorëzuar brenda afatit të paraparë ligjor në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

15. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e nenit 50 të Ligjit, dhe bazuar në këtë, ajo në kërkesën e re KI10/16 do të vlerësojë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 297/2014] të Gjykatës Supreme të Kosovës të 16 dhjetorit 2014.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 12 korrik 2002, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj kundër N.B, M.B, dhe M.P., me të cilën kërkoi vërtetimin e pronësisë së objektit banesor dhe ngastrës nr. 1847/3, në sipërfaqe prej 3,26 ari, të cilat ndodhen në rrugën "Trajko Gërkoviq" në Ferizaj.

17. Në padi, parashtruesi i kërkesës theksoi *"se gjatë vitit 1997, përmes së paditurit të parë N.B., ka ble pasurinë e patundshme nga i padituri i dytë M.P., nga Ferizaj, përkatësisht shtëpinë dhe oborrin të cilët ndodhen në Ferizaj në rrugën 'Trajko Gërkoviq', e cila është evidentuar si ngastër kadastrale nr. 1847/3 në sipërfaqe të përgjithshme prej 3.26 ari ..."*.

18. Më 1 korrik 2008, të paditurit N.B. dhe M.B., gjithashtu, parashtruan kundërpadi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, kundër paditësit (parashtruesi i kërkesës) për vërtetimin e pronësisë mbi të njëjtën pronë, të cilën e kishin fituar në bazë të blerjes.

19. Më 7 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Ferizaj nxori Aktgjykimin [C. nr. 276/02], me të cilin e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke arsyetuar: "*Në bazë të provave të paraqitura dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK, kjo Gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditësit (parashtruesi i kërkesës) për vërtetimin e pronësisë mbi pronën lëndore në bazë të blerjes nga i padituri i dytë, M.P., si shitës, në tërësi është e pabazuar dhe si të tillë e refuzoi në tërësi..."[...] ndërsa kundërpadia e kundërpaditësve N.B. dhe M.B. për vërtetimin e pronësisë mbi pronën lëndore është në tërësi e bazuar ...".*

20. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 276/02] të Gjykatës Komunale në Ferizaj të 7 dhjetorit 2009, për shkak të shkeljeve thelbësore të ligjit dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

21. Më 2 shtator 2014, me Aktgjykimin Ac. nr. 1961/2012, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke arsyetuar: *"... në situatën e tillë të krijuar, Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se paditësi në të vërtetë me*

asnjë provë nuk i ka mbështetur pretendimet e paraqitura në kërkesëpadi dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejt e kishte refuzuar kërkesëpadinë e tij si të pabazuar".

22. Në konkludimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, theksohet: *"Të gjitha pretendimet e paditësit, përkatësisht të autorizuarit të tij në ankesën e tij, gjegjësisht në plotësimin e ankesës, janë refuzuar nga gjykata e shkallës së dytë si të pabazuara, sepse nuk janë mbështetur me asnjë dëshmi konkrete. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit-kundërpaditurit (parashtruesi i kërkesës) se Aktgjykimi i kontestuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182, paragrafi 1 në lidhje me nenin 8 dhe 321, si dhe nenit 182, paragrafi 2, pika 1 në lidhje me nenin 348 të Ligjit për procedurën kontestimore"* (në tekstin e mëtejmë: LPK)".

23. Parashtruesi i kërkesës e paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për revizion të Aktgjykimit [Ac. nr. 1961/2012] të Gjykatës së Apelit të 2 shtatorit 2014.

24. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 297/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të 2 shtatorit 2014, duke arsyetuar: "*Sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (në bazë të cilit parashtruesi e ka bazuar kërkesën e tij) për revizion, nuk qëndrojnë, nga se gjykatat e instancës më të ulët me prova të besueshme kishin vërtetuar së blerës i patundshmërisë lëndore ishte i padituri N.B., e jo paditësi (parashtruesi i kërkesës) Sanija Bajrami".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës konsideron që Gjykata ka marrur një vendim jo të drejtë dhe të njëanshëm. Andaj, e konsideron se është shkelur në mënyrë flagrante dispozita e nenit 31 par 1 dhe 2 të Kushtetutës".

26. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *"anulimin e vendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe të Gjykatës Supreme dhe të merr një vendim me të cilin do ta kthej çështjen civile në rishqyrtim në Gjykatën e shkallës së parë*".

Pranueshmëria e kërkesës

27. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohetnenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

30. Në këtë kërkesë, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

31. Pas shqyrtimit të kërkesës, Gjykata konstatoi se parashtruesi konsideron se me Aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), sepse gjykatat gabimisht vërtetuan gjendjen faktike dhe gabimisht zbatuan të drejtën materiale kur vendosën për meritat e kërkesëpadisë së tij.

32. Gjykata thekson se në përcaktimin e meritave të pretendimeve ankimore të parashtruesit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ajo do t'i respektojë parimet e përcaktuara në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), sipas së cilës "*drejtësia e procesit vlerësohet në bazë të procedurës në tërësi* (GJEDNJ, *Barbera Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, seria A, nr. 146, paragrafi 68*)".*

33. Rrjedhimisht, Gjykata ka analizuar aktgjykimet e gjykatave të rregullta, ku gjeti se gjykatat në aktgjykimet e veta tashmë kishin trajtuar pretendimet ankimore të parashtruesit lidhur me zbatimin e gabuar të dispozitave të të drejtës materiale dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, me ç'rast konkluduan se ato ishin të pabazuara.

34. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se në aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Apelit janë dhënë arsyetime të hollësishme të qëndrimeve lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe të drejtës materiale të zbatuar, të cilat i pranoi edhe Gjykata Supreme.

35. Gjykata më tej vëren se parashtruesi edhe kërkesën e tij të dorëzuar në Gjykatë e ndërtoi vetëm mbi pretendimet të cilat tashmë janë arsyetuar në aktgjykimet e gjykatave të rregullta.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata është e mendimit se aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë bazuar në procedurë të kryer në mënyrë ligjore dhe të interpretimit të pranueshëm kushtetues dhe në zbatimin e të drejtës materiale përkatëse mbi gjendjen faktike e cila është vërtetuar në procedurë gjyqësore.

37. Për më tepër, sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me të drejtë e refuzoi si të papranueshme kërkesën për revizion të parashtruesit në pjesën e cila i referohet vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, sepse në bazë të nenit 214.2 të LPK, revizioni lidhur me këtë çështje nuk mund të dorëzohet:

> *"Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike"*.

38. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta vepruan në pajtim me parimet themelore të së drejtës për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

39. Nga të gjitha sa u tha më lart, Gjykata vlerëson se shqyrtimet e gjykatave të rregullta janë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës: "*gjykatat vendore kane liri të caktuar veprimi në këtë drejtim se cilat argumente dhe prova do t'i pranojnë në një rast të caktuar, por në të njëjtën kohë kanë obligim që t'i arsyetojnë vendimet e tyre në atë mënyre që të paraqesin arsye të qarta dhe të kuptueshme në të cilat i kishin bazuar ato vendime* (Shih, GEDNJ, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801, Aktgjykimi i 1korrikut 2003*)"*.

40. Si përfundim, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

41. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih rastin nr. K119/14 dhe KI21/14, parashtruesi *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

42. Gjykata më tej përsërit se nuk ka detyrë, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të të drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999;.. Shih gjithashtu rastin KI70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmërinë e 16 dhjetorit 2011).

43. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, sepse ai nuk ka treguar se vendimi i kontestuar shkel të drejtat e garantuara me Kushtetutë ose KEDNJ.

44. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, nëpajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat36 (1) (d) dhe (2) (b) tëRregullores së punës,në seancën e mbajturmë 12 prill2016,njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI128/15, Parashtrues Adem Hoti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014

KI128/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 prillit 2015, publikuar më 15 qershor 2016.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, barazia para ligjit, përsëritje e kërkesës*

Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar më parë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me të cilën i kishte kontestuar të njëjtat vendime. Gjykata e kishte deklaruar kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar. (Shih, rastin KI114/14, parashtrues i kërkesës *Adem Hoti*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 janarit 2015.

Parashtruesi ndër të tjera pretendoi, se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me Aktvendimin e saj i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht nenin 24 [Barazia para Ligjit].

Gjykata konstatoi se ajo tashmë kishte gjykuar rastin KI114/14 dhe në kërkesën e tanishme parashtruesi nuk ngre asnjë ankesë të re. Gjykata konkludoi se kërkesa e tanishme, duhet të refuzohet për shkak se ajo është përsëritje e kërkesës së mëparshme KI114 /14, të vendosur nga kjo Gjykatë.

VENDIMPËR REFUZIM TË KËRKESËS
në
rastin nr. KI128/15
Parashtrues
Adem Hoti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Adem Hotinga fshati Revuq, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014, me të cilin është hedhur poshtë, si i palejuar revizioni i ushtruar nga parashtruesi kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 3661/2013, të 28 shkurtit 2014.

3. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar më parë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), me të cilën i kishte kontestuar të njëjtat vendime. Gjykata e kishte deklaruar kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar. (Shih, rastin KI114/14, parashtrues i kërkesës *Adem Hoti*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 janarit 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë sëAktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit i është shkelur e drejta e garantuar e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 32 (5) dhe 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI128/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI128/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 2 dhjetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesinpërregjistrimin ekërkesës.

9. Më 11 janar 2016, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë një dokument ku ka kërkuar shqyrtim urgjent të rastit të tij.

10. Më 12 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, se kërkesa duhet të refuzohet.

Përmbledhja e fakteve

11. Përkitazi me pretendimet e njëjta, të ngritura nga parashtruesi, Gjykata tashmë ka vendosur në rastin KI114/14, të 5 janarit 2015.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI114/14, të 5 janarit 2015

12. Më 4 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014.

13. Parashtruesi, në rastin KI114/14, pretendonte se me Aktgjykimin e lartpërmendur i ishte shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në dëm të tij.

14. Më 8 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë (Aktvendimi, CP. nr. 439/13) refuzoi propozimin për lejimin e përmbarimit të ushtruar kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit në Podujevë.

15. Në mënyrë të ngjashme vepruan edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, të cilat refuzuan ankesën e tij, përkatësisht kërkesën e tij për revizion.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Siç është pretenduar në kërkesën e mëparshme, parashtruesi pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht neni 24 [Barazia para Ligjit].

17. Në kërkesën e tanishme, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë të re dhe as nuk ka ngritur ndonjë ankesë të re.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Gjykata së pari i referohet nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës i cili parashikon:

> *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".*

20. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, që përcakton:

> "*Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. (Ndryshuar më 28 tetor 2014)".*

21. Gjykata vëren se kërkesa e tanishme, e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, është identike me kërkesën e tij KI114/14.

22. Sa i përket kërkesës së tij të mëparshme KI114/14, Gjykata rikujton se ajo kishte nxjerrë një vendim (Aktvendimi për papranueshmëri në rastin KI114/14), të 5 janarit 2015, ku ajo kishte deklaruar kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar. Aktvendimi i lartpërmendur i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës dhe ishte publikuar në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

23. Siç u cek më lart, në kërkesën e tanishme, parashtruesi përsëri konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014, ngre të njëjtat pretendime dhe paraqet të njëjtat fakte dhe dëshmi si në kërkesën e mëparshme të tij, KI114/14.

24. Gjykata rithekson se ajo tashmë kishte gjykuar rastin KI114/14 dhe në kërkesën e tanishme parashtruesi nuk ngre asnjë ankesë të re. Në këtë mënyrë, kërkesa e tanishme është tërësisht përsëritje e kërkesës së mëparshme, KI114/14.

25. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, Gjykata konkludoi se kërkesa e tanishme, duhet të refuzohet për shkak se ajo është përsëritje e kërkesës së mëparshme KI114 /14, të vendosur nga kjo Gjykatë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 12 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Arta Rama-Hajrizi

KI04/16, Parashtrues: "ALDEKO", Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ·UZVP. nr. 10/2015, të 30 korrikut 2015

KI04/16, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 13 prill 2016 dhe publikuar më 15 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte vërtetuar vendimet e gjykatave më të ulëta se kompania parashtruese kishte vepruar jashtë fushëveprimit të licencës të veprimtarisë së saj.

Kompania parashtruese, mes tjerash, pretendoi shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, theksoi se kompania parashtruese nuk i ka dëshmuar pretendimet për shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Faktet e rastit nuk tregojnë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë. Kërkesa u deklarua e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI04/16
Parashtrues
"ALDEKO", Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ·UZVP. nr. 10/2015, të 30 korrikut 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Mulet Haziraj, pronar i "ALDEKO" SH.P.K., nga Tropoja-Pradesh i Republikës së Shqipërisë në emër të "ALDEKO" SH.P.K. me seli në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Kompania parashtruese), të cilën e përfaqëson z. Bajram Morina, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Kompania parashtruese konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ·UZVP. nr. 10/2015, të 30 korrikut 2015, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 434/2014, të 29 nëntorit 2014, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. nr. 586/12 dhe Aktvendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, K.A. nr. 170/2012, të 19 marsit 2012.

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar kompanisë parashtruese më 19 shtator 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 10/2015, të 30 korrikut 2015.

5. Kompania parashtruese pretendon shkeljen e nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 7 [Vlerat], nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës dhe nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 janar 2016, kompania parashtruese e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gresa Caka-Nimani (gjyqtarë).

9. Më 23 mars 2016, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e kompanisë parashtruese për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sigurojë autorizimin e qartë për përfaqësim në Gjykatë. Të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës u është dërguar Gjykatës Supreme dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejmë: KPMM).

10. Më 14 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 7 prill 2004, kompania parashtruese parashtroi kërkesë në KPMM për të marrë licencë për eksploatimin e gurit gëlqeror në afërsi të Gjakovës.

12. Më 30 qershor 2005, KPMM-ja e aprovoi kërkesën e lartpërmendur të kompanisë parashtruese dhe ia lëshoi "Lejen për shfrytëzim" Nr. 204/MI/KPMM/05.

13. Më 21 janar 2009, kompania parashtruese ishte njoftuar nga KPMM-ja se ata nuk i kishin kryer operacionet e tyre në përputhje me licencën dhe kishin bërë shkelje të saj, dhe për këtë arsye, atyre u ishte dhënë një afat kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh në mënyrë që të plotësojnë kriteret e përcaktuara në licencë.

14. Më 20 shtator 2011, KPMM-ja me Vendimin Nr. 5033 anuloi licencën e kompanisë parashtruese, për shkak të mospërmbushjes së kritereve të parapara.

15. Kompania parashtruese parashtroi ankesë kundër Vendimit të KPMM-së për anulimin e licencës në KPMM, pas procedurës përkatëse.

16. Më 19 mars 2012, KPMM-ja me Vendimin K.A. nr. 170/2012 e refuzoi ankesën e kompanisë parashtruese dhe vërtetoi vendimin e saj për anulimin e licencës. KPMM-ja arsyetoi, *inter alia*, se kompania parashtruese ishte njoftuar me kohë se ajo kishte punuar jashtë fushëveprimit të paraparë me licencë, dhe përkundër kësaj, ajo nuk i plotësonte kriteret e përcaktuara në licencë brenda një afati kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve.

17. Më 2 shtator 2014, kompania parashtruese ushtroi ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër vendimit të KPMM-së për anulimin e licencës. Kompania parashtruese, *inter alia*, u ankua se në vazhdimësi ka punuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në licencë, sepse KPMM-ja i ka detyruar ata që të paguajnë tatimin

vjetor për licencë për vitet 2010 dhe 2011, edhe pse licenca është anuluar nga KPMM-ja më 20 shtator 2011.

18. Më 22 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin A. nr. 586/12 e refuzoi kërkesëpadinë e kompanisë parashtruese kundër vendimit të KPMM-së, si të pabazuar. Gjykata Themelore arsyetoi se: (i) KPMM-ja kishte anuluar licencën e kompanisë parashtruese në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, (ii) se kompania parashtruese ishte njoftuar me kohë dhe i është dhënë një afat kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, në mënyrë që të përmbushë kriteret e përcaktuara në licencë, dhe (iii), licenca është anuluar për shkak se kompania parashtruese nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në të, edhe pasi është njoftuar nga KPMM-ja. Gjykata Themelore gjithashtu shtoi se nga faktet e rastit rezulton se ligji nuk është zbatuar në dëm të kompanisë parashtruese, dhe se, KPMM-ja kishte nxjerrë prova të mjaftueshme që vërtetojnë obligimin ligjor të kompanisë parashtruese për të përmbushur kriteret e përcaktuara në licencë.

19. Më 20 tetor 2014, kompania parashtruese parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të së drejtës procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kompania parashtruese, *inter alia*, u ankua ndaj gjetjeve të Gjykatës Themelore se vendimi i KPMM-së ishte i ligjshëm, dhe se, kompania parashtruese nuk ka vepruar në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencë. Thelbi i ankesave të kompanisë parashtruese ishte se Gjykata Themelore nuk ka marrë parasysh faktin se fushëveprimi i licencës ishte zgjeruar me pëlqimin e autoriteteve kompetente lokale dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës.

20. Më 29 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AA. nr. 434/2014, e refuzoi ankesën e kompanisë parashtruese si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vërtetoi aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore dhe përsëriti se: (i) vërtetohet se kompania parashtruese kishte vepruar jashtë fushëveprimit të përcaktuar në licencë (ii), kompania parashtruese nuk i ishte përgjigjur paralajmërimeve të KPMM-së të ngritura ndaj tyre në lidhje me mospërputhshmërinë me kushtet e përcaktuara në licencë dhe (iii) se KPMM-ja ka vepruar në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

21. Sa i përket pretendimit të kompanisë parashtruese në lidhje me zgjerimin e licencës nga organet kompetente, në pjesën përkatëse të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet:

> *"Pëlqimi komunal dhe pëlqimi i APK-së, në të cilët thirret paditësi ka të bëjë me ndërrimin e parcelave në teren dhe aplikim të paditësit për licencë tjetër dhe nuk përkon me licencën e cila i ka të përcaktuar kufijtë e zonës së operimit ndërsa për operim në hapësirë tjetër duhet poseduar licencë valide dhe se kufijtë e operimit kufizohen ashtu si parashihet në nenin 33 të Rregullores për miniera dhe minerale, andaj organi administrativ KPMM, pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe vërtetimit të veprës së kryer duke u bazuar në dispozitat ligjore si në aktvendimin e goditur me padi subjektit ia ka anuluar licencën".*

22. Kompania parashtruese parashtroi kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Gjykatën Supreme. Kompania parashtruese kryesisht pretendon se: (i) të dyja gjykatat, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit e kishin anashkaluar faktin jokontestimor se vendimi i KPMM-së për anulim të licencës është nxjerrë pas 3 (tre) vitesh nga dita e njoftimit të

kompanisë parashtruese në lidhje me mundësinë për anulimin e licencës, (ii) të dyja gjykatat, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit e kishin anashkaluar faktin se kompania parashtruese kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të zgjeruar fushëveprimin e licencës me pëlqimin e autoriteteve kompetente dhe (iii) fakti që KPMM-ja e kishte detyruar kompaninë parashtruese që të paguajë taksën vjetore gjatë viteve 2010 dhe 2011 tregon se ata kishin vepruar brenda fushëveprimit të licencës.

23. Më 30 korrik 2015, Gjykata Supreme me Aktgjykimin ARJ-UZVP Nr. 10/2015 refuzoi kërkesën e kompanisë parashtruese për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve të instancave më të ulëta. Gjykata Supreme aprovoi të gjeturat e gjykatave të instancës më të ulët, përkatësisht se kompania parashtruese ishte duke vepruar jashtë fushëveprimit të licencës dhe se gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar drejtë dispozitat e të drejtës procedurale dhe materiale.

24. Në pjesën relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme thuhet se:

> *"Neni 9 i Ligjit për Minierat dhe Minerale të Kosovës (nr.03/L-163) dhe neni 8 i Rregullores për Minierat dhe Minerale nr.2005/3 përcakton se nëse një Bartësi i Licencës ose Lejes nuk arrin ta ruajë kualifikimin e tij ose nuk i ka përmbushur kërkesat materiale të këtij ligji ose cilësdo Licencë, Leje, marrëveshje ose instrument tjetër të nxjerrë dhe/ose zbatuar në pajtim me këtë Ligj, KPMM do t'i dërgojë bartësit të Licencës ose Lejes një 'Njoftim të dështimit për përmbushje' me shkrim dhe me udhëzim për të përmirësuar dështimin në fjalë. Nëse mospërmbushja vazhdon pas periudhës kohore të përcaktuar në 'Njoftimin për dështimin dhe përmbushjen', Komisioni mund ta pezullojë ose ta anulojë licencën apo lejen e personit në fjalë.*
>
> *Kjo Gjykatë gjithashtu gjen se nga i padituri, më 19.01.2011 i është dërguar paditësit njoftimi për mospërputhshmëri me kushtet e licencës nr.024/MI/ICMM/05. Pasi mospërmbushja ka vazhduar pas periudhës kohore të përcaktuar në 'Njoftim', KPMM me aktvendimin nr. 5033 të datës 20.09.2011 paditësit 'Aldeko' i është anuluar licenca e datës 04.08.2005, ndërsa për shkak se nuk i është përmbajtur vërejtjeve të dhëna, me aktvendimin e Komisionit K.A. nr.170/2012 dt.19.03.2012 i është refuzuar ankesa dhe është lënë në fuqi aktvendimi i shkallës së parë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Kompania parashtruese pretendon shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], të nenit 7 [Vlerat], të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], të nenit 24 [Barazia para Ligjit], të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

26. Në lidhje me aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, kompania parashtruese pretendon se: "*Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, si Gjykatë e shkallës së parë, duke vendosur sikurse me Aktgjykimin e saj, A. Nr. 586/12, i datës 22.09.2014, por edhe Gjykata e Apelit të Kosovës- Departamenti per Çështje Administrative, duke vendosur sipas Aktgjykimit të saj, A.A. Nr. 43412014, të datës 29.12.20 14, kanë dështuar të vlerësojnë ligjështmërin e vendimit kontestues të KPMM, Nr. 170120112, të datës 19.03.2012 (i lëshuar pas gati rreth 3 vjetësh nga dita kur ka ndodhur paralajmrimi për suspendim të Licencës)".*

27. Sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, kompania parashtruese pretendon se: "*Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin e saj, ARJ-UZVP. Nr. 10/2015 të datës 30.07.2015, duke mos vendosur në mënyrë meritore dhe duke përshkruar në arsyetim të aktgjykimit të saj konstatimet e gabuara dhe të paqëndrueshme të Gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, sa i përket çështjes juridike të parashtruesit të kësaj kërkese, për shkaqet e përgjithësuara në aktgjykimin e saj , e ka refuzuar si të pabazuar Kërkesën e parashtruesit të kësaj kërkese, të datës 04.03.2015, për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative".*

Pranueshmëri e kërkesës

28. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Neni 21.4 i Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme], parasheh:

> *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".*

31. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parsheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

32. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës i cili specifikon:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*
>
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

33. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta ishin përgjigjur në çështjet që kanë të bëjnë me rastin e kompanisë parashtruese, sepse ato shpjeguan se: (i) vendimi i KPMM-së për anulimin e licencës ishte bazuar në ligjin e zbatueshëm në Kosovë, (ii) se KPMM-ja ka njoftuar kompaninë parashtruese në kohën e duhur se ata po vepronin jashtë fushëveprimit të paraqitur në licencë dhe për këtë qëllim atyre u ishte dhënë një afat kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh dhe se (iii) licenca ishte anuluar, për shkak se kompania parashtruese nuk i ka respektuar kushtet e përcaktuara në të edhe pasi është njoftuar nga KPMM-ja.

34. Gjykata gjithashtu tërheq vëmendjen për pretendimet e kompanisë parashtruese se gjykatat e rregullta kishin anashkaluar, dhe në atë mënyrë nuk kishin adresuar faktin që fushëveprimi i licencës ishte zgjeruar me pëlqimin e autoriteteve kompetente, duke nënkuptuar se ata kishin kryer operacionet në kuadër të licencës.

35. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se ai pretendim nuk përputhet dhe është në kundërshtim me provat e përfshira në kërkesë. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit kishte konstatuar se pëlqimi i dhënë kompanisë parashtruese nga autoritetet kompetente kishte të bënte me kërkesën për një licencë tjetër dhe nuk kishte të bënte me licencën nën shqyrtim nga KPMM-ja, dhe më pas nga Gjykata Themelore.

36. Sa i përket pretendimeve të kompanisë parashtruese se KPMM-ja kishte anuluar licencën 3 (tre) vjet pas njoftimit të parë zyrtar, Gjykata konsideron se pretendimet e tilla, për qëllimet e procedurës kushtetuese janë të parëndësishme, sepse ato janë një çështje e faktit dhe nuk janë pretendime të ngritura në nivel kushtetues.

37. Për më tepër, Gjykata konsideron se kompania parashtruese vetëm citon dispozitat e Kushtetutës, pa dëshmuar se si ato norma kushtetuese janë shkelur në dëm të tyre siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

38. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

39. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,* rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28 Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ], Aktgjykimi 1999-I).

40. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih, rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

41. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se kompania parashtruese nuk i ka dëshmuar pretendimet për shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Faktet e rastit nuk tregojnë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.

42. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 14 prill 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI88/15, Parashtrues Božidar Dimić, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0018

KI88/15, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2016, publikuar më 20 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për kompensimin e dëmit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për punë dhe ushtrim të profesionit, qartazi e pabazuar*

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me Aktvendimin AC-I-15-0018, të 19 marsit 2015, refuzon kërkesën e parashtruesit për përfitim nga ndërmarrja e privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me këtë vendim i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Kosovës, si dhe të nenit 6 dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi vetëm përmend dispozitat kushtetuese pa i mbështetur ato në fakte ose dëshmi konkrete. Në bazë të kësaj, kërkesa e parashtruar nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë sepse në kërkesën e tij parashtruesi nuk ka dëshmuar se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ janë shkelur me vendimin e kontestuar. Pra, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe deklarohet e papranueshme mbështetur në rregullin 36 (1) d) dhe 2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI88/15
Parashtrues
Božidar Dimić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0018, të 19 marsit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Božidar Dimić, me vendbanim në Kralevë, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0018 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të 19 marsit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 qershor 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjinshqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët:Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 15 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje Kolegjit të Apelit.

8. Më 13 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte punonjës në Ndërmarrjen Shoqërore "Auto Moto Start" (në tekstin e mëtejmë: AMS) deri në vitin 1999.

10. Më 31 dhjetor 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë:AKP-ja) filloi procesin e privatizimit të AMS.

11. Më 2 mars 2011, parashtruesi parashtroi në AKP kërkesë për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës.

12. Më 17 prill 2013; AKP-ja [Aktvendimi nr. 0060] refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pavlefshme, sepse "*Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme të cilat konfirmojnë se ai ka qenë aktivisht i punësuar në NSH "AUTO-MOTO START" (në likuidim) në kuptim të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në (Ligji nr. 04/L-034), i cili parashikon se parashtruesit e kërkesave e kanë të drejtën për pagesën e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse "janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia (AKP) sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në".*

13. AKP-ja, më tej, konkludoi se *"parashtruesi i kërkesës nuk është bërë tepricë si pasojë e Vendimit për Likuidim në vitin 2011, por as teprica e pretenduar nuk është e lidhur me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia [...]. Në fakt, në kohën kur parashtruesi i kërkesës e ka ndërprerë punën në NSH, as Agjencia Kosovare e Privatizimit, as paraardhësja e saj, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, nuk kanë qenë të themeluara ende".*

14. Më 18 prill 2013, parashtruesi parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) kundër Aktvendimit [nr. 0060] të AKP-së.

15. Parashtruesi i kërkesës pohoi në ankesën e tij se*: "ai ka të drejtë në të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe si pasojë edhe në të drejtën e kompensimit dhe pagesës për ndërprerje të punës".*

16. Më 4 prill 2014, AKP-ja i parashtroi përgjigje Kolegjit të Specializuar, duke deklaruar, *inter alia*, se *"marrëdhënia e punës së ankuesit nuk është ndërprerë për shkak të ndonjë veprimi nga ana e AKP-së. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi me të cilat do të*

kishte mundur të dëshmojë se ka qenë i punësuar edhe pas vitit 1999, apo se ka pranuar të ardhura personale në NSH; rrjedhimisht, ankuesi nuk ka qenë i punësuar në NSH në kohën e privatizimit dhe AKP nuk e kishte ndërprerë marrëdhënien e tij të punës".

17. Më 18 dhjetor 2014, Kolegji i Specializuar [Aktgjykimi C-IV-13-0701], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

18. Kolegji i Specializuar konsideroi se *"pohimet e ankuesit në lidhje me atë se ai ka qenë i punësuar në NSH deri në privatizim dhe se AKP-ja ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës janë të pabazuara. Ankesa nuk ofron asnjë dëshmi e cila mund të provojë se ai ka qenë i punësuar në NSH apo që ai ishte në listën e pagave në NSH deri në privatizim apo se AKP-ja ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me anë të njoftimit apo aktvendimit".*

19. Më 16 janar 2015, parashtruesi parashtroi ankesë pranë Kolegjit të Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të dështimit për të marrë parasysh specifikat e gjendjes së parashtruesit të kërkesës, e cila çoi në diskriminim të tij.

20. Më 19 mars 2015, Kolegji i Apelit [Aktgjykimi AC-I-0018] e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, *"sepse ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në lidhje me këto pretendime".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"vendimet dhe aktgjykimet e marra në këtë rast janë skajshmërisht tendencioze, të njëanshme në një pjesë dhe diskriminuese".*

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimet dhe aktgjykimet *"në esencën e tyre shkelin thellë Kushtetutën dhe ligjet, janë shprehimisht të padrejta, si dhe që si të tilla nuk munden as nuk duhet të qëndrojnë dhe të prodhojnë efekt juridik".*

23. Parashtruesi kërkonnga Gjykata që *"ta anulojë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit dhe të Kolegjit të Specializuar, ta aprovojë kërkesën e parashtruesit dhe ta kthejë rastin në gjykatë për rishqyrtim".*

Pranushmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

27. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

28. Gjykata, po ashtu, rikujton se parashtruesi pretendon se të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, janë shkelur si pasojë e ndërprerjes së parakohshme të punës nga ana e AKP-së dhe për shkak të refuzimit të kompensimit dhe pagesës për ndërprerje të punës.

29. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin trajtuar statusin e mëparshëm ose aktual të punësimit të parashtruesit dhe bazat e kërkesës së tij për kompensim dhe pagesë për ndërprerje të punës dhe ata dhanë një vlerësim të arsyetuar të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë respektuar parimet themelore të së drejtës për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

31. Kjo konsideratë është në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), e cila thekson se "*gjykatat kanë liri të caktuar veprimi në këtë drejtim se cilat argumente dhe prova do t'i pranojnë në një rast të caktuar".* (GJEDNJ, *Suominen kundër Finlandës, nr. 37801,* Aktgjykimi i 1 korrikut 2003)·

32. Gjykata më tej konsideron se gjykatat e rregullta gjithashtu i kanë adresuar pretendimet e parashtruesit se ai ishte viktimë e diskriminimit. Në këtë kontekst, Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij [AC-I-0018] konkludoi se parashtruesi i kërkesës mund të kishte bërë ankesën e tij në bazë të diskriminimit sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e cila, *inter alia,* parasheh se, "[...] *një punonjës i cili nuk i plotëson këto kërkesa do të ketë të drejtë në 20%, nëse vërtetohet se diskualifikimi i tij/i saj ishte pasojë e diskriminimit".*

33. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur në AKP dhe në gjykatat kompetente çështjen e përfshirjes në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në pjesën e 20% nga të ardhurat e privatizimit.

34. Gjykata vlerëson separashtruesi në përgjithësi pretendon se gjykatat nuk i kanë marrë parasysh specifikat e rastit, përkatësisht se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë.

Megjithatë, Gjykata konsideron se pretendimi i përgjithshëm i parashtruesit të kërkesës për trajtim të pabarabartë nuk është i mjaftueshëm, pa i treguar bazat konkrete për këtë pabarazi. Prandaj, Gjykata konkludon se referenca e parashtruesit për shkelje të të drejtave nga neni 24 i Kushtetutës është e pabazuar.

35. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thekson se "*[...] diskriminimi është trajtimi i ndryshëm, pa një qëllim objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme*" (Shih Aktgjykimi *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, paragrafi 48, GJEDNJ 2002- IV, Aktgjykimi *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, *Aktgjykimi D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, paragrafi 44).

36. Gjykata konstaton se shkelja e pretenduar e të drejtave sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së është e pabazuar, pasi parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të realizojë pretendimin e tij për *"pritje legjitime"* në lidhje me kërkesën e tij për kompensim dhe pagesë për shkëputje nga puna, që nuk mund në vetvete të përbëjë një bazë të vlefshme që justifikon pretendimet e shkeljes.

37. Gjykata konsideron se neni 1 i Protokollit 1, mbron vetëm pasurinë ekzistuese, por jo edhe të drejtën për fitimin e pronës në të ardhmen. Pritja legjitime në çdo "pronë", "asete" ose "kompensim", sipas kësaj pikëpamjeje duhet të jetë e bazuar në dispozitë ligjore apo akt ligjor, e cila ka bazë të vlefshme ligjore dhe ka ndikim në të drejtat pronësore (Shih rastin *Peter Gratzinger dhe Eva Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, Vendim i Gjykatës Evropiane të 10 korrikut 2002, nr. 39794/98, paragrafi 69*)*.

38. Megjithatë, Gjykata gjen se aktgjykimet e kontestuara janë nxjerrë nga gjykatat e themeluara me Kushtetutë dhe me ligj, në bazë të parimit të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës të cilin parashtruesi e kishte cituar si shkelje. Gjykatat, brenda kufijve të kompetencave të tyre, kanë kryer procedurën në bazë të ligjit, duke dhënë arsye të pranuara kushtetuese, për procedura të tilla.

39. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e rastit të tij nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentuar për shkeljen e dispozitave kushtetuese. (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

40. Gjykata konsideron se parashtruesinuk i ka mbështeturpretendimet e tijdhe as nuk kaparaqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që dotë tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (Shih, rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

41. Gjykata, thekson më tej, se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

42. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar në kërkesën e tij se vendimi i kontestuar i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

43. Prandaj, kërkesaështë qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe është e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 2 (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 13 prill 2016, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI38/16, Parashtrues i kërkesës: Nezir Kryeziu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 148/2015, të 9 nëntorit 2015.

KI38/16, aktvendim për papranueshmëri i 18 majit 2016, i publikuar më 21 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Më 19 nëntor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pml. nr. 148/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (Aktgjykimi P. nr. 130/2014) me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe i ishte shqiptuar dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh dhe 10 (dhjetë) muaj për veprat penale vrasje në tejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe për veprën penale vrasje në tentativë që rezulton me lëndime të lehta.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se atij i ishte shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe po ashtu kërkoi vënien e masave të përkohshme.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të cilat ishin të rëndësishme për rastin penal, ishin shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat, që arsyet materiale dhe ligjore për vendimin të cilin ai e konteston ishin paraqitur detajisht dhe, rrjedhimisht, procedura në gjykatat e rregullta, shikuar në përgjithësi, ishte e drejtë. Kërkesa ishte deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar. Gjykata gjithashtu e refuzoi si të pabazuar kërkesën për masë të përkohshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI38/16
Parashtrues
Nezir Kryeziu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 148/2015, të9 nëntorit 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Nezir Kryeziu nga Suhareka (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson z. Ethem Rogova, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 148/2015, të 9 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të lartpërmendur me të cilin pretendohet se është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi njëkohësisht kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme *"dhe të ndërpresë paraburgimin ndaj të dënuarit Nezir Kryeziun deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 shkurt 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

8. Më 25 mars 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës përregjistrimin ekërkesës.

9. Më 18 maj2016,pas shqyrtimit të raportit tëgjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoiGjykatëspapranueshmërinëe kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 26 tetor 2011, Prokurori në Prizren ngriti aktakuzë (PP. nr. 28/2011) kundër parashtruesit të kërkesës për tri vepra penale si në vijim: veprën penale vrasje; për veprën penale vrasje në tentativë që rezulton me lëndime të lehta trupore dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

11. Më 4 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykimin P. nr. 251/11 e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe i shqiptoi dënim unik në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vitesh për veprën penale vrasje në tejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe për veprën penale vrasje në tentativë që rezulton me lëndime të lehta trupore.

12. Me të njëjtin Aktgjykim, Gjykata Themelore e refuzoi aktakuzën për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sepse kjo vepër penale është e përfshirë me Ligjin për amnisti.

13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (P. nr 251/11) të Gjykatës Themelore.

14. Më 23 prill 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PAKR. nr. 163/2014) e anuloi Aktgjykimin (P. nr. 251/11, të 4 nëntorit 2013) e Gjykatës Themelore dhe çështjen e ktheu në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, me arsyetimin se:

> "*Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe i paqartë nuk përkon me arsyetimin dhe faktet vendimtare të paraqitura nga ana e gjykatës së shkallës së parë".*

15. Më 24 tetor 2014, në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore (Aktgjykimi P. nr. 130/2014) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe i shqiptoi dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh dhe 10 (dhjetë) muaj për veprat penale vrasje në tejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe për veprën penale vrasje në tentativë që rezulton me lëndime të lehta.

16. Prokurori Themelor në Prizren parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkelje esenciale të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPPK), dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

17. Mbrojtësit e parashtruesit të kërkesës paraqitën ankesa në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (P. nr. 130/2014) të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të KPK-së dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

18. Më 22 dhjetor 2014, Prokurori i Apelit (parashtresa PPA/I nr. 604/14) propozoi që ankesa e Prokurorit Themelor të aprovohet, ndërsa ankesat e mbrojtëseve të parashtruesit të kërkesës të refuzohen si të pabazuara.

19. Më 17 mars 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 619/2014), e refuzoi si të papranueshme ankesën e Prokurorit Themelor dhe i refuzoi si të pabazuara ankesat e mbrojtëseve të parashtruesit të kërkesës, e vërtetoi Aktgjykimin ((P. nr. 130/2014) e Gjykatës Themelore sa i përket lartësisë së dënimit me burgim dhe cilësimit të veprës penale vrasje në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

20. Të njëjtënkohë, Gjykata e Apelit *ex officio* e ndryshoi Aktgjykimin (P. nr. 130/2014) të Gjykatës Themelore vetëm në pjesën lidhur me cilësimin juridik të veprës penale nën pikën II, ashtu që veprën penale vrasje në tentativë që rezulton me lëndime të lehta trupore e rikualifikoi si vepër penale vrasje në tentativë.

21. Mbrojtësit e parashtruesit paraqitën në Gjykatën Supreme të Kosovës kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit (P. nr. 130/2014) të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit (PAKR. nr. 0,619/2014) të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të KPPK-së.

22. Më 16 korrik 2015, Prokurori i Shtetit me parashtresë (KMLP. II. nr. 112/2015) rekomandoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

23. Më 19 nëntor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi PML. nr. 148/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit dhe dha shpjegime të hollësishme për të gjitha pretendimet e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktakuzë (PP. nr. 28/2011) ai është akuzuar për veprën penale vrasje, ndërsa me Aktgjykimin (P. nr. 251/2011) e Gjykatës Themelore në Prizren u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale vrasje në tejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

26. Parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak se Prokuroria nuk e ka ricilësuar aktakuzën, ai nuk ka mundur të deklarohet për fajësinë, sepse po t'i ishte lexuar "*...aktakuza e ndryshuar në lidhje me veprën penale"* vrasjenëtejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme *"i akuzuari Nezir do të pranonte kryerjen e veprës penale dhe rrjedhimisht, dënimi i shqiptuar në bazë të pranimit të fajësisë do të ishte më i ultë"*.

27. Parashtruesi i kërkesës thekson se shkeljet e lartpërmendura përbëjnë "*... shkelje absolute nga neni 386 par.1 të KPPK-se e cila dispozitë përcakton se aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin kryesor"*.

28. Parashtruesi i kërkesës, më tej, thekson se çështjen e ricilësimit të aktakuzës e ka theksuar edhe në procedurën ankimore para gjykatave të rregullta.

29. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën në vijim:

> *"Të konstatojë që ka pasur shkelje të nenit 31 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

30. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme *"dhe të ndërpresë paraburgimin ndaj të dënuarit Nezir Kryeziut deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate".*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Gjykata i referohetnenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> "Individët *janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

33. Gjykata, gjithashtu, duhet ta shqyrtojë edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> "Parashtruesi *i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

34. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1)* Gjykata *mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2)* Gjykata *do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

35. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se gjykatat e rregullta kanë pranuar të shqyrtojnë aktakuzën e pandryshuar, dhe kështu kanë bërë shkelje absolute të nenit 386 paragrafi 1, i KPPK-së, dhe se për shkak të interpretimit të tillë të gabuar të ligjit ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

36. Në këtëdrejtim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"1.* Çdokujt *i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

2. Çdokush *gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

37. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 6 (1) e KEDNJ-së që parasheh:

"1 Çdo person ka *të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij".*

38. Si dhe nenin 386 të KPPK-së, në të cilin thirret parashtruesi e që parashikon:

"(1) Aktgjykimi *mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor.*

(2) Gjykata *nuk detyrohet me propozimet e paditësit* [prokurorit] *lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.*

(3) Gjykata *nuk detyrohet me marrëveshje ndërmjet prokurorit publik dhe mbrojtjes lidhur me ndryshimin e akuzës ose pranimin e fajit".*

39. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës këto pretendime i paraqiti edhe në procedurën sipas ankesës në Gjykatën e Apelit, si dhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, të cilat dhanë përgjigje të arsyeshme për këto pretendime të parashtruesit.

40. Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PARK. nr. 619/2014) i shqyrtoi këto pretendime të parashtruesit dhe konkludoi:

"Nga analizimi *i shkresave të lëndës kjo gjykatë konsideron se në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal në favor të akuzuarit, për çka nisur nga parimi Reformatio in Peius, të njëjtën nuk mund ta ndryshojë, por vetëm ta konstatoj..."..."*

41. Gjithashtu, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 148/2015) i shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës:

*"...*Qëndron *pretendimi i mbrojtësit E. R. se gjykata e shkallës së parë është dashur ta filloj shqyrtimin gjyqësor jo me aktakuzën fillestare të Prokurorit të Shtetit sa i përket cilësimit juridik, ngase vepra penale nga vrasja ishte ricilësuar në vrasje me tejkalim të kufijve të mbrojtës së nevojshme dhe ky ricilësim nuk ishte kontestuar nga Prokurori i Shtetit, ndërsa çështja ishte kthyer në rigjykim me ankesë të mbrojtësve të të akuzuarit, mirëpo kjo shkelje nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit dhe nuk është cenuar parimi "reformatio in peius".*

42. Pastaj, Gjykata Supreme e ka arsyetuar në detaje se pse konsideron që gabimi nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit:

"... Së pari *i akuzuari ishte favorizuar nga Prokurori, ngase edhe pse në rrethana të tilla bëhej fjalë për veprën penale të vrasjes së rendë në tentativë të parashikuar nga neni 147. pika 11. lidhur me nenin 20 të KPK, veprimet e t'ia janë cilësuar si një vrasje dhe një tentim vrasje e rëndomtë, të parashikuar nga neni 146 të KPK-s".*

43. Për më tepër, Gjykata Supreme thekson se:

"... është shumë diskutabil përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, për tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme "nga ana e të akuzuarit, ngase nuk mund dikush të jetë edhe aktor i sulmit edhe t'i tejkaloj kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund t'i tejkaloj i sulmuari(personi që mbrohet nga sulmi) e jo sulmuesi siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, mirëpo ky defekt që ka krijuar gjykata e shkallës së parë, në asnjë mënyrë nuk mund të evitohet, ngase do cenohej parimi "reformatio in peius".

44. Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës arsyeton se gabimi në të cilin thirret parashtruesi i kërkesës, bëri që gjykata e shkallës së parë ta ricilësojë veprën e rëndë penale në një vepër më të lehtë penale, duke konkluduar si në vijim:

"... një konstatim të paqartë (Gjykatës Themelore në Prizren) dhe në kundërshtim *me institutin e mbrojtjes së nevojshme, kur në të, i akuzuari konsiderohet edhe si sulmues edhe se i ka tejkaluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme , sido që të jetë ky konstatim i gabuar dhe alogjik i ka sjell favore atij, ngase në përputhje me këtë konstatim, gjykata e shkallës së parë vrasjen e ka ricilësuar si vrasje në tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme".*

45. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh kundërshtimet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës; në mbështetje të kësaj shkon fakti se në bazë të ankesës është anuluar (Aktgjykimi P. nr 251/11) i Gjykatës Themelore në Prizren dhe në procedurën e përsëritur i është shqiptuar dënimi më i ultë.

46. Parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe "*shkeljes absolute nga neni 386 par. l të KPPK-se e cila dispozitë përcakton se aktgjykimi mund ti referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin kryesor*".

47. Gjykata vëren se pikërisht ky nen në paragrafin 2 përcakton që "*Gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës*".

48. Nga të gjitha të lartcekurat, rezulton që parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që në fazat e ndryshme të procedurave pranë gjykatave të rregullta t'i paraqesë argumentet dhe provat që ai i konsideron të rëndësishme për rastin e tij. Në të njëjtën kohë ai kishte mundësi për të kontestuar në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, si të interpretuar gabimisht në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, në procedurë të rregullt gjyqësore.

49. Gjykatarithekson se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse ligjore (Shih rastin: *Perlala kundër Greqisë*, nr. 17721/04, paragrafi 25 të KEDNJ-së, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007).

50. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale nga gjykatat e rregullta, parashtruesi nuk ka dëshmuar pretendimin se vendimet e lartpërmendura kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

51. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet në gjendjen faktike ose në ligjin e aplikueshëm, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës me rastin e pohimit se autoriteti publik i ka cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.

52. Në të vërtetë, Gjykata thekson se detyrë e saj është të vlerësojë nëse procedurat relevante në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, përshirë mënyrën se si janë marrë provat, ose nëse në çfarëdo mënyre procedurat ishin të padrejta ose arbitrare (Shih: *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, paragrafi 16, Vendim përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, GJEDNJ, 30 qershor 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* paragrafi34, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992; *Barbera Messegue Jabardo kundër Spanjës*, paragrafi 68, Aktgjykim i GJENDJ-së i 6 dhjetorit 1988).

53. Gjykata konkludon se të gjitha argumentet e parashtruesit, të cilat ishin të rëndësishme për rastin penal, ishin shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat, që arsyet materiale dhe ligjore për vendimin të cilin ai e konteston ishin paraqitur detajisht dhe, rrjedhimisht, procedura në gjykatat e rregullta, shikuar në përgjithësi, ishte e drejtë.

54. Si përfundim, Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë nuk janë plotësuar. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar t'i prezantojë dhe mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

55. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

56. Siç u përmend më lart, parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme *"... dhe të ndërpresë paraburgimin ndaj të dënuarit Nezir Kryeziut deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate"*.

57. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4 dhe 5) të Rregullores së punës, duhet:

> *"*Rregulli *55 (4) (a), pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar [...] rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *[...]*
>
> Rregulli *55 (5) Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës"*.

58. Siç u përmend më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Parashtruesi nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (d) dhe 55 (5) të Rregullores së punës, më 18 maj 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI155/15 dhe KI157/15, Parashtruese të kërkesës: Snežana Zdravković dhe Miloratka Nikolić, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015

KI155/15 dhe KI157/15, vendim për hedhje poshtë të kërkesës të 17 majit 2016, i publikuar më 28 qershor 2016

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesat e bashkuara, kërkesë pa objekt*

Parashtrueset e kërkesës pretenduan se me Aktgjykimin AC-I-14-0311-A0001-A0023 të Kolegjit të Apelit nuk ishte vendosur për çështjen e kontestit dhe si pasojë, ka mbetur i pazgjidhur statusi i tyre ligjor në lidhje me të drejtën për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

Parashtrueset i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për ta korrigjuar *"gabimin gjatë përpilimit ose diktimit të tekstit të aktgjykimit"* si dhe *"që emri i tyre të futet në listën përfundimtare të punëtorëve të cilëve u përket 20% nga aksionet e të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH-së Voçar"*.

Gjykata konkludoi se kërkesat e parashtruesve janë pa kontest, duke pasur parasysh se me aktgjykimet plotësuese përkatëse (AC-I-14-0311-A1 dhe AC-I- 14-0311-A001) të Kolegjit të Apelit është vendosur për statusin ligjor të parashtrueseve të kërkesave dhe është urdhëruar që të dy parashtrueset të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marre 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

Gjykata në fund konstatoi se objekti i çështjes nuk përfaqëson një rast ose një kontest para Gjykatës, se kërkesat duhet të hidhen poshtë, sepse çështja është zgjidhur në favor të parashtruesve.

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS
në
rastet nr. KI155/15 dhe KI157/15
Parashtrues
Snežana ZdravkovićdheMiloratka Nikolić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa nr. KI155/15 është dorëzuar nga znj. Snežana Zdravković dhe kërkesa nr. KI157/15 është dorëzuar nga znj. Miloratka Nikolić, të dyja nga Graçanica (në tekstin e mëtejmë: parashtrueset e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtrueset e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015, e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar. Parashtrueset pretendojnë se me këtë aktgjykim nuk është vendosur për çështjen lëndore, dhe si pasojë, ka mbetur i pazgjidhur statusi ligjor i parashtrueseve në lidhje me të drejtat për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore "Urata-Voçar" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: NSH "Urata-Voçar").

4. Parashtrueset e kërkesës nuk përmendin asnjë nen konkret të Kushtetutës që ishte shkelur, por konsiderojnë se ishte një "*gabim gjatë përpilimit ose diktimit të tekstit të aktgjykimit, meqë emrat e tyre ishin lënë jashtë liste*".

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 dhjetor 2015, parashtruesja Snežana Zdravković e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), e cila është regjistruar me numrin KI155/15.

7. Më 28 dhjetor 2015, parashtruesja Miloratka Nikolić e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, e cila është regjistruar me numrin KI157/15.

8. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI155/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI155/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 19 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen Snežana Zdravković dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) për regjistrimin e kërkesës së saj dhe e dorëzoi kopjen e kërkesës në Gjykatën Supreme.

10. Më 23 shkurt 2015, Gjykata e informoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) për regjistrimin e kërkesës nr. KI155/15 dhe kërkoi prej saj informata për të treguar nëse parashtruesja Snežana Zdravković gjendej në listën e punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së “Urata-Voçar”.

11. Më 1 mars 2016, AKP-ja iu përgjigj kërkesës së Gjykatës, duke deklaruar se statusi ligjor i parashtrueses Snežana Zdravković nuk është zgjidhur dhe se AKP-ja ka kërkuar nga Kolegji i Apelit të nxjerrë aktgjykim plotësues, me të cilin duhej të vendosej për statusin juridik të parashtrueses në fjalë.

12. Më 7 mars 2016, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës ka urdhëruar bashkimin e kërkesës KI157/15 me kërkesën KI155/15. Sipas këtij Urdhri, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues, në të dy rastet (KI155/15 dhe KI157/15) ishin të njëjtë, siç ishte vendosur me Vendimin nr. KSH. KI155/15.

13. Më 14 mars 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen Miloratka Nikolić dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës nr. KI157/15 dhe e dorëzoi kopjen e kërkesës në Gjykatën Supreme.

14. Më 14 mars 2016, Gjykata e njoftoi AKP-në për regjistrimin e kërkesës nr. KI157/15 dhe kërkoi nga AKP-ja të paraqesë informata në Gjykatë që tregojnë nëse parashtruesja Miloratka Nikolić është e përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së “Urata-Voçar”.

15. Më 23 mars 2016, AKP-ja iu përgjigj kërkesës së Gjykatës, duke deklaruar se statusi ligjor i parashtrueses Miloratka Nikolić është zgjidhur me Aktgjykimin plotësues AC-I-14-0311-A1 të Kolegjit të Apelit, të 17 dhjetorit 2015. Sipas këtij aktgjykimi,

parashtruesja është përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

16. Më 5 prill 2016, Gjykata ka kërkuar nga Gjykata Supreme të paraqesë informata që tregojnë se cili është statusi ligjor i parashtrueses së kërkesës Snežana Zdravković.

17. Më 15 prill 2016, Gjykata Supreme i është përgjigjur Gjykatës, duke theksuar se statusi ligjor i parashtrueses Snežana Zdravković është zgjidhur me Aktgjykimin plotësues AC-I-14-0311-A0001, të Kolegji të Apelit, më 6 prill 2016, me të cilin parashtruesja është përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

18. Më 19 prill 2016, Gjykata i njoftoi parashtrueset e kërkesës dhe Gjykatën Supreme lidhur me bashkimin e lëndës.

19. Më 17 maj 2016, Gjykata shqyrtoi rastin dhe ka vendosur ta shkarkoj kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 2 maj 2007, filloi procesi i privatizimit të NSH-së "Urata-Voçar".

21. Më 21 korrik 2011, AKP-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

22. Në një datë të pacaktuar, secila prej parashtrueseve paraqiti padi të ndara në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar). Ato kontestuan listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

23. Më 29 shtator 2014, Kolegji i Specializuar, me Aktgjykimin SCEL-110045, i aprovoi paditë e parashtrueseve dhe e urdhëroi AKP-në që të dyja parashtrueset të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

24. AKP-ja paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit. AKP-ja ka kontestuar të drejtën e një numri të madh të personave, përfshirë këtu edhe parashtrueset për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

25. Më 15 korrik 2015, Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin AC-I-14-0311-A0001-A0023, e anuloi Aktgjykimin SCEL-11-0045 të Kolegjit të Specializuar.

26. Megjithatë, me Aktgjykimin AC-I-14-0311-A0001-A-0023 të Kolegjit të Apelit nuk është vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga AKP-ja kundër parashtrueseve, domethënë lidhur me statusin ligjor të parashtrueseve.

27. Më 17 dhjetor 2015, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin plotësues AC-I-14-0311-A1 e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e paraqitur nga AKP-ja kundër parashtrueses

Miloratka Nikolić, dhe e urdhëroi AKP-në që parashtruesen ta përfshijë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

28. Më 6 prill 2016, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin plotësues AC-I -14-0311-A001 e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e paraqitur nga AKP-ja kundër Snežana Zdravković, dhe e urdhëroi AKP-në që parashtruesen ta përfshijë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtrueset e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin AC-I-14-0311-A0001-A0023 të Kolegjit të Apelit nuk është vendosur për çështjen e kontestit dhe si pasojë, ka mbetur i pazgjidhur statusi i tyre ligjor në lidhje me të drejtën për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

30. Parashtrueset e kërkesës konsiderojnë se nga arsyetimi i aktgjykimit mund të konstatohet "*se është refuzuar ankesa e AKP-së*" në lidhje me dy parashtrueset, por "*kjo nuk është paraqitur në dispozitivin e aktgjykimit*".

31. Parashtrueset e kërkesës konsiderojnë që "*ekziston mundësia*" që është në pyetje *"gabimi teknik"* në vet aktgjykimin, por nëse nuk ka qenë gabim teknikatëherë ndaj tyre është bërë "*diskriminimi mbi bazën nacionale, si dhe është shkelur e drejta në punë dhe në të ardhurat*".

32. Parashtrueset i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për ta korrigjuar *"gabimin gjatë përpilimit ose diktimit të tekstit të aktgjykimit"* si dhe *"që emri i tyre të futet në listën përfundimtare të punëtorëve të cilëve u përket 20% nga aksionet e të të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH-së Voçar"*.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata rikujton se parashtrueset e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin AC-I-14-0311-A0001-A0023, të Kolegjit të Apelit.

34. Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është ndryshuar me Aktgjykimin plotësues AC-I-14-0311-A1 të Kolegjit të Apelit në lidhje me të drejtën e parashtrueses Miloratka Nikolić. Me anë të tij, u refuzua si e pabazuar ankesa e AKP-së dhe u urdhërua që parashtruesja të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

35. Gjykata më tej konstaton se Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është ndryshuar me Aktgjykimin plotësues AC-I-14-0311-A001, të Kolegjit të Apelit në lidhje me të drejtat e parashtrueses Snežana Zdravković. Me anë të tij, u refuzua si e pabazuar ankesa e parashtruar nga AKP-ja dhe u urdhërua që parashtrueset të përfshiheshin në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

36. Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës nuk kontestojnë para Gjykatës aktgjykimet plotësuese përkatëse (AC-I-14-0311-A1 dhe AC-I-14-0311-A001) të Kolegjit të Apelit.

37. Gjykata, më tej, vëren se me aktgjykimet plotësuese të Kolegjit të Apelit janë adresuar pretendimet e parashtrueseve.

38. Prandaj, aktgjykimet plotësuese (AC-I-14-0311-A1 dhe AC-I-14-0311-A001) të Kolegjit të Apelit janë tashmë vendime përfundimtare lidhur me të drejtën e parashtrueseve të kërkesës për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

39. Në këtë mënyrë, Aktgjykimi i kontestuar (AC-I-14-0311-A0001-A0023) i Kolegjit të Apelit nuk është më vendim përfundimtar i autoritetit publik, e që është edhe arsyeja pse parashtrueset i kanë dorëzuar kërkesat në Gjykatë.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë të qartësojë saktësisht (...) cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

41. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 32 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se (...) nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest (...)".*

42. Gjykata konsideron se kërkesat e parashtruesve janë pa kontest, duke pasur parasysh se me aktgjykimet plotësuese përkatëse (AC-I-14-0311-A1 dhe AC-I-14-0311-A001) të Kolegjit të Apelit është vendosur për statusin ligjor të parashtrueseve të kërkesave dhe AKP-ja është urdhëruar që të dy parashtrueset të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të aksioneve nga privatizimi i NSH-së "Urata-Voçar".

43. Gjykata gjen se çështja që ishte në pikëpyetje për parashtrueset është zgjidhur në favor të tyre dhe nuk ka më kontest që ka mbetur i pazgjidhur.

44. Prandaj, Gjykata konstaton se objekti i çështjes nuk përfaqëson një rast ose një kontest para Gjykatës (Shih, *A.Y. kundër Sllovakisë*, vendimi i GJEDNJ, paragrafi 49, nr. 37146/12, të 24 marsit 2016, shih, gjithashtu rastin: KI143/15, parashtruesja e kërkesës *Donika Kadaj-Bujupi*, Gjykata Kushtetuese, vendimi për hedhje poshtë të kërkesës së 26 shkurtit 2016)

45. Si përfundim, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueseve të kërkesës janë pa rast dhe kërkesat duhet të hidhen poshtë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit, si dhe me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 maj 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ku vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT	NUMRI I FAQEVE
A	
Actio popularis	295
Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)	88, 89
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit	399, 417, 418, 419, 420, 421, 554
Agjencioni Kosovar i Privatizimit	5, 6, 7, 8, 9, 41, 42, 43, 69, 70, 71, 74, 75, 76, 94, 95, 114, 115, 116, 200, 201, 202, 298, 299, 300, 301, 347, 348, 349, 414, 415, 416, 418, 419, 421, 431, 446, 447, 448, 552, 553, 554, 570, 571, 572, 573
Agjencia Pyjore e Kosovës	547
Aktgjykim	16, 19, 30, 31, 33, 45, 103, 138, 175, 190, 194, 213, 228, 243, 261, 274, 288, 294, 295, 309, 331, 338, 341, 344, 359, 368, 375, 383, 386, 414, 427, 450, 468, 469, 477, 485, 505, 521, 528, 529, 537, 557, 567, 571, 572
Akt Ligjor	331, 557
Aktvendim për Papranueshmëri	11, 12, 34, 35, 41, 42, 48, 49, 56, 57, 62, 63, 69, 70, 79, 80, 83, 85, 86, 91, 94, 95, 99, 101, 102, 106, 114, 115, 120, 121, 133, 134, 138, 140, 141, 146, 147, 153, 154, 156, 157, 161, 162, 164, 165, 168, 170, 171, 178, 179, 186, 187, 190, 191, 193, 194, 200, 201, 207, 208, 214, 216, 217, 221, 224, 225, 240, 241, 248, 249, 253, 255, 256, 261, 269, 270, 274, 276, 277, 282, 283, 287, 288, 290, 291, 295, 298, 299, 304, 305, 308, 311, 319, 320, 326, 327, 331, 333, 334, 337, 340, 341, 347, 348, 355, 356, 360, 362, 363, 368, 370, 371, 379, 387, 389, 390, 395, 396, 406, 407, 412, 432, 433, 435, 436, 438, 439, 444, 446, 447, 4450, 453, 454, 459, 463, 464, 468, 472, 473, 477, 479, 480, 485, 488, 489, 495, 498, 499, 508, 509, 516, 517, 520, 521, 524, 525, 529, 531, 532, 539, 544, 545, 550, 552, 553, 557, 560, 561
Aksident	18, 19, 22, 23, 24, 25, 30, 142, 440, 510
Alimentacion	248, 250, 253

Amandament 290
Ankesë kushtetuese 75, 78, 178, 184, 415, 416, 423
Avokat 21, 35, 42, 63, 70, 76, 86, 102, 109, 126, 134, 141, 147, 208, 212, 217, 226, 241, 242, 243, 249, 250, 277, 283, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 312, 321, 327, 348, 363, 372, 390, 439, 447, 454, 464, 489, 499, 501, 505, 509, 532, 545, 561
Avokati i Popullit 226

B

Barazia para Ligjit 27, 75, 94, 114, 115, 118, 126, 129, 133, 134, 136, 156, 157, 171, 174, 186, 187, 189, 190, 207, 208, 212, 241, 244, 255, 259, 290, 292, 293, 311, 312, 314, 378, 379, 384, 415, 421, 430, 446, 447, 451, 453, 454, 469, 499, 508, 509, 516, 517, 519, 524, 525, 539, 540, 541, 544, 545, 548, 552, 553
Bashkësi fetare 11, 14
Baza Juridike 12, 21, 35, 42, 45, 49, 57, 63, 71, 76, 80, 87, 96, 102, 109, 115, 121, 126, 134, 141, 148, 157, 167, 171, 179, 187, 194, 201, 204, 208, 217, 226, 241, 249, 257, 265, 270, 271, 283, 291, 299, 305, 313, 320, 327, 334, 341, 348, 356, 363, 371, 379, 390, 397, 407, 416, 421, 433, 439, 447, 455, 464, 474, 480, 490, 499, 509, 517, 525, 532, 540, 545, 553, 561, 571
Borxhi kontestues 18, 25, 30

D

Deputetët 226, 227, 228, 229, 233, 234, 235, 236
Dëshmitar 135, 159, 213, 251, 372, 382, 383, 384, 386, 387, 498, 501, 502, 503, 504, 505, 510
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) 85, 86, 89, 90, 91, 207, 208, 212, 214, 283, 305, 307, 385, 387, 499, 502

DH

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme 41, 43, 44, 74, 76, 96, 98, 116, 202, 349, 414, 416, 417, 418, 420, 421, 422

E

E Drejta
e pronës 29, 103, 104, 276, 329, 333, 338, 349, 350, 351, 352, 370, 373, 374
e qasjes në dokumente publike 479, 480, 484
për pension 167, 178
për kompensim 27, 216, 552
për gjykim të drejtë dhe të paanshëm 16, 21, 27, 28, 32, 33, 42, 45, 48, 49, 57, 74, 75, 85, 86, 89, 90, 94, 95, 101, 102, 104, 108, 109, 110, 140, 143, 156, 170, 171, 174, 186, 187, 189, 190, 200, 201, 204, 207, 208, 212, 216, 217, 220, 240, 241, 244, 255, 256, 259, 265, 282, 283, 286, 287, 290, 292, 304, 305, 311, 312, 314, 315, 326, 327, 355, 356, 358, 359, 362, 363, 366, 368, 370, 373, 375, 378, 379, 384, 395, 397, 406, 407, 410, 411, 412, 414, 415, 421, 430, 438, 439, 442, 443, 446, 447, 449, 451, 453, 454, 456, 457, 458, 463, 464, 467, 469, 479, 472, 479, 480, 484, 492, 494, 498, 499, 502, 508, 509, 512, 516, 517, 519, 524, 527, 531, 544, 545, 548, 552, 553, 560, 561
për proces të rregullt 140, 146, 259
për zgjidhje efektive 48, 49, 75, 97, 146, 147, 290, 292, 305, 415, 454, 525
e punës dhe ushtrimit të profesionit 79, 80, 109, 110, 121, 156, 157, 178, 269, 270, 273, 274, 470, 489, 492, 552, 553
zgjedhore dhe e pjesëmarrjes 516, 517, 519
për mjete juridike 48, 49, 62, 63, 65, 75, 94, 95, 146, 147, 290, 292, 304, 305, 311, 312, 314, 341, 342, 355, 356, 359, 378, 379, 384, 415, 421, 430, 454, 517, 519

Ex officio 137, 267, 563

F

Fond 25, 79, 81, 83, 178, 180, 181, 182, 183, 184, 188, 189, 414

G

Gazeta Zyrtare e Kosovës 88, 448

Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 151, 448

GJ

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) 31, 46, 53, 67, 83, 91, 98, 99, 106, 118, 123, 137, 152, 153, 161, 162, 168, 175, 184, 190, 191, 198, 213, 214, 221, 244, 245, 246, 253, 261, 274, 280, 288, 295, 302, 309, 331, 337, 338, 344, 352, 360, 368, 386, 387, 393, 403, 412, 424, 427, 428, 429, 443, 444, 450, 459, 460, 468, 469, 477, 485, 486, 495, 496, 506, 513, 519, 520, 521, 528, 529, 536, 537, 550, 556, 557, 567, 575

Gjykata Komunale
- *në Gjakovë* 96, 349
- *në Ferizaj* 534
- *në Prishtinë* 149, 150, 158, 188, 218, 269, 271, 272, 278, 319, 322, 408, 409, 495
- *në Prizren* 284, 372, 459
- *në Pejë* 483
- *në Vushtrri* 395, 399, 400
- *në Suharekë* 392
- *në Skenderaj* 103

Gjykata e Qarkut
- *në Gjilan* 426
- *në Prishtinë* 58, 149, 150, 409, 502
- *në Pejë* 483
- *në Prizren* 392

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë 23

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës 21, 52, 86, 95, 102, 134, 141, 144, 147, 171, 179, 208, 217, 225, 241, 334, 341, 348, 356, 379, 433, 454, 489, 512, 517, 561, 571

Gjykata Supreme e Kosovës 16, 17, 18, 19, 24, 25, 28, 29, 30, 37, 65, 89, 101, 104, 105, 120, 133, 136, 146, 156, 181, 186, 189, 196, 200, 216, 219, 222, 240, 243, 248, 251, 252, 255, 259, 362, 370, 373, 378, 382, 385, 400, 426, 438, 442, 443, 479, 483, 493, 498, 501, 502, 544, 549, 560, 563, 566

Gjyqtar raportues 21, 35, 50, 58, 64, 71, 76, 96, 100, 103, 110, 116, 122, 127, 135, 141, 148, 158, 166,

172, 180, 188, 194, 202, 218, 250, 266, 271, 278, 284, 292, 300, 306, 313, 321, 328, 335, 349, 364, 372, 380, 391, 398, 408, 416, 434, 440, 448, 455, 465, 474, 481, 490, 500, 510, 518, 526, 533, 541, 554, 562

I

Imunitet 125, 126, 127, 129, 226, 229
Inter alia 23, 24, 27, 91, 97, 149, 151, 166, 175, 210, 232, 235, 245, 333, 335, 336, 360, 381, 382, 397, 460, 496, 504, 546, 547, 5554, 556

J

Juridiksion 14, 111, 153, 193, 197, 214, 219, 221, 231, 316, 337, 387, 421, 423, 476, 484, 550

K

Kërkesë e paafatshme 56, 120, 389, 479
Kërkesë e parakohshme 94, 395, 516
Kërkesë e papranueshme 56, 85, 94, 432, 488
Kërkesë e pranueshme 74, 414
Kërkesë individuale 11, 16, 34, 41, 48, 56, 62, 69, 74, 79, 94, 101, 108, 114, 120, 125, 133, 140, 146, 156, 164, 170, 178, 186, 193, 200, 207, 216, 240, 248, 255, 264, 269, 276, 282, 298, 304, 311, 319, 326, 333, 340, 347, 355, 362, 370, 389, 395, 406, 414, 432, 438, 446, 453, 463, 472, 479, 488, 498, 508, 516, 524, 531, 539, 544, 552, 560, 570
Kërkesë qartazi e pabazuar 34, 85, 114, 133, 140, 156, 186, 200, 248, 255, 282, 326, 333, 362, 370, 438, 453, 488, 524, 531, 544, 560
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë 50, 53, 243, 306, 307, 400, 453, 460, 560, 563, 565
Kërkesë e bashkuar 470, 479
Kërkesë jo e plotë 323, 542
Kërkesë pa objekt 125, 570
Kërkesë për rishqyrtim 6, 88, 108, 109, 259, 365

Këshilli
i Pavarur Mbikëqyrës (KPMK) 120, 122, 256, 269, 271, 273, 274
Gjyqësor i Kosovës (KGJK) 364, 365, 366, 367

Prokurorial i Kosovës 9, 58, 134, 135, 137, 158, 210, 211, 333, 334, 335, 336, 337, 378, 380, 381, 383, 473, 474, 476, 501, 510, 513, 516, 517, 518, 519, 521, 522, 563, 566
Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme 69, 71, 74, 201, 203, 204, 414, 422, 552
Kolegji shqyrtues 13, 22, 36, 43, 50, 58, 64, 71, 81, 87, 92, 96, 103, 110, 116, 122, 131, 135, 142, 148, 158, 166, 172, 180, 188, 195, 202, 209, 218, 226, 237, 242, 246, 250, 257, 266, 271, 278, 284, 292, 300, 306, 317, 321, 324, 328, 335, 342, 345, 349, 357, 364, 372, 380, 391, 398, 408, 417, 434, 440, 448, 461, 465, 474, 481, 482, 490, 500, 510, 518, 526, 533, 541, 546, 554, 562, 567
Konfiskim 380, 381, 382, 384
Kontratë
e punës 122, 269, 271, 274, 490, 491, 493, 518
për dhuratën 96, 347, 349, 372
për shitblerje 69, 71, 282, 284, 285

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 56, 60, 160, 210, 243, 380, 381, 382, 384, 456, 459, 501, 511, 512, 513, 514, 524, 528, 529, 562
Kodi Penal i Kosovës (KPK) 58, 158, 210, 211, 378, 380, 381, 383, 501, 510, 513, 517, 518, 519, 521, 522, 563, 566
Komuna e
Deçanit 418, 420, 421, 429
Graçanicës 447
Ferizajit 532
Kaçanikut 109
Prishtinës 122, 195, 439
Prizrenit 201, 474
Pejës 356
Podujevës 299, 540
Suharekës 91, 92, 165, 187, 390, 392
Vushtrrisë 8, 80, 395, 396, 397, 399
Shtërpcë 134
Dragash 305
Lipjan 320
Fushë Kosovë 407

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore 135
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

(KPMM) 48, 50, 51, 52, 53, 88, 546, 547, 548, 549, 550

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 17, 27, 48, 49, 63, 69, 71, 75, 94, 95, 97, 102, 104, 147, 152, 157, 171, 204, 208, 241, 244, 256, 277, 283, 290, 292, 305, 352, 371, 379, 384, 407, 414, 415, 422, 427, 431, 464, 472, 473, 475, 480, 488, 489, 499, 502, 509, 517, 519, 525, 536, 552, 553, 561, 564

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) 83, 180, 181, 182, 184, 406, 408, 409, 410, 411, 412, 438, 441, 442

Kompensim 17, 18, 19, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 37, 83, 184, 186, 187, 188, 212, 216, 217, 218, 219, 221, 258, 278, 279, 313, 315, 331, 351, 374, 389, 395, 398, 399, 409, 410, 412, 424, 438, 440, 441, 491, 552, 554, 556, 557

Krime lufte 498, 501

Kryeministri i Republikës së Kosovës 226

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës 226, 227, 228, 229, 230, 234, 292

Kuvendi i Republikës së Kosovës 229, 230, 233, 290, 294, 295, 350, 448, 518

Kundërvajtje 195, 196

Kthim në gjendjen e mëparshme (restitutio in integrum) 298, 533

L

Legjitimiteti aktiv 22, 418

Legjitimiteti pasiv 188, 189, 191, 406, 410, 411, 412, 438, 441, 442

Lëndim i rëndë trupor 453

Ligji

i Punës 151

për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës 419, 449

për Gjykatat 195, 196, 258

për Gjykatën Kushtetuese 11, 12, 21, 35, 41, 42, 49, 57, 62, 63, 69, 71, 76, 80, 87, 96, 102, 109, 115, 121, 126, 134, 148, 158, 165, 171, 179, 187, 193, 194, 201, 209, 217, 226, 241, 249, 257, 265, 269, 270, 277, 283, 291, 299, 305, 313,

320, 327, 334, 340, 341, 347, 348, 407, 416, 433, 439, 447, 455, 464, 474, 481, 490, 499, 509, 517, 525, 532, 540, 546, 553, 561, 571
për Konfliktet Administrative 90
për Marrëdhëniet e Detyrimeve 27, 38, 218, 448, 449, 450
për Procedurën Kontestimore 36, 143, 300, 343, 344, 392, 399, 401, 409, 441, 535
për Procedurën jokontestimore 329
për Procedurën Përmbarimore 358, 401
për Policinë 380
mbi Qarkullimin 351, 448, 450
mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit 234

Liria e shprehjes 479, 480, 484

M

Marrje e ryshfetit 207, 209, 210, 211
Masa e Përkohshme 67, 77, 78, 92, 176, 236, 237, 285, 311, 319, 324, 345, 353, 404, 416, 423, 461, 516
Mbrojtja
Gjyqësore e të Drejtave 34, 35, 39, 75, 94, 101, 102, 104, 141, 144, 156, 157, 164, 207, 212, 240, 241, 244, 248, 249, 251, 255, 259, 290, 292, 304, 305, 311, 312, 314, 315, 355, 356, 359, 378, 379, 384, 415, 421, 430, 488, 489, 492, 508, 509, 516, 517, 519, 524, 525, 544, 545, 548
e Pronës 27, 28, 29, 32, 42, 45, 74, 75, 85, 86, 89, 94, 95, 101, 102, 104, 133, 134, 136, 170, 171, 174, 248, 249, 251, 277, 282, 304, 305, 311, 312, 314, 326, 327, 336, 348, 351, 352, 355, 371, 373, 374, 375, 389, 390, 414, 415, 421, 430, 446, 447, 451, 479, 480, 484
Mendim mospajtues 5, 17
Ministria (ministri)
e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 122,
e Drejtësisë 319, 322,
e Punës dhe Mirëqenies Sociale 6, 164, 165, 167, 168, 188, 269, 271
e Punëve të Brendshme 259, 465
e Tregtisë dhe Industrisë 172, 174

Mos zbulim i identitetit 340, 341, 342, 345, 346

Mutatis mutandis 46, 53, 67, 83, 99, 106, 161, 168, 175, 184, 190, 198, 214, 221, 245, 253, 302, 316, 337, 344, 352, 368, 375, 386, 387, 403, 423, 427, 435, 450, 468, 469, 485, 506, 521, 529, 550, 567

N

Ndërmarrje Shoqërore 8, 41, 43, 200, 202, 349, 350, 421, 432, 433, 571
Ndalimi i diskriminimit 259, 260, 525
Ndalimi i Torturës 156, 157
Ne bis in idem 156, 159, 160

P

Palët/Pala e Autorizuar/a 28, 167, 231, 260, 287, 290, 294, 295, 315, 411, 424, 425, 426, 429, 442, 466, 493
Palë e tretë 142, 524, 526, 529
Parashkrim 101, 103, 104, 105, 221, 286, 333, 336, 337, 349
Parashkrim fitues (usucapio) 103, 104
Parashtruesi i kërkesës 5, 7, 8, 9, 11, 12, 14, 17, 18, 19, 21, 22, 23, 24, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 34, 35, 36, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 58, 62, 63, 64, 65, 66, 70, 75, 79, 80, 81, 82, 83, 86, 95, 102, 103, 104, 105, 106, 109, 114, 115, 116, 117, 118, 121, 122, 126, 130, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 141, 142, 143, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 157, 158, 159, 160, 161, 165, 166, 167, 168, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 176, 179, 181, 182, 184, 186, 187, 189, 190, 191, 194, 197, 201, 202, 203, 204, 208, 209, 210, 212, 213, 214, 217, 218, 219, 220, 225, 240, 241, 243, 244, 245, 249, 252, 256, 260, 265, 266, 267, 270, 273, 277, 279, 289, 283, 284, 285, 286, 287, 288, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 299, 300, 301, 302, 304, 305, 306, 307, 308, 311, 312, 316, 320, 322, 327, 329, 333, 334, 336, 337, 338, 341, 348, 351, 355, 356, 357, 358, 359, 362, 363, 364, 365, 366, 367, 368, 371, 374, 379, 385, 390, 391, 392, 393, 396, 397, 400, 401, 406, 407, 408, 410, 411, 412, 415, 418, 421, 422, 423, 424, 425, 429, 432,

433, 434, 435, 439, 443, 443, 447, 449, 453, 454, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 464, 472, 473, 474, 475, 476, 477, 480, 481, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 498, 499, 500, 502, 503, 505, 506, 508, 509, 510, 511, 512, 517, 518, 519, 520, 521, 525, 525, 526, 527, 528, 529, 531, 532, 534, 535, 536, 537, 539, 540, 541, 542, 545, 549, 552, 553, 554, 555, 556, 557, 558, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 566, 567, 571, 575

Parimet e Përgjithshme 29, 48, 49, 85, 86, 89, 90, 95, 193, 194, 197, 266, 341, 342, 397, 545, 548, 549, 552, 553, 557

Parimi i subsidiaritetit 53, 62, 66, 94, 98, 99, 114, 164, 168, 213, 302, 309, 316, 344, 375, 403, 477, 521

Pension 79, 81, 82, 83, 167, 178, 180, 182, 183, 188, 202

Person Juridik 27, 293, 441

Përsëritje e kërkesës 539, 542

Pranueshmëria e kërkesës 13, 28, 37, 44, 52, 59, 66, 72, 82, 89, 97, 105, 111, 117, 123, 129, 136, 143, 152, 160, 167, 174, 183, 197, 203, 212, 220, 231, 252, 260, 266, 273, 279, 287, 301, 308, 314, 322, 392, 336, 343, 351, 358, 367, 373, 385, 393, 410, 435, 442, 457, 466, 475, 484, 493, 503, 512, 520, 527, 535, 541, 564, 574

Pretendim 18, 24, 30, 37, 137, 161, 173, 175, 190, 193, 197, 251, 261, 274, 286, 322, 331, 360, 383, 418, 450, 451, 456, 459, 460, 468, 469, 477, 485, 494, 495, 505, 537, 550, 567

Presidenti i Republikës së Kosovës 225, 227, 232, 233

Prima facie 38, 39, 45, 67, 82, 92, 114, 117, 118, 131, 136, 137, 140, 160, 170, 174, 175, 176, 190, 204, 213, 216, 220, 232, 236, 240, 246, 260, 273, 311, 317, 319, 323, 324, 326, 330, 331, 345, 347, 351, 352, 353, 411, 443, 450, 458, 461, 467, 493, 503, 522, 528, 536, 537, 556, 557, 560, 564, 567, 568

Procesi i privatizimit 432, 573

Procedurë penale 56, 384, 498, 508, 524

Procedurë civile 16, 85, 94, 108, 488

Procedura disiplinore 11, 13, 151, 158, 307, 408
Prokuror
Prokurori Publik 58, 158, 455
Prokurori i Shtetit 50, 53, 240, 243, 245, 395, 402, 500, 502, 563, 565
Paluajtshmëri 90, 92, 142, 285, 372

Q

Qeveria e Republikës së Kosovës 295, 311, 313, 314, 315, 316, 317, 417

R

Ratione materiae 11, 14, 290, 295, 508, 513, 514
Rendi juridik i Kosovës 53, 99, 168, 245, 302, 309, 316, 344, 403, 432, 436, 477, 521
Regresim 18, 23, 25, 30
Res Judicata 74, 414, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 429, 431
Revizion 18, 24, 27, 29, 30, 34, 36, 37, 39, 65, 82, 101, 104, 105, 120, 122, 146, 149, 151, 152, 181, 183, 186, 187, 189, 216, 219, 248, 251, 252, 279, 282, 283, 286, 370, 373, 375, 392, 409, 410, 438, 441, 443, 463, 464, 466, 467, 469, 479, 483, 491, 492, 494, 535, 537, 540, 541
Rigjykim 44, 65, 88, 89, 159, 243, 251, 279, 286, 392, 409, 410, 424, 457, 459, 491, 501, 512, 562, 565
Rrethanë lehtësuese 456, 459

S

Seancë dëgjimore 45, 109, 112, 220, 225, 230, 237, 480, 482, 486, 507
Subrogim 16, 26, 27
Sundimi i Ligjit 427
Suspendim (Pezullim) 74, 98, 142, 149, 150, 322, 397, 404, 518, 548

SH

Shërbimi Policor i Kosovës 465

U

UNMIK-u (Rregulloret) 13, 116, 117, 148, 149, 150, 152, 180, 181, 182, 202, 203, 204, 300, 365, 401, 409, 417, 418, 419, 420, 421, 556

V

Vepër penale 59, 127, 159, 211, 319, 321, 381, 382, 383, 384, 454, 504, 517, 429, 562, 563

Vlerësim i

Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit 5, 6, 7, 8, 9, 16, 17, 34, 56, 63, 69, 79, 80, 85, 86, 99, 101, 102, 121, 133, 134, 140, 157, 168, 186, 187, 194, 217, 248, 249, 255, 256, 276, 277, 282, 283, 304, 305, 319, 320, 333, 340, 341, 347, 362, 363, 370, 378, 403, 406, 407, 438, 439, 446, 447, 453, 454, 463, 464, 472, 479, 480, 498, 499, 532, 544, 545, 553, 560, 561, 570, 571

i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit 5, 6, 7, 9, 11, 12, 39, 41, 42, 46, 48, 49, 62, 94, 95, 118, 125, 126, 141, 147, 170, 171, 193, 204, 241, 269, 270, 298, 299, 326, 327, 331, 352, 390, 488, 489, 524, 525, 537, 539, 540, 557

Z

Zgjedhja e presidentit 224, 225, 226, 229, 232, 235

Zhdëmtim 18, 23, 24, 25, 27, 30

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni Titulli/Emërtimi **Numri i faqes**

KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE

5 Gjuhët 472, 473, 475
7 Vlerat 259, 545, 548

KAPITULLI II
TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

21 Parimet e përgjithshme 48, 49, 85, 86, 89, 94, 95, 193, 197, 341, 342, 397, 545, 548, 549, 552, 553, 557
24 Barazia para ligjit 27, 75, 94, 95, 114, 115, 118, 126, 129, 133, 134, 136, 156, 157, 171, 174, 186, 187, 189, 190, 207, 208, 212, 241, 244, 255, 259, 290, 292, 293, 311, 312, 314, 378, 379, 384, 415, 421, 430, 446, 447, 451, 453, 454, 469, 499, 508, 509, 516, 517, 519, 524, 525, 539, 540, 541, 544, 545, 548, 552, 553
29 E drejta e lirisë dhe sigurisë 187, 189, 190
31 E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm 27, 28, 32, 33, 42, 45, 48, 49, 74, 75, 85, 86, 89, 94, 101, 102, 104, 108, 109, 110, 140, 143, 156, 170, 171, 174, 186, 187, 189, 190, 200, 201, 204, 207, 208, 212, 216, 217, 220, 240, 241, 244, 255, 256, 259, 265, 282, 283, 290, 292, 304, 305, 311, 312, 314, 326, 327, 355, 356, 359, 362, 368, 370, 378, 379, 384, 395, 406, 415, 421, 439, 447, 451, 454, 464, 469, 480, 480, 499, 509, 516, 517, 519, 525, 544, 545, 548, 552, 553, 561
32 E drejta për mjete juridike 48, 49, 62, 63, 65, 75, 94, 95, 146, 147, 292, 305, 311, 312, 314, 341,

342, 355, 356, 359, 379, 384, 415, 421, 430, 517
39 Konfesionet fetare 13
46 Mbrojtja e pronës 27, 28, 29, 32, 42, 45, 75, 85, 86, 89, 94, 95, 102, 104, 134, 136, 171, 174, 249, 251, 277, 305, 311, 312, 314, 326, 327, 336, 348, 352, 374, 390, 415, 421, 430, 447, 480, 484
49 E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit 80, 109, 110, 121, 156, 157, 269, 270, 273, 274, 470, 489, 492, 552, 553
53 Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut 29, 95, 102, 104, 352, 447, 460
54 Mbrojtja gjyqësore e të drejtave 34, 35, 39, 75, 95, 102, 104, 144, 156, 157, 207, 208, 212, 241, 249, 251, 255, 259, 292, 305, 311, 312, 314, 355, 356, 359, 379, 384, 415, 421, 430, 489, 492, 509, 516, 517, 519, 525, 544, 545, 548

KAPITULLI IV
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

64 Struktura e Kuvendit 229
75 Imuniteti 127

KAPITULLI V
PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

86 Zgjedhja e presidentit 225, 232, 235

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102 Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor 48, 49, 193, 194, 197, 341, 342, 552, 553, 557

SHKELJE TË NENIT 24, 31, 32, 46, 54 TË KUSHTETUTËS

24	Barazia para Ligjit	415, 431
31	E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	33, 415, 431
32	E Drejta për Mjete Juridike	415, 431
46	Mbrojtja e Pronës	415, 431
54	Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave	415, 431